RAPORTI PËRFUDIMTAR I AUDITIMIT
"Mbi auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë në Bashkinë Mat"

Tiranë, tetor 2026

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**1-4**
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit....	**4-6**
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	**4-6**
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	**4-6**
II.	**HYRJA**	**6-7**
1.	Objektivat dhe qëllimi	**7-7**
2.	Identifikimi i çështjes.....	**7-7**
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	**7-8**
4.	Përgjegjësitë e audituesve.....	**8-8**
5.	Kriteret e vlerësimit.....	**8-8**
5.	Standardet e auditimit.....	**8-9**
7.	Metodat e auditimit.....	**9-9**
8.	Dokumentimi i auditimit.....	**9-9**
III	**PËRSHKRIMI AUDITIMIT**	**11-105**
	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	**10-11**
1.1	Auditimi mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.	**11-22**
2.1	Auditimi mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.	**23-29**
2.5	Vlerësimi dhe mbledhjes së të ardhurave	**29-39**
3	Mbi vlerësimin e raportimit financiar, plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike	**39-52**
4	Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik	**52-107**
4.4	Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve	**108-136**
5	Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit	**137-141**
6	Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore	**142-145**
7	Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e Pronës Publike	**145-148**
8	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	**149-155**
IV	**REKOMANDIME**	**155-167**

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*) ushtron auditim financiar dhe perputhshmerie në Bashkinë Mat, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me vlerësimin e implementimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, veprimtarisë së sektorit të auditimit të brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, transaksioneve financiare dhe ngjarjeve ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar.

Auditimit u krye nga data 16.02.2026 deri në datën 29.06.2026, në subjektin Bashkia Mat, për periudhën objekt auditimi financiar nga data 01.01.2025 deri në 31.12.2025 dhe të përputhshmërisë nga data 01.01.2023 deri në datën 31.12.2025.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, janë mbajtur gjithsej 17 akt-konstatime dhe 1 akt verifikime të cilat janë protokolluar në subjekt me 29.06.2026.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e qeverisjes vendore" nenit 50 "Auditi i jashtëm" pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: "*1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose audituesë të tjerë ligjorë".* Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Mat si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2025. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Mat. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- *mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.*
- *mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.*
- *mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve*
- *mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.*
- *mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit, Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).*
- *mbi zbatimin i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.*

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. **Nga shqyrtimi i evidencave**, rezultoi se institucioni për periudhën nénauditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 26 gjetje dhe ka dhënë 28 rekomandime, nga ku masa organizative me 16 gjetje dhe 18 rekomandime, 6 gjetje dhe 6 rekomandime në masën shpërblim dëmi në vlerën 6,117,898 lekë si dhe 4 gjetje dhe rekomandime në fushën e të ardhurave në vlerën 127,841,547 lekë.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

-Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave

- Mos nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët dhe në vijim të ndjekë të gjitha rrugët ligjore në rend shterues, për arkëtimin e detyrimeve debitore në vlerën **61,535,540 lekë** nga subjektet e biznesit dhe taksapaguesit familjarë, si dhe të bashkëpunojë me Drejtorinë e Financës për kontabilizimin e debitoreve në mbyllje të vitit 2025;

-Të ardhura të munguara nga taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet në vlerën **3,699,795 lekë**, në fund të vitit 2025;

- Në Bashkinë Mat ushtrojnë aktivitet të tregtimit të karburanteve me seli në territorin e Bashkisë Mat, 2 subjekte që nuk kanë likuiduar vlerën e plotë të detyrimeve duke mbetur debitorë në shumën 600,000 lekë në papajtueshmëri me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" neni 22, pika 3, germa "dh" me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, neni 35;

-Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për taksapaguesit e kategorisë "familjar" rezultoi se debitorët për këtë kategori në fund të vitit 2025 janë në shumën 62,006,212 lekë, i cili nga viti në vit ka ardhur duke u rritur edhe pse nga DTTV janë dërguar njoftim-pagese drejt 5226 familjeve debitore. Kështu në fund të vitit 2024 debitorët familjarë ishin në shumën 43,562,163 lekë, gjatë vitit 2025 shuma e borxhit të krijuar është 18,444,049 lekë.

▪ **Procedurat e ndjekura për inventarizimin dhe regjistrimin e aseteve**

Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Bashkisë Mat dhe Njësit Administrative të kaluara me VKM-të përkatëse, Sektori i Lejeve, Licencave dhe Administrimit të Pronave Publike **nuk** ka bërë regjistrimin e tyre në ASHK, **nuk** janë inventarizuar, **nuk** disponohej informacion në lidhje me gjendje reale të këtyre pronave sa nga këto prona janë të zëna sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë, në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, me pika 26 dhe 27, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", si dhe të Ligjit nr. 20/2020, datë 05.03.2020, *"Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"*, neni 37, pika 1.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Kryetari i Bashkisë Mat të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **6,117,898 lekë pa TVSh**

Titullari i Bashkisë Mat të gjitha masat e menjëhershme duke i kërkuar ASHK-së Mat caktimin e një personi ekspert të fushës, që merret me Menaxhimin e Aseteve, me qëllim ngritjen e grupit të përbashkët për verifikimin dhe përditësimin e të gjitha pronave që ka Bashkia dhe NJA të transferuara në favor të tyre me VKM.

Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave në Bashkinë Mat, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifat vendore në fund të vitit 2025 në vlerën **61,535,540 lekë.**

Kryetari i Bashkisë Mat në cilësinë e Titullarit të AK të marrë masa që në komisionet e ngritura për hartimin e fondit limit të vendosen specialistë të fushës të pajisur me liçensat përkatëse.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit
A. OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinioni për auditimin e pasqyrave financiare[1]:

Ne kemi audituar, pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të Bashkisë Mat, për vitin ushtrimor 2025, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës, pasqyra e flukseve të mjeteve monetare, pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdoruara dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinioni:

Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit të pasqyrave financiare të subjektit Bashkia Mat janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e *"Bazës për Opinionin"*, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinioni të kualifikuar[2]**, e shprehur kjo në bazën për opinionin.

Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI.

Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti dhe në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, kemi përmbushur përgjegjësitë etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura duke marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 18,645 mijë lekë. Për këto arsye kemi dhënë **opinion të kualifikuar**, sipas përshkrimit të çështjeve të mëposhtme:

- Në pasqyrën e pozicionit financiar llogaria 231 *"Për aktive afatgjata materiale"* paraqitet në shumën 1,273,157,999 lekë, ndërsa në llogaritë kundërparti të saj në rubrikën "Fondin e konsoliduar" paraqiten në shumën 347,639,031 lekë si tepricë e llog. 105 *"Teprica e granteve kapitale të brendshme"*. Diferenca prej 925,518,968 lekë është keqklasifikuar në llogarinë 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar".*
- Referuar analizës dhe lëvizjeve të llogarisë 231 *"Për aktive afatgjata materiale"* u konstatua se pakësimet në shumën 398,592,705 lekë, e cila nuk kuadron me kapitalizimet në llogaritë e klasës 2 të paraqitur në pasqyrën *"Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata"* në shumën 382,209,312 me një diferencë në shumën 16,383,393 lekë.
- T**e**prica e llogarisë 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* në mbyllje të vitit 2025 është në vlerën 4,487,502,890 lekë, por nga përllogaritjet teprica e kësaj llogarie rezulton në vlerën 4,234,530,751 lekë, me një deviacion prej 252,971,539 lekë.
- Gjendja e llogarisë 7200 *"Grant korent i brendshëm nga buxheti për NJQP"* paraqitet në shumën 330,175,288 lekë, ndërsa sipas seksionit 1 "Akordim fonde buxhetore për shpenzime korente" paraqitet në shumën 738,510,054 lekë në pasqyrën e flukseve monetare, ndërkohë që sipas akrakordimit me thesarin fondet e akorduara për shpenzime korente janë në shumën 394,644,154 lekë.

[1] - Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së"*.

[2]- Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 "Për miratimin e manualit të auditimit financiar " të Kryetarit të KLSH-së, kapitulli VII, pika 7.3,5 faqe 54 "Opinion i Modifikuar, jepet në ato raste kur Pasqyrat Financiare përmbajnë gabime materiale, të cilat çojnë në ndryshim të rezultatit financiar,....."

- Gjendja e llogarisë 600 *'Paga, shpërblime e të tjera personeli"* për vitin 2025 paraqitet në shumën 112,967,198 lekë, ndërsa nga përllogaritja rezulton se në vlerën 113,947,057 lekë, duke u nënvlerësuar për vlerën 979,859 lekë. Po kështu gjendja e llogarisë 601 *'Kontribute për sigurime"* për vitin 2025 paraqitet në shumën 18,694,876 lekë, ndërsa nga përllogaritja rezulton në shumën 18,822,418 lekë, duke u nënvlerësuar për vlerën 127,542 lekë.
- Seksioni *"Shpenzime të tjera"* në mbyllje të vitit ushtrimor paraqitet në shumën 0 lekë, e cila nuk mund të jetë me këtë tepricë, pasi në seksionin *"Shpenzime të tjera"* evidentohen veprimet e korrigjimit të rezultatit, dhe llogaritë duhet të rakordojnë me llogaritë në pasqyrën e flukseve monetare, ku në të cilën tek rubrika "Transferta të tjera" llogaria "Transferime në buxhet të fondeve të pa përdorura" paraqitet në shumën 37,773,819 lekë dhe llogaria "Lëvizje e brendshme e transferta të tjera" paraqitet në shumën 404,322,017 lekë.

Pasaktësia e gjendjes së këtyre llogarive deformon rezultatin e veprimtarisë së vitit ushtrimor 2025, rrjedhimisht pozicionin financiar të subjektit në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, duke mos dhënë siguri edhe mbi tepricat e transaksioneve mbi të cilat është përgatitur pasqyra e flukseve monetar apo pasqyra e pozicionit financiar.

II. Opinioni mbi përputhshmërinë

Mbështetur në, ISSAI 4000 "Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë", Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit Bashkia Mat me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të këtij institucioni gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

"Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Mat, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar të përputhshmërisë".

Baza për dhënien e opinionit

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2025 së subjektit Bashkia Mat, në zbatim të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ISSAI 4000 dhe ISSAI 100, paragrafi 42 . Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 217, datë 15.11.2024, të Kryetarit të KLSH-së. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga Bashkia Mat dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa.

Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për përgatitjen e opinionit të kualifikuar.

Bashkia Mat nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

Nga auditimi i 11 procedurave të prokurimi me vlerë të lartë të zhvilluara në Bashkinë Mat për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2025, me fond limit 767,096 mijë lekë pa TVSh, u konstatuan parregullsi në argumentimin e kritereve të vendosur në DT.

- Në 2 procedura me vlerë totale të fondit limit 54,909 mijë lekë pa TVSh, u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK Bashkia Mat.

Në 6 (gjashtë) raste, rezultuan zëra pune të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, në vlerën 6,117,898 lekë pa TVSH, në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7, si dhe Kontratat përkatëse të zbatimit,

-Në një raste, dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë, pasi akt kontrollet sipas fazave të ndërtimit nuk janë përpiluar dhe dorëzuar elektronikisht sipas përcaktimeve ligjore.

I. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 152/1, datë 13.02.2026, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 16.02.2026 deri në datën 29.06.2026, në subjektin Bashkia Mat u krye "Auditimi Financiar për periudhën 01.01.2025 - 31.12.2025 dhe i Përputhshmërisë për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2025. Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:
1.H. I. – Përgjegjës Grupi
2.I. S.– Anëtar
3.M. M. – Anëtar
4.A. S. – Anëtar
5.A. Z. -.Anëtar

1. Objektivat e auditimit

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Mat kishte si objektiva kryesore:
- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)[3];
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

2. Qëllimi i auditimit

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Mat është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/ shërbimeve dhe investimeve.

3. Identifikimi i çështjes

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Mat dhe përgjegjësive, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.
Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:
1. Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Auditin e Brendshëm.

[3] *Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.*

2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
3. Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2025.
4. Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën 01.01.2023-31.12.2025.
5. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
6. Mbi organizimin dhe funksionimin e IMTV-së.
7. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM.
8. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Mat, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me në përputhje me kuadrin rregullator të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

6. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Mat është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kritereve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Mat. Burimet e kritereve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- Ligji nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme", i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit";
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative";
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore";
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël";

- "VKM nr. 187, datë 8.3.2017 për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit", i ndryshuar.
- VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj";
- VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik";
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura";
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 "Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve" i ndryshuar;
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore";
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar.
- Etj.

7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar në Bashkinë Mat grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë :
- ISSAI 100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik";
- ISSAI 200 "Parimet themelore të auditimit financiar".
- ISSAI 2200-2899 "Standardet e auditimit financiar";
- ISSAI 400 "Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë", që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 "Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë"; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

8. Metodologjia e auditimit

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna *"jashtë normales",* që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Mat me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale[4].

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH-ja aplikon[5].

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionit financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur*; dhe së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

[4] ISSAI 1315

[5] Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

Ky auditim u krye në zbatim të Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, dhe akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- Pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- Informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- Mbrojtjes së informacionit e të aktiveve;

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Mat si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij. Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të MFK-së nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e MFK-së kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm.

Konkluzioni në lidhje me vlerësimin e komponentëve të MFK-së në mënyrë të detajuar argumentohet si më poshtë:

Në lidhje me parimin 1 "Angazhimi për integritet dhe vlera etike".

-Mjedisi i kontrollit është pjesë përbërëse e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Ai siguron përcaktimin e objektivave për përmbushjen e misionit të institucionit, integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe të punonjësve të tjerë të njësisë publike; politikat menaxheriale dhe stilin e punës; strukturën organizative, ndarjen e detyrave, hierarkinë, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; si dhe politikat e praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

-Struktura organizative duhet të garantojë ndarjen e detyrave, rregulla të qarta, të drejta, përgjegjësi dhe linja raportimi.

-Në zbatim të kërkesave të nenit 20 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, Bashkia Mat funksionon bazuar në Rregulloren e Brendshme, miratuar me Urdhrin nr. 390, datë 21.06.2024. Referuar formatit të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, konstatohet se në pjesën që lidhet me Rregulloren e Brendshme të Njësisë Publike janë zbatuar dhe pasqyruar modelet dhe parimet e përcaktuara në këtë manual.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se Kodi i Etikës është përfshirë në Rregulloren e Brendshme.

-Nga verifikimi i Rregullores së Bashkisë Mat u konstatua se Drejtoria e Ekonomisë dhe të Ardhurave nuk është përditësuar me emërtesën e plotë sipas strukturës organizative për vitin 2025, miratuar me shkresën nr. 557 prot., datë 11.02.2025, konkretisht: Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Kontratave.

-Nga verifikimi i Rregullores së Bashkisë Mat u konstatua se Drejtoria e Mbrojtjes Civile dhe Pronave nuk është përditësuar me emërtesën e përcaktuar në strukturën organizative, konkretisht: Drejtoria e Mbrojtjes Civile.
-Nga verifikimi i Rregullores së Bashkisë Mat u konstatua se Drejtoria Juridike dhe e Taksave Vendore nuk është përditësuar sipas strukturës organizative, e cila e ka shkrirë këtë drejtori dhe ka krijuar Drejtorinë e Taksave Vendore dhe Drejtorinë e Integrimit Europian, Projekteve, Performancës dhe Çështjeve Juridike.
-Nga verifikimi i Rregullores së Bashkisë Mat u konstatua se Drejtoria e Kulturës, Artit dhe Muzikës, sipas strukturës organizative të miratuar për vitin 2025, është shkrirë dhe është bërë pjesë e sektorëve të Drejtorisë së Shërbimeve Komunitare.
Për sa më sipër, konstatohet mospërputhje ndërmjet sektorëve dhe drejtorive të përcaktuara në Rregullore dhe strukturës organizative për vitin 2025, miratuar me shkresën nr. 557 prot., datë 11.02.2025.
-Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. A. M., ish-Kryetar i Bashkisë Mat, dhe z. M. Z., ish-Kryetar i komanduar i Bashkisë Mat, emëruar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 22, datë 12.03.2025.
-Ankesat dhe kërkesat e paraqitura pranë Bashkisë Mat regjistrohen në Zyrën e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit dhe Marrëdhëniet me Publikun me një ndalesë. Më pas, ato përcillen në drejtoritë përkatëse dhe trajtohen brenda afateve të përcaktuara, në përputhje me ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014, "Për të drejtën e informimit", si dhe me urdhrin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore".
-Referuar ligjit nr. 152/2013, datë 17.10.2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, VKM-së nr. 109, datë 26.02.2014, "Për vlerësimin e rezultateve në punë", si dhe ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, çdo drejtori ka kryer vlerësimin gjashtëmujor të punonjësve të saj. Vlerësimi nënshkruhet nga zyrtari përgjegjës, nëpunësi përkatës dhe zyrtari i autorizuar.

Në lidhje me parimin nr. 2 "Titullari demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje".

-Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse, që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e Nëpunësit Autorizues dhe stafit menaxherial, janë parashikuar në Rregulloren e Brendshme dhe zbatohen në bazë të saj.
-Për vitin 2025, përveç Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Drejtorisë së Financës, nuk rezulton të jenë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës, si dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit/Nëpunësit Autorizues dhe Këshillit Bashkiak për realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Në Rregulloren e Brendshme është përcaktuar mënyra e hartimit, miratimit, ndjekjes dhe raportimit të realizimit të planeve mujore nga drejtorët në aparatin e Bashkisë, administratorët e njësive administrative dhe drejtorët e njësive të varësisë. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me paragrafin 3.1 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.
-Ekzistojnë raportë periodike dhe vjetore të monitorimit të buxhetit, të paraqitura pranë Këshillit Bashkiak, Nëpunësit Autorizues dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
-Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga Auditi i Brendshëm, nëpërmjet veprimtarisë audituese, si dhe nga Njësia e Harmonizimit në MFE.
-Këshilli Bashkiak, nëpërmjet vendimmarrjes dhe kompetencave të tij, ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së Bashkisë.
Në lidhje me parimin 3 "Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë".
-Për vitin 2026, Bashkia Mat ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me shkresën nr. 557 prot., datë 11.02.2025.
Sipas kësaj strukture, administrata e Bashkisë ka gjithsej 540 pozicione pune, nga të cilat 58 janë pjesë e shërbimit civil, ndërsa 482 rregullohen nga Kodi i Punës.

Në lidhje me parimin 4 "Njësia publike demonstron angazhimin në realizimin e kompetencave".

-Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Mat nuk ka hartuar një plan trajnimesh për personelin e institucionit, si dhe nuk kanë kryer trajnime të brendshme për vitin 2025 në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, paragrafi 3.1. Për sa më sipër mban përgjegjësi, z. G. P., Drejtor i Burimeve Njerëzore.

-Nga verifikimi i disa prej dosjeve të personelit, u konstatua si më poshtë:

-Nga dosja e personelit të Drejtorit të Financës, znj. D. T., u konstatua se mungonte raporti mjekësor për aftësinë në punë

-Nga verifikimi i dosjes së Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, z. A. G., u konstatua se mungon certifikata personale, lista e notave, si dhe libreza e punës.

-Nga verifikimi i dosjes së Drejtorit të Taksave Vendore, znj. S. C., u konstatua se mungon dëshmia e zotërimit të gjuhës së huaj, libreza e punës si dhe raporti i aftësisë në punë për vitin 2025

-Nga verifikimi i dosjes së Drejtorit të Drejtorisë Juridike z. E. A., u konstatua se mungon certifikata personale, raporti për aftësinë për punë, për vitin 2025, si dhe libreza e punës.

-Nga verifikimi i dosjes së Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, znj E. L. u konstatua se mungon raporti për aftësinë në punë, për vitin 2025

-Veprime në kundërshtim me pikën 3 të Kreut II, lidhjen 2 të VKM Nr. 833, datë 28.10.2020 Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit të regjistrit qendror të personelit.

-Për sa më sipër mban përgjegjësi përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore znj. E. B..

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, në Bashkinë Mat vijojnë të punojnë disa prej punonjësve, të cilët kanë plotësuar moshën për të dalë në pension. Informacioni si më poshtë vijon:

M. Z., datëlindja 26.09.1960. Në momentin e mbushjes së moshës për dalje në pension ushtronte detyrën e Kryetarit të Bashkisë, pastaj me marrjen e detyrës nga Kryetari aktual i Bashkisë është emëruar nga ana e tij në pozicionin e Zëvendëskryetarit të Bashkisë;.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se për z. Z., pasi ai është emëruar në pozicionin e zv. Kryetarit të Bashkisë, nuk është vijuar me procedurën e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, si rrjedhojë e plotësimit të viteve për daljen në pension. Veprime në kundërshtim me nenin 31 e vijues të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 64/g e vijues, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore.

-Për sa më sipër mban përgjegjësi, Drejtori i Burimeve Njerëzore z. G. P. dhe Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore, znj E. B..

2. M. S., datëlindja 12.05.1960. Pozicioni i punës: Administrator i Njësisë Administrative Burrel.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se z. S.i ka plotësuar vitet për daljen në pension

-Me shkresën me nr. 2494 prot datë 22.07.2025, Kryetari i komanduar Bashkisë Mat, z. M. Z., ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me z. Z., pas depozitimit të kërkesës së tij për dorëheqje.

-Në bazë të përllogaritjes së viteve në punë, si dhe informacionit që duhet të ishte vënë në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, do duhej të kishte filluar procedura e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës si rrjedhojë e plotësimit të viteve të daljes në pension.

Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me VKM-se Nr. 478, datë 16.06.2010 "Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, nga organet e administratës shtetërore, pas plotësimit të kushteve për pension pleqërie", të nenit 31 e vijues të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 64/g e vijues, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore.

-Për sa më sipër mban përgjegjësi, Drejtori i Burimeve Njerëzore z. G. P. dhe Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore, znj E. B..

3. H. R., datëlindja 14.11.1960. Pozicioni i punës: Punonjës i Taksave Vendore.
-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se me shkresën me nr. 4786 prot datë 31.12.2025, Kryetari i Bashkisë Mat, z. A. B. ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me z. H. R. me motivacionin: “Për plotësim të moshës për pensionin e plotë të pleqërise”.
-Për zbatimin e këtij urdhri janë caktuar Drejtori Financës, Sekretari i Përgjithshëm dhe Përgjegjës i Sektorit të burimeve njerëzore.
Rezulton se z. H. R. vijon të punojë në Bashkinë Mat.
-Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me nenin 31 e vijues të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 64/g e vijues, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore dhe Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Mat, z. A. B.. Për sa më sipër mban përgjegjësi Sekretari i Përgjithshëm, z. E. R., Drejtori i Financës znj. D. T. dhe Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore znj. E. B..
3. F. D., datëlindja 08.02.1964. Pozicioni i punës: Punonjës i shërbimeve mbështetëse dhe magazinimit, në Sektorin e Arkivit dhe Protokollit, në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Agjencinë e Funksioneve të Patransferueshme.
-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se me shkresën me nr. 4787 prot datë 31.12.2025, Kryetari i Bashkisë Mat, z. A. B. ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me znj. F. D. me motivacionin: “Për plotësim të moshës për pensionin e plotë të pleqërise”.
-Për zbatimin e këtij urdhri janë caktuar Drejtori i Agjencisë së Funksioneve të Patransferueshme, Sekretari i Përgjithshëm dhe Përgjegjës i Sektorit të burimeve njerëzore.
-Nga verifikim i listëpagesave për vitin 2025, rezulton se znj. F. D. vijon të punojë në Bashkinë Mat. Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me VKM-se Nr. 478, datë 16.06.2010 "Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, nga organet e administratës shteteëore, pas plotësimit të kushteve per pension pleqerie", të nenit 31 e vijues të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 64/g e vijues, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Mat, z. A. B.. -Për sa më sipër mban përgjegjësi Sekretari i Përgjithshëm, z. E. R., Drejtori i Agjencisë së Funksioneve të Patransfereueshme z. E. H. dhe Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore znj. E. B..
4. N. G., datëlindja 25.05.1964. Pozicioni i punës: Sekretare shkollë, në Shkollën e Mesme të Përgjithshme “28 Nëntori” Burrel, në Sektorin e Menaxhimit të
-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se me me shkresën me nr. 1875 prot datë 25.05.2026, Kryetari i Bashkisë Mat, z. A. B. ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me znj. N. G. me motivacionin: “Për plotësim të moshës për pensionin e plotë të pleqërise”.
-Për zbatimin e këtij urdhri janë caktuar Drejtori i Agjencisë së Funksioneve të Patransferueshme, Sekretari i Përgjithshëm dhe Përgjegjës i Sektorit të burimeve njerëzore.
Nga verifikim i listëpagesave, rezulton se znj. F. D. vijon të punojë në Bashkinë Mat.
-Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me nenin 31 e vijues të ligjit nr.7703, date 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore ne Republiken e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 64/g e vijues, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Mat, z. A. B.. -Për sa më sipër mban përgjegjësi Sekretari i Përgjithshëm, z. E. R., Drejtori i Agjencisë së Funksioneve të Patransfereueshme z. E. H. dhe Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore znj. E. B..
-Me shkresën me nr. 611 prot datë 13.02.2025 është miratuar Plani Vjetor për Pranimin në Shërbimin Civil nga ish Kryetari i Bashkisë Mat, z. A. M.,
-Për Bashkinë Mat në vitin 2025, Nëpunësi Autorizues ka qenë ish Kryetari i Bashkisë, z. A. M. dhe Kryetari i komanduar z. M. Z..
-Për vitin 2025, detyra e nëpunësit zbatues është mbuluar nga Drejtori i Financës , znj. D. T..
-Koordinatori i riskut për Bashkinë Mat, z. E. H. është caktuar në shkresën si më poshtë:
-Me shkresën me nr. 1223 prot, datë 11.04.2025, Kryetari i komanduar i Bashkisë Mat, z. M. Z. ka ngritur Grupin për Menaxhimin e Riskut për vitin 2025 me përbërje në përputhje me përcaktimet e legjislacionit për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

-Nuk dokumentohet realizimi i takimeve të GMS përgjatë vitit 2025, mosveprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe "Manualin për MFK" ku citohet se "Grupi për Menaxhimin Strategjik duhet të mblidhet të paktën katër herë në vit. Vendimet e Grupit duhet të merren në mënyrë kolegjiale dhe objektive duke patur në vëmendje interesin publik dhe nëpërputhje me standardet etike të sektorit publik. Vendimet e Grupit duhet të pasqyrohen në dokumentë dhe t'i vihen në dispozicion menaxhimit të njësisë", në kundërshtim me Udhëzimin nr. 16 të MFE, neni 4, pika 3, "Manuali MFK" Kreu II kap. 2.2.6. Për sa më sipër mban përgjegjësi Drejtori i Financës në Bashkinë Mat znj. D. T..

-Krijimi i ekipit të menaxhimit të programeve (EMP).

Me shkresën me nr. 239 prot, datë 09.04.2025, Kryetari i Bashkisë Mat ka ngritur Ekipin për Menaxhimin e Programeve.

II.Komponenti"Menaxhimi i Riskut"

Në lidhje me parimin 6: Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se është hartuar dhe miratuar regjistri i riskut për vitin 2025, për Bashkinë Mat, por nuk është protokolluar në Zyrën e Arkive/Protokollit. Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me nenin 13 të Normave Tekniko dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor Në Republikën e Shqipërisë e Shqipërisë.

-Për sa më sipër mban përgjegjësi koordinatori i riskut për Bashkinë Mat, z.. E. H., personi përgjegjës për hartimin e regjistrit të riskut, me detyrë Drejtori i Agjencisë së Funksioneve të Transferueshme.

Në lidhje me parimin 7: "Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave".

-Në Bashkinë Mat Drejtoria e Financës për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin Excel dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë.

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se nuk është miratuar gjurma e auditimit. Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. A. M., ish Kryetar i Bashkisë Mat dhe z. M. Z. me detyrë ish Kryetar i Komanduar i Bashkisë Mat. Në lidhje me parimin 8: "Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime".

-Me Urdhërin nr.657 datë 24.10.2016 "Për ngritjen e Strukturës Përgjegjëse për Sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve," ish Kryetari i Bashkisë Mat, z. N. R. ka ngritur Njësinë e Sinjalizimit për Bashkinë Mat.

-Me shkresën me nr. 2374 prot datë 17.07.2025, Kryetari i komanduar i Bashkisë Mat, z. M. Z. ka caktuar personin përgjegjës për raportimin pranë pikës së kontaktit antikorrupsion të Bashkisë Mat në lidhje me zbatimin e strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit, 2024-2030, konkretisht z. E. R., Gj. K., S. B. dhe E. A..

Në lidhje me parimin 9: "Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm".

-Bashkia Mat në politikat dhe procedurat e veprimtarisë së saj ka marrë vazhdimisht në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni, apo nga ndryshimet në menaxhim, duke marrë masa për t'i paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke përcaktuar apo deleguar e autorizuar detyrat në personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se nuk është hartuar dhe miratuar plani i përgjithshëm strategjik i zhvillimit (me afat 5 vjeçar) të Bashkisë Mat sipas përcaktimit në nenin 32 të Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore". Për veprimet dhe mos veprimet ngarkohet me përgjegjësi koordinatori i riskut z. E. H. dhe ish Kryetari i Bashkisë Mat z. A. M. dhe ish Kryetari i komanduar i Bashkisë Mat, z. M. Z..

III.Komponenti: " Aktivitetet e Kontrollit"

Në lidhje me parimin 10: "Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetë kontrolli".

-Bashkia Mat ka hartuar dhe miratuar hartën e proceseve të punës

-Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhornohet sa herë ka ndryshime fondesh. Ekzistojnë dosjet e procedurave të prokurimeve, ku gjurmën e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumenta autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj. -Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet.. Aktivet afatgjata dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet e këtyre aktiveve.

-Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet Bankave të nivelit të dytë në llogarinë e Thesarit për Bashkinë Mat.

-Bashkia Mat në bashkëpunim me Degën e Thesarit, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për çdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponilibiteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga Bashkia.

Në lidhje me parimin 11: "Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetë të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë".

-Mungon sistemi i IT dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up).

Në lidhje me parimin 12: "Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave".

-Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrolle dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedura janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësitë në të gjitha nivelet e Drejtorisë Financës.

IV. Komponenti: "Informimi dhe Komunikimi"

Në lidhje me parimin 13: "Njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor".

Bashkia Mat ka faqen e saj zyrtare në ëeb me adresë https://ëëë.bashkiamat.gov.al/ Mungojnë raportë periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

Në lidhje me parimin 14: Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal dhe shkresor. -Drejtuesit e institucionit (NA & NZ të të gjitha niveleve) kanë informacion të pamjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit. Ky konstatim edhe si rrjedhojë e mungesës së trajnimeve të brendshme për punonjësit e niveleve të ndryshme të këtij institucioni.

Në lidhje me parimin 15: Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm.

-Titullari informohet nga drejtuesit e programeve nëpërmjet mbledhjeve, raporteve dhe relacioneve të ndryshme. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejt me eprorët sipas shkallës hierarkike për probleme apo parregullsi, në rrugë shkresore/verbale/email.

V. Komponenti: "Monitorimi dhe Raportimi" Në lidhje me parimin 16: "Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme".

-Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, administrohen raportimet e drejtuesve të drejtorive përkatëse për përmbushjen e objektivave.

-Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet periodikisht. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me

monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efiçencës e të efektivitetit.
-Bashkia Mat lidhur me pyetësorin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe deklaratën e cilësisë, ka raportuar në MFE për vlerësimin e sistemve për vitin 2025 me shkresën me nr. 655 25.02.2026. Raporti i Cilësisë së Sistemeve të Kontrolli të Brendshëm paraqet problematikat në 5 komponenentët e MFK. Të pesta elementet e MFK janë trajtuar në Raport, së bashku me çfarë është menduar të zgjidhet dhe organet përgjegjëse për problematikat e caktuara. Në lidhje me parimin 17: "Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë". Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë".
-Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura janë bërë prezentë në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.
Me e-mailin e datës 01.07.2026, Drejtori i Drejtorisë së Financës, znj. D. T., paraqiti observacionet lidhur me konstatimet e pasqyruara në Aktkonstatimin nr. 1, datë 29.06.2026, për funksionin e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Me shkresën nr. 3194 prot., datë 04.09.2026, Bashkia Mat ka dërguar observacione lidhur me disa nga konstatimet e pasqyruara në Projekt-Raportin e Auditimit.

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me konstatimet e auditimit, Bashkia Mat kundërshton fillimisht pretendimin se nuk janë realizuar trajnime të brendshme, duke argumentuar se është zhvilluar të paktën një trajnim dhe se për të janë vënë në dispozicion dokumentet provuese. Bashkia pranon vetëm mungesën e një plani të formalizuar të trajnimeve, duke e konsideruar këtë një mangësi formale, e cila është adresuar për periudhën në vijim.

Sa i përket dosjeve të personelit, Bashkia e pranon konstatimin për mangësi dokumentare, por pretendon se këto mangësi janë korrigjuar për pothuajse të gjithë punonjësit dhe se vetëm një rast vijon të jetë në proces plotësimi. Për këtë arsye, kërkohet që veprimet korrigjuese të ndërmarra pas auditimit të merren në konsideratë.

Një nga kundërshtimet kryesore lidhet me bazën ligjore të përdorur nga grupi i auditimit për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës pas plotësimit të kushteve për pension. Bashkia Mat pretendon se duhet të sqarohet nëse VKM nr. 478, datë 16.06.2010, e cila i referohet organeve të administratës shtetërore, është e zbatueshme edhe për njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Subjekti kundërshton përgjegjësinë e Drejtorit dhe Përgjegjësit të Burimeve Njerëzore për vijimin e marrëdhënieve të punës të Zëvendëskryetarit dhe Administratorit të Njësisë Administrative. Subjekti pretendon se këta persona kanë statusin e funksionarëve politikë dhe se marrëdhënia e tyre e punës bazohet në raportin e besimit me Kryetarin e Bashkisë, ndaj nuk mund të trajtohen automatikisht sipas regjimit të përgjithshëm të punësimit dhe daljes në pension.

Bashkia argumenton se kompetenca për emërimin dhe shkarkimin e Zëvendëskryetarit dhe Administratorit i takon shprehimisht Kryetarit të Bashkisë dhe jo strukturës së Burimeve Njerëzore. Sipas këtij argumenti, Burimet Njerëzore kanë kompetencë për administrimin e të dhënave të personelit, evidentimin e rasteve dhe raportimin tek titullari, por jo për të marrë vetë vendimin për përfundimin e marrëdhënies së punës.

Bashkia pretendon më tej se Burimet Njerëzore e kanë përmbushur detyrimin e tyre për evidentimin dhe raportimin e punonjësve që plotësonin kushtet për pension, duke argumentuar se informacioni i është përcjellë titullarit në mënyrë të rregullt, përfshirë edhe komunikimet verbale. Për këtë arsye, sipas Bashkisë, përgjegjësia për mosndërprerjen e marrëdhënieve të punës nuk duhet t'i atribuohet vetëm Burimeve Njerëzore, por duhet të shqyrtohet edhe roli i eprorëve dhe hallkave të tjera drejtuese.

Për rastin e Zëvendëskryetarit M. Z., Bashkia argumenton se, në momentin kur ai plotësoi kushtet për pension, më 26.09.2025, ai ushtronte ende funksionin e Kryetarit të Bashkisë. Sipas pretendimit, ai e përfundoi mandatin si Kryetar më 09.12.2025 dhe, po në këtë datë, u emërua Zëvendëskryetar. Për rrjedhojë, vetëm fakti që kishte plotësuar moshën për pension nuk është i mjaftueshëm për të individualizuar përgjegjësinë e strukturave të Burimeve Njerëzore.

Në rastin e Administratorit të Njësisë Administrative, Bashkia pretendon se Burimet Njerëzore e kishin evidentuar dhe raportuar situatën, ndërsa vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës ishte

kompetencë e Kryetarit të Bashkisë. Si provë përmendet urdhri i Kryetarit nr. 2494 prot., datë 22.07.2025, i nxjerrë pas kërkesës për dorëheqje.
Bashkia kundërshton edhe konstatimin lidhur me punonjësin e Njësisë Administrative Derjan, H. R., duke pretenduar se ai nuk ka vijuar marrëdhënien e punës gjatë muajit qershor. Sipas Bashkisë, listë-prezenca e muajit qershor tregon se punonjësi ka pasur zero ditë pune dhe kjo paraqitet si provë kundër konstatimit të auditimit.
Sa i përket nenit 31 të Ligjit nr. 7703, Bashkia pretendon se kjo dispozitë përcakton kushtet për përfitimin e pensionit, por nuk përcakton Drejtorin apo Përgjegjësin e Burimeve Njerëzore si autoritet kompetent për shkarkimin e Zëvendëskryetarit apo Administratorit. Për rrjedhojë, sipas saj, referimi vetëm te kjo dispozitë nuk është i mjaftueshëm për individualizimin e përgjegjësisë.
Në lidhje me Rregulloren "Për përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të teknologjisë së informacionit", Bashkia kundërshton konstatimin se dokumenti nuk ishte i protokolluar dhe i verifikueshëm. Pretendohet se rregullorja është miratuar me Urdhrin nr. 363, datë 25.05.2022, dhe është protokolluar me nr. 2217 prot., duke e konsideruar këtë si provë se dokumenti ka qenë në fuqi dhe i rregullt nga pikëpamja formale. Ndërkohë, Bashkia pranon se ka mangësi të tjera në sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, të cilat kërkojnë përmirësim.
Për sa i përket konstatimit se Drejtori i Financës nuk është bërë pjesë e GMS-së, subjekti ka dërguar fizikisht shkresën nr. 6784 prot., datë 29.12.2023.
Në lidhje me konstatimin për mosmarrjen e masave administrative ndaj një punonjësi që kishte arritur moshën e pensionit, është paraqitur listë-prezenca e muajit qershor 2026 e Njësisë Administrative Derjan, në të cilën figuron z. H. R..
Për sa i përket konstatimit se Drejtori i Financës nuk është bërë pjesë e GMS-së, subjekti ka dërguar në rrugë postare shkresën nr. 6784 prot., datë 29.12.2023, me anë të së cilës Kryetari ka ngritur strukturën e GMS-së, duke përfshirë edhe Drejtorin e Financës.
Qëndrimi i grupit të auditimit:
Në lidhje me pretendimin se realizimi i një trajnimi të brendshëm provon përmbushjen e detyrimit për trajnimin e personelit, referuar një trajnimi me një temë jashtë karakterit të veprimtarisë së institucioneve vendore, grupi i auditimit vlerëson se ky trajnim nuk përmbush përcaktimet e Manualit për Menaxhimin Financiar, nëpërmjet të cilit synohet trajnimi i personelit për aftësimin e tyre në raport me aktivitetet dhe kompetencat e institucioneve vendore. Për sa i përket mos hartimit të një plani trajnimesh, subjekti e ka pranuar këtë mangësi, duke shprehur gatishmërinë për përmirësimin e veprimtarisë së Burimeve Njerëzore në të ardhmen.
Sa i përket mangësive në dosjet e personelit, pretendimi i Bashkisë, në fakt, konfirmon konstatimin e auditimit, pasi vetë subjekti pranon ekzistencën e mangësive dhe deklaron se ato janë plotësuar ose janë në proces plotësimi. Dokumentacioni i plotësuar pas periudhës së auditimit do të merret në shqyrtim nga grupet e ardhshme të auditimit.
Lidhur me vijimin e marrëdhënieve të punës të Zëvendëskryetarit dhe Administratorit të Njësisë Administrative, pretendimi kryesor i Bashkisë është se këta janë funksionarë politikë dhe se kompetenca për emërimin dhe shkarkimin e tyre i përket Kryetarit të Bashkisë. Grupi i auditimit nuk e kundërshton faktin që Kryetari i Bashkisë është autoriteti kompetent për emërimin dhe shkarkimin e këtyre funksionarëve. Megjithatë, kjo kompetencë nuk i përjashton këta funksionarë nga zbatimi i përcaktimeve të legjislacionit për marrëdhëniet e punës së punonjësit publik, si dhe nuk përjashton përgjegjësinë që kanë strukturat administrative të bashkisë për evidentimin e situatës së personelit, administrimin e dokumentacionit, njoftimin e autoritetit kompetent dhe ndjekjen e procedurave që burojnë nga kuadri ligjor dhe rregullator.
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion gjatë fazës së terrenit të auditimit në Bashkinë Mat, si dhe gjatë fazës së hartimit të Projekt-Raportit dhe Raportit të Auditimit, u konstatua se Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk ka zhvilluar letërkëmbim zyrtar me nëpunësin autorizues lidhur me statusin e punonjësve të cilët kishin mbushur moshën e pensionit dhe ligjshmërinë ose jo të mbajtjes së tyre në punë.
Sa i përket pretendimit për punonjësin e Njësisë Administrative Derjan, dokumentacioni i paraqitur, konkretisht listë-prezenca e muajit qershor 2026, nuk ndryshon konstatimin e auditimit lidhur me marrëdhënien e punës, pasi grupi i auditimit konstaton se punonjësi ka qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë Mat deri në fund të vitit 2025. Rrjedhimisht, dokumentacioni i paraqitur nga subjekti do të merret në shqyrtim në auditimet e ardhshme që do të kryhen në Bashkinë Mat.
Në lidhje me Rregulloren "Për përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të teknologjisë së informacionit", dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, konkretisht Urdhri nr. 363, datë 25.05.2022, dhe shkresa me

protokoll nr. 2217, datë 25.05.2022, të dërguara elektronikisht dhe në rrugë postare, me objekt "Miratimin e Rregullores për përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të teknologjisë së informacionit", provojnë miratimin dhe protokollimin e kësaj rregulloreje.
Për sa i përket pjesëmarrjes së Drejtorit të Financës në strukturën e GMS-së, grupi i auditimit, pas shqyrtimit të shkresës nr. 6784 prot., datë 29.12.2023, gjykon se titullari i institucionit e ka përfshirë Drejtorin e Financës në Grupin për Menaxhimin Strategjik.
Për sa më sipër, **pretendimet e subjektit merren pjesërisht në konsideratë.**

1.2 Auditi i Brendshëm

Organizimi dhe funksionimi i njësisë së auditit të brendshëm publik, kapacitetet audituese që mbulojnë këtë aktivitet, planifikimi, realizimi i programit vjetor të auditimit si dhe kapacitetet audituese të sektorit të auditimi, ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara nga drejtimi.
Në zbatim të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:
1.Karta e Auditimit të Njësisë Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Mat;
2.Plani Strategjik dhe vjetor, si dhe pasqyrat shoqëruese;
3.Programimi i auditimeve të brendshme për vitin -2025;
4.Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmoizimit të Auditit të Brendshëm;
5.Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;

Përshkrimi i situatës mbi krijimin dhe përbërjen e strukturës së njësisë së auditit të brendshëm.

Në bazë të VKM nr.83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik", është krijuar njësia e Auditit të Brendshëm, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditit të Brendshëm duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr.1100 i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm.

Struktura e njësisë AB për vitin 2025

Nr	2024	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi ne pune	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnime te vijueshme
1	G. H.	Përgjegjës	i lartë	40 vjet	15 vite	I çertifikuar	
2	D. H.	Specialist	i lartë	35 vite	5 vjet	I pacertifikuar	

Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB për periudhën 2025.

-Përgjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025, nga sektori i auditit të brendshëm pranë Bashkisë Mat, janë kryer 3 auditime (Auditim financiar në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Pyjeve, Auditim Financiar në Agjencinë e Funksioneve të Transferueshme dhe një Auditim Tematik për zbatimin e rekomandimeve në Nj,A Burrel dhe Komsi, NJA Baz dhe Ulë, NJA Derjan dhe Rukaj, Drejtoria e Ekonomike dhe të Ardhurave) nga 7të tilla të planifikuara. Nga auditimi i dokumentacionit fizik dhe elektronik të vënë në dispozicion nga subjekti, konkretisht Plani i Punës dërguar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm së bashku me Planin Strategjij me shkresën me nr. 3841/1 prot. datë 14.10.2024, ku u konstatua se nga NJAB ishte planifikuar auditimi i përputhshmërisë në Drejtorinë e Bujqësise dhe Pyjeve, Drejtorinë Juridike dhe Taksave Vendore, Ndërmarrjen e Shërbimeve Bashkiake, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Drejtorinë e Kulturës, Zbatimi i rekomandimeve. Drejtorinë e Ekonomisë, Financës dhe Buxhetit. Nga verifikimi i Raportit të Vjetorit të NJAB, Për sa më sipër kjo shmangie nga plani vjetor nuk është argumentuar një në Raportin Vjetor drejtuar MFE, në kundërshtim me nenin 14 pika ç, nënpika ii të Ligjit për Auditin e Brendshëm, pikën 2.6.1 të Manualit për Auditin e Brendshëm.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me nenin 12, pika b e Ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".
-Për gjysmën e dytë të vitit 2025, Njësia e Auditit të Brendshëm ka funksionuar me përbërjen: Përgjegjës dhe Specialistin e Auditit të Brendshëm, në vend të tre punonjësve që përcakton VKM nr. 83 datë 03.02.2016, pika 3. Me shkresën m nr. 06.01.2025, Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë Mat, z. E. R. ka kërkuar nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit publikimin e thirrjes së Bashkisë Mat për rekrutimi e një specialisti të Auditit të Brendshëm. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe komunikimi me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore u konstatua se për pozicionin e përmendur më lart, nuk ka pasur asnjë aplikant.
-Për vitin 2025 niveli profesional i punonjësve në Sektorin e Auditit të Brendshëm nuk është sipas përcaktimeve të bëra në pikën 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik". Sipas këtyre dispozitave numri i punonjësve të pa certifikuar si "Auditues i Brendshëm" nga autoritetet përkatëse, nuk mund të kalojë 1/3 e numrit total të punonjësve në Njësinë e Auditimit, ndërkohë që z D. H. nuk është pajisur me çertifikatën e Audituesit të Brendshëm.
-Plani vjetor i auditimeve për vitin 2025 është përgatitur në mënyrë të rregullt, në përputhje me paragrafin 3.2 të Kapitullit III të MAB, si dhe me modelet përkatëse në po këtë kapitull:
-Nga verifikimi i dosjeve të procedurave të auditimit të realizuar nga NJAB, u konstatua se nuk janë hartuar projekt-raportet e auditimit në kundërshtim me pikën 4.1.11 të Manualit të Auditit të Brendshëm.
-Nga verifikimi i dosjeve të audimit u konstatua se raportet e auditimit nuk janë kryer në përputhje me strukturën e raporteve të parashikuara në kundërshtim me piken 4.1.12 të Manualit të Auditimit të Brendshëm.
-Nuk janë audituar Sektorët dhe Drejtoritë që paraqesin risk të lartë për sa i përket gabimeve, parregullsive dhe shkeljeve ligjore, si psh: Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës, Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatik Taksave, Drejtoria e Urbanistikës në kundërshtim me përcaktimet e bëra në në pikën 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm: "Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit".
-Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore në kundërshtim me nenin 22, të Ligjit Nr.9154, datë 6.11.2003 dhe nenin 19 pika 1 e Normave Tekniko Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.
Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka çelur manualisht dhe elektronikisht dosjet e përhershme mbi njësitë e menaxhimit
Veprime në kundërshtim me paragrafin 6.3 të Manualit për Auditimin e Brendshëm.
Për sa më sipër mban përgjegjësi z. G. H. me detyrë përgjegjës NJAB Bashkia Mat.

***2*.. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.**

2.1. Programimi i PBA dhe programimi i buxhetit vjetor;
2.2 Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative.
2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor (grande dhe të ardhura) dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.
2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

- ***Auditimi i procedurave të ndjekura për hartimin e PBA dhe programimit të buxhetit vjetor.***

- *Përgatitja e Programeve Buxhetore Afatmesme* 2025-2027

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen e PBA 2025-2027 u konstatua se:

- Për realizimin e fazave të përgatitjes PBA është **ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik** (GMS) për PBA me Urdhrin nr. 796, datë 29.12.2023.
- Është përgatitur dhe **miratua**r **kalendari i PBA** 2025-2027 me VKB nr. 56, datë 22.12.2023, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr. 11257/1, datë 28.12.2023.
- Janë miratuar në Këshillin Bashkiak **tavanet përgatitore** për PBA 2025-2027 me VKB nr.27, datë 27.03.2024, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr. 286/1 prot., datë 02.04.2024 në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 34/6.
- Pas miratimit të tavaneve përgatitore **për përgatitjen e** PBA 2025-2027 **është hartuar Udhëzimi i Kryetarit** të Bashkisë nr. 239, datë 09.04.2024.
- PBA 2025-2027 pas përfundimit të fazës së parë është dërguar Ministrinë e Financave me shkresën me nr. 2110 prot., datë 27.05.2024, është bërë miratimi online nga Koordinatori i GMS, nga kryetari i GMS me datë 28.05.2024, si dhe është bërë ngarkimi në sistemin SMBV online me datë 30.05.2024.

Pas përfundimit të fazës së parë dhe pas rekomandimeve, nga Ministria e Financave është dërguar udhëzimi plotësues nr. 08, datë 05.07.2024 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027".

- **Tavanet përfundimtare** të PBA 2025-2027 janë miratuar me VKB nr. 52, datë 25.07.2024 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr. 617/1 prot, datë 29.07.2024 në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 34/6.
- **Pas miratimit të tavaneve përgatitore (përfundimtare) për përgatitjen e** PBA 2025-2027 **është hartuar Udhëzimi i Kryetarit** të Bashkisë nr. 3006, datë 2.8.2024 .

Pas përfundimit të fazës së dytë Projekt buxheti është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 3387 prot., datë 13.09.2024, është bërë miratimi online nga Koordinatori i GMS, Kryetari i GMS dhe Këshilli Bashkiak me datë 12.09.2024 2024 dhe është bërë ngarkimi në sistemin SMBV online me datë 13.09.2024

- Për realizimin e dëgjesave publike nga titullari i institucionit është nxjerrë urdhri nr.575, datë 20.09.2024 "Për dëgjesa publike për paketën fiskale 2025, buxhetin e vitit 2025 dhe PBA 2025-2027.

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetit vjetor **janë kryer konsultime** me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të "Buxhetimit me pjesëmarrje", për të cilat janë mbajtur dokumentacion si: relacione, listë prezenca për pjesëmarrësit si dhe foto nga takimet.

- **Dokumenti përfundimtar** i **PBA 2025-2027** është miratuar me VKB nr. 94, datë 24.12.2024, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr. 1083/1, datë 30.12.2024, jashtë afatit të përcaktuar në Udhëzimin plotësues të MF nr.08 datë 05.07.2024 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027", kreu II "Afatet për përgatitjen e buxhetit" pika 4 në të cilën përcaktohet: "*Brenda datës 15 shtator, njësie vetëqeverisjes vendore dërgon në MF dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, të miratuar nga këshilli i njësisë, së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave gjatë fazës së parë*."

- **Buxheti vjetor 2025** është miratuar me VKB nr. 93, datë 24.12.2024, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr. 1083/1, datë 30,12,2024

Pas përfundimit të fazës së tretë finale të PBA 2025-2027, është bërë miratimi online nga Koordinatori i GMS, Kryetari i GMS dhe Këshilli i NJQV me datë 10.12.2024 dhe është bërë ngarkimi në sistemin SMBV online me datë 09.01.2025

- Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur të hartimit të PBA 2025-2027 dhe buxhetit vjetor, rezulton se **janë hartuar mbi bazën e kërkesave** shkresore nga Njësitë Administrative, nga njësitë vartëse dhe nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Mat në rolin e menaxherëve të

programeve buxhetore përkatëse, nga kërkesat e sektorëve të ndryshëm, që mbulojnë këto programe si dhe nga kërkesat e mbledhura në dëgjesat publike.
- Në fazën përfundimtare të PBA, duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, si dhe duke respektuar tavanet e përcaktuara në fazat e para të përgatitjes, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor tre vjetor sipas programeve si për shpenzimet korrente, investimet dhe të ardhurat. Planifikimi i shpenzimeve në PBA 2025-2027 sipas llogarive dhe peshës specifike që zënë ato në totalin e shpenzimeve paraqiten në tabelën e mëposhtme:

KODI	EMËRTIMI I LLOGARISË	PLANI 2025		PLANI 2026		PLANI 2027	
		000/leke	% ndaj total	000/leke	% ndaj total	000/leke	% ndaj total
600	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	383 872	52%	391 892	52%	394 373	51%
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	58 775	8%	61 184	8%	61 745	8%
602	Mallra dhe sherbime te tjera	92 337	12%	93 690	12%	96 270	12%
604	Transferime korrente te brendeshme	10 948	1%	10 948	1%	10 948	1%
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	5 364	1%	3 903	1%	4 088	1%
609	Rezervat	7 100	1%	6 161	1%	6 161	1%
231	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	180 540	24%	182 647	24%	200 153	26%
TOTALI		**738 936**		**750 425**		**773 738**	

Burimi: *Drejtoria e Financës e Zhvillimit Ekonomik dhe Kontratave, përpunuar nga grupi i auditimit*

Nga auditimi i dokumentacionit të praktikës së përgatitjes dhe hartimit të PBA rezultoi se, janë respektuar kërkesat e në zbatim të Udhëzimit të MFE nr. 3, datë 28.02.2024 "Për një ndryshim të udhëzimit nr. 23, datë 30.7.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të NJQV, të udhëzimit plotësues nr. 8 datë 05.07.2024"Për përgatitjen e PBA 2025-2027"

- *Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2025*

Buxheti **për vitin 2025** është miratuar me VKB nr. 93, datë 24,12,2024 , i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr. 1083/1, datë 30.12.2024. Plani fillestar i miratuar për vitin 2025 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani fillestar i vitit 2025	
		Të ardhurat	Shpenzimet
1	Transferta e pakushtëzuar	318,293	
2	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	210,212	
3	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore + Institucionet e varësisë	210,431	
1	Paga Punonjësish 600		383,872
2	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore 601		58,775
3	Shpenzime operative 602		92,337
4	Transferta korente 604		10,948
5	Fondi i emergjencës 606		5,364
6	Fond kontigjence + rezervë 609		7,100
7	Investime 231		180,540
	Total	**738,936**	**738,936**

Burimi: *Drejtoria e Financës e Zhvillimit Ekonomik dhe Kontratave, përpunuar nga grupi i auditimit*

Me VKB nr. 17, datë 28.02.2025 është miratuar "Përdorimi e të ardhurave të trashëguara të vitit 2024 të Bashkisë", të cilat në mënyrë të detajuar paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani fillestar i vitit 2025	
		Të ardhurat	Shpenzimet
1	Transferta e pakushtëzuar	38,920	
2	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	23,919	
3	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore + Institucionet e varësisë	35,741	
1	Paga Punonjësish 600		12,136
2	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore 601		2,027
3	Shpenzime operative 602		19,049
4	Transferta korente 604		12,500
5	Fondi i emergjencës 606		160
7	Investime 231		52,708

	Total	**98,580**	**98,580**

Burimi: *Drejtoria e Financës e Zhvillimit Ekonomik dhe Kontratave, përpunuar nga grupi i auditimit*

Është bërë një shtesë në buxhetin e vitit 2025 në kuadër të projektit me financim të huaj "CITY MOVE", bazuar në VKB nr. 75, datë 29.10.2024 "Për një shtesë në buxhetin e vitit 2024" në shumën 14,025 mijë lekë si diferencë e pa akorduar gjatë vitit 2024 e ndarë:
- Shpenzime operative 7,090 mijë lekë
- Shpenzime për investime 6,935 mijë lekë

Buxheti fillestar i vitit 2025 është miratuar i balancuar dhe pa defiçite, ku të ardhurat dhe shpenzimet të miratuara janë në shumën 738,936 mijë lekë dhe trashëgimet e fondeve në vlerën 98.580 mijë lekë si dhe projekti me financim të huaj në shumën 14,025 mijë lekë.

➢ *2.2 Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas vendimeve të Këshillit të Bashkisë.*

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.
Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë alokuar fondet nga transfertat e pakushtëzuara, fondet nga transfertat e kushtëzuara, sektoriale, specifike etj, të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit. Në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

- **Për vitin 2025** kanë ndodhur disa ndryshime me VKB, shtesa në buxhet me 5 akte normative, ndryshime me 8 VKB për shtesa në buxhetin e Bashkisë nga buxheti i shtetit. Ndryshimet buxhetore gjatë vitit ushtrimor 2025 paraqiten në Aneks. Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit. Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga Sektori i Buxhetit dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxheti vjetor gjatë vitit ka pësuar ndryshime, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, sipas nevojave të Bashkisë Mat. Plani përfundimtar i shpenzimeve dhe të ardhurave **për vitin 2025** paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Burimet e financimit	Buxheti fillestar	Ndryshimet gjatë vitit		Buxheti perfund	Emërtimi i shpenzimeve	Buxheti fillestar	Ndryshimet gjatë vitit		Buxheti perfund
	2025	2025		imtar		2025	2025		imtar
		Pakesim	Shtesa				Pakesime	Shtesa	
Të ardhurat e trashëguara			35,742	35,742	Art. 600 Paga	379,303		47,539	426,842
Transferta e pakushtëzuar	318,293		46,919	365,212	Art. 601 Sig. shoq.e shëndetësore	63,343		6,982	70,325
Transferta e pakushtëzuar sektoriale	210,212		25,500	235,712	Art.602 Shpenzime operative	92,338		36,770	129,108
Të ardhurat nga taksat e Instituci varësie	210,431		-	210,431	Art.603 Subvencione				-
Sponsorizime dhe të ardhura të tjera			14,024	14,024	Art. 604 Transf korrente të brendshme	10,948		21,692	32,640
Grand nga Qarku			4,200	4,200	Art. 606 Transf të buxhet familja,individ	5,364		374,465	379,829
Transferte e kushtëzuar			661,672	661,672	Art. 230-231 Investime	180,540	(2,773)	304,382	482,149
				-	Art.166+651 Shpenz principali +interesi				-
					Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	7,100	(1,000)		6,100
Total	**738,936**	**-**	**788,057**	**1,526,993**	**Total**	**738,936**	**(3,773)**	**791,830**	**1,526,993**

Burimi: *Drejtoria e Financës e Zhvillimit Ekonomik dhe Kontratave, përpunuar nga grupi i auditimit*

➢ *Auditim mbi saktësinë e realizmit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit*

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Mat si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.

Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Mat , duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv buxhetor, të miratuar me Vendim të KB, apo nga ndryshimet e transfertave të pakushtëzuara sektoriale nga pushteti qendror, nga auditimi i shkresave, evidencave të çeljeve, shpërndarjes së fondeve gjatë vitit, të akt-rakordimeve periodike me degën e Thesarit Mat u konstatua se, si në planifikim dhe në realizim të buxhetit është respektuar disiplina buxhetore.

- **Për vitin 2025** realizimi i treguesve të buxhetit në nivel bashkie, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Institucionet	600 (paga)		601(sigurime)		602(shp.operative)		603-609 (transf indivi)		230-231(investime)		Totali	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Bashkia	109,843	104,498	18,062	17,280	51,558	36,129	44,041	33,152	200,724	117,300	424,228	308,359
Ministrite e linjes	8,562	8,469	1,454	1,414	10,943	10,260	373,685	373,416	267,025	230,339	661,669	623,898
Shuma Bashkia	**118,405**	**112,967**	**19,516**	**18,694**	**62,501**	**46,389**	**417,726**	**406,568**	**467,749**	**347,639**	**1,085,897**	**932,257**
Agjencia e Funksioneve të pa transferueshme FPT(Pyjet, Bujqësia Arsimi, MZSH, Çerdhet, Kultura)	227,827	221,435	37,098	36,757	35,265	21,066	332	239	13,260	1,434	313,782	280,931
Agjencia e Funksioneve të Transferueshme AFT (Sektori i Mbetjeve, Shërbimet Vendore, Rrugët Rurale)	80,610	80,248	13,710	13,368	31,429	28,280	261	206	1,300	1,287	127,310	123,389
TOTALI	**426,842**	**414,650**	**70,324**	**68,819**	**129,195**	**95,735**	**418,319**	**407,013**	**482,309**	**350,360**	**1,526,989**	**1,336,577**
% e realizimit		97%		98%		74%		97%		73%		88%

Burimi: *Drejtoria e Financës e Zhvillimit Ekonomik dhe Kontratave, përpunuar nga grupi i auditimit*

Realizimi i buxhetit 2025 për shpenzimet në mënyrë të përmbledhur për aparatin e bashkisë dhe institucionet e varësisë paraqitet në Aneksin nr. 1 pika 2.1 bashkëlidhur raportit të audiimit

Referuar aktrakordimit me Degën e Thesarit Mat dhe raportit vjetor të monitorimit rezulton se, për vitin 2025 në nivel të gjithë bashkisë, duke përfshirë dhe institucionet e varësisë buxheti është realizuar në shumën 1,336,580 mijë lekë nga 1,526,992 mijë lekë të planifikuara ose në masën 88%. Sipas burimit të financimit fondet buxhetore me burim financimi nga te ardhurat e veta dhe transfertën e pakushtëzuar janë realizuar 865,321 mijë lekë nga 712,682 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 82%, ndërsa fondet buxhetore me burim financimi ministritë e linjës (fondet e kushtëzuara) janë realizuar në shumën 623,898 mijë lekë nga 661,671 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 94%. Në këtë masë realizimi ka ndikuar mosrealizimi në zërat e buxhetit:

- llog.606 "Transferta tek individët" në masën 29 %, ku përfshihet fondi i emergjencës kjo për arsye të mosmiratimit te VKB në kohë brenda vitit të disa raste fatkeqësie dhe ndihma financiare fonde të cilat janë trashëguar për vitin 2026
- llog.602 "Shpenzimet operative" janë realizuar në masën 73% nga mosrealizmi në kohë i procedurave të prokurimit ose planifikim me rezervë të fondeve përtej nevojave në këtë zë të buxhetit.
- llog. 231 me burim financimi i të ardhurat e veta dhe transfertën e pakushtëzuar në masën 56% nga mosrealizimi në kohë i procedurave të prokurimit, mosrealizimi i të ardhurave.

- *<u>Çelja dhe ekzekutimi i fondeve për investime, saktësia e raportimit buxhetor të tyre</u>*

Për **vitin 2025** janë **planifikuar** fonde për investime në shumën ***482,149 mijë lekë*** (me burim financimi nga grant i pakushtëzuar + transferta sektoriale + të ardhura + transfertë e kushtëzuar) të cilat janë ***realizuar në vlerën 350,361 mijë lekë, ose në masën 72.6%***.

Konkluzion: Nga analiza e investimeve theksojmë se një pjesë e investimeve janë prokuruar me vonesë në fund të vitit 2025. Një pjesë e projekteve nuk janë realizuar dhe një pjesë tjetër janë planifikuar me burim financimi të ardhurat e veta.

Fondet për investime nga të ardhurat e Bashkisë

Për vitin 2025 janë planifikuar në vlerën 214,039 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 118,938 mijë lekë ose realizuar në masën 56%, ku nga të ardhurat e veta realizimi është në masën 40.4% dhe nga transferta e pakushtëzuar në masën 82%. Janë planifikuar 39 projekte investimi në proces dhe të reja, janë realizuar 24 projekte dhe nuk janë realizuar 15 projekte.

Fondet për investime të financuara nga Ministritë e Linjës
Për vitin 2025 janë planifikuar në vlerën 267,026 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 230,339 mijë lekë ose në masën 86.2% për 9 projekte nga 11 projekte të planifikuara.

- *Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe kontigjencës si dhe fondeve të emergjencave civile*

a. Fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës.
Për vitin 2025 fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës është në total në shumën 6,100 mijë lekë, i cili është miratuar në buxhetin fillestar me VKB nr. 93&94 datë 24.12.2024 "Për miratimin e Buxheti vjetor 2025 dhe PBA 2025-2027 I Bashkisë Mat dhe u konfirmua nga Prefekti I Qarkut Dibër me shkresën nr.1081/1 datë 30.12.2024.

b. Fondet e emergjencës.
Në bazë të ligjit nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", neni 65, nga Ministria e Mbrojtjes (Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile) Bashkia Dibër ka përfituar fonde. Bazuar në VKM nr. 414, datë 08.07.2021 "Për miratimin e proçedurave dhe kritereve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" dhe me VKB përkatëse është bërë miratimi i përdorimit të fondeve të lira, duke i detajuar ato, sipas zërave të shpenzimeve dhe më pas është kryer prokurimi i tyre, sipas të cilave janë kryer shpenzimet.
Për vitin 2025 me shkresën nr. 492/1, datë 25.02.2025 të ardhur nga Ministria e Mbrojtjes, (AKMC), "Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile" Bashkisë Mat i është akorduar fondi në vlerën 5,509,647 lekë, i ndarë:

Në lekë

Nr.	Emërtimi I shpenzimeve	Shuma e planifikuar	Përdorimi	Mbetja	% e realizimit
1	Shpenzime për marrjen e masave parandaluese , lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme	3,509,647	0	3,509,647.00	0%
2	Shtetas të ndihmuar për banesat e tyre, të cilëve u janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme	2,000,000	1,191,704	808,296.00	59.6%
	Total	**5,509,647**	**1,191,704**	**4,317,943**	

- *Raportet e Monitorimit.*

Për vitet 2025 janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 6 dhe me kërkesat e Shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojcës 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore" pikat 10, 12, 28, 29, 48.
Për vitin 2025 janë dërguar në MFE raportet e detajuara si më poshtë:
"Raport monitorimi Janar-Prill 2025 " me e-mail shkresa nr. prot.1636, datë 23.05.2025
"Raport monitorimi Janar-Gusht 2025" me e-mail shkresa nr.prot. 3511, datë 29.09.2025
Raporti I monitorimit janar-dhjetor 2025 me email shkresa nr 626 datë 23.02.2026

- ***2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve etj.***

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Është hartuar plani i shlyerjes së detyrimeve të vitit 2024 dhe është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr.prot.752, datë 26.02.2025.

Nr.	Bashkia Mat	Detyrimi i mbetur deri në dhjetor 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
	Bashkia Mat	75,393,412	55,000,000	15,934,000	4,459,412

- *Evidentimi, raportimi, ndjekja dhe likujdimi i faturave të palikujduara*

Me fondet e vitit buxhetor 2025, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikujduara të viteve të mëparshme, duke bërë pagesat pjesë-pjesë të detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara Bashkia, nga Ministritë e linjës, sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.

Detyrimet e palikujduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës "*Detyrimet e prapambetura*", sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

Detyrimet e prapambetura deri në fund të periudhës 31.12.2025 Në lekë

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit I mbartur 01.01.2025	Detyrimi I krijuar në periudhën 01/01/2025 - 31.12.2025	Total detyrime	Shlyerja e detyrimeve 2025	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2025
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
a. Investime nga Ministritë e linjës e FZHSH	4,585,172	7,493,587	12,078,759	4,585,172	7,493,587
b. Investime nga Bashkia	69,484,852	108,835,542	178,320,394	132,281,697	46,038,697
INVESTIME :			-		-
Mallra dhe shërbime	1,678,753	5,329,897	7,008,650	5,952,494	1,056,156
Vendime gjyqësore	4,229,807	27,390,801	31,620,608	28,371,398	3,249,210
Totali :	79,978,584	149,049,827	229,028,411	171,190,761	57,837,650

Burimi: *Drejtoria e Financës e Zhvillimit Ekonomik dhe Kontratave, përpunuar nga grupi i auditimit*

Referuar shkresës nr.627 prot., datë 23.02.2025 "Raport vjetor i vetëvlerësimit për situatën e gjendjes financiare për periudhën janar-dhjetor 2026, Bashkia Mat" të dërguar në MF detyrimi i mbetur në fund të vitit ushtrimor në shumën prej 57,837,650 lekë, e cila përbëhet nga: shuma prej 7,493,587 lekë e faturave të palikujduara për investime me financim nga fondet e transfertës së kushtëzuar nga Ministritë e linjës, shuma prej 46,038,697 lekë e faturave të palikujduara për investime me burim financimi të ardhurat e bashkisë (të ardhurat e veta dhe transferta e pakushtëzuar), shuma prej 1,056,156 lekë e faturave të palikujduara për mallra e shërbime nga të ardhurat e bashkisë dhe shuma pjesore prej 3,249,210 lekë e detyrimeve të lindura nga vendimet gjyqësore**.** Këto detyrime paraqiten në aneksin nr. 2 pika 2 bashkëlidhur raportit të auditimit. Gjatë vitit 2025 janë krijuar 149,049,827 lekë detyrime, janë likujduar 171,190,761 lekë detyrime dhe vlera e detyrimit të mbetur të palikujduar në fund të vitit 2025 është 57,837,650 lekë. e ndarë:

- Detyrime të ministrive të linjës 7,493,587 lekë
- Detyrime Bashkia 50,344,063 lekë

Sipas pasqyrave financiare detyrimet e prapambetura të akumuluara në llogarinë e klasës 4 në pasiv të pasqyrës së pozicionit financiar në fund të vitit 2025 janë në shumën 188,893,593lekë, e cila përbëhet nga: shuma prej 31,911,526 lekë e faturave të palikujduara për investime me financim nga fondet e transfertës së kushtëzuar nga Ministritë e linjës, shuma prej 152,131,001 lekë e faturave të palikujduara për investime me burim financimi të ardhurat e bashkisë (të ardhurat e veta dhe transferta e pakushtëzuar), shuma prej 1,661,390 lekë e faturave të palikujduara për mallra e shërbime nga të ardhurat e bashkisë dhe shuma pjesore prej 3,249,210 lekë e detyrimeve të lindura nga vendimet gjyqësore. Pra në MF janë raportuar pjesa e detyrimeve të prapambetura që nuk janë raportuar në vitet e kaluara.

Konkluzion: Nga analiza e detyrimeve gjendje në fund të vitit 2025 u konstatua se detyrimet e papaguara në fund të vitit 2025 sipas raportit të vetëvlerësimit të situatës së gjendjes financiare paraqiten në shumën 57,837,650 lekë, e cila përbëhet nga detyrime për shpenzime për investime në shumën 53,532,284 lekë dhe detyrime për shpenzime për vendimeve gjyqësore në shumën 3,249,210 lekë dhe detyrime për shpenzime mallra e shërbime në shumën 1,056,156 lekë. Mosshlyerja e detyrimeve ndaj të tretëve është në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, nenet 5/c, 40/h, me Udhëzimin e MFE nr. 09, datë 20.07.2018 "*Për procedurat standarte të zbatimit të e buxhetit*" i ndryshuar, pikat 48/i, 58,130, me Udhëzimin e MF nr.22, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të monitorimit*

të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore" shtojca 4 germa (c), me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 27.12.2014 *"Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*", pikat 82-91.

Vështirësia Financiare

Nga auditimi është konstatuar se detyrimet e papaguara (*të akumuluara*) në fund të vitit 2025 paraqiten në vlerën 188,893,593 lekë dhe pesha specifike e stokut të detyrimeve të konstatuara të Bashkisë ndaj palëve të treta është 14 % kundrejt fondeve faktike 1,336,580,000 lekë. Kjo situatë tregon se, Bashkia Mat konsiderohet në situate normale e gjendjes financiare, pasi nuk e ka kaluar pragun 15% të shpenzimeve faktike në fund të vitit ushtrimor, duke mos u konsideruar institucion në vështirësi financiare sipas nenit 56 "Vështirësia financiare" të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" dhe Udhëzimit e MF nr. 35, datë 29.12.2023 "Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore" pika 33.

- *Burimet e financimit të buxhetit vjetor*

Realizimi i buxhetit për vitin 2025 sipas burimit të financimit paraqitet në tabelën e mëposhtme:

- Për vitin 2025 shpenzimet buxhetore janë përballuar nga të ardhurat e veta në shumën 168,963 mijë lekë ose në masën 12.7%, nga transferta e pakushtëzuar në shumën 345,307 mijë lekë ose në masën 25.8%, transferta e pakushtëzuar sektoriale në shumën 198,413 mijë lekë ose në masën 14.8%, transferta e kushtëzuar në shumën 623,898, mijë lekë ose në masën 46.7%.

(Më hollësisht trajtuar në aktkonstatimin nr.6, datë 29.05.2026)

2.5. Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor.

- *Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore*

Struktura organizative e Drejtorisë së Taksave Vendore në Bashkinë Mat për vitin 2025 është miratuar me urdhrat e Kryetarit të Bashkisë Mat, nr. 364, datë 01.09.2025 dhe është organizuar me 11 punonjës (1+7+3), por në fakt ka funksionuar me 10 punonjës.

	Viti 2025	
Drejtoria e Taksave Vendore	**Struktura**	**Fakt**
Drejtor Drejtorie	**1**	**1**
Sektori I Taksave Vendore	**7**	**6**
Përgjegjës Sektori	1	-
Specialistë	3	3
Punonjës Terreni	3	3
Sektori i Taksës së Pronës	**3**	**3**
Përgjegjës Sektori	1	1
Specialistë	2	2
Punonjës gjithsej	**11**	**10**

- *Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:*

Administrimi i taksave vendore bëhet me program, ku janë të pasqyruara regjistrat e biznesit vip, të madh dhe të vogël me bazën e të dhënave përkatëse, me zërat përkatës për detyrimet e taksave dhe tarifat vendore, pagesat dhe gjendjet debitore, si dhe dosjet për secilin taksapagues me njoftim detyrimet dhe pagesat, kjo si për subjektet fizik/juridik, pronarët e pasurive të paluajtshme dhe abonentët familjarë**.** Sipas të dhënave të Drejtorisë së Taksave Vendore, gjendja e subjekteve tatimpagues në territorin nën juridiksionin e Bashkisë Mat paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Emërtimi	Viti	Gjendja Në fillim	Regjistrimet e reja (hyrje)	Pezullim i përkohshëm i aktivitetit/Pasiv	Mbyllur Aktiviteti	Gjendja në fund të vitit total
Biznesi Vip	2025	22	2	0	0	24
Biznesi i Madh	2025	112	2	4	1	109
Biznesi i Vogël	2025	475	50	8	5	512
Institucione	2025	30	0	0	1	29
Total		**639**	**54**	**12**	**7**	**674**

Burimi: *DTTV, përpunuar nga grupi i auditimit.*

Sa më sipër rezulton se në fund të vitit 2025 janë aktiv 674 subjekte të biznesit. Gjatë vitit 2024 janë pezulluar 12 subjekte. Në progresiv rezultojnë 682 subjekte të cilat janë me status pushim i përkohshëm i aktivitetit apo pasiv për periudhën 2011-2025.
Drejtoria e Taksave Vendore ka bashkëpunuar me Qendrën Kombëtare të Biznesit me email çdo ditë në lidhje me kërkesat për pezullim të subjekteve. Gjithashtu Drejtoria e Taksave Vendore ka bashkëpunuar me Qendrën Kombëtare të Biznesit për regjistrimet, çregjistrimet dhe ndryshimet e pësuar për bizneset pranë Bashkisë Mat .Drejtoria e Taksave Vendore të dhënat në lidhje me faturimet e taksave dhe tarifave vendore i mban në sistem kompjuterik.

- *Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve*

Për vitin 2025, paketa e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Mat është miratuar me VKB nr 90, datë 24.12.2024 "*Mbi miratimin e Paketës Fiskale 2025 për Bashkinë Mat*", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr. 1078/1 prot, datë 30.12.2024.
Planifikimi i të ardhurave për vitin 2025 është kryer nga drejtoritë përkatëse sipas përgjegjësive përkatëse për përllogaritjen e taksave dhe tarifave vendore të vitit 2025, miratuar me VKB nr.93, datë 24.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Mat për vitin 2025 dhe VKB nr.94, datë 24.12.2024 për "Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar 2025-2027 për Bashkinë Mat". Plani dhe realizimi për vitin 2025 sipas llojeve të të ardhurave referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarit paraqiten në aneksin nr. 3 pika 2 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Për vitin 2025 referuar të dhënave dhe dokumentacionit të DTTV, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Mat janë realizuar në shumën 145,190,441 lekë nga 210,431,000 lekë të parashikuara, ose në masën 69%. Pra realizimi i të ardhurave paraqitet në masë të ulët, e cila ka ardhur nga realizimi në nivel të ulët e një pjesë të taksave dhe tarifave vendore si më poshtë:
a. Taksat dhe tarifat e paraqitura me realizim të ulët të planit si:
1. Të ardhurat nga Sektori i Taksave Vendore në Drejtorinë e Taksave e Tarifave Vendore janë realizuar 63,709 mijë lekë nga 94,458 mijë lekë të planifikuara ose në masën 67 %, ku në këtë masë realizimi ka ndikuar niveli i ulët i realizimit të taksave dhe tarifave:
- ***Taksa reklame*** është realizuar në vlerën 592 mijë lekë nga 1,000 mijë lekë e planifikuar ose në masën 59%.
- ***Taksë tabele*** është realizuar në vlerën 126 mijë lekë nga 250 mijë lekë e planifikuar ose në masën 51%.
- ***Tarifë pastrimi*** është realizuar në vlerën 40,549 mijë lekë nga 63,000 mijë lekë e planifikuar ose në masën 64%.
- ***Tarifë gjelbërimi*** është realizuar në vlerën 1,888 mijë lekë nga 3,097 mijë lekë e planifikuar ose në masën 61%.
- ***Taksë fjetje në hotel*** është realizuar në vlerën 0 lekë nga 107 mijë lekë e planifikuar ose në masën 0%.
- ***Tarifë e mirëmbajtjes së varrezave publike*** është realizuar në vlerën 1,414 mijë lekë nga 2,800 mijë lekë e planifikuar ose në masën 50%.
- ***Tarifë e mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore*** është realizuar në vlerën 5,867 mijë lekë nga 9,500 mijë lekë e planifikuar ose në masën 81%.
- ***Tarifë e mirëmbajtjes së hyrjeve të pallateve*** është realizuar në vlerën 3,680 mijë lekë nga 5,004 mijë lekë e planifikuar ose në masën 74%.

2. Të ardhurat nga Sektori i Taksës së Pronës në Drejtorinë e Taksave e Tarifave Vendore janë realizuar 17,974 mijë lekë nga 22,500 mijë lekë të planifikuara ose në masën 80%, ku në këtë masë realizimi ka ndikuar niveli i ulët i realizimit të taksave dhe tarifave:
- ***Taksa mbi truallin*** është realizuar 1,855 mijë lekë nga 2,500 mijë lekë e planifikuar ose në masën 74%,
- ***Taksa mbi ndërtesën*** është realizuar në vlerën 16,130 mijë lekë nga 20,000 mijë lekë e planifikuar ose në masën 81%.

3. Të ardhurat nga Sektori i Monitorimit Kontratave Publike, Hapësirat Rekreative dhe Transportit në Drejtorinë e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe janë realizuar 4,693 mijë lekë nga 18,292 mijë lekë të planifikuara ose në masën 26%, ku në këtë masë realizimi ka ndikuar niveli i ulët i realizimit të taksave dhe tarifave:
- Tarifë për leje transporti është realizuar në vlerën 815 mijë lekë nga 1,500 mijë lekë e planifikuar ose në masën 54%.
- Tarifë parkingu është realizuar në vlerën 1,278 mijë lekë nga 10,080 mijë lekë e planifikuar ose në masën 13%.
- Tarifë autorizimi për licencimin e karburanteve është realizuar në vlerën 2,600 mijë lekë nga 6,712 mijë lekë e planifikuar ose në masën 39%.

4. Të ardhurat nga Sektori i Planifikimit Urban dhe Mjedisit në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës janë realizuar 6,295 mijë lekë nga 15,521 mijë lekë të planifikuara ose në masën 41 %, ku në këtë masë realizimi ka ndikuar niveli i ulët i realizimit të taksave dhe tarifave:
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (leje ndërtimi) është realizuar 0 lekë nga 1,082 mijë lekë e planifikuar ose në masën 0%,
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet është realizuar 3,482 mijë lekë nga 8,739 mijë lekë e planifikuar ose në masën 40%,
- Të ardhurat nga privatizimi janë realizuar 1,092 mijë lekë nga 2,000 mijë lekë e planifikuar ose në masën 55%,
- Të ardhurat nga qira trojesh janë realizuar 1,237 mijë lekë nga 3,000 mijë lekë e planifikuar ose në masën 41%,

5. Të ardhura nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjeve në Agjencinë e Funksioneve të Patransferueshme (institucion në varësi të bashkisë) janë realizuar 10,215 mijë lekë nga 20,016 mijë lekë të planifikuara ose në masën 53 %, ku në këtë masë realizimi ka ndikuar niveli i ulët i realizimit të taksave dhe tarifave:
- Të ardhurat nga shfrytëzimi i lëndës drusore janë realizuar 0 lekë nga 3,930 mijë lekë e planifikuar ose në masën 0%,
- Tarifë vjetore vaditje dhe kullim është realizuar në vlerën 14 mijë lekë nga 620 mijë lekë e planifikuar ose në masën 2%,
- Taksa mbi tokën bujqësore është realizuar në vlerën 693 mijë lekë nga 1,600 mijë lekë e planifikuar ose në masën 43%.
- Tarifë e shfrytëzimit të pasurive minerale është realizuar në vlerën 720 mijë lekë nga 1,800 mijë lekë e planifikuar ose në masën 40%,
- Tarifë vendore për hidrocentralin ujor është realizuar në vlerën 7,659 mijë lekë nga 11,000 mijë lekë e planifikuar ose në masën 70%,
- Tarifë vendore në sektorin e pyjeve dhe kullotave nuk është planifikuar, ndërkohë që është realizuar në shumën 362 mijë lekë.

6. Të ardhurat nga Sektori i Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Veprimtarive Social-Kulturore në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale për qiratë e ndërtesave janë realizuar 752 mijë lekë nga 3,000 mijë lekë të planifikuara ose në masën 25 %.

7. Të ardhurat nga Sektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi në Drejtorinë e Mbrojtjes Civile nga tarifat e certifikatat e mbrojtjes nga zjarri janë realizuar 28 mijë lekë nga 326 mijë lekë të planifikuara ose në masën 9%.

8. Të ardhura nga Sektori i Policisë Bashkiake nga gjobat janë realizuar **631** mijë lekë nga 1,500 mijë lekë të planifikuara ose në masën 42%.

10. Të ardhura nga Sektori i Turizmit, Trashëgimisë, Muzeut dhe Strategjitë Vendore nga veprimtari të ndryshme janë realizuar 0 lekë nga 6 mijë lekë të planifikuara.

11. Të ardhura nga Sektori i Bibliotekës, Rinisë dhe Sportit nga tarifat vendore shërbimi janë realizuar 59 mijë lekë nga 584 mijë lekë të planifikuara ose në masën 9%.
Konkluzion: Realizimi i të ardhurave në masë të ulët rreth 61% tregon për një punë të pa mjaftueshme për arkëtimin e tyre, gjë që ka sjellë ndikim negativ në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore. Për mosrealizimet e të ardhurave nuk ka një analizë të detajuar për faktorët që kanë ndikuar dhe masat që duhet të merren për përmirësimin e situatës**.** Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"*Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 42, me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9, pika 1.3. nënpika (ç), neni 51**.**

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: zj. S. C. me detyrë Drejtore e Taksave Vendore, z. *A. G. me detyrë Drejtor i Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës, z. A. H. me detyrë Drejtor i Bujqësisë dhe Pyjeve, zj. M. C. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Monitorimit të Kontratave Publike, Hapësirave Rekreative dhe Transportit, z. D. K. me detyrë Drejtues i Policisë Bashkiake.*

b. Taksat dhe tarifat e paraqitura me realizim mbi planin janë të ardhurat e tjera për të cilat nuk është i mundur planifikimi i saktë i tyre si:
- ***Taksë vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura*** është realizuar në vlerën 15,576 mijë lekë nga 13,500 mijë lekë e planifikuar ose në masën 115%.
- ***Taksë e rentës minerare*** është realizuar në vlerën 470 mijë lekë nga 420 mijë lekë e planifikuar ose në masën 112%.
- ***Tarifë vërtetimi të lëshuara nga bashkia*** është realizuar në vlerën 303 mijë lekë nga 265 mijë lekë e planifikuar ose në masën 114%.
- ***Taksë mbi kalimin e së drejtës së pronësisë*** është realizuar në vlerën 142 mijë lekë nga 12 mijë lekë e planifikuar ose në masën 1183%.
- ***Sponsorizime nga subjektet*** është realizuar në vlerën 0 lekë nga 1,531 mijë lekë e planifikuar.
- ***Të ardhura nga TAP*** është realizuar në vlerën 12,458 mijë lekë nga 11 mijë lekë e planifikuar ose në masën 113%.

• *Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor;*
Në realizimin në nivel të ulët të të ardhurave kanë ndikuar niveli i lartë i debitorëve. Në bazë përpunimit të të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave Vendore në Bashkinë Mat, rezultoi se ka nivel të lartë debitorësh në numër dhe në vlerë, duke përfshirë biznesin, individët, familjarët, (për taksën e ndërtesës, tabelës, trualli, reklame, zënie hapësire publike, tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim, etj), i cili nga viti në vit ka ardhur duke u rritur. Kështu në **fund të vitit 2024** vlera debitore është **73,841,616 lekë** dhe në **fund të vitit 2025** vlera debitore është **61,535,540 lekë** pa përfshirë kategorinë Familjarë. Në uljen e nivelit të debitorëve në shumën 12,306,076 lekë në kanë ndikuar arkëtimet e disa subjekteve që kanë patur detyrime të prapambetura me vlera të larta debitore ndër vite.

• *Arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore për biznesin*
Në Bashkinë Mat subjektet tregtarë ngarkohen me detyrime vendore për taksën mbi ndërtesën, taksë mbi truallin, taksë tabele, taksë reklame, tarifë pastrimi, ndriçimi, tarifën e gjelbërimit, tarifë zënie hapësirë publike dhe tarifë për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit etj..
Për vitin 2025 gjendja e debitorëve të biznesit të madh dhe të vogël sipas llojit të taksave paraqiten në tabelën e mëposhtme:
Në lekë

Nr.	PËR SUBJEKTET FIZIK/JURIDIK/SHTETËROR	Shuma progresive në fund	Shtesa gjatë vitit 2025	Arkëtuar gjatë vitit	Shuma progresive

		të vitit 2024				2025 edhe për vitet para 2025		në fund të vitit 2025	
		Nr.Sub	Vlera	Nr.Sub	Vlera	Nr.Sub	Vlera	Nr.Sub	Vlera
1	Taksë mbi ndërtesën	820	12,300,000	420	5,745,840	589	14,084,658	651	3,961,182
2	Taksë mbi truallin	456	2,052,000	373	1,250,418	284	1,665,622	545	1,636,796
3	Tarifë Pastrimi	982	43,910,076	674	30,453,411	734	32,486,571	922	41,876,916
4	Tarifë Ndriçimi	490	1,225,000	485	880,500	592	1,682,000	383	423,500
5	Tarifë Gjelbërimi	305	457,500	455	753,874	367	610,000	393	601,374
6	Taksë Tabele	30	256,000	0	0	0	0	30	256,000
7	Taksë Reklame	21	630,000	25	552,968	23	592,323	23	590,645
8	Tarifë e zënies hapësirë publike	87	3,758,262	82	2,124,555	59	3,306,468	110	2,576,349
9	Tarifë për Mbrojtjen dhe Përmirësimin e Mjedisit	0	0	2	3,900,000	2	3,900,000	0	0
10	Tarifë për Shfrytëzimin e Pasurive Minerale	1	360,000	4	1,440,000	3	1,080,000	1	720,000
11	Nj. Admin detyrime nga taksat te trsheguara	670	8,892,778	0	0	0	0	670	8,892,778
	TOTALI	3862	73,841,616	2520	47,101,566	2653	59,407,642	3728	61,535,540

Burimi: *DTTV, përpunuar nga grupi i auditimit.*

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion rezultoi se ka nivel të lartë debitorësh në numër dhe në vlerë për taksat dhe tarifat vendore. Debitorët për biznesin të raportuara nga DTV, evidentuar dhe në kontabilitet në fund të vitit 2024 është 73,841,616 lekë, shtesat gjatë vitit 2025 janë në shumën 47,101,566 lekë, janë kryer arkëtime në shumën 59,407,642 lekë. Detyrimet progresive për taksa dhe tarifa vendore në fund të vitit 2025 janë në shumën 61,535,540 lekë, e cila përbëhet nga:

- Debitorë për taksa e tarifa vendore nga biznesi dhe institucionet në shumën 52,642,762 lekë.
- Debitorë për taksa e tarifa vendore të trashëguara nga ish-komunat në shumën 8,892,778 lekë.

Mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga taksapaguesit debitorë ka sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Mat në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* i ndryshuar, nenet 6 dhe 9/pika 1.3.

Dinamika e Borxhit**:**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se struktura e borxhit për subjektet e biznesit të madh, biznesit të vogël dhe pronarë të bizneseve, sipas kohës së krijimit të tij paraqitet si më poshtë:

Mosha e Borxhit në fund të vitit 2025	Vlera/lekë	Nr. Subjekte
2-3 vjet	11,659,266	138
3-5 vjet	16,355,919	243
Mbi 5 vjet	45,551,700	643
Totali	**73,566,885**	**1024**

Referuar të dhënave të pasqyrës, konstatohet se vlerën më të lartë të borxhit e zënë debitorët e të krijuar mbi 3-5 vjet në vlerën 16,355,919 lekë e totalit dhe debitorët e krijuar mbi 5 vjet në vlerën 45,551,700 lekë e totalit**.**

- *Arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore për familjarët.*

Në Bashkinë Mat familjarët ngarkohen me detyrime vendore për taksën e tokës bujqësore, taksën e ndërtesës, taksën e truallit, tarifën e pastrimit, tarifën e ndriçimit, tarifën e gjelbërimit, tarifën e mirëmbajtjes së varrezave publike vetëm për Njësinë Administrative Burrel, tarifën e mirëmbajtjes së rrugëve, tarifa e mirëmbajtjes së kanaleve vaditëse, tarifën e mirëmbajtjes së hyrjeve të pallatave.

Kontrata me Agjentin Tatimor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër (SHRUKD)

Të dhënat në lidhje me debitorët e taksave dhe tarifat vendore për familjarët janë konfirmuar nga Drejtoria e Taksave Vendore, Sektori i Taksave Vendore me shkresën nr.847 prot., datë 03.03.2026 drejtuar Drejtorisë së Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Kontratave.

Bashkëpunimi për mbledhjen e taksave dhe tarifave nga agjenti (SHRUKD) është kryer në bazë të marrëveshjes nr.prot.2063, datë 25.05.2023. **Për vitin 2025** në mënyrë të përmbledhur, detyrimet e familjeve për taksat dhe tarifat vendore sipas njësive administrative janë paraqitur në Aneks.

në lekë

Nr	NJËSIA ADMINISTRATIVE	Taksa mbi tokën bujqësore		Taksë ndërtese		Tarifë pastrimi		Tarifë ndriçimi		Tarifë për mirëmbajtjen e varrezave publike		Tarifë për mirëmbajtjen e rrugëve		Tarifa e mirëmbajtjes së kanaleve vaditëse		Taksë trualli		Tarifë gjelbërimi		Tarifë e mirëmbajtjes së hyrjeve të pallatit		Total
		Nr. Fam	Vlera	Nr. Fam	Vlera	Nr. Fam	Vlera	Nr. Fam	Vlera	Nr. Fam	Vlera	Nr. Fam	Vlera	Nr. Fam.	Vlera	Nr. Fam	Vlera	Nr. Fam	Vlera	Nr. Fam	Vlera	
1	BURREL	151	54,556	2,106	3,294,257	2,565	5,741,002	2,517	654,616	2,564	1,280,375	2,566	2,887,200	-		148	12,964	2565	999278	2240	4475833	19,400,081
2	KOMSI	330	223,041	313	2,591,682	394	2,735,158	2	520			397	546,400	90	54,000	323	28,154	-		-		6,178,955
3	LIS	529	487,291	552	4,238,086	760	4,890,780	23	5,980	23	11,500	760	1,762,800	721	432,600	568	127,937	23	8970	19	38000	12,003,944
4	BAZ	207	194,934	188	1,035,446	254	1,279,570	2	520	-		253	373,600	194	216,400	185	38,999	-		-		3,139,469
5	ULËZ	156	309,126	221	3,328,498	249	2,617,740	75	39,000	-		157	254,400	250	300000	156	121,277	55	42900	-		7,012,941
6	MACUKULL/ DERJAN	625	645,924	626	3,625,756	678	2,758,480	-		-		690	1,560,000	63	75600	633	305,776	-		-		8,971,536
7	RUKAJ	389	434,041	403	2,188,964	361	1,904,980	-		-		422	565600	26	30000	402	175,701	-		-		5,299,286
	TOTAL	**2,387**	**2,348,913**	**4,409**	**20,302,689**	**5,261**	**21,927,710**	**2,619**	**700,636**	**2,587**	**1,291,875**	**5,245**	**7,950,000**	**1,344**	**1,108,600**	**2,415**	**810,808**	**2,643**	**1,051,148**	**2,259**	**4,513,833**	**62,006,212**

Burimi: *DTTV, përpunuar nga grupi i auditimit.*

Konkluzion: Në bazë përpunimit të të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave si dhe informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Mat, rezultoi se ka nivel të lartë debitorësh **për taksat dhe tarifat** në numër dhe në vlerë, për taksapaguesit e kategorisë "familjar" në fund të vitit 2025 vlera e borxhit është **62,006,212 lekë**, i cili nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, kështu në fillim të **vitit 2025** vlera borxhit ishte **43,562,163 lekë, vlera borxhit e krijuar gjatë vitit 2025 është 18,444,049 lekë.** Mosarkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga debitorët është në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"*Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 42, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, *neni 51,* neni 9 pika 1.3 nënpika (ç).

- Detyrime nga taksat dhe tarifat vendore për familjet në vlerën **62,006,212** lekë, vlerë kjo që ka sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Mat. Kjo vlerë nuk është kontabilizuar në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" në pasqyrat financiare. Këto veprime janë në kundërshtim me me UMF nr.5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në UMFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kap. III, pika 3.2 "Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve" paragrafi "Vlerësimi i të drejtave dhe detyrimeve" faqe 28-30.

➢ *Menaxhimi i borxhit nga taksat e tarifat vendore. Auditimi i rasteve në lidhje me zbatimin e masave shtrëngese për arkëtimin e borxhit ndaj subjekteve debitorë***.**

Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore (DTTV), Bashkia Mat është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara vijnë duke u përshkallëzuar si:

- Njoftimi dhe kërkesa për të paguar;
- Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit;
- Masa e sigurimit të detyrimit tatimor;
- Sekuestrimi i pasurisë.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur hapat që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë dërguar dhe njoftuar me njoftim vlerësimi tatimor të gjithë bizneset brenda afateve të përcaktuara në paketën fiskale konkretisht brenda datës 30.04.2025 janë dërguar njoftim vlerësimet për subjektet tregtare në lidhje me tarifat lokale, brenda datës 30.06.2025 janë dërguar njoftim vlerësimet për pronarët e pasurive të paluajtshme dhe për subjektet e krijuara rishtazi janë dërguar brenda afatit të përcaktuar.

Për subjektet debitore dhe familjarët me detyrime të papaguara për kalimin e afatit të pagesave të detyrimit për taksat dhe tarifat vendore janë dërguar njoftime dhe kërkesa për pagese.

Për vitin 2025 drejt debitorëve familjarë për detyrimet e akumuluara DTTV u ka dërguar 5226 njoftime dhe kërkesë për pagesë në vlerën 43,562,163 lekë. Ku 477 kryefamiljarë kanë arritur të paguajnë vlerën prej 4,119,922 lekë. Njoftime dhe kërkesë për pagesë për debitorët familjarë më hollësisht janë paraqitur në Aneks.

Njoftime dhe kërkesë për pagesë për vitin 2025 për debitorët sipas Njësive Administrative

Nr	Njësia Administrative	Nr.rastesh	Vlerë	Nr.Prot, datë	Nr.rastesh	Arkëtime
1	Burrel	2958	9,910,434	Nr.177 Prot, datë 12.01.2025	226	2,436,267
2	Komsi	533	5,238,737	Nr.80Prot , date 06.02.2025	79	480,727
3	Lis	162	9,466,870	Nr.209, date 09.06.2025	63	408,017
4	Macukull/Derjan	626	6,663,986	Nr.19Prot, 14.01.2025	33	220,633
5	Baz	57	2,198,056	Nr.35Prot, date 15.02.2025	17	105,101
6	Rukaj	359	3,958,568	Nr.36Prot, date 30.01.2025	41	348,575
7	Ulëz	531	6,125,512	Nr.26Prot, date 08.02.2025	18	100,652
	TOTAL	**5226**	**43,562,163**		**477**	**4,119,922**

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se, për vitin 2025 drejt subjekteve tregtare janë dërguar 688 njoftime dhe kërkesë për pagesë në vlerën 57,456,062 lekë. Veç njoftimeve për detyrimet e akumuluara, DTTV u është drejtuar edhe bankave të nivelit të dytë për bllokim të llogarive bankare, në total me 273 shkresa me 273 subjekte për vlerën 40,555,532 lekë, ku 95 subjekte kanë reaguar duke paguar vlerën prej **10,278,574** lekë. Në mënyrë të detajuar masat shtrënguese të marra ndaj subjekteve debitorë të biznesit paraqiten në Aneks.

Njoftim dhe kërkesë për pagesë për subjektet debitore,

Njoftime-kërkësë-pagesë 2025			
Nr. protokolli	**Datë**	**Nr. rastesh**	**Vlerë në lekë**
660	17.02.2025	5	4,505,658
749	26.02.2025	93	25,982,044
811	28.02.2025	590	26,968,360
		688	**57,456,062**

Masat shtrënguese për subjektet debitore dhe zhbllokimet e viteve të kaluara

			Bllokime		Zhbllokim	
Institucioni	**Nr.**	**Datë**	**Nr i debitorve**	**Vlera në lekë**	**Nr I debitorve**	**Vlera në lekë**
Bankat e nivelit te dyte	3760	22.10.2025	273	40,555,532	95	10,278,574
Shuma			**273**	**40,555,532**	**95**	**10,278,574**
Urdher sekuestro	4614	23.12.2025	4	**2,563,288**	**3**	**2,331,633**
Shuma			**4**	**2,563,288**	**3**	**2,331,633**

Burimi: *DTTV, përpunuar nga grupi i auditimit.*

Nga dokumentacioni i paraqitur dhe të dhënat e tabelës më lart vihet re se pavarësisht urdhrave të bllokimeve të lëshuara në vitin aktual ka patur arkëtime dhe nga urdhra bllokimesh të lëshuara në vitet paraardhëse konkretisht në **95 subjekte** për vlerën **10,278,574 lekë.**

Në vijim të punës për vjeljen e detyrimeve në vitin 2025 janë nxjerrë 688 njoftime për biznesin dhe 5226 për familjarët, urdhër për bllokime të llogarive bankare për 273 biznese dhe 4 urdhër sekuestro. Si rezultat i këtyre masave të marra nga debitorët gjatë vitit 2025 kanë likuiduar detyrimet 98 subjekte në vlerën 12,610,207 lekë dhe 477 taksapagues familjarë në vlerën 4,119,922 lekë.

Konkluzion: Drejtoria e Taksave Vendore në Bashkinë Mat për vjeljen e detyrimeve është mjaftuar me nxjerrjen e njoftim-vlerësimeve për detyrimin dhe një numri të kufizuar të masave shtërnguese dhe nuk janë aplikuar të gjitha masat administrative dhe ligjore, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Kreu XI "Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara", nenet 89, 90, 91 dhe 93 dhe me VKB nr. 90, datë 24.12.2024 "Për miratimin e paketës fiskale 2025 të Bashkisë Mat".

- *Planifikimi dhe arkëtimi i taksës së tokës bujqësore.*

Taksa mbi tokën bujqësore **për vitin 2025** taksa e tokës është realizuar në shumën 692,831 lekë nga 1,600,000 lekë të planifikuara, ose në masën 43%. Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore për biznesin është Drejtoria e Taksave Vendore pranë Bashkisë Mat sipas parashikimeve të paketës fiskale, kurse për njësitë e tjera administrative struktura e ngarkuar janë punonjësit e caktuar në njësitë administrative sipas parashikimeve të paketës fiskale. Ndërsa struktura që bën planifikimin e taksës së tokës bujqësore është Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjeve në Agjencinë e Funksioneve të Patransferueshme. Të dhënat mbi fondin e tokës bujqësore sipas korespondncës zyrtare me Drejtoria e Administrimit e Mbrojtjes së Tokës(DAMT) në Këshillin e Qarkut Dibër parqiten në tabelën mëposhtme:

Fondi i tokës bujqësore sipas Drejtorisë së Mbrojtjes së tokës deri më 31 Dhjetor 2025

Nr	Emërtimi	Njësia	Shuma	Arë	Pemtore	Vreshtë	Ullishte
	SIPËRFAQJA E TOKËS GJITHËSEJ	**Ha**	**8240.65**	**7047.37**	**1009.5**	**183.78**	
1	Nga Kjo :						
2	**TOKË NË PRONËSI PRIVATE : Nga e cila:**	**Ha**	**5204.57**	**5097.37**	**79**	**28.2**	
2/1	Tokë në pronësi private me origjinë nga ish Kooperativat Bujqësore	Ha	4678.87	4614.87	60	4	
2/2	Tokë në pronësi private me origjinë nga ish	Ha	525.7	482.5	19	24.2	
	Ndërmarrjet Bujqësore						
3	**TOKË NË PRONËSI SHTETËRORE : Nga e cila:**	**Ha**	**3036.08**	**1950**	**930.5**	**155.58**	
3/1	Tokë e pandarë me origjinë nga ish Kooperativat Bujqësore	Ha	2631.08	1749	772.5	109.58	
3/2	Tokë me origjinë nga ish-kooperativat kaluar Agjensisë së Trajtimit të Pronave	Ha					
3/3	Tokë disponibël shtetërore me origjinë nga ish Ndërmarrjet Bujqësore	Ha	405	201	158	46	
3/4	Tokë e ish-Ndërmarrjes bujqësore dhënë në përdorim familjeve bujqësore	Ha					
3/5	Sipërfaqe toke në administrim të Institucioneve të tjera shtetërore.	Ha					

Referuar të dhënave që disponon Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjeve sipas fondit të tokës së ndarë dhe kategorizimit të saj, si dhe tarifave sipas kategorisë së tokës në paketën fiskale, planifikimi I të ardhurave nga taksa e tokës paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Planifikimi i të ardhurave nga taksa e tokës

Kategoria e Tokës	**Sip/ha Nj.A Macukull**	**Sip/ha Nj.A Lis**	**Sip/ha Nj.A Rukaj**	**Sip/ha Nj.A Derjan**	**Sip/ha Nj.A Komsi**	**Sip/ha Nj.A Baz**	**Sip/ha Nj.A Ulëz**	**Shuma në ha sipas kateg**	**Shuma e në ha tokë bujqësore private**	**Lekë ha/vit sipas kateg. sipas paketës fiskale**	**Planifikimi i përlloga ritur**	**Planifikimi i bërë nga Bashkia Mat Në lekë**
Kategoria e II	0	0	0	0	0	0	0	0				
Kategoria e III	0	0	0	0	0	0	0	0		1400		
Kategoria e IV	220	0	0	0	0	27	0	247	247	1350	333,450	200,000
Kategoria e V	717	0	1687	569	1476	0	0	4449	2449	1250	3,061,250	850,000
Kategoria e VI	399	534	110	166	426	1134	197	2966	1966	1200	2,359,200	300,000
Kategoria e VII	0	214	0	0	0	0	316	530	500	1100	550,000	250,000
Kategoria e VIII	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1100		
Totali	**1336**	**748**	**1797**	**735**	**1902**	**1161**	**513**	8192	5162		**6,303,900**	**1,600,000**

Konkluzion: Bazuar në dokumentacionin e vënë dispozicion nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjeve konstatohet se, nuk janë bërë përditësimet e nevojshme të fondit të tokës bujqësore si dhe identifikimin dhe saktësimin e fermerëve taksapagues me qëllim përcaktimin e saktë të detyrimeve për taksën e tokës. Referuar të dhënave mbi fondin e tokës bujqësore të ndarë sipas Njësive Administrative dhe kategorisë së tokës dhe përcaktimeve të paketës fiskale sipas kategorive nga përllogaritjet rezulton se planfikimi i të ardhurave nga taksa e tokës është në shumën 6,303,900 lekë, ndërkohë që sipas aktrakordimit me Thesarin planifikimi është në shumën 1,600,000 lekë e cila nuk ka bazë reale, me një realizim në fakt në shumën 692,831 lekë, ose në masën 43% kundrejt planit, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.8752, datë 26.03.2021 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës" i ndryshuar, neni 11,12, me VKM nr.121, datë 17.02.2011 "Për mënyrat të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjen së tokës në qarqe dhe zyrate e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komuna dhe/ose bashki" i ndryshuar Kreu II "Detyrat dhe përgjegjësitë e DAMT-së për mbajtjen dhe ruajtjen dhe përtëritjen e dokumentacionit kadastral mbi tokën", me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* i ndryshuar, nenet 6 dhe 9 **p**ika 1.3, me VKB nr 90, datë 24.12.2024 "Mbi miratimin e paketës fiskale 2025 për Bashkinë Mat", dhe me Rregulloren e Bashkisë Mat.

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi z. A. H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pyjeve në Agjencinë e Funksioneve të Patransferueshme.

- *Ndjekja e procedurave për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore*.

Në **fund të vitit 2024** rezulton se vlera debitore për taksën e tokës bujqësore është në shumën **1,962,762 lekë**. **Gjatë vitit 2025** rezultojnë 2387 familje debitore në shumën 386,151 lekë, Ndërsa **në fund të vitit 2025** për taksën e tokës janë debitorë 3482 familje fermere në vlerën progresive prej **2,348,913 lekë**. ku peshën më të madhe të familjeve debitore e ka Njësia Administrative Macukull/Derjan, duke vijuar me Njësinë Administrative Lis, ndërsa peshën më të vogël e ka

Njësia Administrative Burrel. Më poshtë pasqyrohet ecuria e debitorëve të rezultuar për taksën e tokës bujqësore:

Në lekë

Debitorë për taksën e tokës bujqësore viti 2025					
Njësia Administrative		Debitorë të krijuar në vitin 2025 (Lekë)			Ne fund të vitit 2025
	Debitorë të trashëguar deri ne fillim të vitit 2025	Familje me tokë bujqësore	Familje debitore(Nr)	Familje debitore (vlerë)	DEBIA PROGRESIVE
Burrel	23,698	376	151	30,858	54,556
Komsi	156,171	941	330	66,870	223,041
Lis	400,000	856	529	87,291	487,291
Baz	150,000	324	207	44,934	194,934
Rukaj	400,000	554	389	34,041	434,041
Macukull/Derjan	542,267	753	625	103,657	645,924
Ulëz	290,626	245	156	18,500	309,126
TOTAL	**1,962,762**	**4049**	**2387**	**386,151**	**2,348,913**

Burimi: DTTV, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Konkluzion: Nga Drejtoria e Taksave Vendore nëpërmjet specialistëve të taksave në 8 Njësitë Administrative (Burrel, Baz, Komsi, Lis, Macukull, Derjan, Rukaj, Ulëz) nuk është kryer punë e mjaftueshme për përditësimin e të dhënave si dhe për rritjen e arkëtimeve dhe uljen e borxhit për taksën e tokës, e cila në fund të vitit 2025 është në shumën 2,348,913 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* i ndryshuar, neni 6, neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë"**,** pika 1.3. nënpika(ç)

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: zj.S. C. me detyrë Drejtore e Taksave Vendore.

- *Mbi menaxhimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë.*

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Sektori i Planifikimit Urban dhe Mjedisit në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës, Bashkia Mat në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT, Mat janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ASHK, Drejtoria Mat.

Konkluzion: Referuar listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimit të tyre me pagesat e kryera nga personat që kanë patur detyrime për taksën e ndikimit në infrastrukturë, u konstatua se n**ë fund të vitit 2024** se detyrimet e pa paguara për TNI nga legalizimet janë në vlerën 3,768,709 lekë. G**jatë vitit 2025** janë legalizuar 37 objekte me vlerë totale të detyrimit 1,256,968 lekë, janë arkëtuar 1,325,882 lekë dhe kanë mbetur detyrime pa likujduar deri datë 31.12.2025 me vlerë progresive 3,699,795 lekë nga 54 persona. Nga Sektori i Planifikimit Urban dhe Mjedisit në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës nuk është bërë punë e mjaftueshme për arkëtimin e (TNI) nga legalizimet, veprime këto në kundërshtim me me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006"*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, i ndryshuar me Ligjin nr. 95/2018, neni 9, pika 3/c, me ligjin nr. 98/2020 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar, neni 1, "në nenin 27, pika 3, shkronja "c", me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim*" pika 5, me VKB nr. 90, datë 24.12.2024 "*Mbi miratimin e Paketës Fiskale 2025 për Bashkinë Mat*". Në mënyrë të përmbledhur debitorët e taksës së ndikimit në infrastrukturë paraqiten në aneks.

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi: z. A. G. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës.

- *Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:*

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Sektori i Monitorimit Kontratave Publike, Hapësirat Rekreative dhe Transportit në Drejtorinë e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Kontratave, rezultojnë se për vitin 2025 ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Mat dhe në

Njësitë Administrative **10** subjekte, të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, të cilat paraqiten në aneksin nr. 4 pika 2 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Konkluzion: Referuar dosjeve të subjekteve që operojnë në territorin e Bashkisë Mat për shitje me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tij konstatohet se, për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 10 subjekte nga të cilat 2 subjekte janë të pajisura me autorizim me afat me 5 vjet për lejim ushtrim aktiviteti dhe kanë kryer pagesë për vlerën e plotë prej 1,000,000 lekë dhe 6 subjekte janë pajisur me atorizime për lejim ushtrim aktiviteti me afat 1 vjecar të cilët kanë kryer pagesa pjesore. Ndërsa 2 subjekte "J." dhe "P." nuk janë pajisur me autorizime, duke rezultuar me **detyrime të pashlyera në vlerë totale 600,000 lekë**. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, ligjin nr. 71/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, nenet 4,15 dhe 20/2" dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", kreu II, pika 3, pika 15.1.

- *Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta:*

Të ardhurat nga agjentët tatimorë derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Mat dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Mat me të cilin mbahen akt-rakordimet mujore. Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë gjatë periudhës së audituar janë:

në lekë

Agjenti Tatimor	Lloji i Taksës	Vlera e realizuar Viti 2025
Drejtoria Rajonale Tatimore	Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin	59,739
Drejtoria e Përgjith e Shërbim të Transport Rrugor, Drejtoria Rajonale Dibër	Taksa vjetore e mjete të përdorura	15,576,403
SH.R.U.K.Dibër	Taksa & Tarifa Vendore Familjare	30,946,598.15
D. R. T Dibër; D.R.T Tiranë Tatimpag e Mëdhenj e Drejtori e Përgjithsh e Dogana	Renta Minerare	470,090
Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Dibër	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë	142,385
	Totali	**47,195,215.15**

- DTTV e Bashkisë Mat ka kryer akt rakordimet përkatëse me Drejtorinë Rajonale Tatimore Dibër në lidhje me Tatimin e thjeshtuar mbi fitimin.
- Pjesa më e rëndësishme e të ardhurave që vilen me agjentët tatimorë është Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër (SH.R.U.K.DI). Është shumë e rëndësishme të theksohet se vjelja e këtyre të ardhurave ka pasur përmirësime pas kontraktimit me Agjentin Tatimor nga viti 2020 e në vazhdim. Nga verifikimi i akt rakordimeve mujore të mbajtur midis Bashkisë dhe SHRUKD rezulton që, taksat e tarifat e vitit 2025 janë kaluar në favor të Bashkisë Mat në vlerën prej 30,946,598.15 lekë.
- Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet është bërë rakordimi periodik i rregullt mujor me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, Dibër. Janë kryer kërkesa për transferim të rentës minerare drejtuar, Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër, dhe rakordimi i pjesës takuese te rentës minerare që i përket Bashkisë Mat dhe rezulton realizim i rentës minerare për vitin 2025 në vlerën 470,090 leke e realizuar në masën 112% nga planifikimi prej 420,000 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në aktkonstatimin nr.7, datë 29.05.2026)

3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2025, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.
3.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.

- ***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:***

Për vitin 202025 nga njësia shpenzuese "Bashkia Mat " për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5 datë 21.02.2022.

- ***Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.***

Bashkia Mat për vitin 2025 ka hartuar Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, pasi ka në varësi njësi shpenzuese me nipt më vete si me poshte:

1. Agjensinë e Funksioneve të patransferueshme Mat
2. Agjensinë e Funksioneve të transferueshme Mat
3. Klubi i Futbollit Burreli
4. Tregu sha Mat

- ***Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare***

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Mat për vitin ushtrimor 2025 me shkresë përcjellëse nr.prot.1113, datë 24.03.2026. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari i Bashkisë Mat dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori Financës. Pra në këtë rast nuk kemi delegime të detyrave.

- ***Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.***

Për vitin 2025 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrate banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- *Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit*

- ***Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.***

Për tu siguruar nëse regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në rregjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:
- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mosndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:
- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabiltetit të Aparatit Bashkisë***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:
- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program "Excel"dhe nuk ka një program financiar, i cili do të shmangte pasaktësitë
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjke dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditaret e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj. Eshtë mbajtur libri i madh për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në librin e madh deri në bilancin vërtetues. Gjithashtu është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumentave bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vertetesi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e nje prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arketimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

- ***Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.***

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financaiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomiko - financiar për vitin 2025

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhen nën auditim

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të rregjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.
Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin rregjistruar janë rregjistruar, **Saktësia:** Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e rregjistruara dhe ngjarjet janë rregjistruar në mënyrë të përshtatshme
Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë rregjistruar në periudhen e saktë kontabël, **Klasifikimi:**Transaksionet dhe ngjarjet janë rregjistruar në llogaritë e duhura.
Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhes

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe fondet e veta ekzistojnë.
Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.
Plotësia: Të gjitha asetet dhe fondet e veta janë rregjistruar, dhe detyrimet janë rregjistruar të gjitha në mbyllje të vitit ushtrimor, pra janë të paraqitura të plota në bilanc..
Vlerësimi dhe alokimi: Aktivet, pasivet dhe fondet e veta janë të përfshira në pasqyrat financiare me shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, si dhe rregullimet që rezultojnë janë të rregjistruara.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara, si dhe janë mbajtur shënimet shpjeguese, të cilat shprehin paqartësitë e ndodhura.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera në përgjithësi është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasinë e duhur.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Finances Zhvillimit Ekonomik dhe Monitorimit të Kontratave . Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në celje për vitin 2025 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2024.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2025 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Konkluzion: Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë 520 "Disponibilitete në Thesar" dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në formatin nr.5 "Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2025".

- *Nga testi kontrollit për vitet 2025 në lidhje me:*

Rregullaritetin i veprimeve me arkë nga ku rezultoi se:

Veprimet me arkë kryhen vetëm për rastet e arkëtimit për pagesat e kopshteve dhe çerdheve.gjendja e arkës nuk e kalon limit e arkës. Për të gjitha arkëtimet ditore bëheshin derdhjet në bankë në llogarinë likujduese të institucionit.

Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konform nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* dhe kreut III pika 34 dhe 35 germat a, b dhe c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3 të ligjit nr.290, datë 14.06.1993 *"Për limitin e arkës"*.

Ligjshmëria dhe saktësia e e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

- *Vlerësimi nëse aktivet dhe pasivet janë llogaritur saktë dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.*

Totali i Aktivit për vitin 2025 është në vlerën 5,375,932,897 lekë dhe i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari sintetike dhe analitike paraqitet në aneksin nr. 1 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

A. AKTIVE AFATSHKURTRA

Në formatin nr. 1 **"Aktivet Afatshkurtra" në aktiv të bilancit** paraqiten në mbyllje të vitit 2025 në vlerën **617,548,620** lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 559,664,353 lekë.

Klasa 5 "Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre" në mbyllje të vitit 2025 është në vlerën **248,881,567** lekë**,** të cilat rakordojnë me rubrikën VI " Teprica e likujditeteve në fund te vitit ushtrimor" në Formatin nr.3 "Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOW) sipas metodës direkte" të paraqitur në aneksin nr. 2 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

- Referuar analizës së pasqyrës në formatin nr.5 "Pasqyra e lëvizjes në cash viti 2024" rezulton se vlerat në zërat anilitikë në rreshtat e pasqyrë nuk janë të sakta si:
- Tek rubrika II "Arkëtime e të hyra (Cash), gjatë vitit ushtrimor" të hyrat nga të ardhurat jotatimore janë 0 lekë, kur në pasqyrën e performancës janë në shumën 22,894,696 lekë, shumë e cila është përfshirë në zërin të hyra nga tatimet në shumën 145,190,441 lekë, e cila rakordon me akt-rakordimin e thesarit. Ndërsa në pasqyrën e përformancës të ardhurat gjithsej në shumën 145,190,441 lekë përbëhen nga gjendjet në: llogarinë 70 "Të ardhurat nga taksat dhe tatimet" janë në shumën 88,499,157 lekë, llogarinë 71 "Të ardhurat jotatimore" në shumën 22,894,696 lekë, llogarinë 7204 "Pjesëmarrje e institucioneve në tatimet nacionale" në shumën 29,596,588 lekë, llogarinë 7202 "Grant nga një nivel qeverisje-nga buxheti i pushtetit vendor" në shumën 4,200,000 lekë.
- Rubrika 3 "Pagesa për detyrime e shpenzime korente"në shumën 594,042,809 lekë rakordon me realizimin e fondeve për shpenzime korente sipas aktrakordimit me thesarin. Tek kjo rubrikë pagesa për detyrime nga vitet e kaluara në mbyllje të vitit 2025 është - 84,519,169 lekë, ndërsa pagesat për detyrimet për fatura të palikujduara për vitet e kaluara sipas tabelës së analizës së detyrimeve afatshkutra në llog.401-404 "furnitorë e llogari të lidhura me to" dhe llog.467 "kreditorë të ndryshëm" janë në vlerën 105,545,579 lekë me një deviacion prej 21,026,410 lekë, duke u keqklasifikuar në zërin "Pagesa për detyrime e shpenzime korente", e cila rakordon me thesarin.
- Në rubrikën "Veprimtaritë e investimeve" zëri "Akordim fonde buxhetore për shpenzime kapitale" paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 482,310,109 lekë, e cila rakordon me fondet e çelura për investime për vitin 2025 sipas akt-rakordimit me Thesarin.

Konkluzion: Ky format në nivel llogarish sintetike është plotësuar në mënyrë të saktë, ku teprica e likujditeteve në fund të vitit ushtrimor rakordon me tepricën e llogarisë 520 *"Disponibilitete në Thesar",* sipas bilancit në mbyllje të vitit 2025 është në vlerën 248,881,567 lekë, gjendje e cila rakordon dhe me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit, ku lëvizjet e këtyre disponibiliteteve paraqiten në formatin nr.5 "Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2025".

Në klasën 3 "Gjendja e inventarit qarkullues" të aktiveve qarkulluese paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën **76,757,644** lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 77,834,735 lekë, ku diferenca e tyre në ulje në vlerën prej -1,077,091 lekë rakordon me gjendjen e llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" në formatin nr.2 "Pasqyra e performancës financiare". Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:

- Gjendja e llogarisë 31 "Materiale" paraqitet paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 41,419,252 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 39,001,811 lekë me një diferencë në ulje për vitin ushtrimor prej -3,663,419, lekë, e cila përfaqëson rritje të gjendjes së mallrave në fund të vitit 2024.

- Gjendja e llogarisë 32 "Inventari i imët" paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 44,382,444 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 38,832,924 lekë me një shtesë për vitin ushtrimor prej 2,586,328 lekë, e e cila përfaqëson rritje të gjendjes së mallrave ne fund te vitit 2025.

Klasa 4 "Llogari të arkëtueshme" paraqiten në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 291,909,409 lekë dhenë mbyllje të vitit 2024 në vlerën 232,364,802 lekë, ku kemi shtesë duke e krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i rritjes se detyrimeve te debitorëve të ndryshëm.

- ***Teprica e llogarisë* 423,429 *"Personeli, paradhënie, deficite, gjoba"***. paraqitet në të njëjtën shumë prej 17,774,523 lekë si në mbyllje të vitit 2024 dhe në mbyllje të vitit 2025, e cila përfaqëson detyrime të lëna për kthim nga auditimet e ushtruara nga Prefektura dhe KLSH në ish-komunat sot NJA para viteve 2015 të trashëguara nga pasqyrat financiare të tyre, të cilave u ka kaluar afati kërkimit për arkëtim.

- ***Gjendja e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm",*** e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, ku në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 73,566,885 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën 73,841,617 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2025 në krahasim me vitin 2024 ka pësuar një ulje prej 274,732 lekë. Në vlerën e lartë të gjendjes së llogarisë së debitorëve ka ndikuar dhe gjendja e debitorëve të krijuar në vitin 2025 nga detyrimet e lindura nga Kontratat e Heceve për fondin pyjor kullosor në shumën 14,503,526 lekë dhe taksa e ndikimit në infrastrukturë në shumën 5,025,677 lekë. Analiza e gjendjes së llog.468 "Debitorë të ndryshëm" dhe lëvizjet e pësuara në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Nr	Emërtimi	Gjendja me 31.12.2024	Shtesa 2025	Pakësime 2025	Mbetja 2025
1	Nj. Admin detyrime nga taksat te trshegu	6,846,344			6,846,344
1	Biznesi i Madh	25,775,959	14,238,886	17,376,451	22,638,394
2	Biznesi i Vogël	23,520,822	13,177,730	16,619,206	20,079,346
3	Biznesi Vip	5,972,743	17,041,490	22,625,141	389,092
4	Lojra fati ,kompani sigurimesh	904,632	175,460	184,710	895,382
5	Institucionet	2,733,500	2,468,000	2,465,000	2,736,500
6	Ambulantët	2,440,782	-	137,134	2,303,648
9	Gjoba të Inspektoriatit Ndërtimor	2,750,000	-	-	2,750,000
10	Tregu Industrial	2,285,900	-	-	2,285,900
11	Tregu Industrial	610,935	-	-	610,935
12	Subjektet Hidrokarbure	-	3,200,000	2,600,000	600,000
13	Kontratat	-	14,503,526	6,771,976	7,731,550
14	Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë	-	5,025,677	1,325,882	3,699,795
	SHUMA	**73,841,617**	**69,830,769**	**70,105,500**	**73,566,886**

K**onkluzion:** Referuar analizës gjendjes së llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" e cila paraqitet në shumën 73,566,885 lekë rezulton se nuk është përfshirë shuma e debitorëve prej 62,006,212 lekë të taksapaguesve të kategorisë "familjarë" si dhe gjobat e Policisë Bashkiake në shumën 880,000 lekë në kundërshtim me UMF nr.5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kap. III, kap.3.1, pika 32, pika 3.2 "Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve" paragrafi "Vlerësimi i të drejtave dhe detyrimeve" fq 28-30.

- ***Teprica e llogarisë 4342* "Të tjera operacione me shtetin (të drejta)"** në aktiv të pasqyrës të pozicionit financiar paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në shumën 200,568,001 lekë, e cila përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për mbulimin me fonde në vitin pasardhës të shpenzimeve të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara. Kjo gjendje rakordon me shumën e llogarive kundërparti në pasivin e bilancit: llog.401-404 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" në vlerën 185,703,907 lekë, llog.42"Detyrime ndaj personelit" për vlerën 8,004,613 lekë, llog.431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa" për vlerën 818,905 lekë, llog.435 "Sigurime shoqërore" për vlerën 2,452,924 lekë, llog.436 "Sigurime shëndetësore" për vlerën 338,432 lekë dhe vlerën pjesore prej 3,249,210 lekë të llog.467"Kreditorë të ndryshëm".

II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Auditimi i aktiveve afatgjata materiale

Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

2. Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

- Për auditimin e aktiveve **afatgjata materiale**, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:
- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve **afatgjata materiale** në raport me gjëndjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet **afatgjata materiale**;
- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuara dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjate ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:

a. Gjatë hyrjes se aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave te UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

- Për Aktivet e blera janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Për Aktivet e marra falas janë kryer teste për 3 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

b. Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:

- Proçedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuara;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 **"Aktivet Afatgjata" në aktiv të bilancit** paraqiten në vlerën neto në mbyllje të vitit 2025 në vlerën **4,758,384,277** lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 4,519,308,478 lekë, ku diferenca përfaqëson vlerën e amortizimit të llogaritur.Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)"paraqiten në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 4,317,682,786 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 3,453,528,328 të cilat janë të pasqyruara më poshtë sipas llogarive analitike.

Klasa 20 "Aktive Afatgjata jo materiale" që përbëhet nga**:**

Konkluzion: Gjëndja e llogarisë 202 ***"Studime dhe kërkime"*** në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2025 në shumën 46,282,809 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në shumën prej 45,199,039 lekë, të cilat rakordojnë me llogarinë anloge në Formatin 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)". Në mënyrë të detajuar gjendja e kësaj llogarie paraqitet në aneksin nr. 3 pika 3 bashkëlidhur projektraportit të auditimit. Vlera e mbetur në fund të vitit 2025 prej prej 46,282,809 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e *llogarisë 202 "Studime dhe Kërkime",* për 23 projekt-studime për investime të pakryera ose të kryera nga ish-komunat, të cilat duhet ishin shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale në rastin e investimeve të kryera. Gjithashtu për këto aktive nuk është llogaritur amortizimi në masën 15% që nga viti 2021, duke sjellë mbivlerësimin e tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave

financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II pika16/b.d, Kreu III. pika 36, Aneksi 1 pika 2 Klasa 2.

U zhvilluan teste kontrolli dhe teste të detajeve të posteve Aktiveve materiale të llogarive sintetike dhe analitike të bilancit kontabël për vitin 2024 dhe 2025.

Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) "Aktivet afatgjata materiale" paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2025 në 3,407,245,519 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në shumën totale prej 3,118,299,876 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqiten në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 4,268,972,950 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024, në vlerën 4,734,893,142 lekë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- ***Gjendja e llog. 210 "Toka, Troje, Terrene"*** paraqitet me vlerë neto me vlerë neto në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 5,683,586 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në në vlerën 5,683,586 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" si në mbyllje të vitit 2025 eshte 5,683,586 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 është në vleren 5,683,586 lekë dhe nuk ka asnjë ndryshim nga viti në vit. Kjo gjendje paraqitet e analizuar sipas vlerës bruto në tabelën e mëposhtme:

llog	Emertimi	Kosto 2024	Shtesa	Pakesime	Kosto 2025
210	Toke per Varrezat	4,532,186			4,532,186
210	Shpronesim per varreza	1,151,400			1,151,400
	Shuma 210	**5,683,586**	-	-	**5,683,586**

- ***Gjendja e llogarisë 211 "Pyje, Plantacione"*** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2025 ne shumen prej 11,389,867 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 10,550,203 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025 ne vleren 11,389,867 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në shumën prej 10,550,203 lekë.

Inventari kontabel i llogarisë *211 "Pyje, Plantacione"* me datë 31.12.2025

Llog	Emertimi	Viti I venies ne pun	vlera e mbetur 31.12.2024	Shtesa	Pakesime	Kosto 2025
211	Pyllzim me arror	2 011	8,071, 53			8,071, 53
211	Pyje e Kullota	2 012	1, 365,71			1, 365,71
211	Sistemim gjelberim		1,112,96			1,112,96
211	Pyllezim	2 025		839,66		839,66
	Shuma		10,550,203	839,66	-	11,389,86

- ***Gjendja e Llogarisë 212 "Ndërtesa Konstruksione"*** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 1,243,097,957 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 958,455,621 lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,395,179,276 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 1,735,861,012 lekë. Gjatë vitit 2025 janë pakesuar aktive per shkak te amortizimit ne vleren 56,039,400 leke dhe jane shtuar aktive ne vleren 340,681,736 lekë.

- ***Gjendja e Llogarisë 213"Rrugë, rrjete, vepra ujore"*** paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 2,054,589,028 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në 2,059,157,591 lekë. Gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 2,731,546,252 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 2,630,422,068 lekë. Gjatë vitit 2025 janë bërë shtesat në vlerën 101,124,184 lekëdhe pakësime nga amortizimi në vlerën 105,692,747.

- ***Gjendja e llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"*** në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 30,328,774 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 7,393,785 lekë. Ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2025 ne vleren 36,483,206 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën13,183,448 lekë ku është pakesuar gjatë vitit 2025 per shkak te amortizimit 364,669 leke dhe është shtuar ne vlerën 23,299,758 leke.

- Gjendja e llogarisë 215 "Mjete Transporti" në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 30,755,426 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 38,444,282 lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 39,487,454 dhe në mbyllje të vitit 2024 eshte në vlerën 39,274,454 lekë ka shtesa në vlerën 213,000 leke dhe pakësime nga amortizimi në vlerën 2,382,548 lekë gjatë vitit 2025. Analiza e gjëndjes së kësaj llogarije dhe lëvizjet e këtyre aktiveve në fund të vitit 2024 dhe 2025 paraqiten në aneksin nr. 4 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.:

- Gjendja e llogarisë 218 "Inventar ekonomik" paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën neto prej 52,413,117 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën neto 65,146,352 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 174,441,765 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 174,679,915 lekë.

- Gjendja e aktiveve afatgjata në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet per vitin 2025 paraqiten në Formatin nr.7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)" të PF paraqitet në aneksin nr. 5 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit. Në pasqyrën"Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata"në rubrikën "Shtesat gjatë vitit ushtrimor (kosto historike) shuma prej 294,385,190 lekë e evidentuar në kolonën "Lëvizje brenda aktiveve" shumë e cila duhej të evidentohej në kolonën "Blerje e krijuar me pagesë", pasi nga analiza e investimeve janë aktive të financuara nga buxheti i bashkisë. Kolona "Shtesa pa pagesë brenda sistemit" e paraqitur shuma prej 86,431,655 lekë duhet të evidentohej në kolonën "Shtesa pa pagesë jashtë sisitemit" pasi nga analiza rezulton se:
- Shuma prej 22,450,579 lekë në llogarinë 212 "Ndërtesa e konstruksione" i përket Investimit me objekt: " Rikonstruksion Pallati i Kultures faza 1" financuar me fondet me financim të huaj (grant) tek bankat e nivelit të dytë gjatë vitit 2024 por që nuk është përfshirë në pasqyrat financiare të vitit 2024
- Shuma prej 44,503,641 lekë e llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune" janë materiale të ardhura falas për shkollat nga ZVA Mat dhe materialeë të ndryshme ndërtimi sipas marrëveshjes me FSHZH
- Shuma prej 19,264,435 lekë e llogarisëë 218 " Inventar ekonomik" janë materiale të ardhura falas për shkollat nga ZVA Mat dhe materiale të ndryshme ndërtimi sipas marrëveshjes me FSHZH
- Shuma prej 213,000 lekë e llogarisë 215 "Mjete transporti" I përket një motor makine i vendosur nga Agjensia e Funksioneve të Patransferueshme Mat (Njesi nartësie e Bashkisë Mat).

- Gjendja e llog. 231"Shpenzime në proces për rritjen e AQT" paraqitet në mbyllje të vit 2024 në vlerën 1,324,111,613 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2025 në vlerën 1,273,157,999 lekë, ku sipas analizës rezulton që kjo llogari paraqet vlerën pjesore të paguar të kontratave të investimeve që janë në vazhdim të pa kapitalizuar. Analiza e kësaj llogarie paraqitet në aneksin nr. 6 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.
Konkluzion: Në pasqyrën e pozicionit financiar llogaria 231 *"Për aktive afatgjata materiale"* paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në shumën 1,273,157,999 lekë, ndërsa në llogaritë kundërparti të saj lekë në rubrikën në pasiv *"*Fondin e konsoliduar" paraqiten në shumën 347,639,031 lekë si: llog. 105 *"Teprica e granteve kapitale të brendshme"* në shumën 347,639,031 lekë, llog. 106 *"Teprica e granteve kapitale të huaja"* në shumën 0 lekë, llog.115 "*Nga fondet e veta të investimeve"* në shumën 0 lekë, pra llogaritë e shpenzimeve për investime duhet të kuadronin me llogaritë e burimeve të financimit. Diferenca prej 925,518,968 lekë është keqklasifikuar në llogarinë 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar".*
Referuar analizës dhe lëvizjeve të llogarisë 231 *"Për aktive afatgjata materiale"* u konstatua se shtesat gjatë vitit 2025 janë në shumën 347,639,091 lekë dhe pakësimet në shumën 398,592,705 lekë, pakësime të cilat i përkasin mallrave, projekteve dhe punimeve të marra në dorëzim të cilat janë kapitalizuar në llogaritë e klasës 2 të paraqitur në pasqyrën *"Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata"*në shumën 382,209,312 sipas kolonës "Blerje e krijuar me pagesë" në shumën 87,824,122 lekë dhe kolonës "Lëvizje brenda aktiveve" në shumën 294,385,190 lekë. Pra veprimet

kontabël në kredi të llogarisë 231*"Për aktive afatgjata materiale"* nuk rakordojnë me veprimet në debi pas kapitalizimeve me një diferencë në shumën 16,383,393 lekë.
Në pasqyrën e investimeve dhe burimeve të investimeve tepricat e llogarisë 231*"Për aktive afatgjata materiale"* në fillim të vitit ushtrimor është në shumën 0 lekë, kur teprica e kësaj llogarie në pasqyrën e pozicionit financiar është në shumën 1,324,111,613 lekë. Teprica në fund të vitit ushtrimor është në shumën 0 lekë, kur teprica e kësaj llogarie në pasqyrën e pozicionit financiar është në shumën 1,273,011,812 lekë.
Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar, Aneksin nr. 1 pika 3 bashkëlidhur project raportit të auditimit.

Pasivet afatshkurtra. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 450,553,793 lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

- Gjendja e llogarisë 401- 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara. Gjendja e kësaj llogarije në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 185,703,917 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 130,608,160 lekë, ku rezulton një shtesë prej 55,097,757 lekë. Analiza e gjendjes së llog.401- 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" paraqitet në Aneksin nr. 7 pika 3 bashkëlidhur project raportit të auditimit.

- Teprica e llogarisë 42 "Detyrime ndaj personelit" paraqitet në fund të vitit 2025 në vlerën 8,004,613 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor 2025 për pagat që do të paguhen në Janar të vitit 2026

- Teprica e llogarisë 431 "Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat paraqitet në fund të vitit 2025 në vlerën kontabël 818,905 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor 2025 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2026.

- Teprica e llogarisë 435 "Sigurime shoqërore paraqitet në fund të vitit 2025 në vlerën 2,452.924 lekë, të llogaritura për tu paguar në muajin pasaardhës.

***- Teprica e llogarisë* 436** "*Sigurime shëndetësore*" në fund të vitit 2025 është në vlerën kontabël 338,432 lekë.

***- Teprica e llogarisë* 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*"** përfshin garancitë e ngurtësuara për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarije paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 158,644,384 lekë. Për këtë gjendje të llog. 466 është bërë rakordimi në degën e Thesarit Mat. Analiza e llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" paraqitet në aneksin nr 8 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

- Teprica e llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm" paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 0 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 3,249,210 lekë, e cila përfaqëson detyrime për vendime gjyqësore të formës së prerë në 3 raste për largime nga puna dhe në 1 rast të Klubfutbollit. Analiza e gjendjes së llogarisë 467 "kreditorë të ndryshëm paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Analiza e gjendjes së llog.467 "Krditorë të ndryshëm"

Objekti	Operatori Fitues	Gjendja në datë 31.12.2024	Shtesa	Pakësime	Gjendja në datë 31.12.2025
Shp vendime gjyqesore	FSHF E. G.	2,077,610.00			2,077,610.00
Shp vendime gjyqesore	A. D.	1,665,600.00		1,000,000.00	665,600.00
Shp vendime gjyqesore			198,000.00	198,000.00	-
Shp vendime gjyqesore			618,812.00	618,812.00	-
Shp vendime gjyqesore			574,800.00	574,800.00	-
Shp vendime gjyqesore	A. S.		682,000.00	622,000.00	60,000.00
Shp vendime gjyqesore	G. K.		896,000.00	450,000.00	446,000.00
Shp vendime gjyqesore		321,947.00		321,947.00	-
Shp vendime gjyqesore	A. D.	164,650.00		164,650.00	-
shuma 467		**4,229,807.00**	**2,969,612.00**	**3,950,209.00**	**3,249,210.00**

- Teprica e llogarisë 4341 ***"Operacione me shtetin (detyrime)"*** paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 91,341,408 lekë, të cila kuadrojnë me shumën e llogarive kundërparti në aktiv: llog.423,429 "Personeli, paradhënie, deficite, gjoba" në vlerën 17,774,523 lekë dhe llog. "Debitorë të ndryshëm" në vlerën 73,566,855 lekë. Llogaria 4341"Operacione me shtetin (detyrime)" është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme.

- Rubrika D: Fondi i Konsoliduar

- **Teprica e llogarisë 101** ***"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"*** në mbyllje të vitit 2025 është në vlerën 4,487,502,890 lekë lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 3,946,656,640 lekë.
- **Teprica e llogarisë 105** ***"Teprica e granteve kapitale të brendshme"*** në mbyllje të vitit 2025 është në vlerën 347,639,031 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 650,486,572 lekë

Konkluzion: **Te**prica e llogarisë 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* në mbyllje të vitit 2025 është në vlerën 4,487,502,890 lekë lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 3,946,656,640 lekë, të cilat rakordojnë me tepricat e llogarisë analoge në pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto të paraqitura në fillim dhe në fund të vitit ushtrimor.

- Llogaria 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/defiçiti i akumuluar"* kreditohet për shtesat e vitit sipas pasqyrës nr. 7/b *"Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)"* në vlerën 514,146,630 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën -1,077,091lekë sipas llogarisë 63 *"Ndryshimi i gjendjes së inventarit".*
- Llogaria 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/defiçiti i akumuluar"* debitohet për amortizimin shtesë të vitit 2024 në vlerën -177,513,655 lekë

Teprica e kësaj llogarie në fakt rezulton në vlerën 4,234,530,751 lekë, e cila është llogaritur kështu: çelje (vitit paraardhës) e llogarisë 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* në vlerën 3,946,656,640 lekë duke zbritur tepricën e llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit" në vlerën -1,077,091 lekë dhe shtesën e aktiveve për vitin 2025 në vlerën 514,146,630 lekë, duke zbritur vlerën e amortizimit të AAGJM prej -177,513,655 lekë dhe vlerën prej 47,142,668 lekë e kalimit kapital Ndërmarrjes së Shërbimeve e nxjerrjet jashtë përdorimi të aktiveve si vlerën prej 539,105 lekë të amortizimit të nxjerrjeve jashtë përdorimi, pra me një diferencë prej 252,971,539 lekë (4,487,502,890 lekë - 4,234,530,751 lekë). Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar kap 1.1, kap 2.1, kap.3.1 dhe Aneksi 1
Tepricat e llogarive në "Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto", rakordojnë me tepricat e llogarive analoge në rubrikën D "Fondi i konsoliduar" në pasqyrën e pozicionit financiar.

- **Teprica e llogarisë 115** ***"Nga fondet e veta të investimeve"*** në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në vlerën 0 lekë plus gjendjen e llogarisë 105 *"Teprica e granteve kapitale të brendshme"* në vlerën 347,639,031 lekë nuk rakordojnë me tepricën e llogarisë kundërparti 231 *"Për aktive afatgjata materiale"* në vlerën 1,273,011,812 lekë**.**

- Teprica e llogarisë 85 ***"Rezultati i veprimtarisë ushtrimore"*** në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në vlerën 90,237,184 lekë, e cila rakordon me llogarinë analoge në pasqyrën e performancës.

Analizë: Formati nr.2 "Pasqyra e performancës financiare" paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike paraqitet në aneksin nr. 9 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.
Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2025, të cilat në total janë në vlerën 675,933,730 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Belsh paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike ***70* "Të ardhurat nga nga taksat dhe tatimet"**paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën **88,499,157 lekë**, e cila kuadron me Akrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

-Gjendja e llogarisë analitike ***7002* "*Tatim mbi biznesin e vogël*"** pasqyrohet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 59,739 lekë e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin..

- Gjendja e llogarisë ***7020 "Tatim mbi pasurinë e palujtshme"*** pasqyrohet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 16,964,814 lekë që përfshin (*taksë toke në vlerën 692,831 lekë, taksën mbi pasurin në vlerën 16,129,598 lekë dhe taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë 142,385 lekë),* e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

- Gjendja e llogarisë ***7035 "Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie"*** pasqyrohet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 71,474,604 lekë që përfshin *(taksë tabele në vlerën* 126,764 *lekë, taksë ndikimi në infrastrkturë në vlerën 3,481,587 lekë, taksë për zënien e hapësirës publike në vlerën 3,306,468 lekë, tarifë për vërtetime në vlerën 303,176 lekë, taksë reklame në vlerën 592,323 lekë, tarifë pastrimi në vlerën 40,548,885 lekë, tarifë gjelbërimi në vlerën 1,887,746 lekë, të ardhura nga licensimi i karburanteve 2,600,000 lekë, tarifë e mirëmbajtjes së varrezave publike në vlerën 1,413,848 lekë , taksë e përkohshme vendore për infrastrukturën arsimore në vlerën 263,549 lekë, tarifë ndotje në vlerën 3,900,000 lekë, tarifë ndricimi në vlerën 2,062,046 lekë, tarifë e mirëmbajtjes së se infrastrukturës vaditëse në vlerën 1,048,383 lekë, tarifë vendore për hidrocentralin ujor në vlerën 7,658,755, tarifë vendore në sektorin e pyjve dhe kullotave në vlerën 361,854 lekë, tarifa vendore shërbimi nga institucionet kulturore në vlerën 58,700 lekë, taksë trualli në vlerën 1844517 lekë dhe të ardhura për qira të tokës bujqësore në shumën 16,003 lekë),* e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

- Gjendja e llogarisë ***71* "Të ardhurat jo tatimore"**paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën **22,894,696** lekë, i cila kuadron me aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

- Gjendja e llogarisë ***7109*** "***Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia"*** paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 2,708,493 lekë, që përfshin *(të ardhura nga qira për troje në vlerën 1,236, 636 lekë, tarifa e shfrytëzimit të pasurive minerare 720,000 lekë dhe të ardhura nga qira për ndërtesat në vlerën 751,856 lekë),* e cila kuadron me aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

- Gjendja e llogarisë ***7110*** "***Tarifë administrative dhe rregullatorë"*** paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 10,860,955 lekë, që përfshin *(tarifë leje transporti 814,580 lekë, tarifë e mirëmbajtjes së hyrjeve të pallateve 3,680,844 lekë, tarifë e mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore 5,866,531 lekë, tarifë vaditje dhe kullimi 14,000 lekë, Të tjera tarifa administrative 485,000 lekë)* e cila kuadron me aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

- Gjendja e llogarisë ***7111*** "***Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh"*** paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 7,994,224 lekë, që përfshin *(të ardhura nga kopshtet në vlerën 5,076,259 lekë, Të ardhura nga çerdhet në vlerën 1,584,645 lekë, të ardhura nga Qendra e Formimit Profesional 54,920 lekë, të ardhura nga parkingu në vlerën 1,278,400 lekë),* e cila kuadron me aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

- Gjendja e llogarisë ***7113*** "***Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve"*** paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 28,000 lekë, që përfshin *(të ardhura nga PMNZ në vlerën 28,000 lekë),* e cila kuadron me aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

- Gjendja e llogarisë ***7115*** "***Gjoba, kamatvonesa, sekuestrime e zhdëmtime"*** paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 1,301,024 lekë, që përfshin *(gjoba policia rrugore në vlerën 73,550 lekë, gjoba të policisë bashkiake në vlerën 631,480 lekë, të tjera gjoba në vlerën 479,714 lekë dhe kamatvonesa në vlerën 116,280 lekë),* e cila kuadron me aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Gjendja e llogarisë së fondeve ***72 "Grante Korente"*** në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në vlerën prej 564,539,877 lekë, vlerë e cila përbëhet nga:

Konkluzion: Gjendja e llogarisë 7200 "Grante korent i brendshëm nga buxheti për NJQP" praqitet në shumën 330,175,288 lekë, ndërsa sipas seksionit 1 "Akordim fonde buxhetore për shpenzime

korente" paraqitet në shumën 738,510,054 lekë në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare, ku sipas akrakordimit me thesarin fondet e akorduara janë në shumën 394,644,154 lekë.
- Gjendja e llogarisë *7201* "*Nga buxheti për NJQP (Vendore)"* paraqitet në shumën 4,200,000 lekë(fonde nga Qarku Dibër), e cila në fakt është pjesë e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore sipas aktrakordimit me Thesarin
- Gjendja e llogarisë *7204* "*Pjesmarrja e institucioneve në tatime nacionale"* paraqitet në shumën 29,596,588 lekë, që përfshin *(KSHA në vlerën 15,176,403 lekë, TAP në vlerën 12,458,018 lekë, Renta në vlerën 470,090 lekë dhe të ardhura nga privatizimet në shumën 1,092,077 lekë),* e cila është pjesë e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore sipas aktrakordimit me Thesarin.
- Gjendja e llogarisë *7206* **"***Financim i pritshëm* në vlerën 200,568,001 lekë vlerë e cila rakordon me gjendjen e llogarisë analoge 4342 *"Operacione me shtetin (të drejta)"*në formatin nr.1 "Pasqyra e pozicionit financiar", pasi kjo gjendje pasqyron detyrimin, që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara**.**

Analiza e shpenzimeve në vitin 2025, të cilat në total janë në vlerën **585,696,546** lekë paraqitet më poshtë:
Konkluzion: Gjendja e llogarisë *600 'Paga, shpërblime e të tjera personeli"* për vitin 2025, paraqitet në pasqyrën e performancës në vlerën 112,967,198 lekë, që përfaqëson shpenzime të kryera të konstatuara. Nga përllogaritja rezulton se shpenzimet e kryera në fakt të konstatuara janë në vlerën 113,947,057 lekë me një deviacion në vlerën 979,859 lekë, e cila ka rezultuar nga shpenzimet për paga të paguara sipas aktrakordimit me thesarin duke zbritur pagat e dhjetorit të vitit 2024 të paguara në janar të vitit 2025 dhe duke shtuar pagat e dhjetorit të vitit 2025.

Konkluzion: Gjendja e llogarisë *601 'Kontribute për sigurime"* për vitin 2025, paraqitet në bilanc në vlerën 18,694,876 lekë, që përfaqëson shpenzime të kryera të konstatuara. Nga përllogaritja rezulton se shpenzimet e kryera në fakt të konstatuara janë në vlerën 18,822,418 lekë me një deviacion në vlerën 127,542 lekë, e cila ka rezultuar nga shpenzimet për sigurime e tatime të paguara sipas aktrakordimit me thesarin duke zbritur kontributet për sigurime e tatime të vitit 2024 të paguara në janar të vitit 2025 dhe duke shtuar kontributet për sigurime e tatime nga pagat dhjetorit të vitit 2025.
Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu II.
- Gjendja e llogarisë *602 "Blerje mallra e shërbime"* paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 40,985,991 lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin.
- Gjendja e llogarisë së fondeve *604 "Transferime korente te brendshme"* paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 33,129,625 lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin.
- Gjendja e llogarisë së fondeve *606 "Transferime për buxhetet familjare e individë"* paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 378,841,765, e cila rakordon me aktrakordimin me Thesarin.

Konkluzion: Seksioni *"Shpenzime të tjera"* në mbyllje të vitit ushtrimor paraqitet në shumën 0 lekë, e cila nuk mund të jetë me këtë tepricë, pasi në seksionin *"Shpenzime të tjera"* evidentohen veprimet e korrigjimit të rezultatit, dhe llogaritë duhet të rakordojnë me llogaritë në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare, ku në të cilën tek rubrika "Transferta të tjera" llogaria "Transferime në buxhet të fondeve të pa përdorura" paraqitet në shumën 37,773,819 lekë dhe llogaria "Lëvizje e brendshme e transferta të tjera" paraqitet në shumën 404,322,017 lekë.

Për **vitin 2025 totali i të ardhurave** është 675,933,730 lekë dhe **totali shpenzimeve** është 585,696,546 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 90,237,184 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 *"Rezultati i ushtrimit"*
- Gjithashtu gjendja e llogarisë *63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit"* është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2025 është në vlerën -1,077,091 lekë.

Formati nr.6 "Investimet dhe burimet e financimit"

- Pasqyra "Investimet dhe burimet e financimit" paraqitet në aneksin nr. 10 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Konkluzion: Pasqyra"Investimet dhe burimet e financimit" nuk është plotësuar në mënyrë të saktë, pasi nuk janë plotësuar tepricat e llogarive në fillim dhe në mbyllje të vitit ushtrimor, duke mos rakorduar me pasqyrat e tjera.

- *Inventarizimi i aktiveve për vitin e raportimit financiar.*

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Financës e Zhvillimit Ekonomik dhe Kontratave për procesin e inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve për vitin 2025 për Bashkinë Mat dhe Njësite Administrative në varësi.

Për kryerjen e procesit të inventarizimit per vitin 2025 kanë dalë urdhrat e titullarit me nr.prot.542, datë 18.12.2025 nr.prot.542, datë 18.12.2025 dhe nr.541, datë 18.12.2025 "Për ngritjen e komisionit për invetarizimin dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata dhe inventarit në përdorim për vitin 2025". Në bazë të këtij urdhri janë përcaktuar komisionet e inventarizimit sipas objekteve ku do kryhet inventarizimi. Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se, komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventareve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive si për Aparatin e Bashkisë dhe për njësitë në varësi si Njësitë Administrative, 2 çerdhe, 3 kopshte, Konvikti, Kultura dhe Magazina**.** Fletët e inventareve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit dhjetor **2025** dhe rezultojnë pa diferenca. Është hartuar një relacion përmbledhës për gjithë inventarin e AAGJM, ku të përshkruhet mënyra e ruajtjes së këtyre aktiveve dhe konfirmimi i rezultatit të inventarit, gjatë vitit 2025 janë kryer procedurat e nxjerres aktiveve afatgjata jashtë përdorimit për inventaret e vitit 2024 bazuar ne urdhrin nr. 919 datë 19.11.2024 për llog.327 "inventor imët në vlerën 955,242.56 lekë, për llog.214"Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" në vlerën 24,600,00 lekë dhe për llog. 218 "inventar ekonomik" në vlerën 2,670,926.03 lekë. Në fund janë kryer edhe procedurat e asgjesimit të tyre të cilat jane reflektuar ne pasqyrat financiare 2025

Për kryerjen e procesit të inventarizimit per vitin 2025 ka dalë urdhri i titullarit me nr.prot.542, 18.12.2025"Për ngritjen e komisionit për invetarizimin dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata dhe inventarit në përdorim për vitin 2025". Në këtë dokument janë përcaktuar komisionet e inventarit për Aparatin e Bashkisë, cerdhe, kopshte, shkolla, konvikti, kultura dhe magazina komisioni i vlerësimit të AAGJM dhe inventarit në përdorim. Deri tani është kryer procesi i inventarizimit, ku janë mbajtur fletët e inventarit me krahasimin e inventarit kontabël me inventarin fizik. Nga këto komisione janë bërë propozimet për aktivet që nuk kanë më vlerë përdorimi. Procesi i inventarizimit vazhdon për kryerjen e procedurave të nxjerrje jashtë përdorimi të aktiveve të propozuara.

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi: zj, D. T. me detyrë Drejtore e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Monitorimit të Kontratave, në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe në cilësinë e hartueses të pasqyrave financiare.

4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

-Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me VKB sipas viteve përkatëse bashkë me ndryshimet gjatë

vitit.

-Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SPE, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2025, Bashkia Mat referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve ka kryer gjithsej **63** procedura prokurimi me fond limit **1,282,992,180 lekë pa TVSh,** me vlerë kontrate **1,211,608,803 lekë pa TVSh**, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën **71,383,377 lekë pa TVSh,** ose **6 %**. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrën si vijon:

Procedura 01.01.2023 – 31.12.2025	**Nr.**	**Vl. Fond Limit pa TVSh**	**Vl. Kontrate pa TVSh**	**Fondi total i kursyer pa TVSh**
GJITHESEJ	**63**	**1,282,992,180**	**1,211,608,803**	**71,383,377**
-Të hapura	**17**	**1,130,891,269**	**1,077,540,040**	**53,351,229**
-Shërbim konsulence	1	4,228,333	4,225,642	2,691
-Negocim pa shpallje	0			
-E hapur e thjeshtuar	45	147,872,578	129,843,121	18,029,457

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave/informacioneve të paraqitura dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, përzgjodhi për auditim:

1. "Përshtatje për ambiente frigoriferike dhe punime meremetimesh në tregun fruta-perime, Burrel", viti 2023 me fond limit 24,999,999 lekë, ku fitues është shpallur OE "K." Sh.p.k me vlerë kontrate 24,770,000 lekë.
2. "Rikonstruksion i pallatit të kulturës "Shefqet Doda" Burrel, Bashkia Mat", viti 2023 me fond limit 18,140,977 lekë, ku fitues është shpallur BOE: "A." Sh.p.k &"C." Sh.p.k me vlerë kontrate 17,780,731 lekë.
3. "Rikonstruksion rruga Lis", viti 2023 me fond limit 27,870,583 lekë, ku fitues është shpallur OE "L." Sh.p.k me vlerë kontrate 27,469,100 lekë.
4. "Rikonstruksion rruga Qamil Xhika", viti 2023 me fond limit 19,971,512 lekë, ku fitues është shpallur OE "U." Sh.p.k me vlerë kontrate 19,355,919 lekë.
5. "Rikonstruksion i ish-Hotelit të ish-Uzinës së Ferrokromit, në qytetin e Burrelit", viti 2023 me fond limit 61,212,916 lekë, ku fitues është shpallur OE "C." Sh.p.k me vlerë kontrate 61,054,278 lekë.
6. "Rikonstruksion i plotë i shkollës së mesme "Pjetër Budi" + terrene sportive", viti 2023 me fond limit 79,060,800 lekë, ku fitues është shpallur OE "U." Sh.p.k me vlerë kontrate 76,990,739 lekë.
7. "Rikonstruksion ure pasarel në fshatin Rreth-Baz, Njësia Administrative Baz, Bashkia Mat", viti 2023 me fond limit 15,315,674 lekë, ku fitues është shpallur BOE "D." & F." Sh.p.k
" Sh.p.k me vlerë kontrate 14,914,982 lekë.
8. "Rikualifikim urban i Bllokut "Lagje e re", viti 2023 me fond limit 27,617,117 lekë, ku fitues është shpallur OE "N." Sh.p.k me vlerë kontrate 27,439,912 lekë.
9. "Asfaltim i rrugëve lidhëse në fshatrat e Njësive Administrative Burrel, Baz, Lis, Komsi, Rukaj", viti 2024 me fond limit 360,432,605 lekë, ku fitues është shpallur B.O.E. "Z." Sh.p.k., dhe "S." Sh.p.k. me vlerë kontrate 330,000,505 lekë.
10. "Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit Shqefën", viti 2025 me fond limit 75,416,389 lekë, ku fitues është shpallur OE. "L. " Sh.p.k., me vlerë kontrate 73,116,754 lekë.
11. "Rikonstruksion shkolla e mesme e bashkuar "Abdyrrahman Permeti" Lis si dhe ndertim ambienti sportiv brenda ambjenteve te saj", viti 2025 me fond limit 94,203,705 lekë, ku fitues është shpallur OE. "A." Sh.p.k., me vlerë kontrate 94,203,705 lekë.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit u konstatuan mangësi në procedurat si më poshtë vijon:
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*" (i ndryshuar), etj., konkretisht si vijon:
- Nga auditimi i **7 dosjeve** të procedurave të prokurimit për vitin 2023, rezultoi se procesverbalet e mbajtura gjatë zhvillimit të procedurës **janë të paprotokolluar**, në kundërshtim me "*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*", neni 18, ku përcaktohet:

"*Procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme. Ato protokollohen. Procesverbalet e mbledhjeve të forumit të organit shtetëror shtypen veças për çdo çështje dhe nënshkruhen nga mbajtësi dhe titullari ose zëvendësi i tij....*".

- Nga auditimi i fazave të zhvillimit të procedurës, konstatohet se nuk janë zbatuar dispozitat e LPP, pasi protokollet e shkresave vijnë me numra të ndryshim dhe jo me fraksione të numërit të parë;

Gjithashtu, të gjitha dosjet e audituara, ku ndër të tjera përmban procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., nuk janë të pajisura me inventarin e brendshëm të dosjes për të gjithë përmbajtjen e tyre. Fletët e dosjes, edhe pse janë të shoqëruara me një inventar paraprak, nuk janë të numëruara në çdo faqe. Mos argumentimi i kritereve, mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të painventarizuara, mbartin riskun, e cenimit të transparencës në procedurat e prokurimit, si dhe të humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit, veprime në kundërshtim me nenet 21, 58, 59 dhe 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, me germën (g), të nenit 8- "*Përpunimin tekniko-shkencor i dokumenteve të prapambetura*", të vendimit nr. 4, datë 19.6.2017 "*Për miratimin e rregullave të njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të RSH*", Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 "Për arkivat"; Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, duke ngarkuar me përgjegjësi sipas procedurave personin përgjegjës të procedurës:**: znj. F. S. dhe z. E. A.**

1. **Auditim i procedurës me objekt: *"Rikonstruksion i pallatit të kulturës "Shefqet Doda" Burrel, Bashkia Mat".***

<table>
<tr><td colspan="4">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i pallatit të kulturës "Shefqet Doda" Burrel, Bashkia Mat".</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "E Hapur - Punë" REF-64361-03-30-2023
Urdhri nr. 161, datë 28.03.2023</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit
Urdhri nr. 161 datë 28.03.2023
1. F. S.
2. M. C.
3. A. P.</td><td>2 Njësia e Prokurimit

1. F. S.
2. M. C.
3. A. P.</td><td>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr. 162, datë 28.03.2023.
1. E. H.
2. J. S.
3. E. R.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa tvsh) 18,140,977 lekë pa TVSH</td><td colspan="2">5. Oferta fituese, vlera fituese:
BOE: "A." Sh.p.k &"C." Sh.p.k 17,780,731.38 lekë pa TVSH.</td><td>6. Diferenca me fondin limit 360,245.62 lekë pa TVSH</td></tr>
<tr><td>7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 20.04.2023</td><td colspan="2" rowspan="2">8. Burimi Financimit
Nga grandi i BE: 18,140,977 lekë pa TVSH</td><td rowspan="2">9. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender: 2 OE
b) S'kualifikuar: 1 OE,
c) Kualifikuar: 1 BOE</td></tr>
<tr><td>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 3 muaj</td></tr>
<tr><td>10.Ankimime
AK-s'ka
APP–s'ka
KPP-s'ka</td><td colspan="2">11. Data e lidhjes të kontratës:
Nr. 1927 prot., datë 11.05.2023</td><td>12. Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK</td></tr>
</table>

- **AK në lidhje me "Përllogaritjen e Fondit Limit":**

Nga auditimi i dosjes së procedurës, konstatohet se *Projekt – Preventivat, Relacionet, Raportet, Grafikun e punimeve* dhe *Specifikimet Teknike* përkatëse për punimet objekt prokurimi *"Rikonstruksion i pallatit të kulturës "Shefqet Doda" Burrel, Bashkia Mat"* është hartuar nga studio e projektimit "T." ShPK për vlerën 18,140,977 lekë. Nga verifikimi i disa prej zërave, u konstatua se nuk ka diferenca dhe se çmimet e aplikuara janë në zbatim të manualit të çmimeve.

AK në lidhje me "Hartimin e Specifikimeve Teknike":

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, është ngritur një komision paraprak me urdhrin nr. 161 datë 28.03.2023 "Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit", i përbërë nga znj. F. S. *(Jurist/ Person përgjegjës)*, znj. M. C. *(Inxh. Ndërtimi/ Specialist i fushës)*, z. A. P. *(Ekonomist/ Anëtar)*, të cilët janë evidentuar në procesverbalin e datës 30.03.2023.

Nga auditimi i procesverbalit nr. ska të datës 30.03.2023 konstatohet se:

Në pikën 2.3.5 të DST ndër të tjerat është kërkuar që *Operatori ekonomik duhet të paraqesë* autoritetit kontraktor një mostër për mallrat/ materialet për Pllaka Guri dhe Polisterol kompakt. Mosdorëzimi i mostrës për secilën pajisje të kërkuar ditën e hapjes së ofertave përbën kusht për s'kualifikim.

Sipas grupit të auditimit: Kërkesa për mostra nuk argumentohet qartë pse mostra është e domosdoshme. Mostrat shërbejnë kryesisht për verifikimin e karakteristikave teknike të produkteve të ofruara. Në rastet kur operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacion teknik, katalogë, fletë teknike, certifikata cilësie ose dokumente të tjera që provojnë përputhshmërinë e mallrave me specifikimet teknike të kërkuara, mungesa e mostrës nuk ndikon drejtpërdrejt në aftësinë e autoritetit kontraktor për të vlerësuar përputhshmërinë e ofertës.

Në pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik, AK i ka kërkuar: *"Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë në stafin kryesor dhe stafin mbështetës* - 1 (një) Arkitekt.

Në lidhje me kërkesën për arkitekt, sqarojmë se në dokumentet e procedurës së prokurimit AK ka publikuar njëherazi "Preventivin e punimeve", "Relacionin Teknik", "Specifikimet Teknike", "Grafikun e punimeve" dhe "Projektin e Zbatimit", duke i vënë në dispozicion, informacionin operatorëve ekonomikë pjesëmarrës mbi projektin të cilët këto të fundit do të zbatojnë në rast të fitimit të kontratës. Disponueshmëria si pjesë e stafit teknik të një arkitekti në fazën e zbatimit të punimeve, ku ndër të tjera autoriteti kontrakor ka kërkuar referuar kritereve të veçanta të kualifikimit pjesë të stafit teknik, inxhinierët, si ndërtimi, elektrik, dhe mekanik, shkon përtej synimit të AK dhe njëherazi nuk është në proprocion me natyrën dhe volumin e kontratës. Disponueshmëria e një arkitekti referuar natyrës së punimeve dhe duke marrë në konsideratë faktin se AK ka parashikuar në mënyrë të detajuar projektin e zbatimit, specifikimet teknike, nuk shfaqet e nevojshme në proporcion me natyrën dhe volumin e punimeve.

Në pikën 2.3.7/c të kapacitetit teknik, AK i ka kërkuar: "Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë Minimumi 1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë/dëshmi si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" , Minimuni 1 (një) punonjës që përmbush kriteret për të qenë "Ekspert për Ndihmën e parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave" si dhe Minimumi 1 (një) punonjës të çertifikuar si "Auditues i Energjisë, në profilin Auditimi Energjitik në ndërtesa".

Sqarim i grupit të auditimit Në lidhje me kërkesat e sipërcituara duke u mbështetur në tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet dhe volumet e tyre autoriteti kontraktor nuk ka mirë argumentuar kërkesën për 1 (një) punonjës që përmbush kriteret për të qenë "Ekspert për Ndihmën e parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave" dhe 1 (një) punonjës që të disponojë çertifikatë/dëshmi si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" ku shpesh here i njëjti punonjës mund të zotërojë të dy certifikimet. Gjithashtu kërkesa për minimum 1 (një) punonjës të certifikuar si "Auditues i Energjisë në ndërtesa" nuk argumentohet se gjatë zbatimit të kontratës do të kryhen aktivitete auditimi energjetik ose certifikimi energjetik të ndërtesës. Sa më sipër veprimet apo

mosveprimet janë në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", **neni 78, pika 2** "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese ... bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.*

*- **Në çdo rast**, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.*". Konstatohet se nuk ka asnjë argumentim në lidhje me kriterin kryesor të procedurës së prokurimit, i cili është "*Kriteri për shpalljen e ofertës fituese*". Janë konstatuar shkelje të **nenit 87 pika 2 dhe 4**, të Ligjit nr. 162/2020, "*Për prokurimin publik*", sipas të cilit: " *4- Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese...*".

*Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: **1. F. S.** (Jurist/ Person përgjegjës), **2. M. C.** (Inxh. Ndërtimi/ Specialist i fushës), **3. A. P.** (Ekonomist/ Anëtar),*

b. Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë **3** *(dy)* OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 4, të **datës 26.04.2023**, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	**BOE: "A."** Sh.p.k & "**C.**" *Sh.p.k*	**17,780,731.38**	**Kualifikuar**
2	**OE: "F."** Sh.p.k.	**Nuk ka paqitur Ofertë**	**S'kualifikuar;** Nuk ka paraqitur Ofërtë Ekonomike (sipas Shtojcës 1 të DTS-së në zbatim të nenit 28 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 *"Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik"* (i ndryshuar), si dhe dokumentat e kërkuara në Dokumentat Standarte të Tenderit.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës Nr.Prot.1907, më datë 10.05.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 2 *(dy)* operatorë pjesëmarrës është s'kualifikuar 1 *(një)* OE, është kualifikuar 1 *(një)* BOE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 09.05.2023 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë BOE: "A." Sh.p.k., me numër Nipt-i: M....H & "C." Sh.p.k me numër Nipt-i: K.....V për të cilën është lidhur kontrata datë 11.05.2023 për vlerën 17,780,731.38 lekë pa TVSH dhe vlera 21,336,877.66 lekë me TVSH, dhe me afat 4 *(katër)* muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

***Konkluzion:** Arrihet në përfundimin se ky operator i plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në DST dhe vendimi i KVO për shpalljen fitues të këtij operatori është i drejtë.*

2. **Auditim i procedurës me objekt:** *"Përshtatje për ambiente frigoriferike dhe punime merremetimesh në tregun fruta-perime, Burrel".*

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: *"Përshtatje për ambiente frigoriferike dhe punime merremetimesh në tregun fruta-perime, Burrel"*.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "E Hapur - Punë"	**1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit**	**2 Njësia e Prokurimit** 1. E. A. 2. M. C.	**3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhri **nr. 562**, datë **28.09.2023**.

REF-82120-10-03-2023 Urdhri **nr. 561**, datë **28.09.2023**	Urdhri nr. **561**, datë **28.09.2023** 1. E. A. 2. M. C. 3. D. O.	3. D. O.	1. E. H. 2. R. K. 3. E. R.
4. Fondi Limit (pa tvsh) **24,999,999** lekë pa TVSH	**5. Oferta fituese, vlera fituese:** Operatori Fitues: **"K."** Sh.p.k. **24,770,000** lekë pa TVSH.		**6. Diferenca me fondin limit** **229,999** lekë pa TVSH
7/1 Data e hapjes së tenderit: **Data 19.10.2023**	**8. Burimi Financimit** Të ardhurat: **24,999,999** lekë pa TVSH		**9. Operatoret Ekonomike** a) Pjesëmarrës në tender: **2 OE** b) S'kualifikuar: **1 OE,** c) Kualifikuar: **1 OE**
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 3 muaj			
10.Ankimime **AK**-s'ka **APP**–s'ka **KPP**-s'ka	**11. Data e lidhjes të kontratës:** **Nr. 6054 prot., datë 14.11.2023**		**12.** P**ërgjigje** Ankesës nga APP, AK apo **KKP: AK**

- **AK në lidhje me "Përllogaritjen e Fondit Limit":**

Nga auditimi i dosjes së procedurës, konstatohet se *Projekt – Preventivat, Relacionet, Raportet, Grafikun e punimeve* dhe *Specifikimet Teknike* përkatëse për punimet objekt prokurimi *"Përshtatje për ambjente frigoriferike dhe punime meremetimesh në tregun fruta-perime, Burrel"* është hartuar nga studio e projektimit "N." ShPK për vlerën 24,999,999 lekë. Nga verifikimi i disa prej zërave, u konstatua se nuk ka diferenca dhe se çmimet e aplikuara janë në zbatim të manualit të çmimeve.

AK në lidhje me "Hartimin e Specifikimeve Teknike" dhe "Përllogaritjen e Fondit Limit" :

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, është ngritur një komision paraprak me urdhrin nr. 561 datë 28.09.2023 "Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit", i përbërë nga z. E. A. *(Jurist/ Person përgjegjës)*, znj. M. C. *(Inxh. Ndërtimi/ Specialist i fushës)*, znj. D. O. *(Ekonomist/ Anëtar)*, të cilët janë evidentuar në procesverbalin e datës 03.10.2023.

Nga auditimi i procesverbalit nr. ska të datës 03.10.2023 konstatohet se:

Në pikën 2.3.6 të DST, është kërkuar nga Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **40** *(dyzet)* **punonjës** për periudhën **3** *(tre)* muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik.

Sipas grupit të auditimit: Për të përcaktuar stafin teknik dhe stafin mbështetës të nevojshme për realizimin e kontratës, duhet analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 216, date 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim" bazuar ne përllogaritjen e orëve të punës , kategoritë e punimeve të përcaktuara në preventive, specifikimet teknike të objektit, detajeve të projektit dhe tipologjia e zërave të punimeve , të cilat lidhen ngushtësisht me listën e stafit teknik të kërkuar nga AK , si edhe bazuar në domosdoshmërinë e realizimit sa me shpejt të objektit konkretisht:

Nr.	AN.	ZËRAT E PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ORË PUNE / NJËSI	ORË PUNE TOTAL	DITË PUNE

Në pikën 2.3.7/d të DST, është kërkuar nga Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë **1** *(një)* **mjek** të përgjithshëm, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,* duhet të paraqesë dokumentacionin: Kontratë të vlefshme pune/ kontratë shërbimi mjeku, Urdhër mjeku, dhe Diplomë.

Sipas grupit të auditimit: *konstatohet se nuk ka element të kontratës që të bëjnë të jetë e nevojshme kërkesa për mjek. Autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë që operatorët ekonomik ti vërtetojnë se plotësojnë çdo detyrim që ata kanë për funksionimin e tyre si shoqëri private. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë vetëm plotësimin e kritereve që kanë lidhje me zbatimin e kontratës. Organizimi i shërbimit mjekësor nga operatorët ekonomik është një çështje që ju përket atyre dhe organeve të tjera kontrolluese të këtij elementi (Ispektorati i Punës etj.,) dhe jo çështje e verifikimit nga autoritetit kontraktor, përderisa mjeku nuk lidhet me natyrën e kontratës, që do të thotë me elementët e punimeve të preventivit.*

- Në vendosjen e këtij kriteri nuk është të mbajtur në konsideratë VKM nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 108, datë 9.2.2011, "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", në lidhje me detyrimin e punëdhënësit për të siguruar shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës, apo nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë, sipas grupeve përkatëse në të cilin mund të bëjnë pjesë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, si dhe numrit respektiv të punonjësve për secilin grup të përcaktuar më sipër.

Në pikën 2.3.7/e të DST, është kërkuar nga Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar 1 *(një)* inxhinier që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizmit të punimeve nuk argumentohet teknikisht sepse është I nevojshëm pasi në pikën 2.3.7/a është kërkuar Inxhinieri i ndërtimit. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", **neni 78, pika 2** "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese ... bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.*

*- **Në çdo rast**, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.*". Konstatohet se nuk ka asnjë argumentim në lidhje me kriterin kryesor të procedurës së prokurimit, i cili është "*Kriteri për shpalljen e ofertës fituese*". Janë konstatuar shkelje të **nenit 87 pika 2 dhe 4**, të Ligjit nr. 162/2020, "*Për prokurimin publik*", sipas të cilit: " *4- Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese...*".

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: z. E. A. *(Jurist/ Person përgjegjës),* znj. M. C. *(Inxh. Ndërtimi/ Specialist i fushës)*, znj. D. O. *(Ekonomist/ Anëtar)*

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë **3** *(dy)* OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 4, të **datës 27.10.2023**, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	**"K."** Sh.p.k.	**24,700,000**	**Kualifikuar**
2	**OE: "N."** Sh.p.k.	**24,876,200**	**S'kualifikuar;** I. Nuk është përmbushur kriteri i pikës **1 gërma "b"**/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur *Sigurimi i Ofertës, sipas Shtojcës 3*. I. Nuk është përmbushur kriteri i pikës **2.3.4/ 2.3** Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur liçenca (Kodi III.2.B) e kërkuar. II. Nuk është përmbushur kriteri i pikës **2.3.5/ 2.3** Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar, si: *Autorizimet e prodhuesit/ distributorit, Katalogjet dhe Çertifikatat ISO*, për listën e mallrave/ materialeve të kërkuar.

			III. Nuk është përmbushur kriteri i pikës **2.3.7 gërma "a"**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur konstatohet se, në seksionin B: DEKLARATË *"Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate"*/ *Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit* të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, *sipas Shtojcës 8*, nuk është deklaruar disponimi i *minimumit 1 (një) Inxhinier Ndërtimi*, dhe *minimumit 1 (një) Inxhinier Mekanik*. .Nuk është përmbushur kriteri i pikës **2.3.7 gërma "b"**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur konstatohet se, në seksionin B: DEKLARATË *"Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate"*/ *Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit* të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, *sipas Shtojcës 8*, nuk është deklaruar disponimi i punonjësve të specializuar/ kualifikuar: *Inxhinier ndertimi profili strukturist*, *Menaxhues ndërtimi*, *Teknik ndërtimi*, *Teknik termohidraulik*, *Teknik mekanik*, *Teknik elektroteknik*, *Betonues*, si dhe nuk disponon punonjësit: *3 (tre) Specialist elektrik*, por vetëm 1 *(një)* të tillë, *3 (tre) Hidraulik* por vetëm 2 *(dy)* të tillë. .Nuk është përmbushur kriteri i pikës **2.3.7 gërma "c"**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur konstatohet se, në seksionin B: DEKLARATË *"Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate"*/ *Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit* të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, *sipas Shtojcës 8*, nuk është deklaruar disponimi i *të paktën 4 (katër) punonjës të specializuar dhe çertifikuar për punime në lartësi*. .Nuk është përmbushur kriteri i pikës **2.3.7 gërma "g"**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur deklarata për caktimin e Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt. .Nuk është përmbushur kriteri i pikës **2.3.8/ 2.3** Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur konstatohet se, në seksionin B: DEKLARATË *"Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate"*/ *Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit* të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, *sipas Shtojcës 8*, nuk është deklaruar disponimi i *minimumit 4 (katër) shoferë të mjeteve të rënda*, por vetëm por vetëm 1 *(një)* të tillë. .Nuk është përmbushur kriteri i pikës **2.3.9 gërma "a" dhe "b"**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur konstatohet se, në seksionin C: DEKLARATË *"Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate"*/ *Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit*, të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, *sipas Shtojcës 8*, nuk është deklaruar disponimi i automjeteve, makinerive dhe pajisjeve: *Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min. 15 ton, Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10 - 15 ton, Kamion me Vinç, Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3 ton, Minifadromë, Autobetoniere, Autobot uji, Gazogjen, Armatura druri dhe betoforma, Saldatrice* si dhe nuk disponon *2 (dy) Kamion/ Kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5 - 10 ton*, por vetëm 1 *(një)* të tillë. Po ashtu nuk ka deklaruar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve mbrojtëse në punë të kërkuara në gërmën "b".

			.Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës **2.3.10/ 2.3** Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur grafiku i punimeve.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës Nr.Prot.5974, më datë 09.11.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 2 *(dy)* operatorë pjesëmarrës është s'kualifikuar 1 *(një)* OE, është kualifikuar 1 *(një)* OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 09.11.2023 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë "K." Sh.p.k., me numër Nipt-i: J.....D për të cilën është lidhur kontrata datë 14.11.2023 për vlerën 24,700,000 lekë pa TVSH dhe vlera 29,640,000 lekë me TVSH, dhe me afat 3 *(tre)* muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.
Konkluzion: *Arrihet në përfundimin se ky operator i plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në DST dhe vendimi i KVO për shpalljen fitues të këtij operatori është i drejtë.*

3. Auditim i procedurës me objekt "**Rikonstruksion rruga Qamil Xhika**".

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: *"Rikonstruksion rruga Qamil Xhika".*			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit **"E Hapur - Punë"** **REF-55700-01-09-2023** Urdhri **nr. 840**, datë **21.12.2022**	**1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit** Urdhri nr. **840**, datë **21.12.2022** 1. E. A. 2. M. C. 3. D. R.	**2 Njësia e Prokurimit** 1. E. A. 2. M. C. 3. D. R.	**3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhri **nr. 841**, datë **21.12.2022**. 1. E. H. 2. R. K. 3. E. R.
4. Fondi Limit (pa tvsh) **19,971,512** lekë pa TVSH	**5. Oferta fituese, vlera fituese:** Operatori Fitues: **"U."** Sh.p.k. **19,355,919** lekë pa tvsh.		**6. Diferenca me fondin limit** **615,593** lekë pa tvsh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 25.01.2023 **7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 7 muaj**	**8. Burimi Financimit** Buxheti i shtetit: **13,191,666.67** lekë pa TVSH Të ardhurat: **6,808,333.33** lekë pa TVSH		**9. Operatoret Ekonomike** a) Pjesëmarrës në tender: **1** OE b) S'kualifikuar: **0** B/OE**,** c) Kualifikuar: **1** B/OE
10.Ankimime **AK**-s'ka/ka; **s'ka** **APP–**s'ka/ka; **KPP**-s'ka/ka; **s'ka**	**11. Data e lidhjes të kontratës:** **Nr. 832 prot., datë 24.02.2023**		**12.P*ë*rgjigje** Ankesës nga APP, AK apo **KKP: AK**

- **AK në lidhje me "Përllogaritjen e Fondit Limit":**

Nga auditimi i dosjes së procedurës, konstatohet se *Projekt – Preventivat, Relacionet, Raportet, Grafikun e punimeve* dhe *Specifikimet Teknike* përkatëse për punimet objekt prokurimi *"Rikonstruksion rruga Qamil Xhika"* është hartuar nga Ing. M. A. me nr. licence K.... për vlerën 19,971,512 lekë. Nga verifikimi i disa prej zërave, u konstatua se nuk ka diferenca dhe se çmimet e aplikuara janë në zbatim të manualit të çmimeve.

AK në lidhje me "Hartimin e Specifikimeve Teknike"

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, është ngritur një komision paraprak me urdhrin nr. 840 datë 21.12.2022 "Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit", i përbërë nga z. E. A. *(Jurist/ Person përgjegjës)*, znj. M. C. *(Inxh. Ndërtimi/ Specialist i fushës)*, z. A. P. *(Ekonomist/ Anëtar)*, të cilët janë evidentuar në procesverbalin e datës 09.01.2023.

Nga auditimi i procesverbalit nr. ska të datës 09.01.2023 konstatohet se:

Në pikën 2.3.2 të DST*, ndër të tjera janë kërkuar kategori licence* Kategoria NS- 9 (*Punime strukturorë speciale)* – Klasifikimi A si dhe *NS-18 A Punime topogjeodezike* – Klasifikimi A

Sipas grupit të auditimit *dhe në konsultim me inxhinierin e grupit, këto kategori licence nuk përputhen me tipologjinë e procedurës, kjo për faktin se referuar zërave të preventivit nuk ka asnjë zë që argumentin këto linesa, ku kategoria N.S – 18/A- Punime topogjeodezike konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.*

Në pikën 2.3.5 të DST, është kërkuar nga Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **40** *(dyzet)* **punonjës** për periudhën **3** *(tre)* muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik.

Sipas grupit të auditimit: Për të përcaktuar stafin teknik dhe stafin mbështetës të nevojshme për realizimin e kontratës, duhet analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 216, date 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim" bazuar ne përllogaritjen e orëve të punës , kategoritë e punimeve të përcaktuara në preventive, specifikimet teknike të objektit, detajeve të projektit dhe tipologjia e zërave të punimeve , të cilat lidhen ngushtësisht me listën e stafit teknik të kërkuar nga AK , si edhe bazuar në domosdoshmërinë e realizimit sa me shpejt të objektit konkretisht:

[2]

Nr.	AN.	ZËRAT E PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ORË PUNE / NJËSI	ORË PUNE TOTAL	DITË PUNE

Në pikën 2.3.7/c të kapacitetit teknik, AK i ka kërkuar: "Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë Minimumi 1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë/dëshmi si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" , Minimuni 1 (një) punonjës që përmbush kriteret për të qenë "Ekspert për Ndihmën e parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave" si dhe Minimumi 1 (një) punonjës të çertifikuar si "Auditues i Energjisë, në profilin Auditimi Energjitik në ndërtesa".

Sqarim i grupit të auditimit në lidhje me kërkesën për disponimin e 1 (një) punonjësi që përmbush kriteret për të qenë "Ekspert për Ndihmën e Parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave" dhe 1 (një) punonjësi me certifikatë/dëshmi si "Përgjegjës për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë", Autoriteti Kontraktor nuk ka paraqitur argumentim të mjaftueshëm mbi domosdoshmërinë e kërkimit të këtyre funksioneve si pozicione të veçanta, duke marrë në konsideratë natyrën, tipologjinë dhe volumet e kontratës që prokurohet.

Në pikën 2.3.7/e të kapacitetit teknik, AK i ka kërkuar: *"Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë në stafin kryesor dhe stafin mbështetës* 1 *(një)* inxhinier Auditues/Inspektues i Sigurise Rrugore,

Në lidhje me kërkesën për 1 *(një)* inxhinier Auditues/Inspektues i Sigurisë Rrugore, **sqarojmë se** në dokumentet e procedurës së prokurimit AK ka publikuar njëherazi "Preventivin e punimeve", "Relacionin Teknik", "Specifikimet Teknike", "Grafikun e punimeve" dhe "Projektin e Zbatimit", duke i vënë në dispozicion, informacionin operatorëve ekonomikë pjesëmarrës mbi projektin të cilët këto të fundit do të zbatojnë në rast të fitimit të kontratës. Disponueshmëria si pjesë e stafit teknik të 1 *(një)* inxhinier Auditues/Inspektues i Sigurise Rrugore, në fazën e zbatimit të punimeve, ku ndër të tjera autoriteti kontrakor ka kërkuar referuar kritereve të veçanta të kualifikimit pjesë të stafit teknik, inxhinierët, si ndërtimi, elektrik, dhe mekanik, shkon përtej synimit të AK dhe njëherazi nuk është në proprocion me natyrën dhe volumin e kontratës. Disponueshmëria e 1 *(një)* inxhinier Auditues/Inspektues i Sigurise Rrugore, referuar natyrës së punimeve dhe duke marrë në konsideratë faktin se AK ka parashikuar në mënyrë të detajuar projektin e zbatimit, specifikimet teknike, nuk shfaqet e nevojshme në proporcion me natyrën dhe volumin e punimeve.

Sa më sipër veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", **neni 78, pika 2** "hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" ku citohet se: "Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me

kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese ... bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.
- **Në çdo rast**, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.". Konstatohet se nuk ka asnjë argumentim në lidhje me kriterin kryesor të procedurës së prokurimit, i cili është "Kriteri për shpalljen e ofertës fituese". Janë konstatuar shkelje të **nenit 87 pika 2 dhe 4**, të Ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", sipas të cilit: " 4- Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese".
Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: ***1. E. A.*** *(Jurist/ Person përgjegjës),* ***2. M. C.*** *(Inxh. Ndërtimi/ Specialist i fushës),* ***3. D. R.*** *(Ekonomist/ Anëtar).*

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.
Në procedurën e prokurimit ka marrë pjesë **1** OE, për të cilin, referuar procesverbalit **nr. 4**, të **datës 09.02.2023**, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	**"U."** Sh.p.k.	**19,355,919**	Kualifikuar

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës **Nr.Prot.827**, më **datë 21.02.2023**, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe Formularit të Njoftimit të Fituesit, ka qënë vetëm **1** *(një)* operator pjesëmarrës i cili është kualifikuar. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 21.02.2023 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë **"U."** Sh.p.k., për të cilën është lidhur kontrata **Nr. 892 Prot.**, **datë 24.02.2023** për vlerën **19,355,919** lekë pa TVSH dhe vlera **23,227,102.8** lekë me TVSH, dhe me afat **7** *(shtatë)* **muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit**.

Konkluzion: *Arrihet në përfundimin se ky operator i plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në DST dhe vendimi i KVO për shpalljen fitues të këtij operatori është i drejtë.*

4. Auditim i procedurës me objekt ***"Rikonstruksion i ish-Hotelit të ish-Uzinës së Ferrokromit, në qytetin e Burrelit"***.

<table>
<tr><td colspan="4">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i ish-Hotelit të ish-Uzinës së Ferrokromit, në qytetin e Burrelit".</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
"E Hapur - Punë"
REF-84427-10-19-2023
Urdhri nr. 610, datë 17.10.2023.</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit
Urdhri nr. 610, datë 17.10.2023
1. E. A.
2. M. C.
3. D. T.</td><td>2 Njësia e Prokurimit

1. E. A.
2. M. C.
3. D. T.</td><td>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr. 611, datë 17.10.2023.
1. E. H.
2. R. K.
3. E. R.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa tvsh)
61,212,916.65 lekë pa TVSH</td><td colspan="2">5. Oferta fituese, vlera fituese:
Operatori Fitues: "C." Sh.p.k.
61,054,278 lekë pa TVSH.</td><td>6. Diferenca me fondin limit
158,638.65 lekë pa TVSH</td></tr>
<tr><td>7/1 Data e hapjes së tenderit:
Data 06.11.2023</td><td colspan="2">8. Burimi Financimit
Buxheti i shtetit: 48,970,333.33 lekë pa TVSH
Grandi i bashkisë: 10,249,466.66 lekë pa TVSH</td><td>9. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender: 2 OE</td></tr>
</table>

7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj	Të ardhurat: **1,993,116.66** lekë pa TVSH	b) S'kualifikuar: **1 B/OE,** c) Kualifikuar: **1 B/OE**
10.Ankimime **AK**-s'ka **APP–**s'ka **KPP**-s'ka	**11. Data e lidhjes të kontratës:** **Nr. 6332 prot., datë 30.11.2023**	**12. P*ë*rgjigje** Ankesës nga APP, AK apo **KKP: AK**

- **AK në lidhje me "Përllogaritjen e Fondit Limit":**

Nga auditimi i dosjes së procedurës, konstatohet se *Projekt – Preventivat, Relacionet, Raportet, Grafikun e punimeve* dhe *Specifikimet Teknike* përkatëse për punimet objekt prokurimi *"Rikonstruksion i ish-Hotelit të ish-Uzinës së Ferrokromit, në qytetin e Burrelit"* është hartuar nga studio projektimi "D." për vlerën 61,212,916.65 lekë. Nga verifikimi i disa prej zërave, u konstatua se nuk ka diferenca dhe se çmimet e aplikuara janë në zbatim të manualit të çmimeve.

AK në lidhje me "Hartimin e Specifikimeve Teknike"

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, është ngritur një komision paraprak me urdhrin nr. 610 datë 17.10.2023 "Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit", i përbërë nga z. E. A. *(Jurist/ Person përgjegjës),* znj. M. C. *(Inxh. Ndërtimi/ Specialist i fushës),* znj. D. T. *(Ekonomist/ Anëtar),* të cilët janë evidentuar në procesverbalin e datës 09.01.2023.

Nga auditimi i procesverbalit nr. ska të datës 19.10.2023 konstatohet se:

Në pikën 2.3.2 të DST*, ndër të tjera janë kërkuar kategori licence (Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada)* **– Klasifikimi C dhe Kategoria NS-4** *(Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese)* **– Klasifikimi B** *këto kategori licence nuk janë të argumentuara sipas preventivit të punimeve.*

Në pikën 2.3.5 të DST, është kërkuar nga Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **50** *(pesëdhjetë)* **punonjës** për periudhën **3** *(tre)* muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik.

Sipas grupit të auditimit: Për të përcaktuar stafin teknik dhe stafin mbështetës të nevojshme për realizimin e kontratës, duhet analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 216, date 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim" bazuar ne përllogaritjen e orëve të punës , kategoritë e punimeve të përcaktuara në preventive, specifikimet teknike të objektit, detajeve të projektit dhe tipologjia e zërave të punimeve , të cilat lidhen ngushtësisht me listën e stafit teknik të kërkuar nga AK , si edhe bazuar në domosdoshmërinë e realizimit sa me shpejt të objektit konkretisht:

[3]

Nr.	AN.	ZËRAT E PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ORË PUNE / NJËSI	ORË PUNE TOTAL	DITË PUNE

Në pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik, AK i ka kërkuar: *"Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë në stafin kryesor dhe stafin mbështetës* - 1 (një) Arkitekt.

Në lidhje me kërkesën për arkitekt, sqarojmë se në dokumentet e procedurës së prokurimit AK ka publikuar njëherazi "Preventivin e punimeve", "Relacionin Teknik", "Specifikimet Teknike", "Grafikun e punimeve" dhe "Projektin e Zbatimit", duke i vënë në dispozicion, informacionin operatorëve ekonomikë pjesëmarrës mbi projektin të cilët këto të fundit do të zbatojnë në rast të fitimit të kontratës. Disponueshmëria si pjesë e stafit teknik të një arkitekti në fazën e zbatimit të punimeve, ku ndër të tjera autoriteti kontrakor ka kërkuar referuar kritereve të veçanta të kualifikimit pjesë të stafit teknik, inxhinierët, si ndërtimi, elektrik, dhe mekanik, shkon përtej synimit të AK dhe njëherazi nuk është në proprocion me natyrën dhe volumin e kontratës. Disponueshmëria e një arkitekti referuar natyrës së punimeve dhe duke marrë në konsideratë

faktin se AK ka parashikuar në mënyrë të detajuar projektin e zbatimit, specifikimet teknike, nuk shfaqet e nevojshme në proporcion me natyrën dhe volumin e punimeve.
Në pikën 2.3.7/e të DST, është kërkuar nga Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar **1** *(një)* **mjek** të përgjithshëm si dhe 1 *(një)* inxhinier që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizmit të punimeve nuk argumentohet teknikisht sepse është i nevojshëm pasi në pikën 2.3.3 është kërkuar certifikata ISO 45001 (Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë).
Sa më sipër veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", **neni 78, pika 2** "hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" ku citohet se: "Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese ... bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.
- **Në çdo rast**, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.". Konstatohet se nuk ka asnjë argumentim në lidhje me kriterin kryesor të procedurës së prokurimit, i cili është "Kriteri për shpalljen e ofertës fituese". Janë konstatuar shkelje të **nenit 87 pika 2 dhe 4**, të Ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", sipas të cilit: " 4- Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese".
Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: ***1. E. A.*** *(Jurist/ Person përgjegjës),* ***2. M. C.*** *(Inxh. Ndërtimi/ Specialist i fushës),* ***3. D. T.*** *(Ekonomist/ Anëtar).*

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.
Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë **2** *(dy)* OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 4, të **datës 10.11.2023**, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	**"C."** Sh.p.k.	**61 054 278**	**Kualifikuar**
2	**"L."** Sh.p.k.	**53 864 767.41**	**S'kualifikuar;** IV. I. Nuk është përmbushur përcaktimi i **pikës 2.3.4**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik për përmbushjen e këtij kriteri konstatohet se: - Për mallin pllaka porcelani, nuk është paraqitur *Autorizimi/ Marrëveshja i/e prodhuesit* "S." C. për distributorin "D." Sh..A. - Për mallin pajisje hidrosanitare dhe hidraulike, nuk është paraqitur katalogu për pajisjet hidrosanitare të prodhuesit *"G."*, ndërsa për pajisjet hidraulike, nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar si: *Autorizim prodhuesi, Çertifikatë ISO, Katalogu i pajisjeve.* - Për listën e mallrave pajisje elektrike, nuk është paraqitur Autorizimi i distributorit *"S." Sh.p.k., për ofertuesin "L." Sh.p.k., si dhe mungon katalogu për pajisjet kryesore elektrike si: priza, çelësa, etj. të përcaktuara në preventivin objekt prokurimi*. - Për mallrat pajisje hidroizoluese dhe termoizoluese, referuar dokumentacionit të paraqitur (Autorizim, Çertifikatë ISO, Katalog) rezulton se, shoqëria "D." Sh.A., nuk është prodhuese e materialeve hidroizoluese (katrama) dhe termoizoluese (Polisterol) të përcaktuara në preventivin objekt prokurimi.

			- Për mallin bojë hidroplastike, nuk është paraqitur katalogu i prodhuesit "D." Sh.A.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës **Nr.Prot.6286**, më **datë 24.11.2023**, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga **2** *(dy)* operatorë pjesëmarrës është s'kualifikuar **1** *(një)* OE, është kualifikuar **1** *(një)* OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më **datë 24.11.2023** ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë **"C."** Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K....F** për të cilën është lidhur kontrata **datë 30.11.2023** për vlerën **61,054,278** lekë pa TVSH dhe vlera **73,265,133** lekë me TVSH, dhe me afat **6** *(gjashtë)* **muaj** nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Konkluzion: *Arrihet në përfundimin se ky operator i plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në DST dhe vendimi i KVO për shpalljen fitues të këtij operatori është i drejtë.*

5. Auditim i procedurës me objekt ***"Rikonstruksion i plotë i shkollës së mesme "Pjetër Budi" + terrene sportive"***.

<table>
<tr><td colspan="4">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i plotë i shkollës së mesme "Pjetër Budi" + terrene sportive".</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
"E Hapur - Punë"
REF-77246-08-10-2023
Urdhri nr. 363, datë 08.08.2023</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit
Urdhri nr. 363, datë 08.08.20231.
1. E. A.
2. M. C.
3. D. T.</td><td>2 Njësia e Prokurimit

1. E. A.
2. M. C.
3. D. T.</td><td>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr. 364, datë 08.08.2023.
1. E. H.
2. R. K.
3. E. R.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa tvsh)
79,060,800 lekë pa TVSH</td><td colspan="2">5. Oferta fituese, vlera fituese:
Operatori Fitues: "U." Sh.p.k.
76,990,739.94 lekë pa TVSH.</td><td>6. Diferenca me fondin limit
2,070,060.06 lekë pa TVSH</td></tr>
<tr><td>7/1 Data e hapjes së tenderit:
Data 28.08.2023
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj</td><td colspan="2">8. Burimi Financimit
Buxheti i shtetit: 67,368,516.66 lekë pa TVSH
Grandi i Bashkisë: 4,483,333.33 lekë pa TVSH
Të ardhurat: 7,208,950 lekë pa TVSH</td><td>9. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender: 3 OE
b) S'kualifikuar: 2 B/OE,
c) Kualifikuar: 1 B/OE</td></tr>
<tr><td>10.Ankimime
AK-s'ka
APP–s'ka
KPP-s'ka</td><td colspan="2">11. Data e lidhjes të kontratës:
Nr. 5296 prot., datë 04.10.2023</td><td>12. Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK</td></tr>
</table>

- **AK në lidhje me "Përllogaritjen e Fondit Limit":**

Nga auditimi i dosjes së procedurës, konstatohet se *Projekt – Preventivat, Relacionet, Raportet, Grafikun e punimeve* dhe *Specifikimet Teknike* përkatëse për punimet objekt prokurimi *"Rikonstruksion i plotë i shkollës së mesme "Pjetër Budi" + terrene sportive"* është hartuar nga studio projektimi "T." për vlerën 79,060,800 lekë. Nga verifikimi i disa prej zërave, u konstatua se nuk ka diferenca dhe se çmimet e aplikuara janë në zbatim të manualit të çmimeve.

AK në lidhje me "Hartimin e Specifikimeve Teknike"

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, është ngritur një komision paraprak me urdhrin nr. 363 datë 21.12.2022 "Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit", i përbërë nga z. E. A. *(Jurist/ Person përgjegjës)*, znj. M. C. *(Inxh. Ndërtimi/ Specialist i fushës)*, z. D. R. *(Ekonomist/ Anëtar)*, të cilët janë evidentuar në procesverbalin e datës 09.01.2023.

Nga auditimi i procesverbalit nr. ska të datës 10.08.2023 konstatohet se:

Në pikën 2.1 të DST, *është kërkuar nga OE që* të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2019**, **2020**, dhe **2021** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 *(një)* nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 100 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.
Kërkesa për paraqitjen e xhiros vjetore 2019-2021 është kërkes e pa argumentuar pasi data e hapjes së tenderit është data 08.08.2023, pra është mbyllur viti ushtrimor 2022. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në percaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Në pikën 2.2 të DST, *është kërkuar nga OE që* të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2019**, **2020**, dhe **2021**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar.
Kërkesa për paraqitjen e bilancit vjetore 2019-2021 është kërkes e pa argumentuar pasi data e hapjes së tenderit është data 08.08.2023, pra është mbyllur viti ushtrimor 2022, i cili mbyllet brenda 31 marsi të vitit pasardhës sipas përcaktimeve të Ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe pika 4, e Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Në pikën 2.3.2 të DST*, ndër të tjera janë kërkuar kategori licence* Kategoria *NS-18 Punime topogjeodezike* – Klasifikimi B
Sipas grupit të auditimit *dhe në konsultim me inxhinierin e grupit, këto kategori licence nuk përputhen me tipologjinë e procedurës, kjo për faktin se referuar zërave të preventivit nuk ka asnjë zë që argumentin këto linesa, ku kategoria N.S – 18/B- Punime topogjeodezike konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.*
Në pikën 2.3.4 të DST, *është kërkuar nga OE ofertues disponimin si vijon: -*"*të paraqesë licencën – **Kodi III.2.B - "Për grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme",** të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), të vlefshme*".
Kjo kërkesë është ezauruar gjatë fazës së hartimit të projekt/preventivit, relacioneve teknike respektive dhe raporti i vlerësimit në mjedis**.** Nga sa më sipër rezulton se për aq kohë sa subjekti zbatues i punimeve nuk do të ketë lidhje me grumbullimin dhe transportin e mbetjeve nga ujërat e ndotura, kjo pasi siç theksohet edhe në cilësimet e bëra nga ana e Projektuesit, kriteri i propozuar paraprakisht nga NJP dhe i miratuar nga ana e Titullarit të AK është i paargumentuar, përtej domosdoshmërive dhe jashtë nevojave duke u bërë kështu shkak për krijimin e kushteve të mungesës së një konkurrence të lirë e të ndershme, në mospërputhje me pikën (a) e nenit 1 të Ligjit nr. 10440, datë 7.7.2021 "*Për vlerësimin në mjedis*", me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit. Gjithashtu e drejta për të marrë kategorinë e licencës III.2/B jepet për shoqëri që kryejnë aktivitet që kanë ndikim në mjedis, si për shoqërinë që kanë impiante betoni, asfalti apo aktivitete të tjerë që ndikojnë në mjedis. Referuar procedurës së prokurimit rezulton se nuk është aktivitet që plotësoni këto kushte. Nga NJP është përcaktuar baza ligjore ku është mbështetur një kriter i tillë.

Në pikën 2.3.5 të DST, është kërkuar nga Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **85** *(tetëdhjetë e pesë)* **punonjës** për periudhën **3** *(tre)* muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik.
Sipas grupit të auditimit: Për të përcaktuar stafin teknik dhe stafin mbështetës të nevojshme për realizimin e kontratës, duhet analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 216, date 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin

e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim" bazuar ne përllogaritjen e orëve të punës , kategoritë e punimeve të përcaktuara në preventive, specifikimet teknike të objektit, detajeve të projektit dhe tipologjia e zërave të punimeve , të cilat lidhen ngushtësisht me listën e stafit teknik të kërkuar nga AK , si edhe bazuar në domosdoshmërinë e realizimit sa me shpejt të objektit konkretisht:
[4]

Nr.	AN.	ZËRAT E PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ORË PUNE / NJËSI	ORË PUNE TOTAL	DITË PUNE

Në pikën 2.3.6 të DST, *është kërkuar nga OE t*ë kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, Minimuni **1** *(një)* **Arkitekt.** *Kërkesa për ing. Arkitekt në procedura me objekt rikonstruksion që nuk lidhet me tipologjinë e procedurës dhe se ky kriter është ezuruar gjatë fazës së hartimit të projektit;*
Në pikën 2.3.7/e të DST, është kërkuar nga Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar **1** *(një)* **mjek** të përgjithshëm si dhe 1 *(një)* inxhinier që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizmit të punimeve nuk argumentohet teknikisht sepse është i nevojshëm pasi në pikën 2.3.3 është kërkuar certifikata ISO 45001 (Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë).

Sa më sipër veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", **neni 78, pika 2** "hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" ku citohet se: "Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese ... bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.
- **Në çdo rast**, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.". Konstatohet se nuk ka asnjë argumentim në lidhje me kriterin kryesor të procedurës së prokurimit, i cili është "Kriteri për shpalljen e ofertës fituese". Janë konstatuar shkelje të **nenit 87 pika 2 dhe 4**, të Ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", sipas të cilit: " 4- Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese".
Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: ***1. E. A.*** *(Jurist/ Person përgjegjës),* ***2. M. C.*** *(Inxh. Ndërtimi/ Specialist i fushës),* ***3. D. T.*** *(Ekonomist/ Anëtar).*

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.
Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë **3** *(dy)* OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 4, të **datës 15.09.2023**, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	**"U."** Sh.p.k.	**76,990,739.94**	**Kualifikuar**
2	**BOE: "A."** Sh.p.k. & "**K."** Sh.p.k	**77,695,002.074**	**S'kualifikuar;** II. Nuk është përmbushur përcaktimi i **pikës 2.3.5**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë për përmbushjen e këtij kriteri konstatohet se, *Autorizimet, katalogjet etj.*, të paraqitura janë lëshuar për mallra/materiale të tjera të kërkuara në një proçedure tjetër prokurimi të zhvilluar më herët nga një autoritet tjetër kontraktor, dhe nuk është

			paraqitur dokumentacioni për mallrat/ materialet e kërkuara në këtë proçedurë prokurimi në të cilën kanë marrë pjesë si ofertues. II. Nuk është përmbushur përcaktimi i **pikës 2.3.7 gërma "a"**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi referuar Formularëve Përmbledhës të Vetëdeklarimit *sipas shtojcës 8* në DST, të paraqitura nga secili prej operatorëve ekonomik në bashkim, nuk është deklaruar nga ana e tyre se disponojnë minimumi 1 *(një)* inxhinier ndërtimi me profilin strukturist të kërkuar. X. Nuk është përmbushur përcaktimi i **pikës 2.3.9 gërma "a"**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi referuar Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, të paraqitur nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomik, shoqëria "A." Sh.p.k., konstatohet se, në Seksionin *C: DEKLARATË "Për disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate"*, nuk janë përcaktuar saktë llojet e mjeteve (kamion) në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, për të cilat janë paraqitur të dhënat. X. Nuk është përmbushur përcaktimi i **pikës 2.3.10**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar për përmbushjen e këtij kushti.
3	**BOE: "U."** Sh.p.k.,**"R."** Sh.p.k **"N."** Sh.p.k, & **M."**	**78,304,409**	**<u>S'kualifikuar;</u>** Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës **2.3.1**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga anëtari i B.O.E., shoqëria "M." Sh.p.k., konstatohet se, kontrata e paraqitur nuk është e përfunduar, pasi vlera e kontratës është në shumën 924,000 Euro me TVSH, ndërsa vlera e realizuar/ situacionuar është në shumën: 50,381,100 lekë pa TVSH, ose 385,000 Euro pa TVSH, vlerë e cila rezulton ti jetë dhënë paradhënie në bazë të kushteve të kontratës së shërbimit të nënshkruar me palën pronare/ porositëse, si dhe dokumentacioni teknik nuk është i rregullt. Nuk është përmbushur përcaktimi i **pikës 2.3.3**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë për përmbushjen e këtij kriteri konstatohet se, nga anëtari i B.O.E., shoqëria "N." Sh.p.k., nuk janë paraqitur çertifikatat ISO të kërkuara. Nuk është përmbushur përcaktimi i **pikës 2.3.5**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë për përmbushjen e këtij kriteri konstatohet se, nuk është paraqitur çertifikata ISO 9001 për prodhuesin e materialeve elektrike ("L.") të përcaktuara në

			preventiv, për vërtetimin se materialet e ofertuara janë të prodhuar nga prodhues të çertifikuar me ISO 9001. Nuk është përmbushur përcaktimi i **pikës 2.3.7 gërma "b"**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi referuar Formularëve Përmbledhës të Vetëdeklarimit *sipas shtojcës 8* në DST, të paraqitura nga operatorët ekonomik në bashkim konstatohet se, anëtari i B.O.E., shoqëria "R." Sh.p.k., nuk disponon punonjës/ specialistë elektrik, për kryejen e punimeve për rrjetin elektrik të fuqisë dhe rrjetin elektrik të ndriçimit të klasave, të marra përsipër sipas preventivit të ndarjes së punimeve të paraqitur, anëtari i B.O.E., shoqëria "U." Sh.p.k., nuk disponon punonjës/ specialistë hidraulik, për kryejen e punimeve për punimet hidrosanitare (I. Sistemi i furnizimit me uj sanitar) të marra përsipër sipas preventivit të ndarjes së punimeve të paraqitur, në kundërshtim kjo me përcaktimet e nenit 88 pika 3/1 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 (i ndryshuar). Nuk është përmbushur përcaktimi i **pikës 2.3.7 gërma "c"**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi referuar Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit *sipas shtojcës 8* në DST, të paraqitur nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomik, shoqëria "N." Sh.p.k., konstatohet se, nuk disponon punonjës/ specialistë të specializuar dhe çertifikuar për përdorim dhe punime në skela (për punimet në lartësi), për kryejen e punimeve për fasadën të marra përsipër sipas preventivit të ndarjes së punimeve të paraqitur, në kundërshtim kjo me përcaktimet e nenit 88 pika 3/1 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 (i ndryshuar). Nuk është përmbushur përcaktimi i **pikës 2.3.8**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi referuar Formularëve Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, të paraqitura nga operatorët ekonomik në bashkim konstatohet se, nuk dispojnë 5 *(pesë)* shoferë të mjeteve të rënda, por vetëm 4 *(katër)* të tillë. Nuk është përmbushur përcaktimi i **pikës 2.3.9**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi referuar Formularëve Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, të paraqitura nga operatorët ekonomik në bashkim konstatohet se, Seksioni *C: DEKLARATË "Për disponimin e mjeteve/ pajisje/ makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate"*, nuk është plotësuar saktë me të gjitha të dhënat që kërkohen, ku: Anëtari i B.O.E. shoqëria "N." Sh.p.k., nuk ka deklaruar të dhënat e Faturave Tatimore për pajisjet: *Skeleri, Betoniere 0.25 – 05 m^3, Vibrator thellësie, gjenerator, matrapik*, si dhe nuk ka deklaruar disponimin e mjeteve/pajisjeve për mbrojtjen në punë të punëtorëve. Anëtari i B.O.E. shoqëria "R." Sh.p.k., nuk ka deklaruar të dhënat e Faturës Tatimore për pajisjet skeleri (500 m^2).

			Anëtari i B.O.E. shoqëria "M." nuk ka deklaruar disponimin e mjeteve/pajisjeve për mbrojtjen në punë të punëtorëve që do të angazhojë për punimet që ka marrë përsipër. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.10/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar për përmbushjen e këtij kushti.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës **Nr.Prot.5208**, më **datë 29.09.2023**, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga **3** *(tre)* operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar **2** *(dy)* BOE, është kualifikuar **1** *(një)* OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më **datë 29.09.2023** ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë **"U."** Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J.....O** për të cilën është lidhur kontrata **datë 04.10.2023** për vlerën **76,990,739.94** lekë pa TVSH dhe vlera **91,182,262.17** lekë me TVSH, dhe me afat **12** *(dymbëdhjetë)* **muaj** nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Në lidhje me vlerësimin e ofertave, nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e subjektit sitemin SPE, dhe dokumentacionit të OE fitues, rezultoi se:
1- Skualifikimin i OE nga KVO-ja është bërë në përputhje me dispozitat e LPP, pasi OE pjesëmarrës nuk plotësonin kërkesat kualifikuse të DT, të evidentuara nga KVO.
2- *Arrihet në përfundimin se ky operator ekonomik "U." Sh.p.k., me numër Nipt-i: J.....O i plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në DST dhe vendimi i KVO për shpalljen fitues të këtij operatori është i drejtë.*

*6. Auditimi i procedurës me objekt: **"Rikonstruksion rruga Lis".***

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: *"Rikonstruksion rruga Lis"*.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit **"E Hapur - Punë"** **REF-55699-01-09-2023** Urdhri **nr. 842**, datë **21.12.2022**	**1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit** Urdhri nr. **842**, datë **21.12.2022** 1. E. A. 2. M. C. 3. D. R.	**2 Njësia e Prokurimit** 1. E. A. 2. M. C. 3. D. R.	**3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhri **nr. 843**, datë **21.12.2022**. 1. E. H. 2. R. K. 3. E. R.
4. Fondi Limit (pa tvsh) **27,870,583** lekë pa TVSH	**5. Oferta fituese, vlera fituese:** Operatori Fitues: **"L."** Sh.p.k. **27,469,100** lekë pa TVSH.		**6. Diferenca me fondin limit** **401,483** lekë pa TVSH
7/1 Data e hapjes së tenderit: **Data 25.01.2023** **7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 7 muaj**	**8. Burimi Financimit** Buxheti i shtetit: **18,175,000** lekë pa TVSH Të ardhurat: **9,695,583** lekë pa TVSH		**9. Operatoret Ekonomike** a) Pjesëmarrës në tender: **2 OE** b) S'kualifikuar: **1 B/OE,** c) Kualifikuar: **1 B/OE**
10.Ankimime **AK**-s'ka **APP**–s'ka **KPP**-s'ka	**11. Data e lidhjes të kontratës:** **Nr. 957 prot., datë 01.03.2023**		**12. P*ë*rgjigje** Ankesës nga APP, AK apo **KKP: AK**

- **AK në lidhje me "Përllogaritjen e Fondit Limit":**

Nga auditimi i dosjes së procedurës, konstatohet se *Projekt – Preventivat, Relacionet, Raportet, Grafikun e punimeve* dhe *Specifikimet Teknike* përkatëse për punimet objekt prokurimi *"*Rikonstruksion rruga Lis*"* është hartuar nga Ing M. A. me nr. Licence K.... për vlerën 27,870,583 lekë. Nga verifikimi i disa prej zërave, u konstatua se nuk ka diferenca dhe se çmimet e aplikuara janë në zbatim të manualit të çmimeve.

AK në lidhje me "Hartimin e Specifikimeve Teknike" dhe "Përllogaritjen e Fondit Limit" :

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, është ngritur një komision paraprak me urdhrin nr. 842 datë 21.12.2022 "Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit", i përbërë nga z. E. A. (Jurist/ Person përgjegjës), znj. M. C. (Inxh. Ndërtimi/ Specialist i fushës), z. D. R. (Ekonomist/ Anëtar), të cilët janë evidentuar në procesverbalin e datës 06.01.2023.

Nga auditimi i procesverbalit nr. ska të datës 06.01.2023 konstatohet se:

Në pikën 2.3.2 të DST, ndër të tjera janë kërkuar kategori licence Kategoria NS-18 Punime topogjeodezike – Klasifikimi A

Sipas grupit të auditimit dhe në konsultim me inxhinierin e grupit, këto kategori licence nuk përputhen me tipologjinë e procedurës, kjo për faktin se referuar zërave të preventivit nuk ka asnjë zë që argumentin këto linesa, ku kategoria N.S – 18/A- Punime topogjeodezike konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

Në pikën 2.3.5 të DST, është kërkuar nga Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak **40** (dyzet) **punonjës** për periudhën **3** (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik.

Sipas grupit të auditimit: Për të përcaktuar stafin teknik dhe stafin mbështetës të nevojshme për realizimin e kontratës, duhet analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 216, date 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim" bazuar ne përllogaritjen e orëve të punës , kategoritë e punimeve të përcaktuara në preventive, specifikimet teknike të objektit, detajeve të projektit dhe tipologjia e zërave të punimeve , të cilat lidhen ngushtësisht me listën e stafit teknik të kërkuar nga AK , si edhe bazuar në domosdoshmërinë e realizimit sa me shpejt të objektit konkretisht:

5

Nr.	AN.	ZËRAT E PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ORË PUNE / NJËSI	ORË PUNE TOTAL	DITË PUNE

Në pikën 2.3.6 të DST, ndër të tjera janë kërkuar minimuni 1 (një) Inxhinier Mjedisi është një kërkes e cila nga grupi I punës për hartimin e kërkesave të vecanta të kualifikimit nuk gjen një argument tekniko ligjor sipas tipologjis së punimeve që do të realizohen sipas preventivit të punimeve.

Në pikën 2.3.7/e të DST, është kërkuar nga Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar 1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë/dëshmi si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" si dhe 1 (një) punonjës që përmbush kriteret për të qenë "Ekspert për Ndihmën e parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave". nuk argumentohet teknikisht sepse është i nevojshëm pasi në pikën 2.3.3 është kërkuar certifikata ISO 45001 (Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë).

Në pikën 2.3.8 të DST, është kërkuar total prej 7 Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës nga 3.5 deri mbi 20 ton, të cilët nuk janë argumentuar sipas zërave të punimeve. Gjithashtu janë kërkuar 2 Eskavator me goma, 1 Eskavator me zinxhirë, 1 Buldozer me zinxhir mbi 6 ton si dhe 2 Fadromë me goma (Kovë para dhe mbrapa) janë kërkesa specifikime të cilat nuk argumentohen me zërat e preventivit pasi sasia e gërmimit sipas preventivit është 1,500 m^3.

Gjithashtu është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të disponoje në pronesi, qira ose kontratë bashkepunimi impiantet si me poshte vijon:

a. 1 (një) Impiant prodhimi Inerte (Kodi III.1.A)
b. 1 (nje) Impiant prodhimi Betoni (Kodi III.1.B)

Për impiantin e prodhimit te inerteve/betonit, ne rast se është ne pronësi duhet te paraqiten dokumente qe vërtetojnë pronësinë e saj, (Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B) .Ne rast se impianti i prodhimit te inerteve/betonit, është me qera ose kontrate bashkëpunimi duhet te paraqitet kontrata e qerase/bashkëpunimit e vlefshme për periudhën tone te zbatimit te punimeve .

Kriteret e vendosura në kërkesat e pikës 2.3.9 nuk janë të argumentuar teknikisht dhe ligjërisht pasi në rastet kur fabrika e betonit - elementeve të betonit - bordurave dhe pllakave nuk janë në pronësi të ofertuesit rezulton se kërkesa për paraqitjen me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, për të cilën duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë/kontratën e qerase/kontratën e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, u drejtohet personave të tretë që nuk janë konkurent në këtë procedur prokurimi. Nuk përmbushin parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik sipas nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar i cili përcakton se:

"Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës" .

Sa më sipër veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", **neni 78, pika 2** "hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" ku citohet se: "Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese ... bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

- **Në çdo rast**, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.". Konstatohet se nuk ka asnjë argumentim në lidhje me kriterin kryesor të procedurës së prokurimit, i cili është "Kriteri për shpalljen e ofertës fituese". Janë konstatuar shkelje të **nenit 87 pika 2 dhe 4**, të Ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", sipas të cilit: " 4- Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese".

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: **1. E. A.** (Jurist/ Person përgjegjës), **2. M. C.** (Inxh. Ndërtimi/ Specialist i fushës), **3. D. T.** (Ekonomist/ Anëtar).

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë **2** *(dy)* OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 4, të **datës 08.02.2023**, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	**"L."** Sh.p.k.	**27,469,100**	**Kualifikuar**
2	**"V."** Sh.p.k.	**27,677,600**	**S'kualifikuar;** I. I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1, gërma "a"/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit: *"1. Ofertuesi duhet të paraqesë:* *a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8..."*

			➢ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se *Formulari Përmbledhës i vetëdeklarimit* i paraqitur nuk është sipas formatit të Shtojcës 8 të Dokumentave Standarte të Tenderit për këtë proçedurë prokurimi, miratuar ndryshimet me Vendimin Nr.10, datë 05.10.2022 *"Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në dokumentet standarte të tenderit për mallra, punë, shërbime për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur"* të Agjencisë së Prokurimit Publik. II. II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit: *2.3.8 (Makineri, Pajisje)* ***a)** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;...* ➢ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, *Formulari Përmbledhës i vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr.8*, konstatohet se, për mjetin e kërkuar *"Buldozer me zinxhir mbi 6 ton"* (deklaruar në pronësi), nuk është përcaktuar lloji *(gomë/ zinxhir)* dhe pesha e tij, siç kërkohet në kriterin e DST-së. III. IV. III. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.9/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit: *2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë "Njësi/ Fabrikë prodhimi Asfaltobetoni", në pronësi ose me qera ose me kontratë furnizimi (Kontrata Noteriale e Qerasë/ Furnizimit duhet të ketë kohëzgjatje për gjithë periudhën e realizimit të punimeve objekt kontrate), ku për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet:* *- Dokumentacioni që vërteton pronësinë (Çertifikatë, Plan-Vendosje & Kartelë e pasurisë) dhe kontratën noteriale të qerasë/ furnizimit në rast se kantieri është me qera ose kontratë furnizimi.* *- Leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (në përputhje me ligjin Nr.10 448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit" i ndryshuar).* ➢ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për vërtetimin e disponimit të "Njësisë/ Fabrikë prodhimi Asfaltobetoni". V. IV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.10/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit: *2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratën, ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objekt investimit, dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).* ➢ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, operatori ekonomik nuk ka paraqitur deklaratën në lidhje me dakortësinë mbi mënyrën e financimit të objekt investimit.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës **Nr.Prot.863**, më **datë 23.02.2023**, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga **2** *(dy)* operatorë pjesëmarrës është s'kualifikuar **1** *(një)* OE, është kualifikuar **1** *(një)* OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK

më **datë 23.02.2023** ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë **"L."** Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K……Ë** për të cilën është lidhur kontrata **datë 01.03.2023** për vlerën **27,469,100** lekë pa TVSH dhe vlera **32,962,920** lekë me TVSH, dhe me afat **7** *(shtatë)* **muaj** nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Në lidhje me vlerësimin e ofertave, nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e subjektit sitemin SPE, dhe dokumentacionit të OE fitues, rezultoi se:
1- Skualifikimin i OE nga KVO-ja **është bërë në përputhje me dispozitat e LPP**, pasi OE pjesëmarrës nuk plotësonin kërkesat kualifikuse të DT, të evidentuara nga KVO;
2- Referuar formularit të vetëdeklarimit të paraqitur nga OE "L." Shpk rezultojnë se është deklaruar mjete Rrul asfalti për të cilin është paraqitur Deklarata Doganore Nr. R44248 date 06.07.2009, mjeti Minifadrome është paraqitur Kontrate shit-blerje numer 3408 Rep. numër 2588 kol. date 22.07.2010, mjeti Asfaltoshtruese është paraqitur Deklarata Doganore NR 93248 DT 16.12.2008, mjetin Eskavator me zinxhirë është paraqitur Deklarata Doganore R 39027 DATE 12.04.2017, mjeti Minieskavator është paraqitur Fat. R 39037 date 12.04.2017 sj dhe për mjetin Rrul gomë – cilindër mbi 12 ton është paraqitur Deklarata Doganore Nr. R20582 date 22.03.2009. Këto mjete nuk janë të regjistruar në regjistrat publikë dhe nuk disponon çertifikatën e pronësisë, lejen e qarkullimit, çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, por vetëm deklaratën/vërtetimin e zhdoganimit të datës 10.06.2019. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, "Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 58 "Makinat teknologjike" dhe neni 113 "Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike".
Për sa trajtuar më sipër OE "L." Shpk nuk plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimet dhe kriteret e veçanta të vendosura në DT. Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave" pika 2.
Për sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO, me përbërje si vijon: ***1.*** *E. H. (Person përgjegjës),* ***2.*** *R. K.,* ***3.*** *E. R. (Anëtar).*

7. Auditimi i procedurës me objekt: "Rikonstruksion ure pasarel në fshatin Rreth-Baz, Njësia Administrative Baz, Bashkia Mat".

<table>
<tr><td colspan="4">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion ure pasarel në fshatin Rreth-Baz, Njësia Administrative Baz, Bashkia Mat".</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
"E Hapur - Punë"
REF-75646-07-20-2023
Urdhri nr.319, datë 19.07.2023</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit
Urdhri nr.319, datë 19.07.2023
1. E. A.i
2. M. C.
3. E. X.</td><td>2 Njësia e Prokurimit

1. E. A.i
2. M. C.
3. E. X.</td><td>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr. 320, datë 19.07.2023.

1. E. H.
2. R. K.
3. E. R.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa tvsh)
15,315,674 lekë pa TVSH</td><td colspan="2">5. Oferta fituese, vlera fituese:
BOE: "D." Sh.p.k &" "F." Sh.p.k
14 914 982.45 lekë pa TVSH.</td><td>6. Diferenca me fondin limit
400,691.55 lekë pa TVSH</td></tr>
<tr><td>7/1 Data e hapjes së tenderit:
Data 07.08.2023</td><td colspan="2" rowspan="2">8. Burimi Financimit
Nga buxheti i shtetit: 15,315,674 lekë pa TVSH</td><td rowspan="2">9. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender: 1 OE
b) S'kualifikuar: 0 OE,
c) Kualifikuar: 1 BOE</td></tr>
<tr><td>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 5 muaj</td></tr>
<tr><td>10.Ankimime
AK-s'ka
APP–s'ka
KPP-s'ka</td><td colspan="2">11. Data e lidhjes të kontratës:
Nr. 4046 prot., datë 31.08.2023</td><td>12. Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK</td></tr>
</table>

- **AK në lidhje me "Përllogaritjen e Fondit Limit":**

Nga auditimi i dosjes së procedurës, konstatohet se *Projekt – Preventivat, Relacionet, Raportet, Grafikun e punimeve* dhe *Specifikimet Teknike* përkatëse për punimet objekt prokurimi "Rikonstruksion ure pasarel në fshatin Rreth-Baz, Njësia Administrative Baz, Bashkia Mat" është hartuar nga Ing. B. M. dhe studio projektimi "E." për vlerën 15,315,674 lekë. Nga verifikimi i disa prej zërave, u konstatua se nuk ka diferenca dhe se çmimet e aplikuara janë në zbatim të manualit të çmimeve.

AK në lidhje me "Hartimin e Specifikimeve Teknike"

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, është ngritur një komision paraprak me urdhrin nr. **319**, datë **19.07.2023** "Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit", i përbërë nga z. E. A. (Jurist/ Person përgjegjës), znj. M. C. (Inxh. Ndërtimi/ Specialist i fushës), znj. **E. X.** (Ekonomist/ Anëtar), të cilët janë evidentuar në procesverbalin e datës 30.03.2023.

Nga auditimi i procesverbalit nr. ska të datës 30.03.2023 konstatohet se:

Në pikën 2.3.2 të DST, ndër të tjera janë kërkuar kategori licence **Kategoria NP-2** *(Ndërtime civile e industriale)* **– Klasifikimi A dhe Kategoria NP-5** *(Punime nëntokësore, ura e vepra arti)* **– Klasifikimi A.** Këto kategori licence nuk janë të argumentuara teknikishtë referuar zërave të preventivit sipas pikës 1, të nenit 77 të LPP dhe pikës 4, të nenit 39 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për rregullat e prokurimit publik".

Në pikën 2.3.5 të DST, është kërkuar nga Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak **40** (dyzet) **punonjës** për periudhën **3** (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik.

Sipas grupit të auditimit: Për të përcaktuar stafin teknik dhe stafin mbështetës të nevojshme për realizimin e kontratës, duhet analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 216, date 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim" bazuar ne përllogaritjen e orëve të punës , kategoritë e punimeve të përcaktuara në preventive, specifikimet teknike të objektit, detajeve të projektit dhe tipologjia e zërave të punimeve , të cilat lidhen ngushtësisht me listën e stafit teknik të kërkuar nga AK , si edhe bazuar në domosdoshmërinë e realizimit sa me shpejt të objektit konkretisht:

6

Nr.	AN.	ZËRAT E PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ORË PUNE / NJËSI	ORË PUNE TOTAL	DITË PUNE

Në pikën 2.3.6 të DST, ndër të tjera janë kërkuar minimuni 1 (një) Inxhinier Meanik është një kërkes e cila nga grupi i punës për hartimin e kërkesave të vecanta të kualifikimit nuk gjen një argument tekniko ligjor sipas tipologjis së punimeve që do të realizohen sipas preventivit të punimeve.

Në pikën 2.3.7/c të kapacitetit teknik, AK i ka kërkuar: "Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë Minimumi 1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë/dëshmi si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" , Minimuni 1 (një) punonjës që përmbush kriteret për të qenë "Ekspert për Ndihmën e parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave" si dhe Minimumi 1 (një) punonjës të çertifikuar "Përdorim vinç të lëvizshëm"

Sqarim i grupit të auditimit në lidhje me kërkesën për disponimin e 1 (një) punonjësi që përmbush kriteret për të qenë "Ekspert për Ndihmën e Parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave", 1 (një) punonjës të çertifikuar "Përdorim vinç të lëvizshëm" dhe 1 (një) punonjësi me certifikatë/dëshmi si "Përgjegjës për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë", Autoriteti Kontraktor nuk ka paraqitur argumentim të mjaftueshëm mbi domosdoshmërinë e kërkimit të

këtyre funksioneve si pozicione të veçanta, duke marrë në konsideratë natyrën, tipologjinë dhe volumet e kontratës që prokurohet.

Në pikën 2.3.8 të DST, është kërkuar Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë 1 *(një)* Impiant prodhimi Inerte në pronësi, ose me qera, ose me kontratë furnizimi.
Kriteret e vendosura në kërkesat e pikës 2.3.9 nuk janë të argumentuar teknikisht dhe ligjërisht pasi në rastet kur fabrika e betonit - elementeve të betonit - bordurave dhe pllakave nuk janë në pronësi të ofertuesit rezulton se kërkesa për paraqitjen me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, për të cilën duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë/kontratën e qerase/kontratën e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, u drejtohet personave të tretë që nuk janë konkurent në këtë procedur prokurimi. Nuk përmbushin parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik sipas nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar i cili përcakton se:

"Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës" .

Sa më sipër veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", **neni 78, pika 2** "hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" ku citohet se: "Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese ... bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.
- **Në çdo rast**, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.". Konstatohet se nuk ka asnjë argumentim në lidhje me kriterin kryesor të procedurës së prokurimit, i cili është "Kriteri për shpalljen e ofertës fituese". Janë konstatuar shkelje të **nenit 87 pika 2 dhe 4**, të Ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", sipas të cilit: " 4- Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese".
Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: **1. E. A.** (Jurist/ Person përgjegjës), **2. M. C.** (Inxh. Ndërtimi/ Specialist i fushës), **3. E. X.** (Ekonomist/ Anëtar).

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.
Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë **1***(një)* BOE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 4, të **datës 16.08.2023**, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	**BOE: "D."** Sh.p.k & "**F.**" *Sh.p.k*	**14,914,982.45**	**Kualifikuar**

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës **Nr.Prot.3840**, më **datë 23.08.2023**, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, ka qenë pjesëmarrës vetëm **1** *(një)* Bashkim Operatorësh Pjesëmarrës, i cili është kualifikuar. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më **datë 23.08.2023** ka shpallur fituese ofertën e B.O.E. **"D."** Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K....J** dhe **"F."** Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K....C** për të cilën është lidhur kontrata **datë 31.08.2023** për vlerën **14,914,982.45** lekë pa TVSH dhe vlera **17,897,978.94** lekë me TVSH, dhe me afat **5** ***(pesë)*** **muaj** nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Konklucion: *Arrihet në përfundimin se ky operator i plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në DST dhe vendimi i KVO për shpalljen fitues të këtij operatori është i drejtë.*

8. Auditimi i procedurës me objekt: ***"Rikualifikim urban i Bllokut "Lagje e re"****.*

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: ***"Rikualifikim urban i Bllokut "Lagje e re"****.*			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit **"E Hapur - Punë"** **REF-55678-01-06-2023** Urdhri **nr. 848**, datë **21.12.2022**	**1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit** Urdhri **nr. 848**, datë **21.12.2022** 1. E. A. 2. M. C. 3. D. R.	**2 Njësia e Prokurimit** 1. E. A. 2. M. C. 3. D. R.	**3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhri **nr. 849**, datë **21.12.2022**. 1. E. H. 2. R. K. 3. E. R.
4. Fondi Limit (pa tvsh) **27,617,117** lekë pa TVSH	**5. Oferta fituese, vlera fituese:** Operatori Fitues: **"N."** Sh.p.k. **27,439,912.5** lekë pa TVSH.		**6. Diferenca me fondin limit** **177,204.5** lekë pa TVSH
7/1 Data e hapjes së tenderit: **Data 24.01.2023** **7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj**	**8. Burimi Financimit** Buxheti i shtetit: **15,270,000** lekë pa TVSH Të ardhurat: **12,355,000** lekë pa TVSH		**9. Operatoret Ekonomike** a) Pjesëmarrës në tender: **3 OE** b) S'kualifikuar: **2 B/OE,** c) Kualifikuar: **1 B/OE**
10.Ankimime **AK**-s'ka **APP**–s'ka **KPP**-s'ka	**11. Data e lidhjes të kontratës:** **Nr. 960 prot., datë 01.03.2023**		**12.Përgjigje** Ankesës nga APP, AK apo **KKP: AK**

- **AK në lidhje me "Përllogaritjen e Fondit Limit":**

Nga auditimi i dosjes së procedurës, konstatohet se *Projekt – Preventivat, Relacionet, Raportet, Grafikun e punimeve* dhe *Specifikimet Teknike* përkatëse për punimet objekt prokurimi "*Rikualifikim urban i Bllokut "Lagje e re*" është hartuar studio projektimi "E." për vlerën 27,617,117 lekë. Nga verifikimi i disa prej zërave, u konstatua se nuk ka diferenca dhe se çmimet e aplikuara janë në zbatim të manualit të çmimeve.

AK në lidhje me "Hartimin e Specifikimeve Teknike"

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, është ngritur një komision paraprak me urdhrin nr. 848 datë 21.12.2022 "Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit", i përbërë nga z. E. A. (Jurist/ Person përgjegjës), znj. M. C. (Inxh. Ndërtimi/ Specialist i fushës), z. D. R. (Ekonomist/ Anëtar), të cilët janë evidentuar në procesverbalin e datës **06.01.2023**.

Nga auditimi i procesverbalit nr. ska të datës 06.01.2023 konstatohet se:

Në pikën 2.3.2 të DST, ndër të tjera janë kërkuar kategori licence Kategoria NS-18 Punime topogjeodezike – Klasifikimi A

Sipas grupit të auditimit dhe në konsultim me inxhinierin e grupit, këto kategori licence nuk përputhen me tipologjinë e procedurës, kjo për faktin se referuar zërave të preventivit nuk ka asnjë zë që argumentin këto linesa, ku kategoria N.S – 18/A- Punime topogjeodezike konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

Në pikën 2.3.6 të DST, është kërkuar nga Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak **30** (tridhjetë) **punonjës** për periudhën **3** (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik.

Sipas grupit të auditimit: Për të përcaktuar stafin teknik dhe stafin mbështetës të nevojshme për realizimin e kontratës, duhet analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 216, date 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim" bazuar ne përllogaritjen e orëve të punës , kategoritë e punimeve të përcaktuara në preventive, specifikimet teknike të objektit, detajeve të projektit dhe tipologjia e zërave të punimeve , të cilat lidhen ngushtësisht me listën e stafit teknik të kërkuar nga AK , si edhe bazuar në domosdoshmërinë e realizimit sa me shpejt të objektit konkretisht:

[7]

Nr.	AN.	ZËRAT E PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ORË PUNE / NJËSI	ORË PUNE TOTAL	DITË PUNE

Në pikën 2.3.8 të DST, është kërkuar që Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë "Njësi/ Fabrikë prodhimi Asfaltobetoni", në pronësi ose me qera ose me kontratë furnizimi. Dokumentacioni që vërteton pronësinë (Çertifikatë, Plan-Vendosje & Kartelë e pasurisë) dhe kontratën noteriale të qerasë/ furnizimit në rast se kantieri është me qera ose kontratë furnizimi. Leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit *(në përputhje me ligjin Nr.10 448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit" i ndryshuar)*.

Kriteret e vendosura në kërkesat e pikës 2.3.9 nuk janë të argumentuar teknikisht dhe ligjërisht pasi në rastet kur fabrika e betonit - elementeve të betonit - bordurave dhe pllakave nuk janë në pronësi të ofertuesit rezulton se kërkesa për paraqitjen me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, për të cilën duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë/kontratën e qerase/kontratën e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, u drejtohet personave të tretë që nuk janë konkurent në këtë procedur prokurimi. Nuk përmbushin parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik sipas nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar i cili përcakton se:

"Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës" .

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: 1. E. A. (Jurist/ Person përgjegjës), 2. M. C. (Inxh. Ndërtimi/ Specialist i fushës), 3. D. R. (Ekonomist/ Anëtar).

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë **3** *(tre)* OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 4, të **datës 07.02.2023**, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomik	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	**"N."** Sh.p.k.	**27,439,912.5**	Kualifikuar
2	**"E."** Sh.p.k.	**26,890,636.50**	**S'kualifikuar;** ***a)* I.** Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.7 gërma "b"/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:... ➢ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, në Tabelën që përmban të dhënat e punonjësve të kërkuar konstatohet se: - Për punonjësit e specializuar/ kualifikuar të shënuar në tabelë me nr.rendor (2-10, dhe 12-14) nuk jepen të dhënat për *"Nr.*

			Amzës/ekuivalent i diplomës/çertifikatës profesionale" që disponojnë, por janë shënuar nr.personal të identitetit të tyre; - Për punonjësit e specializuar/ kualifikuar të shënuar në tabelë me nr.rendor (4, 9, 14 dhe 16) nuk jepen të dhënat për *"Institucionin publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës"*; - Për punonjësit e specializuar/ kualifikuar të shënuar në tabelë me nr.rendor (2, 4, 6, 8, 10, 12, 14, dhe 16) nuk jepen të dhënat për *"Datën e vlefshmërisë së çertifikatës së Sigurimit Teknik"*. ***b)*** **II.** Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.9/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:... ➢ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, *Formulari Përmbledhës i vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr.8*, konstatohet se, Seksionin *C: DEKLARATË "Për disponimin e mjeteve/ pajisje/ makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate"* nuk është plotësuar saktë me të gjitha të dhënat që kërkohen, ku: - Për mjetet: *"Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton"* me targa: AA...TP, dhe AA...KK, për të cilët keni deklaruar se i dispononi me qira, nuk keni deklaruar të dhënat e kontratës noteriale të nënshkruar me qiradhënësin. - Për mjetet e kërkuar: *"Rrul vibrues për ngjeshje asfalti deri 8 ton, dhe Rrul vibrues gomë - hekur deri 7 ton"*, ky kusht nuk përmbushet nga ana Juaj, pasi keni deklaruar Rrul minimum 8 ton, ndërsa kërkesa është për rrul deri në 8 ton, si dhe për mjetin tjetër keni deklaruar vetëm Rrul, pa paraqitur të dhënat e tij, si dhe nuk keni përcaktuar peshën e tij siç kërkohet në kriterin e DST-së. - Për mjetin: *"Autobetoniere kantieri"*, për të cilat keni deklaruar pronësinë me deklaratat doganore Nr. R 96477, dhe R 40962, nuk janë paraqitur të dhënat e tyre, duke qënë se janë automjete të cilat duhet të regjistrohen në regjistrat publik, ndërsa për Autobetonieret CO BETON me targa: AA...AE; AA...SR; AA...NR të deklaruara me qira, afati i kontratës së qirasë për disponimin e tyre nuk mbulon të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi. - Për mjetin: *"Asfaltoshtruese"* me nr. shasie 867142, nuk keni deklaruar të dhënat e kontratës noteriale të nënshkruar me qiradhënësin. - Për mjetin: *"Asfaltoshtruese"* të deklaruar me qira, për të cilën në deklaratë keni shënuar vetëm *"Nr.1234REP"* në çdo kolonë, nuk jepen të dhënat e asfaltoshtrueses, si dhe të dhënat e Kontratës noteriale të nënshkruar me qiradhënësin. - Për Makinerinë e vijëzimit të deklaruar "*Fat. Nr. R64544, dt.09.06.2017 (13.09.2022-13.09.2023)"* nuk keni deklaruar të dhënat e kontratës noteriale të nënshkruar me qiradhënësin.
3	**"NDERTIMI"** Sh.p.k.	**27,575,310**	**<u>S'kualifikuar;</u>** *2* **I.** Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1, gërma "b"/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:... ➢ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk është paraqitur Formulari i Sigurimit të Ofertës. **II.** Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.3/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:... ➢ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk është paraqitur Çertifikata *PAS 99 (Për sistemin e menaxhimit të integruar) ose ekuivalente me të;* *3* **III.** Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.5/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:... ➢ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar për listën e mallrave/ materialeve.

			IV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.7 gërma "b"/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit: ➢ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk është paraqitur Tabela me të dhënat e kërkuar, si dhe referuar deklarimeve në *Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr.*8 për punonjësit e specializuar/ kualifikuar, rezulton se: - Nga 3 *(tre)* punonjës të kërkuar me specialitetin "Murator", operatori ekonomik ka deklaruar se disponon vetëm 1 *(një*) punonjës me këtë specialitet; - Nuk ka deklaruar se disponon 1 *(një)* punonjës të specializuar "Saldator" dhe 2 *(dy)* punonjës të specializuar/ kualifikuar "Mekanik". V. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit: ➢ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, *Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr.*8, konstatohet se, operatori ekonomik nuk ka deklaruar se disponon 3 *(tre)* shoferë të mjeteve të rënda. VI. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.9/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit: ➢ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, *Formulari Përmbledhës i vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr.8*, konstatohet se: - Operatori ekonomik pjesëmarrës nuk ka deklaruar se disponon 1 *(një)* Minifadromë, 1 *(një)* Autobitumatriçe, 2 *(dy)* Kompaktor ngjeshës, 1 *(një)* Çekiç pneumatik, 1 *(një)* Makineri prerëse asfalti, dhe 1 *(një)* Semafor kantieri për punime në rrugë. - Për mjetet e kërkuar: *"Rrul vibrues gomë – hekur mbi 15 ton"* (deklaruar në pronësi), *"Rrul vibrues për ngjeshje asfalti deri 8 ton"* (deklaruar me qira), dhe *"Rrul vibrues gomë - hekur deri 7 ton"* (deklaruar me qira), nuk është përcaktuar lloji *(gomë/ cilindër)* dhe pesha për secilin rul siç kërkohet në kriterin e DST-së. VII. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.10/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit: ➢ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për vërtetimin e disponimit të "Njësisë/ Fabrikë prodhimi Asfaltobetoni". VIII. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.11/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit: ➢ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, operatori ekonomik nuk ka paraqitur deklaratën në lidhje me dakortësinë mbi mënyrën e financimit të objekt investimit. IX. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.12/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit: ➢ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, operatori ekonomik nuk ka paraqitur grafikun e punimeve objekt investimi.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës **Nr.Prot.544**, më **datë 22.02.2023**, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga **3** *(tre)* operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar **2** *(dy)* OE, është kualifikuar **1** *(një)* OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më **datë 22.02.2023** ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë **"N."** Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K....I** për të cilën është lidhur kontrata **datë 01.03.2023** për vlerën **27,439,912.5** lekë pa TVSH dhe vlera

32,927,895 lekë me TVSH, dhe me afat **6** *(gjashtë)* **muaj** nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Në lidhje me vlerësimin e ofertave, nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e subjektit sitemin SPE, dhe dokumentacionit të OE fitues, rezultoi se:
1- Skualifikimin i OE nga KVO-ja **është bërë në përputhje me dispozitat e LPP**, pasi OE pjesëmarrës nuk plotësonin kërkesat kualifikuse të DT, të evidentuara nga KVO;
I **2-** Referuar formularit të vetëdeklarimit të paraqitur nga OE "**N.**" Shpk rezultojnë se është deklaruar mjete Eskavator me zinxhira komatsu PC me numër shasie 22E5210041 dhe faturës tatimore të shitjes nr. serie 71372051,Minieskavator 4-5 ton Komatsu PC MR-2 nr shasie 5536 Minifadrom me nr. shasie 0L00608178, Rrul vibrues për ngjeshje asfalti deri në 8 ton AMMANN për të cilin është deklaruar fatur doganore, Rrul vibrues-gomë-hekur deri 7 ton PROTEC BOXHER 107 S të cilat janë në pronësi të OE "**N.**" Shpk nuk ka deklaruar faturat doganore per secilin prej tyre si dhe nuk janë të regjistruar në regjistrat publikë dhe nuk disponon çertifikatën e pronësisë. Gjithashtu është deklaruar disponibiliteti i mjeteve Grejder me nr shasie 2277 dhe mjeti asfaltoshtruese me nr shasie 665385 sipas kontratës noteriale sipas kontratës noteriale nr. 7148 rep., nr. 3638 kol të nënshkruar përpara noteres A. B. të cilat nuk janë të regjistruar në regjistrat publikë dhe nuk disponon çertifikatën e pronësisë dhe siguracionin e mjetit, por vetëm deklaratën/vërtetimin e zhdoganimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, "Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 58 "Makinat teknologjike" dhe neni 113 "Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike".
Për sa trajtuar më sipër OE "**N.**" Shpk nuk plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimet dhe kriteret e veçanta të vendosura në DT. Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave" pika 2.
Për sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO, me përbërje si vijon: ***1.*** *E. H. (Person përgjegjës),* ***2.*** *R. K.,* ***3.*** *E. R. (Anëtar).*
Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: 1. E. A. (Jurist/ Person përgjegjës), 2. M. C. (Inxh. Ndërtimi/ Specialist i fushës), 3. D. R. (Ekonomist/ Anëtar).

9. Të dhëna mbi objektin e prokurimit: ***"Asfaltim i rrugëve lidhëse në fshatrat e Njësive Administrative Burrel, Baz, Lis, Komsi, Rukaj"****.*

<table>
<tr><td colspan="4">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Asfaltim i rrugëve lidhëse në fshatrat e Njësive Administrative Burrel, Baz, Lis, Komsi, Rukaj".</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
"E Hapur - Punë"
Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj
REF-30569-11-21-2024</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit
Urdhri nr. 920, datë 20.11.2024
1. E. A.
2. M. C.
3. D. T.</td><td>2 Njësia e Prokurimit
1. E. A.
2. M. C.
3. D. T.</td><td>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr. 921, datë 20.11.2024.
1. E. R.
2. R. K.
3. F. S.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa tvsh)
360,432,605 lekë pa TVSH</td><td colspan="2">5. Oferta fituese, vlera fituese:
Operatori Fitues: B.O.E. "Z." Sh.p.k., dhe "S." Sh.p.k.
330,000,505 lekë pa TVSH.</td><td>6. Diferenca me fondin limit
30,432,100 lekë pa TVSH</td></tr>
<tr><td>7/1 Data e hapjes së tenderit:
Data 10.12.2024</td><td colspan="2" rowspan="2">8. Burimi Financimit
Buxheti i shtetit: 195,688,866 lekë pa TVSH
Të ardhurat: 164,743,739 lekë pa TVSH</td><td rowspan="2">9. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender: 2 BOE
b) S'kualifikuar: 1 BOE,
c) Kualifikuar: 1 BOE</td></tr>
<tr><td>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj</td></tr>
<tr><td>10.Ankimime
AK - s'ka
APP–s'ka/ka;</td><td colspan="2">11. Data e lidhjes të Marrëveshjes Kuadër:
Nr. 4783/11 prot., datë 09.01.2025
12. Data e lidhjes të kontratës:</td><td>13.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK</td></tr>
</table>

- **AK në lidhje me "Përllogaritjen e Fondit Limit":**

Nga auditimi i dosjes së procedurës, konstatohet se *Projekt – Preventivat, Relacionet, Raportet, Grafikun e punimeve* dhe *Specifikimet Teknike* përkatëse për punimet objekt prokurimi *"Asfaltim i rrugëve lidhëse në fshatrat e Njësive Administrative Burrel, Baz, Lis, Komsi, Rukaj"* është hartuar nga Projektues, Inxhinier ndërtimi A. I. me Lic.K. 2763/1, për vlerën 360,432,605 lekë. Nga verifikimi i disa prej zërave, u konstatua se nuk ka diferenca dhe se çmimet e aplikuara janë në zbatim të manualit të çmimeve.

AK në lidhje me "Hartimin e Specifikimeve Teknike"

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, është ngritur një komision paraprak me urdhrin nr. 920, datë 20.11.2024 "Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit", i përbërë nga z. E. A. *(Jurist/ Person përgjegjës)*, znj. M. C. *(Inxh. Ndërtimi/ Specialist i fushës)*, znj. D. T. *(Ekonomist/ Anëtar)*, të cilët janë evidentuar në procesverbalin e datës 21.11.2024.

Nga auditimi i procesverbalit nr. ska të datës 21.11.2024 konstatohet se:

Në pikën 2.3.2 të DST*, ndër të tjera janë kërkuar kategori licence* Kategoria *NS-18 Punime topogjeodezike* – Klasifikimi A

Sipas grupit të auditimit *dhe në konsultim me inxhinierin e grupit, këto kategori licence nuk përputhen me tipologjinë e procedurës, kjo për faktin se referuar zërave të preventivit nuk ka asnjë zë që argumentin këto linesa, ku kategoria N.S – 18/A- Punime topogjeodezike konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.*

Në pikën 2.3.4 të DST, *është kërkuar nga OE ofertues disponimin si vijon: -*"*të paraqesë licencën – **Kodi III.2.B - "Për grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme",** të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), të vlefshme*".

Kjo kërkesë është ezauruar gjatë fazës së hartimit të projekt/preventivit, relacioneve teknike respektive dhe raporti i vlerësimit në mjedis**.** Nga sa më sipër rezulton se për aq kohë sa subjekti zbatues i punimeve nuk do të ketë lidhje me grumbullimin dhe transportin e mbetjeve nga ujërat e ndotura, kjo pasi siç theksohet edhe në cilësimet e bëra nga ana e Projektuesit, kriteri i propozuar paraprakisht nga NJP dhe i miratuar nga ana e Titullarit të AK është i paargumentuar, përtej domosdoshmërive dhe jashtë nevojave duke u bërë kështu shkak për krijimin e kushteve të mungesës së një konkurrence të lirë e të ndershme, në mospërputhje me pikën (a) e nenit 1 të Ligjit nr. 10440, datë 7.7.2021 "*Për vlerësimin në mjedis*", me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit. Gjithashtu e drejta për të marrë kategorinë e licencës III.2/B jepet për shoqëri që kryejnë aktivitet që kanë ndikim në mjedis, si për shoqërinë që kanë impiante betoni, asfalti apo aktivitete të tjerë që ndikojnë në mjedis. Referuar procedurës së prokurimit rezulton se nuk është aktivitet që plotësoni këto kushte. Nga NJP është përcaktuar baza ligjore ku është mbështetur një kriter i tillë.

Në pikën 2.3.5 të DST, është kërkuar nga Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **65** *(jashtëdhjetë e pesë)* **punonjës** për periudhën **3** *(tre)* muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik.

Sipas grupit të auditimit: Për të përcaktuar stafin teknik dhe stafin mbështetës të nevojshme për realizimin e kontratës, duhet analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 216, date 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim" bazuar ne përllogaritjen e orëve të punës , kategoritë e punimeve të përcaktuara në preventive, specifikimet teknike të objektit, detajeve të projektit dhe tipologjia e zërave të punimeve , të cilat lidhen ngushtësisht me listën e stafit teknik

të kërkuar nga AK , si edhe bazuar në domosdoshmërinë e realizimit sa me shpejt të objektit konkretisht:
[8]

Nr.	AN.	ZËRAT E PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ORË PUNE / NJËSI	ORË PUNE TOTAL	DITË PUNE

Në pikën 2.3.6/b të DST, *është kërkuar nga OE t*ë kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, Minimuni **1** *(një)* **Inxhinier Gjeolog,** Minimuni **1** *(një)* Gjeodet/ Topograf/ Markshajder; **si dhe** Minimuni **1** *(një)* Inxhinier Ndërtimi *(Profili Gjeoteknik). Kërkesa për* Minimuni **1** *(një)* **Inxhinier Gjeolog si dhe** Minimuni **1** *(një)* Inxhinier Ndërtimi *(Profili Gjeoteknik janë kërkesa që nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht pasi referuar preventivit nuk rezultojnë punime* pilotime; mure masive mbajtëse; stabilizime shpatesh; tunele; vepra të rëndësishme gjeoteknike.
Në pikën 2.3.7/e të DST, është kërkuar nga Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar **1** *(një)* **mjek** të përgjithshëm si dhe 1 *(një)* inxhinier që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizmit të punimeve nuk argumentohet teknikisht sepse është i nevojshëm pasi në pikën 2.3.3 është kërkuar certifikata
g. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar 1 *(një)* punonjës që përmbush kriteret për të qenë ***"Përgjegjës për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë".***
h. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar 1 *(një)* specialist ekspert zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, i cili duhet të figurojë në listëpagesa të shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.7.
i. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar 1 *(një)* punonjës të trajnuar dhe të certifikuar për *"Përgjegjës për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë sipas ISO 9001:2015"*, i cili duhet të figurojë në listëpagesa të shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.7.
Duke qenë se nga ana e Autoritetit Kontraktor është parashikuar edhe kërkesa që subjekti duhet të jetë i pajisur me çertifikatën OHSAS 18001- 2007/2013 ose ISO 45001-2018 *(Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë)* ose ekuivalente (e vlefshme), konsiderohen të tepërta këto kërkesa pasi çertifikata në vetvete është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar dhe që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë. Shoqëritë që pajisen më këtë çertifikatë duhet të plotësojnë kriteret përkatëse të cilat janë konsideruar të nevojshme nga institucionet çertifikuese ndaj dhe kjo çertifikatë i jep garanci AK lidhur me aftësinë dhe kapacitetet që disponon operatori ekonomik për menaxhimin e shëndetit e sigurisë në punë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.
Sa më sipër veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", **neni 78, pika 2** "hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" ku citohet se: "Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese ... bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.
- **Në çdo rast**, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.". Konstatohet se nuk ka asnjë argumentim në lidhje me kriterin kryesor të procedurës së prokurimit, i cili është "Kriteri për shpalljen e ofertës fituese". Janë konstatuar shkelje të **nenit 87 pika 2 dhe 4**, të Ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", sipas të cilit: " 4- Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese".
Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: ***1. E. A.*** *(Jurist/ Person përgjegjës),* ***2. M. C.*** *(Inxh. Ndërtimi/ Specialist i fushës),* ***3. D. T.*** *(Ekonomist/ Anëtar).*

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë **2** *(dy)* B.O.E., për të cilët, referuar procesverbalit **Nr.Prot.4783/6**, të **datës 20.12.2024**, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	**B.O.E. "Z."** Sh.p.k., dhe **"S."** Sh.p.k.	**330,000,505**	Kualifikuar
2	**B.O.E. "B."** Sh.p.k., **"A."** Sh.p.k., dhe **"A."** Sh.p.k.	**224,996,835**	**S'kualifikuar;** - Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.2.2**/ 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se, anëtari i B.O.E., shoqëria "A." *Degë e shoqërisë së huaj*, nuk ka paraqitur të plotë Raportin e Auditit për bilancin e vitin 2021, në të cilin mungon nënshkrimi i audituesit *(Ekspertit Kontabël të Autorizuar)*. - Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.5**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk disponon një kontratë noteriale shërbimi të lidhur me një laborator të akreditуar e cila të jetë e vlefshme vetëm për objektin e kësaj kontrate, pasi kontrata e shërbimit e datës 07.03.2023 nënshkruar me laboratorin e akreditуar/ shoqërinë "N." Sh.p.k., nuk është lidhur për testimin e materialeve të kësaj kontrate objekt prokurimi, ndërsa kontrata e titulluar "Akt- Marrëveshje/ Kontratë Bashkëpunimi *(Për bashkimin e operatorëve ekonomikë)*" paraqitur si e lidhur më datë 06.12.2024 ndërmjet B.O.E., dhe laboratorit të akreditуar/ shoqërisë **"E.& C."** Sh.p.k., është e panënshkruar dhe vulosur nga noterja. - Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.7**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, *sipas Shtojcës 8*, të paraqitur nga anëtari i B.O.E. shoqëria "A." *Degë e shoqërisë së huaj*, konstatohet se, në seksionin B: DEKLARATË *"Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate"/ Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit* të, nuk ka deklaruar numrin e punonjësve për muajin Tetor 2024, muaj i cili përfshihet në periudhën e kërkuar për përmbushjen e këtij kriteri *(3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave)*. - Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.8 gërma "a** dhe **b"**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, *sipas Shtojcës 8*/ seksioni B: DEKLARATË *"Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate"/ Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/ Kualifikimit*) i Anëtarit të B.O.E., shoqëria "A." *Degë e shoqërisë së huaj*, nuk disponon stafin e

			drejtuesve teknik të kërkuar në **gërmën "a"** dhe stafin ndihmës të kërkuar në pikën **"b"**, në përputhje me përqindjen *(elementët konkretë)* të pjesëmarrjes në bashkim. - Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.9/** 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, *sipas Shtojcës 8*/ seksioni B: DEKLARATË *"Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate"*/ *Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/ Kualifikimit*) i Anëtarit të B.O.E., shoqëria "A." *Degë e shoqërisë së huaj*, nuk ka deklaruar se disponon shoferë të mjeteve të rënda, dhe manovratorë/ eskavatoristë/ automakinist/ Buldozier, në përputhje me përqindjen *(elementët konkretë)* të pjesëmarrjes në bashkim. - Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.10 gërma "b"**, si dhe **pika 6/** 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, *sipas Shtojcës 8*/ seksioni B: DEKLARATË *"Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate"*/ *Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/ Kualifikimit*) i Anëtarit të B.O.E., shoqëria "A." Sh.p.k., nuk ka deklaruar se disponon mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, në përputhje me përqindjen *(elementët konkretë)* të pjesëmarrjes në bashkim, si dhe të 3 *(tre)* anëtarët e B.O.E., nuk kanë deklaruar se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera, por kanë deklaruar se, citojmë *"...nuk do të jenë të angazhuara..."*.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës **Nr.Prot.4783/10**, më **datë 07.01.2025**, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga **2** *(dy)* Bashkim Operatorësh Ekonomik pjesëmarrës është s'kualifikuar **1** *(një)* B.O.E., është kualifikuar **1** *(një)* B.O.E. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më **datë 07.01.2025** ka shpallur fituese ofertën e **B.O.E. "Z."** Sh.p.k., dhe **"S."** Sh.p.k., për të cilën është lidhur Marrëveshja Kuadër **Nr.Prot. 4783/11**, **datë 09.01.2025**, me afat: **24** *(njëzet e katër)* **muaj**, dhe kontrata **Nr.Prot. 4783/15**, **datë 16.01.2025** për vlerën **330,000,505** lekë pa TVSH dhe vlera **396,000,606** lekë me TVSH, dhe me afat **12** *(dymbëdhjetë)* **muaj** nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Në lidhje me vlerësimin e ofertave, nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e subjektit sitemin SPE, dhe dokumentacionit të OE fitues, rezultoi se:

1- Skualifikimin i OE nga KVO-ja **është bërë në përputhje me dispozitat e LPP**, pasi OE pjesëmarrës nuk plotësonin kërkesat kualifikuse të DT, të evidentuara nga KVO;

2. *Arrihet në përfundimin se ky operator i plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në DST dhe vendimi i KVO për shpalljen fitues të këtij operatori është i drejtë.*

10. Auditim i procedurës me objekt ***"Ndërtim ambjenti sportiv + Rikonstruksioni i shkollës së mesme të bashkuar "Abdyrrahman Përmeti" Lis, Bashkia Mat"***

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: ***"Ndërtim ambjenti sportiv + Rikonstruksioni i shkollës së mesme të bashkuar "Abdyrrahman Përmeti" Lis, Bashkia Mat"***			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit **"E Hapur - Punë"** **REF-53033-07-01-2025** Urdhri **nr. 244**, datë **23.06.2025**	**1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit** Urdhri **nr. 244**, datë **23.06.2025** 1. E. A. 2. M. C. 3. D. T.	**2 Njësia e Prokurimit** 1. E. A. 2. M. C. 3. D. T.	**3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhri **nr. 245**, datë **23.06.2025**. (i ndryshuar me Urdhri **nr. 300**, datë **23.07.2025** 1. E. R. 2. K. R. 3.F, M.
4. Fondi Limit (pa tvsh) **97,118,469** lekë pa TVSH	**5. Oferta fituese, vlera fituese:** Operatori Fitues: **B.O.E. "A."** Sh.p.k., dhe **"A."** Sh.p.k. **94,203,705.15** lekë pa TVSH.		**6. Diferenca me fondin limit** **2,914,763.85** lekë pa TVSH
7/1 Data e hapjes së tenderit: **Data 17.07.2025** **7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 9 muaj**	**8. Burimi Financimit** Buxheti i shtetit: **84,203,570** lekë pa TVSH Nga gandi i bashkisë: **12,914,899** lekë pa TVSH		**9. Operatoret Ekonomike** a) Pjesëmarrës në tender: **2 B/OE** b) S'kualifikuar: **1 OE,** c) Kualifikuar: **1 BOE**
10.Ankimime **AK - s'ka** **APP**–s'ka/ka**;** **KPP - s'ka**	**11. Data e lidhjes të kontratës:** **Nr.2049/14 prot., datë 28.08.2025**		**12.**P**ërgjigje** Ankesës nga APP, AK apo **KKP: AK**

- **AK në lidhje me "Përllogaritjen e Fondit Limit":**

Nga auditimi i dosjes së procedurës, konstatohet se *Projekt – Preventivat, Relacionet, Raportet, Grafikun e punimeve* dhe *Specifikimet Teknike* përkatëse për punimet objekt prokurimi *"Ndërtim ambjenti sportiv + Rikonstruksioni i shkollës së mesme të bashkuar "Abdyrrahman Përmeti" Lis, Bashkia Mat"* është hartuar nga studio projektimi "**N.**" për vlerën **97,118,469** lekë. Nga verifikimi i disa prej zërave, u konstatua se nuk ka diferenca dhe se çmimet e aplikuara janë në zbatim të manualit të çmimeve.

AK në lidhje me "Hartimin e Specifikimeve Teknike"

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, është ngritur një komision paraprak me urdhrin nr. **244**, datë **23.06.2025** "Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit", i përbërë nga z. E. A. *(Jurist/ Person përgjegjës)*, znj. M. C. *(Inxh. Ndërtimi/ Specialist i fushës)*, znj. D. T. *(Ekonomist/ Anëtar)*, të cilët janë evidentuar në procesverbalin e datës 17.07.2025.

Nga auditimi i procesverbalit nr. ska të datës 17.07.2025 konstatohet se:

Në pikën 2.3.2 të DST*, ndër të tjera janë kërkuar kategori licence* Kategoria *NS-18 Punime topogjeodezike* – Klasifikimi A

Sipas grupit të auditimit *dhe në konsultim me inxhinierin e grupit, këto kategori licence nuk përputhen me tipologjinë e procedurës, kjo për faktin se referuar zërave të preventivit nuk ka asnjë zë që argumentin këto linesa, ku kategoria N.S – 18/A- Punime topogjeodezike konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.*

Në pikën 2.3.4 të DST, *është kërkuar nga OE ofertues disponimin si vijon: -*"*të paraqesë licencën – **Kodi III.2.B - "Për grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme",** të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), të vlefshme*".

Kjo kërkesë është ezauruar gjatë fazës së hartimit të projekt/preventivit, relacioneve teknike respektive dhe raporti i vlerësimit në mjedis**.** Nga sa më sipër rezulton se për aq kohë sa subjekti

zbatues i punimeve nuk do të ketë lidhje me grumbullimin dhe transportin e mbetjeve nga ujërat e ndotura, kjo pasi siç theksohet edhe në cilësimet e bëra nga ana e Projektuesit, kriteri i propozuar paraprakisht nga NJP dhe i miratuar nga ana e Titullarit të AK është i paargumentuar, përtej domosdoshmërive dhe jashtë nevojave duke u bërë kështu shkak për krijimin e kushteve të mungesës së një konkurrence të lirë e të ndershme, në mospërputhje me pikën (a) e nenit 1 të Ligjit nr. 10440, datë 7.7.2021 "*Për vlerësimin në mjedis*", me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit. Gjithashtu e drejta për të marrë kategorinë e licencës III.2/B jepet për shoqëri që kryejnë aktivitet që kanë ndikim në mjedis, si për shoqërinë që kanë impiante betoni, asfalti apo aktivitete të tjerë që ndikojnë në mjedis. Referuar procedurës së prokurimit rezulton se nuk është aktivitet që plotësoni këto kushte. Nga NJP është përcaktuar baza ligjore ku është mbështetur një kriter i tillë.

Në pikën 2.3.5 të DST, është kërkuar nga Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **85** *(tetëdhjetë e pesë)* **punonjës** për periudhën **3** *(tre)* muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik.
Sipas grupit të auditimit: Për të përcaktuar stafin teknik dhe stafin mbështetës të nevojshme për realizimin e kontratës, duhet analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 216, date 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim" bazuar ne përllogaritjen e orëve të punës , kategoritë e punimeve të përcaktuara në preventive, specifikimet teknike të objektit, detajeve të projektit dhe tipologjia e zërave të punimeve , të cilat lidhen ngushtësisht me listën e stafit teknik të kërkuar nga AK , si edhe bazuar në domosdoshmërinë e realizimit sa me shpejt të objektit konkretisht:
[9]

Nr.	AN.	ZËRAT E PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ORË PUNE / NJËSI	ORË PUNE TOTAL	DITË PUNE

Në pikën 2.3.6 të DST, *është kërkuar nga OE t*ë kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, Minimuni **1** *(një)* **Arkitekt.** *Kërkesa për ing. Arkitekt në procedura me objekt rikonstruksion që nuk lidhet me tipologjinë e procedurës dhe se ky kriter është ezuruar gjatë fazës së hartimit të projektit;*
Në pikën 2.3.7/e të DST, është kërkuar nga Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar **1** *(një)* **mjek** të përgjithshëm si dhe 1 *(një)* inxhinier që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizmit të punimeve nuk argumentohet teknikisht sepse është i nevojshëm pasi në pikën 2.3.3 është kërkuar certifikata ISO 45001 (Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë).
Në pikën 2.3.11 të DST ndër të tjerat është kërkuar që *Operatori ekonomik duhet të paraqesë* autoritetit kontraktor një mostër për mallrat/ materialet për Dritare d/alumini plastike me dopio xham dhe Dyer të brendeshme tamburate të rimesuara. Mosdorëzimi i mostrës për secilën pajisje të kërkuar ditën e hapjes së ofertave përbën kusht për s'kualifikim.
Sipas grupit të auditimit: Kërkesa për mostra nuk argumentohet qartë pse mostra është e domosdoshme. Mostrat shërbejnë kryesisht për verifikimin e karakteristikave teknike të produkteve të ofruara. Në rastet kur operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacion teknik, katalogë, fletë teknike, certifikata cilësie ose dokumente të tjera që provojnë përputhshmërinë e mallrave me specifikimet teknike të kërkuara, mungesa e mostrës nuk ndikon drejtpërdrejt në aftësinë e autoritetit kontraktor për të vlerësuar përputhshmërinë e ofertës.
Sa më sipër veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", **neni 78, pika 2** "hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" ku citohet se: "Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese ... bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

- **Në çdo rast**, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.". Konstatohet se nuk ka asnjë argumentim në lidhje me kriterin kryesor të procedurës së prokurimit, i cili është "Kriteri për shpalljen e ofertës fituese". Janë konstatuar shkelje të **nenit 87 pika 2 dhe 4**, të Ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", sipas të cilit: " 4- Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese".
Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: ***1. E. A.*** *(Jurist/ Person përgjegjës),* ***2. M. C.*** *(Inxh. Ndërtimi/ Specialist i fushës),* ***3. D. T.*** *(Ekonomist/ Anëtar).*

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.
Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë **2** *(dy)* O.E., për të cilët, referuar procesverbalit **Nr.Prot.2049/8**, të **datës 25.07.2025**, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	**B.O.E. "A."** Sh.p.k., dhe **"A."** Sh.p.k.	**94,203,705.15**	Kualifikuar
2	**OE. "L."** Sh.p.k.	**96,148,512.94**	**S'kualifikuar;** I. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 1 gërma "a"** dhe **"b"**/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk janë paraqitur: *Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8* dhe *Sigurimi i Ofertës, sipas Shtojcës 3.* II.Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.2.3**/ 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur *Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*, në të cilin ky kriter përmbushet nëpërmjet vetëdeklarimit të operatorit ekonomik pjesëmarrës në seksionin *"Pjesa II: Shkaqet e Përjashtimit "A: Deklarata për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit"*. III. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.4**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar, *licenca (Kodi III.2.B) - "Për grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme"*. IV. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.5**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar, si: *Autorizimet e prodhuesit/ distributorit, Katalogjet* dhe *Çertifikatat ISO 9001/ Vetëdeklarim të prodhuesit*, për listën e mallrave/ materialeve të kërkuar. V. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.6**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur *Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*, në të cilin ky kriter përmbushet nëpërmjet

			vetëdeklarimit të operatorit ekonomik pjesëmarrës në seksionin *"Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit "B: DEKLARATË "Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate"* VI. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.7 gërma "a, b, c, d, e, f, g, h"** / 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur *Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*, në të cilin ky kriter përmbushet nëpërmjet vetëdeklarimit të operatorit ekonomik pjesëmarrës në seksionin *"Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit "B: DEKLARATË "Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate"* VII. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.8**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur *Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*, në të cilin ky kriter përmbushet nëpërmjet vetëdeklarimit të operatorit ekonomik pjesëmarrës në seksionin *"Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit "B: DEKLARATË "Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate"* VIII. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.9/** 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur *Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*, në të cilin ky kriter përmbushet nëpërmjet vetëdeklarimit të operatorit ekonomik pjesëmarrës në seksionin *"Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit "C: DEKLARATË "Për disponimin e mjeteve/ pajisje/ makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate"*. IX. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.10**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar, *për vërtetimin e disponimit të 1 (një) kantieri për prodhimin e betonit, në pronësi ose me qera ose me kontratë furnizimi*. X. Nuk është përmbushur përcaktimi i **pikës 2.3.11**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur *mostrat për pajisjet/materialet e kërkuar* ditën e hapjes së ofertave pranë autoritetit kontraktor. XI. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.12**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur konstatohet se, nuk është paraqitur Analiza e çmimeve të preventivit, Plan – organizimi, Metodologjia e punimeve në objekt dhe Grafiku i punimeve.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës **Nr.Prot.2049/11**, më **datë 12.08.2025**, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga **2** *(dy)* Operatorë Ekonomik pjesëmarrës

është s'kualifikuar **1** *(një)* O.E., dhe është kualifikuar **1** *(një)* B.O.E. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më **datë 12.08.2025** ka shpallur fituese ofertën e **B.O.E. "A."** Sh.p.k., dhe **"A."** Sh.p.k., për të cilën është lidhur kontrata **Nr.Prot. 2049/14**, **datë 28.08.2025** për vlerën **94,203,705.15** lekë pa TVSH dhe vlera **112,564,446.18** lekë me TVSH, dhe me afat **9** *(nëntë)* **muaj** nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Konkluzion: *Arrihet në përfundimin se ky operator i plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në DST dhe vendimi i KVO për shpalljen fitues të këtij operatori është i drejtë.*

11. Auditim i procedurës me objekt ***"Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit Shqefën, Bashkia Mat"***

<table>
<tr><td colspan="4">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit Shqefën, Bashkia Mat".</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
"E Hapur - Punë"
REF-51334-06-16-2025
Urdhri nr. 230, datë 12.06.2025</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit
Urdhri nr. 230, datë 12.06.2025
1. E. A.
2. M. C.
3. D. T.</td><td>2 Njësia e Prokurimit
1. E. A.
2. M. C.
3. D. T.</td><td>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr.231, datë 12.06.2025.
1. E. R.
2. F. S.
3. K. R.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa tvsh)
75,416,389 lekë pa TVSH</td><td colspan="2">5. Oferta fituese, vlera fituese:
Operatori Fitues: B.O.E. "L." Sh.p.k., dhe "V." Sh.p.k.
73,116,754.28 lekë pa TVSH.</td><td>6. Diferenca me fondin limit
2,299,634.72 lekë pa TVSH</td></tr>
<tr><td>7/1 Data e hapjes së tenderit:
Data 02.07.2025</td><td colspan="2" rowspan="2">8. Burimi Financimit
Buxheti i shtetit: 75,416,389 lekë pa TVSH</td><td rowspan="2">9. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender: 4 BOE
b) S'kualifikuar: 3 B/OE,
c) Kualifikuar: 1 B/OE</td></tr>
<tr><td>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 8 muaj</td></tr>
<tr><td>10.Ankimime
AK - s'ka
APP - s'ka;
KPP - s'ka</td><td colspan="2">11. Data e lidhjes të kontratës:
Nr. 1918/112 prot., datë 14.08.2025</td><td>12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK</td></tr>
</table>

- **AK në lidhje me "Përllogaritjen e Fondit Limit":**

Nga auditimi i dosjes së procedurës, konstatohet se *Projekt – Preventivat, Relacionet, Raportet, Grafikun e punimeve* dhe *Specifikimet Teknike* përkatëse për punimet objekt prokurimi *"Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit Shqefën, Bashkia Mat"* është hartuar nga studio projektimi "E." për vlerën 75,416,389 lekë. Nga verifikimi i disa prej zërave, u konstatua se nuk ka diferenca dhe se çmimet e aplikuara janë në zbatim të manualit të çmimeve.

AK në lidhje me "Hartimin e Specifikimeve Teknike"

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, është ngritur një komision paraprak me urdhrin nr. **230**, datë **12.06.2025** "Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit", i përbërë nga z. E. A. *(Jurist/ Person përgjegjës)*, znj. M. C. *(Inxh. Ndërtimi/ Specialist i fushës)*, znj. D. T. *(Ekonomist/ Anëtar)*, të cilët janë evidentuar në procesverbalin e datës 16.06.2025.

Nga auditimi i procesverbalit nr. ska të datës 16.06.2025 konstatohet se:

Në pikën 2.3.2 të DST*, ndër të tjera janë kërkuar kategori licence* Kategoria *NS-18 Punime topogjeodezike* – Klasifikimi A

Sipas grupit të auditimit *dhe në konsultim me inxhinierin e grupit, këto kategori licence nuk përputhen me tipologjinë e procedurës, kjo për faktin se referuar zërave të preventivit nuk ka asnjë zë që argumentin këto linesa, ku kategoria N.S – 18/A- Punime topogjeodezike konsiderohet*

zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

Në pikën 2.3.4 të DST, *është kërkuar nga OE ofertues disponimin si vijon: -*"*të paraqesë licencën – **Kodi III.2.B - "Për grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme",** të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), të vlefshme*".
Kjo kërkesë është ezauruar gjatë fazës së hartimit të projekt/preventivit, relacioneve teknike respektive dhe raporti i vlerësimit në mjedis**.** Nga sa më sipër rezulton se për aq kohë sa subjekti zbatues i punimeve nuk do të ketë lidhje me grumbullimin dhe transportin e mbetjeve nga ujërat e ndotura, kjo pasi siç theksohet edhe në cilësimet e bëra nga ana e Projektuesit, kriteri i propozuar paraprakisht nga NJP dhe i miratuar nga ana e Titullarit të AK është i paargumentuar, përtej domosdoshmërive dhe jashtë nevojave duke u bërë kështu shkak për krijimin e kushteve të mungesës së një konkurrence të lirë e të ndershme, në mospërputhje me pikën (a) e nenit 1 të Ligjit nr. 10440, datë 7.7.2021 "*Për vlerësimin në mjedis*", me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit. Gjithashtu e drejta për të marrë kategorinë e licencës III.2/B jepet për shoqëri që kryejnë aktivitet që kanë ndikim në mjedis, si për shoqërinë që kanë impiante betoni, asfalti apo aktivitete të tjerë që ndikojnë në mjedis. Referuar procedurës së prokurimit rezulton se nuk është aktivitet që plotësoni këto kushte. Nga NJP është përcaktuar baza ligjore ku është mbështetur një kriter i tillë.

Në pikën 2.3.5 të DST, është kërkuar nga Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **50** *(pesëdhjetë)* **punonjës** për periudhën **3** *(tre)* muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik.
Sipas grupit të auditimit: Për të përcaktuar stafin teknik dhe stafin mbështetës të nevojshme për realizimin e kontratës, duhet analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 216, date 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim" bazuar ne përllogaritjen e orëve të punës , kategoritë e punimeve të përcaktuara në preventive, specifikimet teknike të objektit, detajeve të projektit dhe tipologjia e zërave të punimeve , të cilat lidhen ngushtësisht me listën e stafit teknik të kërkuar nga AK , si edhe bazuar në domosdoshmërinë e realizimit sa me shpejt të objektit konkretisht:
[10]

Nr.	AN.	ZËRAT E PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ORË PUNE / NJËSI	ORË PUNE TOTAL	DITË PUNE

Në pikën 2.3.6 të DST, është kërkuar nga OE të kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, Minimuni 1 (një) Inxhinier Gjeolog dhe Minimuni 1 (një) Inxhinier për kontrollin e Cilësisë. *Kërkesa për Minimuni 1 (një) Inxhinier Gjeolog dhe Minimuni 1 (një) Inxhinier për kontrollin e Cilësisë nuk janë argumentuar teknikisht dhe ligjërisht nga njesia e prokurimit.*
Në pikën 2.3.7/e të DST, është kërkuar nga Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar **1** *(një)* **mjek** të përgjithshëm si dhe 1 *(një)* inxhinier që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizmit të punimeve nuk argumentohet teknikisht sepse është i nevojshëm pasi në pikën 2.3.3 është kërkuar certifikata ISO 45001 (Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë).
Sa më sipër veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", **neni 78, pika 2** "hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" ku citohet se: "Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese ... bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

- **Në çdo rast**, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.". Konstatohet se nuk ka asnjë argumentim në lidhje me kriterin kryesor të procedurës së prokurimit, i cili është "Kriteri për shpalljen e ofertës fituese". Janë konstatuar shkelje të **nenit 87 pika 2 dhe 4**, të Ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", sipas të cilit: " 4- Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese".
Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: ***1. E. A.*** *(Jurist/ Person përgjegjës),* ***2. M. C.*** *(Inxh. Ndërtimi/ Specialist i fushës),* ***3. D. T.*** *(Ekonomist/ Anëtar).*

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.
Në procedurën e prokurimit ka marrë pjesë 4 *(katër)* O.E., për të cilët, referuar procesverbalit **Nr.Prot.1918/5**, të **datës 02.07.2025**, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomik	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	**OE: "H."** Sh.p.k.	**61,688,531.37**	S'kualifikuar: Nuk është përmbushur kriteri i pikës 2.3.5/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar, si: *Autorizimi i prodhuesit/ distributorit, Katalogu* dhe *Çertifikatë/ Vetëdeklarim të prodhuesit që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit/ ve është sipas standartit ISO 9001-2015*, për mallin/ materialin e kërkuar: *Saracineskë gize me fllanxha (Sipas specifikime teknike në projekt),* si dhe Çertifikata ISO 9001: 2015 e prodhuesit të tubave të çelikut ("A. Sh.p.k.) është e papërkthyer në gjuhën shqip. Nuk është përmbushur kriteri i pikës 2.3.8 gërma "b"/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi Tabela e paraqitur për punonjësit specialist nuk është plotësuar me të gjithë të dhënat e kërkuara *(mungojnë të dhënat e numrit indetifikues i çertifikatës/ diplomës),* si dhe bazuar vetëdeklarimit të kryer në seksionin B: DEKLARATË *"Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate"*/ *Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/ Kualifikimit* të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, *sipas Shtojcës 8*, rezulton se: - Nuk disponon të paktën 2 *(dy)* punonjës të specializuar/ kualifikuar si Teknik Ndërtimi, por vetëm 1 *(një)* të tillë; - Nuk disponon të paktën 2 *(dy)* punonjës të specializuar/ kualifikuar si Elektromekanik, por vetëm 1 *(një)* të tillë; Nuk është përmbushur kriteri i pikës 2.3.10 gërma "a" dhe pika 6/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar vetëdeklarimit të kryer në seksionin C: DEKLARATË *"Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate"*/ *Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit*, të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, *sipas Shtojcës 8*, rezulton se mjetet/ makineritë/ pajisjet e siguruara me

			qira, nuk janë marrë me qira nëpërmjet kontratave noteriale të lidhura vetëm për këtë objekt prokurimi, si dhe referuar Deklaratës së paraqitur nga administratori i shoqërisë konstatohet se, nuk ka deklaruar se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera, por ka deklaruar se ...*nuk do të jenë të angazhuara në kontrata të tjera.*
2	**OE: "K."** Sh.p.k.	**63,569,436.16**	**S'kualifikuar:** I.Nuk është përmbushur kriteri i pikës 2.1.a/ 2.1 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. I.Nuk është përmbushur kriteri i pikës 2.3.2/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se nuk është paraqitur liçensa profesionale për zbatim punimesh në ndërtim. I.Nuk është përmbushur kriteri i pikës 2.3.6/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk disponon një kontratë noteriale shërbimi të lidhur me një laborator të akredituar e cila të jetë e vlefshme vetëm për objektin e kësaj kontrate. Y.Nuk është përmbushur kriteri i pikës 2.3.7/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se nuk është paraqitur Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, *sipas Shtojcës 8*, ku të deklarojë se disponon numrin e punonjësve për periudhën e kërkuar. Y.Nuk është përmbushur kriteri i pikës 2.3.8 gërmat "a, b, c, d, e, f, g"/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk është paraqitur Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, *sipas Shtojcës 8*, ku të deklarojë se disponon stafin e kërkuar. I.Nuk është përmbushur kriteri i pikës 2.3.9/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk është paraqitur Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, *sipas Shtojcës 8*, ku të deklarojë se disponon stafin e kërkuar. II.Nuk është përmbushur kriteri i pikës 2.3.10/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk është paraqitur Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, *sipas Shtojcës 8*, ku të deklarojë se disponon makineritë/pajisjet e kërkuara.
3	**OE: "E."** Sh.p.k.	**72,770,946,47**	**S'kualifikuar:** I. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.1.b**/ 2.1 Sigurimi i Ofertës, sipas Shtojcës 3/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se, nuk është paraqitur Sigurimi i Ofertës sipas Shtojcës 3. II. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.5**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, për përmbushjen e këtij kriteri nga ana e Op. Ek. Pjesmarrës nuk është paraqitur dokumentacion. III. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.6**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk disponon një kontratë noteriale shërbimi të lidhur me një laborator

			të akreditуar e cila të jetë e vlefshme vetëm për objektin e kësaj kontrate. IV. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.8 gërma "a** dhe **b"/** 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, *sipas Shtojcës 8*/ seksioni B: DEKLARATË *"Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate"*/ *Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/ Kualifikimit*) shoqëria "E.", nuk disponon të gjithë stafin e drejtuesve teknik të kërkuar në **gërmën "a"**, minimuni 1 (një) Inxhinier për kontrollin e Cilësisë si dhe stafin ndihmës të kërkuar në pikën **"b"**. v. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.8 gërma "f"/** 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, *sipas Shtojcës 8*/ seksioni B: DEKLARATË *"Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate"*/ *Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/ Kualifikimit*) shoqëria "E." nuk ka deklaruar se disponon pjesë të stafit si të punësuar 1 *(një)* specialist ekspert zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin. VI.Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.10 pika 6/** 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, *sipas Shtojcës 8*/ seksioni B: DEKLARATË *"Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate"*/ *Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/ Kualifikimit*) shoqëria "E." Sh.p.k., nuk ka deklaruar vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik si dhe te pranoje verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor dhe nuk kanë deklaruar se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera. VII. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.11/** 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk disponon 1 *(një)* kantier për prodhimin e betonit dhe 1 *(një)* kantier për prodhimin e inerteve në pronësi ose me qera ose me kontratë furnizimi. VIII. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.12/** 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk janë paraqitur Plan – organizimi dhe metodologjia e punimeve në objekt, me një relacion shpjegues sipas kërkesave të përcaktuara nga KPT dhe KTZ në fuqi, si dhe Grafiku i punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.
4	**B.O.E: "L."** Sh.p.k., dhe **"V."** Sh.p.k.	**73,116,754.28**	Kualifikuar

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës **Nr.Prot.1918/9**, më **datë 30.07.2025**, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, kanë qenë pjesëmarrës **4** *(katër)* Operatorë Pjesëmarrës, janë s'kualifikuar **3** *(tre)* O.E., është kualifikuar **1** *(një)* B.O.E. Në përfundim, mbi

bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më **datë 30.07.2025** ka shpallur fituese ofertën e B.O.E. **"L."** Sh.p.k., dhe **"V."** Sh.p.k., për të cilën është lidhur kontrata Nr.prot. **1918/10, datë 30.07.2025** për vlerën **73,116,754.28** lekë pa TVSH dhe vlera **87,740,105.14** lekë me TVSH, dhe me afat **9 *(nëntë)* muaj** nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Në lidhje me vlerësimin e ofertave, nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e subjektit sitemin SPE, dhe dokumentacionit të OE fitues, rezultoi se:
1- Skualifikimin i OE nga KVO-ja **është bërë në përputhje me dispozitat e LPP**, pasi OE pjesëmarrës nuk plotësonin kërkesat kualifikuse të DT, të evidentuara nga KVO;
2. *Arrihet në përfundimin se ky operator i plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në DST dhe vendimi i KVO për shpalljen fitues të këtij operatori është i drejtë.*

Auditimi i prcçedurave të prokurimit me vlerë të vogël për vitin 2023, 2024, 2025.

-Për vitin 2023, me shkresën me nr. 63, prot, datë 06.01.2023, titullari i AK z. A. M. ka caktuar personat përgjegjës për procedurat e prokurimit publikm, si vijon: Z. E. A.,me detyrë përgjegjës sektori pranë Sektorit Juridik dhe Prokurimev, znj. F. S. me detyrë specialiste praë Sektorit Juridik dhe Prokurimeve.
-Me shkresën me nr. 64 prot datë 06.01.2023, titullari i AK ka njoftuar Agjencinë e Prokurimit Publik për caktimin e personave përgjegjës për vitin ushtrimor 2023.
-Me shkresën me nr. 65 prot datë 06.01.2023, titullari i AK ka ngritur Komisionin për Prokurimin me Vlerë të Vogë me përbërje si vijon: E. A. Kryetar, D. R. anëtar, F. S. anëtar.
-Për vitin 2024, me shkresën me nr. 62, prot, datë 05.01.2024, titullari i AK z. A. M. ka caktuar personin përgjegjës për procedurat e prokurimit publik, Z. E. A.,me detyrë përgjegjës sektori pranë Sektorit Juridik dhe Prokurimev.
-Me shkresën me nr. 97 prot datë 08.01.2024, titullari i AK ka njoftuar Agjencinë e Prokurimit Publik për caktimin e personit përgjegjë për vitin ushtrimor 2024.
-Me shkresën me nr. 63 prot datë 05.01.2024, titullari i AK ka ngritur Komisionin për Prokurimin me Vlerë të Vogël me përbërje si vijon: E. A. Kryetar, D. T. anëtar, F. S. anëtar.
-Për vitin 2025, me shkresën me nr. 16, prot, datë 06.01.2025, titullari i AK z. A. M. ka caktuar personin përgjegjës për procedurat e prokurimit publik, Z. E. A.,me detyrë përgjegjës sektori pranë Sektorit Juridik dhe Prokurimeve.
-Me shkresën me nr. 39 prot datë 07.01.2025, titullari i AK ka njoftuar Agjencinë e Prokurimit Publik për caktimin e personit përgjegjës për vitin ushtrimor 2025.
-Me shkresën me nr. 17 prot datë 06.01.2025, titullari i AK ka ngritur Komisionin për Prokurimin me Vlerë të Vogël me përbërje si vijon: E. A. Kryetar, D. T. anëtar, F. S. anëtar.
-Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion (Regjistri i Realizimeve i Prokurimeve me Vlerë të Vogël për vitin 2023 vitin 2024, viti 2025), hartuar nga personi/personat përgjegjës për prokurimet, u konstatua se hartimi është bërë në përputhje më kërkesat e legjislacionit për prokurimin publik. 1) Për procedurën me objekt: "Blerje fotokopje printera", me fondin limit 424,660 lekë pa TVSH.
-Me shkresën me nr. 1699, prot, datë 29.05.2025, Titullari i AK, z.A. M. ka vendosur hapjen e procedurës me vlerë të vogël me objekt: "Blerje fotokopje printera"
Përllogaritja e fondit limit.
-Me shkresën me nr. 1471 prot, datë 14.05.2025, Drejtoria i Burimeve Njerëzore z. G. P. ka dërguar kërkesë titullarit të AK, me objekt përdorimin e fondeve të nevojshme për blerjen e bazës materiale objekt prokurimi.
-Me shkresën me nr. 1471/1 prot datë 14.05.2025, titullari i AK ka miratuar kërkesën e Drejtorit të Burimeve Njerëzore.
-Me shkresën me nr. 1491 prot datë 15.05.2025, titullari i AK, z. A. M. ka ngritur Komisionin e Përllogaritjes së Vlerës Limit të Kontratës dhe Përcaktimit të Specifikimeve Teknike, me përbërje: z. E, T. (Kryetar) me detyrë përgjegjës sektori i administrimit të sistemeve të IT dhe marrëdhënieve

me publikun, zjz. F, M. (Anëtare) me detyrë specialistë në Sektorin Juridik dhe Prokurimeve, znj. A. R. (Anëtar) me detyrë specialistë finance.
-Me procesverbalin pa nr prot, të datës 19.05.2025, Komisioni për Përllogaritjen e Fondit Limit ka përllogaritur fondin limit duke përdorur metodën e studimit të tregut. Për sa më sipër, komisioni i ngritur për përllogaritjen e fondit limit ka administruar ofertat ekonomike të tre subjektit, konkretisht subjektit "E. sh.p.k, R. T. dhe L. L.. Nga ofertat ekonomike të këtyre tre subjekteve, komisioni ka fiksuar fondin limit në vlerën 417,666.66 lekë pa TVSH.
-Nga verifikimi i procesverbaleve hartuar nga Komisioni i Prokurimit dhe Komisioni i Argumentimit të Specifikimeve Teknike, si dhe shkresa e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore drejtuar titullarit të AK u konstatua se nuk është argumentuar sasia e mallrave objekt prokurimi dhe nevoja e Drejtorisë së Shërbimeve për një sasi të tillë. Nga AK nuk dokumentohet teknikisht argumentimi i volumit të sasisë së nevojshme pasi dokumentacioni është i paplotë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 285 datë 19.05.2022, neni 74, pika 3, gërma
Për sa më sipër mban përgjegjësi, z. E. A., Kryetari i Njësisë së Prokurimit, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Prokurimeve.
Hartimi i kritereve
-Me shkresën me nr. 1491 prot datë 15.05.2025, titullari i AK, z. A. M. ka ngritur Komisionin e Përllogaritjes së Vlerës Limit të Kontratës dhe Përcaktimit të Specifikimeve Teknike, me përbërje: z. E, T. (Kryetar) me detyrë përgjegjës sektori i administrimit të sistemeve të IT dhe marrëdhënieve me publikun, z. F, M. (Anëtare) me detyrë specialistë në Sektorin Juridik dhe Prokurimeve, znj. A. R. (Anëtar) me detyrë specialistë finance.
-Me procesverbalin e me nr. 1699/2 prot datë 02.06.2026, Njësia e Miratimit ka miratuar kriteret për kualifikim për procedurën e prokurimit marrë nën shqyrtim.
-Në kërkesën 9 të Ftesës për Ofertë, ku kërkohet nga operatorët ekonomikë një deklaratë garancie që garanton mbulimin e garancisë së pajisjeve, u konstatua se ky kriter nuk është argumentuar nga pikëpamja juridike.
-Veprime në kundërshtim me nenin 78, pika 2 të VKM për Rregullat e Prokurimit Publik.
-Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e NJP: E. A. Kryetar, D. T. anëtar, F. S. anëtar.
Vlerësimi i ofertave.
-Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit rezulton se në këtë procedurë prokurimi për periudhën objekt auditimi, është caktuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Mat, znj. D. T. si anëtar i NJP/ KVO. Znj. T. është me pozicion pune Drejtor i Dejtorisë së Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues. Vendosja e Znj. T. me detyrë Drejtor Finance dhe nëpunës zbatues i Bashkia Mat, si anëtar i NJP/KVO, është jo në përputhje me kuadrin ligjor rregullator të nëpunësit zbatues. Veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", 12, pika 3, gërma 3), neni 22, pika 5.
Veprim për të cilin mban përgjegjësi titullari i AK z. M. Z. dhe z. D. T..
-Me procesverbalin me nr1699/4 prot datë 04.6.2025, NJP/KVO ka kryer vlerësimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë.
-Me procesverbalin e datës 09.06.2025, KVO ka konstatuar se operatori i renditur i pari, E. me ofertë ekonomike në vlerën 256,900 lekë ka ngarkuar në system njoftimin për tërheqje. Për sa më sipër KVO ka vijuar me operatorët e renditur më poshtë, përkatësisht OE K. dhe OE E., të cilët kanë paraqitur ofertë të njëjtë ekonomike në vlerën 269,000 lekë pa TVSH. Në zbatim të përcaktimeve të Udhëzimit për Procedurat me Vlerë të Vogë, KVO ka kryer procesin e shortit ndërmjet dy operatorëve, të cilët nuk kanë marrë pjesë në këtë proces. Në përfundim të realizimit të këtij procesi, u konstatua se OE K. është renditur i dyti, ndërsa OE E. është renditur i pari.
-Me procesverbalin e datës 11.06.2025, KVO ka konstatua se OE E. është tërhequr nga procedura. Në vijim të procedurës, KVO ka njoftuar OE K. sh.p.k me ofertë ekonomike në vlerën 285,500 lekë pa TVSH. K. ka njoftuar tërheqjen nga procedura dhe ka vijuar me operatorin e radhës.
-Me shkresën me nr. 1926 prot datë 12.06.2025, OE "K." sh.p.k ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar nga AK,

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga operatori ekonomik u konstatua se ky i fundit ka plotësuar të gjitha kërkesat e Ftesës për Ofertë.
Zbatimi i kontratës.
-Me shkresën me nr. 1699/6 prot datë 13.06.2025, titullari i AK ka urdhëruar ngritjen e Komisionit të Marrjes në Dorëzim për mallrat objekt prokurimi me përbërje si vijon: E, T. me detyrë përgjegjës i sektorit të IT, R. K. me detyrë specialist finance, S. M. me detyrë magaziniere.
-Me procesverbalin me nr. 1699/7 prot datë 18.06.2025, Komisioni ka marrë në dorëzim mallrat objekt prokurimi. Sasitë dhe produktet janë në përputhje me të dhënat e pasqyruara në faturën tatimore me nr. 1443/2025.
2) Për procedurën me objekt:"Shërbime publikimi dhe pasqyrimi i veprimtarive të Bashkisë Mat në media lokale", me fondin limit 333,333 lekë.
-Me shkresën me nr. 568, prot, datë 11.02.2025, Titullari i AK, z.A. M. ka vendosur hapjen e procedurës me vlerë të vogël me objekt: "Shërbime publikimi dhe pasqyrimi i veprimtarive të Bashkisë Mat në media lokale".
Përllogaritja e Fondit Limit
-Me shkresën me nr. 463 prot, datë 03.02.2025, Drejtoria i Burimeve Njerëzore z. G. P. ka dërguar kërkesë titullarit të AK, me objekt përdorimin e fondeve të nevojshme për blerjen e bazës materiale objekt prokurimi.
-Me shkresën me nr. 463/1 prot datë 03.02.2025, titullari i AK ka miratuar kërkesën e Drejtorit të Burmeve Njerëzore.
-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se nuk është argumentuar në asnjë prej formave të parashikuara në legjislacionin për prokurimin publik.
-Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me VKM nr. 285 datë 19.05.2021, neni 76.
-Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e NJP: E. A. Kryetar, D. T. anëtar, F. S. anëtar.
Hartimi i kritereve
-Me procesverbalin me nr. 586/2 prot datë 11.02.2025. Njësia e Prokurimit ka miratuar dhe argumentuar kriteret për kualifikim për procedurën e prokurimit marrë nën shqyrtim.
-Me procesverbalin e datës 22.09.2023, NJP ka argumentuar dhe miratuar specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim
-Nga verifikimi i këtyre kritereve konstatojmë se janë hartuar në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik dhe rregullat e prokurimit publik.
Vlerësimi i ofertave
-Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit rezulton se në këtë procedurë prokurimi për periudhën objekt auditimi, është caktuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Mat, znj. D. T. si anëtar i NJP/ KVO. Znj. T. është me pozicion pune Drejtor i Dejtorisë së Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues. Vendosja e Znj. T. me detyrë Drejtor Finance dhe nëpunës zbatues i Bashkia Mat, si anëtar i NJP/KVO, është jo në përputhje me kuadrin ligjor rregullator të nëpunësit zbatues. Veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", 12, pika 3, gërma 3), neni 22, pika 5
Për sa më sipër mbanjne përgjegjësi znj D. T. me detyrë Drejtoreshë e Financë dhe ish Kryetari i Bashkisë Mat z. A. M.

-Me procesverbalin me nr 568/4 prot datë 12.02.2025, NJP/KVO ka kryer vlerësimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë, si vijon: H. me nipt L....D me ofertë ekonomike në vlerën 312,000 lekë pa TVSH, M.sh.p.k me nipt L....F me ofertë ekonomike në vlerën 308,000 lekë pa TVSH dhe OE V. sh.p.k me nipt K.....Q me ofertë ekonomike në vlerën 315,000 lekë pa TVSH.
-NJP/KVO ka skualifikuar operatorët H. dhe M.sh.p.k me arsyetimin se objekti i veprimtarisë së tyre nuk lidhet me objektin e procedurës së prokurimit.
-Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në QKB nga këta dy subjekte, u konstatua se vendimi i KVO ka qenë i saktë.
-Për sa më sipër KVO ka vendosur të kualifikojë dhe të shpallë fitues OE V... sh.p.k me ofertë ekonomike në vlerën 315,000 lekë pa TVSH

-Me shkresën me nr. 1926 prot datë 12.06.2025, OE "V." sh.p.k ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar nga AK,
-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga operatori ekonomik u konstatua se ky i fundit ka plotësuar të gjitha kërkesat e Ftesës për Ofertë.
Zbatimi i kontratës
-Me shkresën me nr. 586/6 prot datë 21.02.2025 është nënshkruar Kontrata e Shërbimit mes Bashkisë Mat, përfaqësuar nga z. A. M. dhe shoqërisë V. sh.p.k, përfaqësuar nga z. L. V..
-Shërbimi i kërkuar është në përputhje me përcaktimet e faturës tatimore me nr. 16/2025.
3) Për procedurën e prokurimit me objekt: "Blerje kompjutera dhe printera " me fond limit në vlerën 1,000,000 lekë pa TVSH.
-Me shkresën me nr. 3248, prot, datë 04.09.2024, Titullari i AK, z.A. M. ka vendosur hapjen e procedurës me vlerë të vogël me objekt: Blerje kompjutera dhe printera s".
Përllogaritja e Fondit Limit
-Me shkresën me nr. 2083 prot, datë 24.05.2025, Drejtoria i Burimeve Njerëzore z. G. P. ka dërguar kërkesë titullarit të AK, me objekt përdorimin e fondeve të nevojshme për blerjen e bazës materiale objekt prokurimi.
-Me shkresën me nr. 2083/1 prot datë 24.05.2025, titullari i AK ka miratuar kërkesën e Drejtorit të Burimeve Njerëzore.
-Me shkresën me nr. 463 prot, datë 03.02.2025, Drejtoria i Burimeve Njerëzore z. G. P. ka dërguar kërkesë titullarit të AK, me objekt përdorimin e fondeve të nevojshme për blerjen e bazës materiale objekt prokurimi.
-Me shkresën me nr. 463/1 prot datë 03.02.2025, titullari i AK ka miratuar kërkesën e Drejtorit të Burimeve Njerëzore.
-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se për zërat e preventivit janë përdorur çmimet e administuara për një procedurë të ngjashme prokurimi të anuluar. [ër sa më sipër NJP ka fiksuar fondin limit në vlerën 1,000,000 lekë pa TVSH.
-Nga verifikimi i procesverbaleve hartuar nga Komisioni i Prokurimit si dhe shkresa e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore drejtuar titullarit të AK u konstatua se nuk është argumentuar saisa mallrave objekt prokurimi. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 285 datë 19.05.2021, neni 74, pika 3, gërma a
Për sa më sipër mban përgjegjësi, z. E. A., Kryetari i Njësisë së Prokurimit, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Prokurimeve.
Hartimi i kritereve
-Me procesverbalin me nr. 3284/2 prot datë 04.02.2025. Njësia e Prokurimit ka miratuar dhe argumentuar kriteret për kualifikim për procedurën e prokurimit marrë nën shqyrtim.
-Me procesverbalin e datës 22.09.2023, NJP ka argumentuar dhe miratuar specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim
-Nga verifikimi i këtyre kritereve konstatojmë se janë hartuar në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik dhe rregullat e prokurimit publik.
Vlerësimi i ofertave.
-Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit rezulton se në këtë procedurë prokurimi për periudhën objekt auditimi, është caktuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Mat, znj. D. T. si anëtar i NJP/ KVO. Znj. T. është me pozicion pune Drejtor i Dejtorisë së Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues. Vendosja e Znj. T. me detyrë Drejtor Finance dhe nëpunës zbatues i Bashkia Mat, si anëtar i NJP/KVO, është jo në përputhje me kuadrin ligjor rregullator të nëpunësit zbatues. Veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", 12, pika 3, gërma 3), neni 22, pika 5
Për sa më sipër mbanjne përgjegjësi znj D. T. me detyrë Drejtoreshë e Financë dhe ish Kryetari i Bashkisë Mat z. A. M.
-Me procesverbalin me nr.3294/4 prot datë 06.09.2024, NJP/KVO ka kryer vlerësimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë.

-KVO ka skualifkuar 37 operatorë dhe ka kualifikuar OE S. me nipt L....I me ofertë ekonomike në vlerën 449,000 lekë pa TVSH dhe OE E. sh.p.k me nipt L....O me ofertë ekonomike në vlerën 470,000 lekë pa TVSH.
-Me procesverbalin e datës 10.09.2024, KVO ka konstatuar tërheqjen e OE S. nëpërmjet një njoftimit në SPE dhe ka vijuar me njoftimin e OE E. sh.p.k.
-Për sa më sipër KVO ka shpallur fitues OE "E. sh.p.k/
-Me shkresën me nr. 3361 prot datë 11.09.2023, subjekti ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar nga AK
Zbatimi i kontratës
-Me shkresën me nr. 1699/6 prot datë 13.06.2025, titullari i AK ka urdhëruar ngritjen e Komisionit të Marrjes në Dorëzim për mallrat objekt prokurimi me përbërje si vijon: E, T. me detyrë përgjegjës i sektorit të IT, R. K. me detyrë specialist finance, S. M. me detyrë magaziniere.
-Me procesverbalin me nr. 1699/7 prot datë 18.06.2025, Komisioni ka marrë në dorëzim mallrat objekt prokurimi. Mallrat janë në përputhje me përcaktimet e faturës tatimore me nr. 41/2024
4) Për procedurën e prokurimit me objekt: "Materiale Pastrimi", me fond limit në vlerën 770,827 lekë pa TVSH.
-Me shkresën me nr. 1371, prot, datë 04.04.2024, Titullari i AK, z.A. M. ka vendosur hapjen e procedurës me vlerë të vogël me objekt: "Materiale Pastrimi".
Përllogaritja e Fondit Limit
-Me shkresën me nr. 1069 prot, datë 13.03.2024, Drejtori i Shërbimeve z. E. R. ka dërguar kërkesë titullarit të AK, me objekt përdorimin e fondeve të nevojshme për blerjen e bazës materiale objekt prokurimi.
-Me shkresën me nr. 1069/1 prot datë 13.03.2024, titullari i AK ka miratuar kërkesën e Drejtorit të Burimeve Njerëzore.
-Me shkresën me nr. 463 prot, datë 03.02.2025, Drejtoria i Burimeve Njerëzore z. G. P. ka dërguar kërkesë titullarit të AK, me objekt përdorimin e fondeve të nevojshme për blerjen e bazës materiale objekt prokurimi.
-Me shkresën me nr. 463/1 prot datë 03.02.2025, titullari i AK ka miratuar kërkesën e Drejtorit të Burimeve Njerëzore.
-Mes shkresën me nr. 1167 prot datë 21.03.2024, titullari i AK ka ngritur komisionin për përllogaritjen e fondit limit me përbërje: A. K., kryetare, A. S., E. X..
-Komisioni ka administruar ofertat nga tre subjekte: M. F. me nipt L....E, M. me nipt M...l, H. sh.p.k me numër nipt L...N. Në bazë të këtyre ofertave u fiksua fondi limit në vlerën 770,827 lekë pa TVSH.
-Nga verifikimi i procesverbaleve hartuar nga Komisioni i Prokurimit si dhe shkresa e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore drejtuar titullarit të AK u konstatua se nuk është argumentuar sasia e materialeve objekt prokurimi bazuar në sasitë e shpenzuara vitin paraardhës. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 285 datë 19.05.2021, neni 74, pika 3, gërma a
-Për sa më sipër mban përgjegjësi, z. E. A., Kryetari i Njësisë së Prokurimit, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Prokurimeve.
Hartimi i kritereve
-Me procesverbalin me nr. 1371/2 prot datë 04.04.2024, NJP ka argumentuar dhe miratuar specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim.
-Për sa i përket produktit larës dyshemesh, Komisioni ka specifikuar markën ACE, duke ardhur kështu në kundërshtim me nenin 36 pika 4 të Ligjit Për Prokurimin Publik.
-Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e Komisionit: A. K., N. M. dhe E. X. si dhe anëtaret e NJP E. A. Kryetar, D. T. anëtar, F. S. anëtar.
-Nga verifikimi i këtyre kritereve konstatojmë se janë hartuar në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik dhe rregullat e prokurimit publik.
Vlerësimi i ofertave.

-Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit rezulton se në këtë procedurë prokurimi për periudhën objekt auditimi, është caktuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Mat, znj. D. T. si anëtar i NJP/ KVO. Znj. T. është me pozicion pune Drejtor i Drejtorisë së Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues. Vendosja e Znj. T. me detyrë Drejtor Finance dhe nëpunës zbatues i Bashkia Mat, si anëtar i NJP/KVO, është jo në përputhje me kuadrin ligjor rregullator të nëpunësit zbatues. Veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", 12, pika 3, gërma 3), neni 22, pika 5
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi znj D. T. me detyrë Drejtoreshë e Financë dhe ish Kryetari i Bashkisë Mat z. A. M.
-Me procesverbalin me nr 1371/4 prot datë 05.04.2024, NJP/KVO ka kryer vlerësimin e ofertave të paraqitura nga 38 operatorë ekonomikë, nga të cilat dy u skualifikuan për shkak se nuk kishin në objekt të veprimtarisë së tyre objektin e procedurës së prokurimit.
-Me procesverbalin e mbajtur më datë 09.04.2024, KVO ka konstatuar se operatori ekonomik i renditur i pari "B. K." me ofertë ekonomike në vlerën 441,200 lekë pa TVSH ka njoftuar tërheqjen nga procedura e prokurimit. Për sa më sipër KVO ka njoftuar operatorin ekonomik të radhës "J. M."
-Me procesverbalin e datës 11.09.2024, KVO ka konstatuar tërheqjen e OE J. dhe ka njoftuar OE B. me ofertë ekonomike në vlerën 488,000 lekë pa TVSH.
-Me procesverbalin e datës 12.04.2024, KVO ka konstatuar tërheqjen e OE B. sh.p.k dhe kane vijuar me njoftimin e M. me ofertë ekonomike në vlerën 492,000 lekë pa TVSH.
-Për sa më sipër KVO ka vendosur të kualifikojë dhe të shpallë fitues OE M. sh.p.k me ofertë ekonomike në vlerën 492,000 lekë pa TVSH
-Me shkresën me nr. 1495 prot datë 15.04.2024, OE "M." sh.p.k ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar nga AK,
-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga operatori ekonomik u konstatua se ky i fundit ka plotësuar të gjitha kërkesat e Ftesës për Ofertë.
Zbatimi i kontratës
Me shkresën me nr. 1371/6 prot, datë 16.04.2024, titullari i AK ka ngritur komisionin për marrjen në dorëzim të mallrave objekt prokurimi me përbërje si vijon: A. K. me detyrë përgjegjëse e sektorit të arsimit, N. H. me detyrë specialist, S. M. me detyrë magaziniere.
-Me shkresën me nr. 1371/7 prot datë 18.04.2024, komisionu i ngritur nga titullari i AK ka marrë në dorëzim materialet objekti prokurimi. Sasitë dhe produktet e marra në dorëzim janë në përputhje me të dhenat e pasqyrura në faturën tatimore me nr. 13/2024
5) Për procedurën e prokurimit me objekt: "Blerje dyer për godinën e Bashkisë Mat", me fond limit në vlerën 833,000 lekë pa TVSH

-Me shkresën me nr. 6640, prot, datë 21.12.2023, Titullari i AK, z. A. M. ka vendosur hapjen e procedurës me vlerë të vogël me objekt: "Blerje dyer për godinën e Bashkisë Mat".
Përllogaritja e Fondit Limit
-Me shkresën me nr. 6255, prot, datë 03.11.2023, Drejtoria e Shërbimeve i ka dërguar shkresë Drejtorisë së Financës dhe Njësisë së Prokurimit, me objekt akordimin e fondeve të nevojshme për blerjen e materialeve objekt prokurimi.
-Nga verifikimi i dosjes së procedurës së prokurimit, u konstatua se nuk është dokumentuar përllogaritja e fondit limit për këtë procedurë.
-Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me nenin 76, pika 2 të VKM për Rregullat e Prokurimit Publik.
-Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e NJP: E. A. Kryetar, D. T. anëtar, F. S. anëtar.
-Nga verifikimi i procesverbaleve hartuar nga Komisioni i Prokurimit dhe Komisioni i Argumentimit të Specifikimeve Teknike, si dhe shkresa e Drejtorisë së Shërbimeve drejtuar Drejtorisë së Financës u konstatua se nuk është argumentuar sasia e mallrave objekt prokurimi dhe nevoja e Drejtorisë së Shërbimeve për një sasi të tillë. Nga AK nuk dokumentohet teknikisht argumentimi i volumit të sasisë së nevojshme pasi dokumentacioni është i paplotë. Veprimet dhe

mosveprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 285 datë 19.05.2022, neni 74, pika 3, gërma a.

Për sa më sipër mban përgjegjësi, z. E. A., me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike.

Hartimi i kritereve

-Me procesverbalin e datës 21.12.2023, NJP ka argumentuar dhe miratuar specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim

-Në kërkesën 10 të procesverbalit për hartimin dhe miratimin e kritereve për kualifikim dhe specifikimeve teknike, NJP ka kërkuar nga operatori ekonomik fitues pasjen e tre punonjësve për furnizimin e mallrave objekt prokurimi. NJP nuk ka argumentuar teknikisht numrin e nevojshëm të punonjësve, punën specifike të secilit prej tyre në procesin e furnizimit dhe lidhjen e secilit prej tyre me zërin e preventivit.

-Veprime në kundërshtim me nenin 78 pika 2 të VKM për Rregullat e Prokurimit Publik.

-Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e NJP: E. A. Kryetar, D. T. anëtar, F. S. anëtar.

Vlerësimi i ofertave

-Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit rezulton se në këtë procedurë prokurimi për periudhën objekt auditimi, është caktuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Mat, znj. D. T. si anëtar i NJP/ KVO. Znj. T. është me pozicion pune Drejtor i Dejtorisë së Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues. Vendosja e Znj. T. me detyrë Drejtor Finance dhe nëpunës zbatues i Bashkia Mat, si anëtar i NJP/KVO, është jo në përputhje me kuadrin ligjor rregullator të nëpunësit zbatues. Veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", 12, pika 3, gërma 3), neni 22, pika 5

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi znj D. T. me detyrë Drejtoreshë e Financë dhe ish Kryetari i Bashkisë Mat z. A. M.

-Me procesverbalin pa nr prot datë 26.12.2023, NJP/KVO ka kryer vlerësimin e ofertave të paraqitura nga 15 operatorë ekonomikë, nga të cilat dy u skualifikuan për shkak se nuk kishin në objekt të veprimtarisë së tyre objektin e procedurës së prokurimi

-Pas verifikimeve të parashikuara NJP/KVO ka kualifikuar më tej 11 operatorë ekonomik.

-Nga shqyrtimi i raportit përmbledhës së procedurës u konstatua se 9 operatorë ekonomikë nuk janë paraqitur ose janë tërhequr nga procedura e prokurimit, duke shpallur fitues OE A. me ofertë ekonomike në vlerën 800,000 lekë pa TVSH.

-NJP/KVO nuk e ka dokumentuar procesin e vlerësimit, konkretisht tërheqjen e operatorëve ekonomike me anë të procesverbaleve.

-Veprime në kundërshtim me nenin 80, pika 4 të VKM për Rregullat e Prokurimit Publik.

-Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e NJP: E. A. Kryetar, D. T. anëtar, F. S. anëtar

-Me shkresën me nr. 219 prot datë 16.01.2024, OE "A." sh.p.k ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar nga AK.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga operatori ekonomik u konstatua se ky i fundit ka plotësuar të gjitha kërkesat e Ftesës për Ofertë.

Zbatimi i kontratës

Me shkresën me nr. 286, prot datë 19.01.2024, titullari i AK ka ngritur komisionin e marrjes në dorëzim të mallrave objekt prokurimi me përbërje: M. C., D. H. dhe S. M.

Me shkresën me nr. 26.01.2024, Komisioni ka marrë në dorëzim mallrat objekt prokurimi në përputhje me përcaktimet e faturës tatimore me nr. 2/2024.

6) Për procedurën me objekt "Blerje materiale pastrimi" (viti 2023) me fond limit 644,827 lekë pa TVSH

-Me shkresën me nr. 1519, prot, datë 07.04.2023, Titullari i AK, z.A. M. ka vendosur hapjen e procedurës me vlerë të vogël me objekt: "Blerje materiale të ndryshme për dekorimin e qytetit për festat e fundvitit."

Përllogaritja e fondit limit.

-Me shkresën me nr. 1354, prot datë 28.03.2023, Drejtoria e Shërbimeve i ka drejtuar një kërkesë Njësisë së Prokurimit Publik. me objekt realizimin e procedurës së prokurimit për blerjen e materialeve të pastrimit.

-Me shkresën me nr. 1360 prot datë 28.03.2023,,titullari i AK, z. A. M. ka ngritur Komisionin e Përllogaritjes së Vlerës Limit të Kontratës dhe Përcaktimit të Specifikimeve Teknike, me përbërje: A. K., N. M. dhe L. X..
-Me procesverbalin e datës 1360/1 prot datë 06.04.2023, Komisioni për Përllogaritjen e Fondit Limit ka argumentuar përllogaritjen e fondit limit, duke përdorur metodën e testimit të tregut nëpërmjet administrimt të ofertave ekonomike nga tre subjekte. Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të dosjes së prokurimit, u konstatua se janë administruar treguesit e çmimeve për subjektet si vijon: S.S., B. B., H.. Nga kryerja e veprimeve matematikore, komisioni ka fiksuar fondin limit në vlerën 644,827 lekë pa TVSH.
-Nga verifikimi i procesverbaleve hartuar nga Komisioni i Prokurimit dhe Komisioni i Argumentimit të Specifikimeve Teknike, si dhe shkresa e Drejtorisë së Shërbimeve drejtuar Njësisë së Prokurimit u konstatua se nuk është argumentuar sasia e mallrave objekt prokurimi dhe nevoja e Drejtorisë së Shërbimeve për një sasi të tillë. Nga AK nuk dokumentohet teknikisht argumentimi i volumit të sasisë së nevojshme pasi dokumentacioni është i paplotë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 285 datë 19.05.2022, neni 74, pika 3.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi, z. E. A., Kryetari i Njësisë së Prokurimit, me detyrë Drejtor i Drejtorinë Juridike.
Hartimi i kritereve
-Me procesverbalin e datës 1360/1 prot datë 06.04.2023, Komisioni për Hartimin e Specifikimeve Teknike ka hartuar dhe argumentuar specifikimet teknike. Për sa i përket produktit pastrues pllaksh, Komisioni ka specifikuar markën ACE, duke ardhur kështu në kundërshtim me nenin 36 pika 4 të Ligjit Për Prokurimin Publik.
-Me procesverbalin e datës 07.04.2023, NJP ka argumentuar dhe miratuar specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim për procedurën e prokurimit.
-Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e Komisionit: A. K., N. M. dhe L. X. si dhe anëtaret e NJP E. A. Kryetar, D. R. anëtar, F. S. anëtar.
Vlerësimi i ofertave
-Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit rezulton se në këtë procedurë prokurimi për periudhën objekt auditimi, është caktuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Mat personi i autorizuar z. M. K., z. D. T.i si kryetar i KVO. Znj. T. është me pozicion pune Drejtor i Drejtorisë së Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues. Vendosja e Znj. T. me detyrë Drejtor Finance dhe nëpunës zbatues i Bashkia Mat, si anëtar i KVO, është jo në përputhje me kuadrin ligjor rregullator të nëpunësit zbatues. Veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, 12, pika 3, gërma 3), neni 22, pika 5.
Veprim për të cilin mban përgjegjësi titullari i AK z. A. M.dhe z. D. T.i.
-Me procesverbalin pa nr prot datë 12.04.2023, NJP/KVO ka kryer vlerësimin e ofertave të paraqitura nga 32 operatorë ekonomikë.
-Pas verifikimeve të parashikuara NJP/KVO ka kualifikuar më tej 25 operatorë ekonomikë prej të cilëve u shqyrtuan ofertat e 10 operatorëve
-Me procesverbalin e datës 18.04.2023, NJP/KVO ka konstatuar se operatori ekonomik i renditur i pari 4S me ofertë ekonomike në vlerën 375,000 lekë pa TVSH, nuk është paraqitur pranë AK me dokumentacionin e kërkuar. Për sa më sipër KVO ka kaluar te OE A. sh.p.k me ofertë ekonomike në vlerën 463,000 lekë pa TVSH.
-Me procesverbalin e datës 19.04.2023, KVO ka konstatua se OE A. sh.p.k ka ngarkuar në sistem kërkesën për tërheqje nga procedura e prokurimit. Për sa më sipër KVO ka vijuar me operatorin e radhës B. sh.p.k me ofertë ekonomike në vlerën 512,000 lekë pa TVSH.
-Me procesverbalin e datës 20.04.2023 KVO ka konstatuar se OE B. ka ngarkuar në sistem tërheqjen nga procedura e prokurimit. Për sa më sipër KVO ka vijuar me OE M. sh.p.k me ofertë ekonomike në vlerën 520,000 lekë pa TVSH.
-Për sa më sipër KVO ka shpallur fitues OE M..
-Operatori ka dorëzuar dokumentacionin në përputhje me kërkesat e DST.

Zbatimi i kontratës
-Me shkresën me nr. 1680, prot datë 25.04.2023, titullari i AK ka ngritur komisionin e marrjes në dorëzim të mallrave objekt prokurimi me përbërje: A. K., E. X. dhe F. D..
-Me shkresën me nr. 1680/1 prot, datë 27.04.2023, komisioni ka marrë në dorëzim mallrat objekt prokurimi,
Me shkresën me nr. 26.01.2024, Komisioni ka marrë në dorëzim mallrat objekt prokurimi.
-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion me faturën nr. 32/2023 u konstatua se sasia e marrë në dorëzim është në përputhje me sasinë e kërkuar nga AK.
7) Për procedurën me objekt "Blerje fotokopje Multifunction B&Ë MFP Basic dhe pajisje kompjuterike" (viti 2023) me fond limit 759,065 lekë pa TVSH.
-Me shkresën me nr. 2107, prot, datë 30.05.2023, Titullari i AK, z.A. M. ka vendosur hapjen e procedurës me vlerë të vogël me objekt: "Blerje fotokopje Multifunction B&Ë MFP Basic dhe pajisje kompjuterike."
Përllogaritja e fondit limit.
-Me shkresën me nr. 1467, prot datë 04.04.2023, Drejtori i Burimeve Njerëzire Shërbimeve i ka drejtuar një kërkesë titullarit të AK. me objekt realizimin e procedurës së prokurimit për blerjen e fotokopjeve dhe pajisjeve kompjuterike. 2
-Me shkresën me nr. 1517 prot datë 07.04.2023,,titullari i AK, z. A. M. ka ngritur Komisionin e Përllogaritjes së Vlerës Limit të Kontratës dhe Përcaktimit të Specifikimeve Teknike, me përbërje: E, T., E. X. dhe F. M..
-Me shkresën me nr. 1517/1 prot datë 19.04.2023, Komisioni për Përllogaritjen e Fondit Limit ka argumentuar përllogaritjen e fondit limit, duke përdorur metodën e testimit të tregut nëpërmjet administrimit të ofertave ekonomike nga tre subjekte. Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të dosjes së prokurimit, u konstatua se janë administruar treguesit e çmimeve për subjektet si vijon: L. S., R. T., Ë. H.. Nga kryerja e veprimeve matematikore, komisioni ka fiksuar fondin limit në vlerën 759,065 lekë pa TVSH.
-Nga verifikimi i procesverbaleve hartuar nga Komisioni i Prokurimit dhe Komisioni i Argumentimit të Specifikimeve Teknike, si dhe shkresa e Drejtorisë së Shërbimeve drejtuar Njësisë së Prokurimit u konstatua se nuk është argumentuar sasia e mallrave objekt prokurimi dhe nevoja e Drejtorisë së Shërbimeve për një sasi të tillë. Nga AK nuk dokumentohet teknikisht argumentimi i volumit të sasisë së nevojshme pasi dokumentacioni është i paplotë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 285 datë 19.05.2022, neni 74, pika 3, gërma a.
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi, z. E. A., Kryetari i Njësisë së Prokurimit, me detyrë Drejtor i Drejtorinë Juridike.
Hartimi i kritereve
-Me procesverbalin e datës 30.05.2023, NJP ka argumentuar dhe miratuar specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim për procedurën e prokurimit.
-Kriteret dhe specifikimet janë hartuar në përputhje me përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik.
Vlerësimi i ofertave
-Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit rezulton se në këtë procedurë prokurimi për periudhën objekt auditimi, është caktuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Mat personi i autorizuar z. M. K., z. D. T. si kryetar i KVO. Znj. T. është me pozicion pune Drejtor i Drejtorisë së Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues. Vendosja e Znj. T. me detyrë Drejtor Finance dhe nëpunës zbatues i Bashkia Mat, si anëtar i KVO, është jo në përputhje me kuadrin ligjor rregullator të nëpunësit zbatues. Veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", 12, pika 3, gërma 3), neni 22, pika 5.
Veprim për të cilin mban përgjegjësi titullari i AK z. A. M. dhe z. D. T.

-Me procesverbalin pa nr. prot datë 02.06.2023, NJP/KVO ka kryer vlerësimin e ofertave të paraqitura nga 28 operatorë ekonomikë.

-Pas verifikimeve të parashikuara NJP/KVO ka kualifikuar më tej 17 operatorë ekonomikë prej të cilëve u shqyrtuan ofertat e 10 operatorëve
-Për sa më sipër KVO ka shpallur fitues OE K. sh.p.k me ofertë ekonomike në vlerën 646,000 lekë pa TVSH
-Operatori ka dorëzuar dokumentacionin në përputhje me kërkesat e DST.
Zbatimi i kontratës
-Me shkresën me nr. 2227, prot datë 07.06.2023, titullari i AK ka ngritur komisionin e marrjes në dorëzim të mallrave objekt prokurimi me përbërje: E, T., N. M. dhe F. D..
-Me shkresën me nr. 1680/1 prot, datë 27.04.2023, komisioni ka marrë në dorëzim mallrat objektk prokurimi.
-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion me faturën nr. 1209/2023 u konstatua se sasia e marrë në dorëzim është në përputhje me sasinë e kërkuar nga AK.

4.4 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.

Në mënyrë të përmbledhur realizimi i kontratave për punë publike, për periudhën e auditimit, paraqitet, si më poshtë.

Në zbatim të pikës 4.4 të Programit të Auditimit, në Bashkinë Mat, nga grupi i auditimit të KLSH-së, u analizuan regjistrat e investimeve të përfunduara dhe të mara në dorëzim për periudhën e auditimit 01.01.2023 – 31.12.2025 për **20 (njëzet)** investime në shumën **634,795,772.96 lekë me TVSH (**pasqyruar në regjistrin e realizimit të prokurimeve tek anekset**)**. Nga kjo analizë, nga grupi i auditimit u arsyetua që si objekte me risk në realizimin e punimeve, të cilat janë kërkuar për t'u audituar, janë përzgjedhur në bazë të vlerës së kontratës, llojit të punimeve të ndërtimit, zërave të punimeve të ndërtimit me risk të madh në zbatimin e veprave, të rishikimit të projekteve të zbatimit si dhe afatit të përfundimit të punimeve për objektet e paraqituara në **Tabelën 1**, si vijon:

Tabela 1: Regjistri i kontratave për punë publike të përfunduara, të kolauduara dhe, të marra në dorzim nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Mat, për periudhën e auditimit 2023 - 2025.

Nr.	Objekti i investimit	Burimi Financimit	Op. Fitues	Vlera e kontratës (TVSH)	Dt. Lidhjes kontrates
	Viti 2023				
1	"Ndërtimi i rrugës Varrezat e qytetit – fshati Batër e Vogël, Faza I" Bashkia Mat	Bashkia Mat	OE "K." ShPK	32,415,101	24.02.2023
2	Rikonstruksioni i ish hotelit të ish Uzinës së ferrokromit në qytetin e Burrelit" Bashkia Mat	Bashkia Mat	OE "C." ShPK	73,265,133	30.11.2023
3	"Rikonstruksioni i rrugës Lis" Bashkia Mat	Ministria	OE "L." ShPK	32,962,920	01.03.2023
4	*"Rikonstruksion i plotë i shkollës së mesme "Pjetër Budi" + terrene sportive", Burrel Bashkia Mat*	Ministria	OE "U.".ShPK	91,182,262.17	04.10.2023
	Viti 2024				
5	"Rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare "Ali Metra" Komsi dhe sistemi i ngrohjes + ndërtim palestre" Bashkia Mat	Ministria	OE "U." ShPK	105,215,770.96	28.06.2024
6	*"Banesa Sociale me qira, adoptim i objektit ekzistues (Rikonstuksion i ish-shtëpisë së ushtarakëve), Burrel*	Ministria	BOE "A.".ShPK & "Z.".ShPK	68,973,645	04.10.2024
	Total në lekë me TVSH			404,014,832.13	

Burimi: Bashkia Mat.

Mbështetur sa më sipër, për auditimin e zbatimit të punimeve të kontratave për punë publike, për periudhën e auditimit 01.01.2023 – 31.12.2025, u audituan **6 (gjashtë)** investime në shumën totale **404,014,832.13 lekë me TVSH ose 63%** të shumës totale të kontratave për punë publike **277,724,543.78 lekë me TVSH.**

Në përfundim të auditimit të zbatimit të kontratave për punë publike, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, dhe shqyrtimit të observacioneve të subjektit të audituar Bashkia Mat, **po pasqyrojmë në mënyrë të detajuar problematikat e konstatuara,** si vijon:

1. "Ndërtimi i rrugës Varrezat e qytetit – fshati Batër e Vogël, Faza I" Bashkia Mat.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 887 prot datë 24.02.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mat, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. A. M. dhe Operatori Ekonomik "K." SHPK, me përfaqësues z. S. K., me licencë profesionale NZ 4951/22. Vlera e kontratës është 32,415,101 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 5 muaj nga data dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1095 prot, datë 10.03.2023, është lidhur kontrata me OE "E." SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. .../17 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 191,946 lekë me TVSH.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 6187 prot., datë 21.11.2023 është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria "N." ShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. .../7 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 38,800 lekë me TVSH.

Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, është ngritur grupi i punës me përbërje M. C., A. P. dhe R. H. (në dosje nuk administrohet urdhri i Kryetarit të bashkisë), në zbati të të cilit është hartuar Certifikata e Marrjes së Përkohshme në dorëzim me nr. 9559/1 prot., datë 28.12.2023, i nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi, kolaudatori i punimeve, si dhe nga grupi i punës dhe Kryetari i Bashkisë z. A. M. për Investitorin.

Për marrjen e përhershme në dorëzim të objektit, është ngritur grupi i punës me përbërje M. C., K. R. dhe R. H. (në dosje nuk administrohet urdhri i Kryetarit të Bashkisë), nga i cili është hartuar Certifikata e Marrjes së Përkohshme në dorëzim me nr. 1312/1 prot., datë 09.04.2026, i nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi, kolaudatori i punimeve, si dhe nga grupi i punës dhe Kryetari i Bashkisë z. A. B. për Investitorin.

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, administrohet në dosje Leje infrastrukturore me nr. 350, datë 31.03.2023. Ky veprim është në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit", i ndryshuar, neni 11/1, "Punime që duhet t'u kërkohet leja e ndërtimit".

Në dosjen e zbatimit administrohet Oponenca Teknike me shkresën nr. 192/4, datë 03.03.2023 të Rektoratit të Universitetit të Tiranës, në përputhje me Ligjin Nr. 3/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike;** b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...".

- Projekti i zbatimit është hartuar nga shoqëria "I." SHPK në vitin 2022.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 05.04.2023 (përkon me datën e dorëzimit të sheshit të ndërtimit) dhe kanë përfunduar me datë 05.09.2023, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Ndërtimi i rrugës Varrezat e qytetit – fshati Batër e Vogël, Faza I" Bashkia Mat		
14.Lidhja e kontratës Nr. 887 prot datë 24.02.2023	**15.Vlera e kontratës (me TVSH)** 32,415,101 lekë **Sipërmarrës "K." ShPK**	**16.Likuiduar deri dt**

17- Situacioni Përfundimtar **-Vlera me TVSH 32,415,101 lekë** **-Vlera pa TVSH 27,012,584 lekë**	**18.Afati i kontratës në dite** Parashikuar 150 ditë , Zbatuar 150 ditë. Fillimi punimeve: 05.04.023 Perfundimi punimeve : 05.09.2023		**19. Zgjatja e kontratës** Nuk ka	
20. **Mbikëqyrësi i punimeve** OE "E." SHPK	Licenca Nr: MK ..../17	Kontrata me nr. 1095 prot, datë 10.03.2023		
21. **Kolaudatori i punimeve** "N." SHPK	Licenca Nr: MK ..../7	Kontrata nr. 6187 prot., datë 21.11.2023		
22.Akt Kolaudimi Datë 30.11.2023	**23**.**Akt i marrjes në dorëzim**, datë 28.12.2023			

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **577,390 lekë pa TVSH**.

Tabela nr. 1

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
2	**Punime shtesash për trupin e rrugës**							
1	Shtresë çakulli t=20 cm, përhapur e ngjeshur me makineri	m^3	1270	1110	1110	1015	95	120,650
3	**Punime trotuari**							
1	Trotuar me 6 cm beton me ngjyrë, me llustër	m^2	600	1478	1478	1109	369	221,400
4.C	**Punime riparimi i urës metalike**							
1	Ura druri, shtresë më dërrasa 8 cm	m^2	2600	123	123	88.6	34.4	89,440
5	**Punime elektrike**							
9	FV pusetë plastike 40x40x40, kapak i fortë	copë	3020	45	45	0	45	135,900
IV	**Punime për sinjalistikën rrugore.**							
	FV tabela të ndryshme rrugore	copë	5000	4	4	2	2	10,000
							Total	**577,390**

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

2- Punime shtresash për trupin e rrugës

1. Zëri 1. Shtresë çakulli t=20 cm, përhapur e ngjeshur me makineri. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 1110 m^3. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 1110 m^3. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 1126 m^3, i detajuar sipas seksioneve të rrugës, në gjatësi 1555 ml rruga kryesore, me gjerësi të ndryshueshme dhe trashësi 0.2 m. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimi në terren, konstatohet se në librin e masave, nga pik 8 deri në pik 27, gjerësia e shtresës së çakullit është marrë në mënyrë të paargumentuar 1.0 – 1.5 m më e madhe se shtresat e stabilizantit, binderit dhe asfaltobetonit. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 1015 m^3 (5075 m^2 (sa sipërfaqja e shtresave të tjera) x 0.2 m trashësi), ose 95 m^3 më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

3- Punime trotuari

2. Zëri 1. Trotuar me 6 cm beton me ngjyrë, me llustër. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 1478 m^2. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 1478 m^2. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 1478 m^2, i padetajuar. Nga verifikimi i librit të masave për zërin e çakullit dhe verifikimi në terren, konstatohet se gjatësia është 1478 ml dhe gjerësia e trotuarit të betonit është 0.75 m (në dukje është 1 m, por 25 cm janë bordurë monolite pas trotuarit (25x12 cm), e librezuar dhe situacionuar në zëri nr. 4 të këtij kapitulli). Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 1109 m^2 (1478 ml x 0.75 m), ose 369 m^2 më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

4.C Punime riparimi i urës metalike

3. Zëri 1. Ura druri, shtresë më dërrasa 8 cm. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 123 m^2. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 123 m^2. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 123 m^2, i detajuar për përmasat e urës 28.5 ml x 4.22 m. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimi në terren, konstatohet se gjatësia e urës 21 ml dhe gjerësia e 4.22 m. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 88.6 m^2 (21 ml x 4.22 m), ose 34.4 m^2 më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

5- Punime elektrike

4. Zëri 9. FV pusetë plastike 40x40x40, kapak i fortë RIC 1084+1086. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 45 copë. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 45 copë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 45 copë, i padetajuar. Nga verifikimi në terren, konstatohet se ky zë pune nuk është realizuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

IV- Punime për sinjalistikën

5. Zëri 3. FV tabela të ndryshme rrugore D=90. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 4 copë. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 4 copë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 4 copë, i padetajuar. Nga verifikimi në terren, rezulton se janë 2 copë tabela, ose 2 më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 577,390 lekë pa TVSH** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** OE "E." SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

1) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, *ku përcaktohet se:*

"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit."

2) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit nr. 1095 prot, datë 10.03.2023.

- **Nga ana e kolaudatorit të punimeve** "N." ShPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

1) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, *ku përcaktohet se:*

"Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është

realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve"

2) Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3 *ku përcaktohet se:*

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:
a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.
b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.
c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.
ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes

3) Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve nr. 6187 prot., datë 21.11.2023.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. G. I. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. E. N. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

2. "Rikonstruksioni i ish hotelit të ish Uzinës së Ferrokromit në qytetin e Burrelit" Bashkia Mat.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 6332 prot datë 30.11.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mat, të përfaqësuar nga Zv. Kryetari i Bashkisë z. M. Z. dhe Operatori Ekonomik "C." SHPK, me përfaqësues z. N. C., me licencë profesionale NZ 2175/21. Vlera e kontratës është 73,265,133 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 6 muaj nga data dorëzimit të sheshit të ndërtimit nga supervizori.
Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 6069 prot, datë 15.11.2023, është lidhur kontrata me OE "N." SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. .../7 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 812,498 lekë me TVSH.
Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 5306/8 prot., datë 17.12.2024 është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria "E." ShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. ... dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 80,970 lekë me TVSH.
Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, është ngritur grupi i punës me përbërje M. C., E. T. dhe K. R., nga i cili është hartuar Certifikata e Marrjes së Përkohshme në dorëzim me nr. 903/1 prot., datë 07.03.2025, i nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi, kolaudatori i punimeve, si dhe nga grupi i punës dhe Kryetari i Bashkisë z. A. M. për Investitorin.
Për marrjen e përhershme në dorëzim të objektit, është ngritur grupi i punës me përbërje K. R., E. A. dhe E. T. (në dosje nuk administrohet urdhri i Kryetarit të bashkisë), nga i cili është hartuar Certifikata e Marrjes së Përhershme në dorëzim me nr. 422/1 prot., datë 13.02.2026, i nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi, kolaudatori i punimeve, si dhe nga grupi i punës dhe Kryetari i Bashkisë z. A. B. për Investitorin.

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, administrohet në dosje Deklaratë paraprake për kryerje punimesh me nr. 389, datë 10.11.2023. Ky veprim është në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit", i ndryshuar, neni 11/1, "Punime që duhet t'u kërkohet leja e ndërtimit".
Në dosjen e zbatimit administrohet Oponenca Teknike, në përputhje me Ligjin Nr. 3/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga

ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike;** b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...".
- Projekti i zbatimit është hartuar nga shoqëria "D." SHPK në vitin 2022.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 30.11.2023 (përkon me datën e dorëzimit të sheshit të ndërtimit) dhe kanë përfunduar me datë 30.09.2024, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentet e kontratës..
- Në dosjen teknike administrohet korrespondenca midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit, në lidhje me punimet e paparashikuara dhe pezullimin e punimeve për shkak të disa prishjeve të paparashikuara që duhen bërë në prezencën e banorëve në objekt. Është hartuar një procesverbal midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit për pezullimin e punimeve në datën 04.04.2024 (ose më pak se 2 muaj nga afati kontraktual i përfundimit të punimeve), pa afat të përcaktuar, deri në prishjen e strukturave të betonit dhe krijimit të kushteve për vazhdimin e mëtejshëm të kontratës. Pas kërkesës së mbikëqyrësit për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me shkresën nr. 160 prot., datë 23.05.2024, është hartuar Amendamenti nr. 1, me nr. 2048/2 prot., datë 27.05.2024, duke ndryshuar afatin e punimeve nga 6 muaj në 9 muaj. Pas kërkesës së mbikëqyrësit për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me shkresën nr. 221 prot., datë 30.08.2024, për shkak të moslirimit të apartamenteve nga ana e banorëve, është hartuar Amendamenti nr. 2, me nr. 3221/2 prot., datë 30.08.2024, duke ndryshuar afatin e punimeve nga 9 muaj në 10 muaj.

- Në dosjen teknike administrohet gjithashtu korrespondenca midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit, në lidhje me ndryshimet në projekt dhe miratimi i preventivit të ripunuar. Nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen prej lekë 3,426,793 lekë pa TVSH dhe punime që pakësohen prej 2,229,650 lekë pa TVSH, duke përdotur fondin rezervë në vlerën 1,197,135 lekë pa TVSH.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksioni i ish hotelit të ish Uzinës së ferrokromit në qytetin e Burrelit" Bashkia Mat				
14.Lidhja e kontratës Nr. 6332 prot datë 30.11.2023	**15.Vlera e kontratës (me TVSH)** 73,265,133 lekë **Sipërmarrës "C." ShPK**		**16.Likuiduar deri dt**	
17- Situacioni Përfundimtar **-Vlera me TVSH 73,265,133 lekë** **-Vlera pa TVSH 59,857,135 lekë**	**18.Afati i kontratës në dite** Parashikuar 180 ditë , Zbatuar 300 ditë. Fillimi punimeve: 30.11.2023 Perfundimi punimeve : 30.09.2024		**19. Zgjatja e kontratës** Amendamenti nr. 1, me nr. 2048/2 prot., datë 27.05.2024, shtyrja 3 muaj Amendamenti nr. 2, me nr. 3221/2 prot., datë 30.08.2024, shtyrja 1 muaj	
20. **Mbikëqyrësi i punimeve** OE "N." SHPK	Licenca Nr: MK ..../7	Kontrata me nr. 6069 prot, datë 15.11.2023		
21. **Kolaudatori i punimeve** "E." SHPK	Licenca Nr: MK	Kontrata nr. 5306/8 prot., datë 17.12.2024		
22.Akt Kolaudimi Datë 30.11.2023	**23**.**Akt i marrjes në dorëzim**, datë 28.12.2023			

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **1,672,568 lekë pa TVSH**.
Tabela nr. 1

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
C	**Punime tavani, suvatimi dhe veshje**							
3+G2	Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5cm + rrjetë + suva & bojë hidroplastike importi (fasada)	m^2	3200 (2800+400)	1696.5	1848.65	1536	160.5	513,600
E	**Punime shtresash**							
4	Plintuse grez importi, h=10 cm, çmimi	ml	300 lekë/ml	2100	2100	261 lekë/ml	39 lekë/ml	81,900
F	**Punime dyer dritare**							
3	FV dyer të brendshme druri, importi, cilësia e parë, çmimi	m^2	21400 lekë/m^2	138	138	14,264 lekë/m^2	7136 lekë/m^2	984,768
H	**Punime pandus dhe sheshpushimi**							
3	Beton C 202/25 për pandus	m^3	17000	5	6	1.1	3.9	66,300
5	Parapet pandusi me tuba inoksi h=80-90 cm	ml	6500	4	4	0	4	26,000
							Total	**1,672,568**

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

C. Punime tavani, suvatimi dhe veshje

1. Zëri 3 + G.2. Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5 cm + rrjetë + suva + + bojë hidroplastike importi (fasada). Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 1320 m^2. Në preventivin e rishikuar është 1696.5 m^2 dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 1696.5 m^2. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 1848.65 m^2, i detajuar sipas fasadave (veriore dhe jugore, me gjatësi 37.25 ml dhe fasada lindore dhe perëndimore me gjatësi 21.66 ml, të gjitha me h= 15.3 m) dhe korniza me gjatësi 115 ml dhe lartësi 0.4 ml. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren konstatohet se nuk janë zbritur hapësirat e dritareve (236 m^2) dhe nuk është zbritur pjesa e paprishur në fasadën veriore me gjatësi 7.3 ml dhe lartësi 4.7 m. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 1536 m^2, ose 160.5 m^2 më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

E. Punime Shtresash

2. Zëri 4. Plintuse grez importi, h=10 cm, (korridore + apartamente), çmimi. Nga verifikimi i librit të masave, situacionit përfundimtar dhe verifikimi në terren, rezulton se është situacionuar 2100 ml plintus pllaka grez me h=10 cm, me çmim 300 lekë/ml, e cila nga verifikimi në terren rezulton të jetë h= 8 cm. Nga verifikimi i analizës së çmimit të këtij zëri pune, sipas manualit (2.324/a), rezulton se çmimi i nënzërit material në këtë zë pune, është 65 % e të gjithë zërit të punës. Nga rillogaritja, çmimi i këtij zëri pune është 261 lekë/ml (65% x 300 lekë/ml x 8cm/10cm + 35 % x 300 lekë/ml), ose 39 lekë/ml më pak se çmimi i situacionuar. Për pasojë, diferenca e çmimit prej 39 lekë/ml (për sasinë e plintuseve prej 2100 ml), është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

F. Punime dyer dritare

3. Zëri 3. FV dyer të brendshme druri, importi, cilësia e parë, çmimi. Nga verifikimi i librit të masave, situacionit përfundimtar dhe verifikimi në terren, rezulton se është situacionuar 138 m^2 dyer druri, me çmim 21,400 lekë/m^2, e cila nga verifikimi në terren rezulton të jenë me dyer tamburato, të cilat në manualin e çmimeve rezultojnë me analizë nr. 2.388/1, me çmim 14,264 lekë/m^2, ose 7,136 lekë/m^2 më pak se çmimi i situacionuar. Për pasojë, diferenca e çmimit prej 7136 lekë/m^2 (për sipërfaqen e dyerve prej 138 m^2), është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

H. Punime pandusi dhe sheshpushimi

4. Zëri 3. Beton C 20/25 për pandus. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 5 m^3. Në preventivin e rishikuar është 5 m^3 dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 5 m^3. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 6 m^3, i padetajuar me përmasa. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimi në terren, konstatohet se përmasat e pandusit janë gjatësi 2.5 m, gjerësi 1 m dhe lartësi nga 0 në 0.45 m. Nga rillogaritja volumi i këtij zëri pune është 1.1 m^3, ose 3.9 m^3, më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

5. Zëri 5. Parapet pandusi me tuba inoksi h=80-90 cm. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 4 ml. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 4 ml. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 4 ml, i padetajuar. Nga verifikimi në terren, rezulton se ky volum nuk është realizuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 1,672,568 lekë pa TVSH** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** OE "N." SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

3) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, *ku përcaktohet se:*

"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit."

4) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit nr. 6069 prot, datë 15.11.2023.

- **Nga ana e kolaudatorit të punimeve** "E." ShPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

4) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, *ku përcaktohet se:*

"Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve"

5) Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3 *ku përcaktohet se:*

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:
a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.
b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.
c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.
ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes

6) Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve nr. 5306/8 prot., datë 17.12.2024.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. E. N. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. M. P. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

3. "Rikonstruksioni i rrugës Lis" Bashkia Mat.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 957 prot datë 01.03.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mat, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. A. M. dhe Operatori Ekonomik "L." SHPK, me përfaqësues z. M. K., me licencë profesionale NZ ..../25. Vlera e kontratës është 32,962,920 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 7 muaj nga data dorëzimit të sheshit të ndërtimit nga supervizori i punimeve.
Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1091 prot, datë 10.03.2023, është lidhur kontrata me OE "E." SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. ..../17 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 213,000 lekë me TVSH.
Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 6066 prot., datë 15.11.2023 është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria "H." ShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. .../3 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 38,708 lekë me TVSH.
Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, është ngritur grupi i punës me përbërje E. R., M. C. dhe R. K., në zbatim të të cilit është hartuar Certifikata e Marrjes së Përkohshme në dorëzim me nr. 2974/1 prot., datë 02.08.2024, i nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi, kolaudatori i punimeve, si dhe nga grupi i punës dhe Kryetari i Bashkisë z. A. M. për Investitorin..

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, administrohet në dosje Leje infrastrukture me nr. 349, datë 31.03.2023. Ky veprim është në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit", i ndryshuar, neni 11.

Në dosjen e zbatimit administrohet Oponenca Teknike me nr. 654/2 prot., datë 22.05.2024 të Institutit të Ndërtimit, në përputhje me Ligjin Nr. 3/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike;** b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...".

- Projekti i zbatimit është hartuar nga një grup projektimi i Bashkisë Mat, me përbërje M. A. me licencë K ...., B. H. me licencë Gj ..., A. H. me licencë K ... dhe A. I. me licencë K ..., në vitin 2022.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 01.04.2023 dhe kanë përfunduar me datë 07.03.2025, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

- Pas kërkesës së mbikëqyrësit për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve, protokolluar nr. 5609 prot., datë 31.12.2024, është hartuar Amendamenti nr. 1, me nr. 5609/2 prot., datë 06.01.2025, duke ndryshuar afatin e punimeve nga 6 muaj në 8 muaj.
- Në dosjen teknike administrohet gjithashtu korrespondenca midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit, në lidhje me ndryshimet në projekt dhe miratimi i preventivit të ripunuar. Nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen prej 2,245,548 lekë pa TVSH dhe punime që pakësohen prej 2,245,700 lekë pa TVSH.

Nga verifikimi në terren, u konstatua se në dy zona, rreth progr. 0+450 dhe prog 0+800, janë prishur shtresat asfaltike me një sipërfaqe prej rreth 200 m^2, e cila duhet të riparohet para marrjes së përhershme në dorëzim të këtij objekti.



- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksioni i rrugës Lis" Bashkia Mat				
14.Lidhja e kontratës Nr. 957 prot datë 01.03.2023	**15.Vlera e kontratës (me TVSH)** 32,962,920 lekë **Sipërmarrës "L." ShPK**		**16.Likuiduar deri dt**	
17- Situacioni Përfundimtar **-Vlera me TVSH 32,962,738 lekë** **-Vlera pa TVSH 27,468,948 lekë**	**18.Afati i kontratës në dite** Parashikuar 210 ditë , Zbatuar 180 ditë. Fillimi punimeve: 01.04.2023 Perfundimi punimeve : 29.08.2023		**19. Zgjatja e kontratës** Nuk ka	
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE "E." SHPK	Licenca Nr: MK ..../17	Kontrata me nr. 1091 prot, datë 10.03.2023		
21. Kolaudatori i punimeve "H." SHPK	Licenca Nr: MK ..../3	Kontrata nr. 6066 prot., datë 15.11.2023		
22.Akt Kolaudimi Nr. 6462 prot., datë 07.12.2023	**23.Akt i marrjes në dorëzim**, datë 02.08.2024			

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **977,180 lekë pa TVSH**.

Tabela nr. 1

Nr	**Zëri i punimeve**	**Njësia**	**Çmimi i ofertës**	**Situacioni përfundimtar**	**Libri i masave**	**Fakti**	**Diferenca në +**	
							Vol.	**Vlera**
2	**Punime për trupin e rrugës**							
1	Shtresë çakulli kave t=20 cm, përhapur e ngjeshur me makineri	m^2	580	8305.6	8311	6655	1331	771,980
1	Shtresë asfaltobetoni me granil gur kave t=3	m^2	1350	5604	5605	5452	152	205,200

	cm, përhapur e ngjeshur me makineri							
							Total	**977,180**

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

2- Punime shtresash për trupin e rrugës

1. Zëri 1. Shtresë çakulli kave t=20 cm, përhapur e ngjeshur me makineri. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 7005 m^2. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 8305.6 m^2. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 8311 m^2, i detajuar sipas seksioneve të rrugës, në gjatësi 1297 ml rruga kryesore, me gjerësi të ndryshueshme mesatarisht 6 m, për xhepat dhe rrugë dytësore me gjatësi dhe gjerësi të ndryshueshme. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimi në terren, konstatohet se gjerësia e shtresës së çakullit është marrë jo sipas projektit dhe pa argumentim teknik 1 m më e madhe se shtresat e stabilizantit, binderit dhe asfaltobetonit. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 6655 m^2 (324 m^2 për xhepat dhe rrugët dytësore dhe sasia tjetër është sa 5/6), ose 1331 m^2 më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

3. Zëri 5. Shtresë asfaltobetoni me granil gur kave t=3 cm, përhapur e ngjeshur me makineri. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 5800 m^2. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 5604 m^2. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 5605.3 m^2, i detajuar sipas seksioneve të rrugës, në gjatësi 1297 ml rruga kryesore, me gjerësi të ndryshueshme mesatarisht 4 m, për xhepat dhe rrugë dytësore me gjatësi dhe gjerësi të ndryshueshme. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimi në terren, konstatohet se ky volum nuk është kryer në xhepa dhe rrugë dytësore, përveç rrugës dytësore në prog. 0+105.00, majtas. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 5452, ose 152 m^2 më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 977,180 lekë pa TVSH** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** OE "E." SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

5) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, *ku përcaktohet se:*

"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit."

6) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit nr. 1091 prot, datë 10.03.2023.

- **Nga ana e kolaudatorit të punimeve** "H." ShPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

7) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, *ku përcaktohet se:*

"Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve"

8) Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3 *ku përcaktohet se:*

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:
a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.
b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.
c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.
ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes

9) Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve nr. 6066 prot., datë 15.11.2023.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
1. Z. G. I. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. E. Q. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

4. "Rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare "Ali Metra" Komsi dhe sistemi i ngrohjes + ndërtim palestre" Bashkia Mat.

Kontratat
Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 1638/11 prot datë 28.06.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mat, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. A. M. dhe Operatori Ekonomik "U." SHPK, me përfaqësues z. N. S., me licencë profesionale NZ ..../21. Vlera e kontratës është 105,215,770.96 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 6 muaj nga data dorëzimit të sheshit të ndërtimit nga supervizori.
Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1966/14 prot, datë 08.07.2024, është lidhur kontrata me OE "E." SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. ..../17 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 1,777,324.3 lekë me TVSH.
Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 2790/6 prot., datë 26.08.2025 është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria "H." ShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. ... dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 171,999 lekë me TVSH.
Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, është ngritur grupi i punës me përbërje K. R., E. T. dhe D.S. (në dosje nuk administrohet urdhri i Kryetarit të bashkisë), në zbatim të të cilit është hartuar Certifikata e Marrjes së Përkohshme në dorëzim me nr. 3503/1 prot., datë 08.10.2025, i nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi, kolaudatori i punimeve, si dhe nga grupi i punës dhe Kryetari i Bashkisë z. M. Z. për Investitorin.

Projektpreventivi
- Për këtë objekt, administrohet në dosje Leje ndërtimi, në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit", i ndryshuar, neni 11/1, "Punime që duhet t'u kërkohet leja e ndërtimit".
Në dosjen e zbatimit administrohet Oponenca Teknike me nr. 654/2 prot., datë 22.05.2024 të Institutit të Ndërtimit, në përputhje me Ligjin Nr. 3/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike;** b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...".
- Projekti i zbatimit është hartuar nga shoqëria "E." SHPK në vitin 2019.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 08.07.2024 (përkon me datën e dorëzimit të sheshit të ndërtimit) dhe kanë përfunduar me datë 07.03.2025, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

- Pas kërkesës së mbikëqyrësit për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve, protokolluar nr. 5609 prot., datë 31.12.2024, është hartuar Amendamenti nr. 1, me nr. 5609/2 prot., datë 06.01.2025, duke ndryshuar afatin e punimeve nga 6 muaj në 8 muaj.
- Në dosjen teknike administrohet gjithashtu korrespondenca midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit, në lidhje me ndryshimet në projekt dhe miratimi i preventivit të ripunuar. Nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen prej lekë 14,291,644 lekë me TVSH dhe punime që pakësohen prej 9,888,692 lekë me TVSH, duke përdorur fondin rezervë në vlerën 4,405,718 lekë pa TVSH. Janë shtuar 3 zëra të rinj, për të cilët është bërë negocimi i çmimit me procesverbalin nr. 670/1 prot., datë 28.02.2025, nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe përfaqësuesit e investitorit dhe janë miratuar çmimet sipas manualit të çmimeve të punimeve të ndërtimit në fuqi.

Nga auditimi është konstatuar se është prishur dhe ribërë 390 m^2 suva e jashtme, e cila. nisur nga fakti që objektit do t'i bëhet veshje me polisterol, nuk ishte e nevojshme, duke kryer punime pa efektivitet në vlerën 897,000 lekë pa TVSH (195,000 prishje + 702,000). Për sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi dhe ndjekësja e kontratës.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare "Ali Metra" Komsi dhe sistemi i ngrohjes + ndërtim palestre" Bashkia Mat				
14.Lidhja e kontratës Nr. 1638/11 prot datë 28.06.2024	**15.Vlera e kontratës (me TVSH)** 105,215,770.96 lekë **Sipërmarrës "U." ShPK**		**16.Likuiduar deri dt**	
17- Situacioni Përfundimtar **-Vlera me TVSH 105,213,005 lekë** **-Vlera pa TVSH 87,677,504 lekë**	**18.Afati i kontratës në dite** Parashikuar 180 ditë , Zbatuar 240 ditë. Fillimi punimeve: 08.07.2024 Perfundimi punimeve : 07.03.2025		**19. Zgjatja e kontratës** Amendamenti nr. 1, me nr. 5609/2 prot., datë 06.01.2025, shtyrja 2 muaj	
20. **Mbikëqyrësi i punimeve** OE "E." SHPK	Licenca Nr: MK ..../17	Kontrata me nr. 1966/14 prot, datë 08.07.2024		
21. **Kolaudatori i punimeve** "H." SHPK	Licenca Nr: MK ...	Kontrata nr. 2790/6 prot., datë 26.08.2025		
22.Akt Kolaudimi Datë 26.09.2025	**23**.**Akt i marrjes në dorëzim**, datë 08.10.2025			

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **391,447 lekë pa TVSH**.

Tabela nr. 1

Nr	**Zëri i punimeve**	**Njësia**	**Çmimi i ofertës**	**Situacioni përfundimtar**	**Libri i masave**	**Fakti**	**Diferenca në +**	
							Vol.	**Vlera**
A	**Godina e shkollës**							
I	**Punime ndërtimore**							
2	**Punime murature**							
1	Mur tulle me 6 vrima t=12 cm	m^3	15,742	10	10.45	3.6	6.4	100,749

3	**Punime suvatimi dhe veshje**							
3	Suva fasade, çmimi	m^2	1800 lekë/m^2	390	390	1318 lekë/m^2	482 lekë/m^2	187,980
4	**Punime dyer dritare**							
2	FV dyer të brendshme druri, importi, cilësia I	m^2	21559	66	66	63	3	64,677
B	**Palestra**							
	Punime shtresash, suvatime e lyerje							
5+6	Shtresë parketi laminat+shtresë dërrasa	m^2	4877	360	360	352.2	7.8	38,041
							Total	**391,447**

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

A. Godina e shkollës

3. Punime murature

1. Zëri 1 Mur tulle me 6 vrima t=12 cm. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 10.5 m^3. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 10 m^3. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 10.45 m^3, i detajuar për dy mure, me trashësinë 0.35 m. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimi në terren, konstatohet se ky volum është llogaritur me trashësi, 0.35 m nga 0.12 m që duhet të ishte sipas projektpreventivit. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 3.6 m^3, ose 6.4 m^3 më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

3. Punime suvatimi dhe veshje

2. Zëri 3. Suva fasade, çmimi. Nga verifikimi i librit të masave dhe situacionit përfundimtar, rezulton se është situacionuar 390 m^2 suva fasade, me çmim 1800 lekë/m^2. Ky zë pune nuk është parashikuar në preventivin fillestar, por nuk figuron të jetë bërë negociim çmimi, pasi nuk është zë i ri pune, sepse është në kapitullin e ndërtimit të palestrës me çmimin 1318 lekë/m^2, ose 482 lekë/m^2 më pak se çmimi i situacionuar. Për pasojë, diferenca e çmimit prej 482 lekë/m^2 (për sipërfaqen e suvasë prej 390 m^2), është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

4. Punime dyer dritare

3. Zëri 2. FV dyer të brendshme druri, importi, cilësia e parë, çmimi. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 105 m^2. Në preventivin e rishikuar është 66 m^2 dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 66 m^2. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 66 m^2, i detajuar për 31 dyert e klasave dhe 2 dyert e jashtme. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren konstatohet se janë 29 dyer klasash (15 në katin përdhe dhe 14 në katin e parë). Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 63 m^2, ose 3 m^2 më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

B. Palestra e shkollës

11. Punime shtresash, suvatime e lyerje

4. Zëri 5. Shtresë parketi laminat. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 360 m^2. Në preventivin e rishikuar është 360 m^2 dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 360 m^2. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 360 m^2, i detajuar për përmasat e fushës (13.8 m x 26 m). Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren konstatohet se përmasat

janë 13.6 m x 25.9 m dhe sipërfaqja 352.2 m^2, ose 7.8 m^2 më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 391,447 lekë pa TVSH** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** OE "E." SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

7) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, <u>ku përcaktohet se:</u>

"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit."

8) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit nr. 1966/14 prot, datë 08.07.2024.

- **Nga ana e kolaudatorit të punimeve** "H." ShPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

10) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, <u>ku përcaktohet se:</u>

"Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve"

11) Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3 <u>ku përcaktohet se</u>:

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:
a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.
b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.
c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.
ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes

12) Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve nr. 2790/6 prot., datë 26.08.2025.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
1. Z. G. I. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. A. M. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: ***: "Banesa Sociale me qira, adoptim i objektit ekzistues (Rikonstuksion i ish-shtëpisë së ushtarakëve), Burrel*** ku rezultoi se: Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës së sipërmarrjes publike me nr. 2932/13 prot., datë 04.10.2024, lidhur midis AK Bashkia Mat dhe Kontraktorit BOE "A.".ShPK & "Z.".ShPK sipas licencave respektive për zbatim punimesh me nr.NZ…./2 dhe NZ…./17. Vlera e kontratës është 68,973,645 lekë me TVSh.
-Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 9 muaj nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit. Për këtë objekt është hartuar vetëm një deklaratë për kryerje punimesh nr.3875/1, datë 26.09.2024. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr.2981/19 prot., datë 14.10.2024, midis AK Bashkia Mat dhe Mbikëqyrësit OE

“T.”ShPK, sipas liçencës për mbikëqyrje dhe kolaudim të punimeve të zbatimit MK….. Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr.3326/7 prot., datë 02.10.2025, midis AK Bashkia Mat dhe Kolaudatorit OE “P.”ShPK, me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK…./2. -Nga kontrolli i dokumentacionit tekniko-ligjor të vënë në dispozicion të GA konstatohet se: Dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe njoftimi i fillimit të punimeve është kryer më datë 31.10.2023. Për këtë objekt ka pasur vonesa për shak të kushteve atmosferike dhe prezencës së banorëve brenda banesave, të cilët janë bërë pengesë për zhvillin normal të punimeve, për këto shkaqe është mbajtur një amendament për zgjatjen e afateve me 1 një muaj sipas amendamentit me nr.2150/2 prot., datë 08.07.2025. Njoftimi i përfundimit të punimeve është kryer nga Kontraktori dhe Mbikëqyrësi më datë 14.08.2025. Në dosjen teknike nuk administrohet licenca e Mbikëqyrësit dhe licenca e Kolaudatorit; si dëshmi e vlefshmërisë së tyre për periudhën e zhvillimit të kontratës. Në dosje nuk administrohet kërkesa e Kontraktorit dhe Mbikqyrësit të punimeve për miratimin e ndryshimeve në projekt preventiv. Ditari i punimeve nuk është mbajtur në mënyrë korrekte, pasi janë vendosur të njëjtët punëtor në numër për çdo ditë pune dhe të njëjtat mjete për çdo ditë pune; gjithashtu temperaturat dhe moti janë lënë të paplotësuar. -Në dosjen teknike nuk janë shoqëruar me certifikata cilësie materialet e përdorura, gjithashtu mungojnë skedat teknike, provat laboratorike si dhe testimet për sistemet elektrike, hidraulike provat nën ngarkesë, proceverbali i tokëzimit etj. Në dosjen teknike administrohet libreza e masave përfundimtare e cila korrespondon me situacionin përfundimtar.
-Librezat e masave janë hartuar në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”* dhe udhëzimet nr.1 datë 16.06.2011, dhe nr.3 datë 15.02.2001 *“Për mbikeqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar*, pasi nuk janë shoqëruara me vizatime dhe skica ilustruese për çdo zë pune.
-Nga kontrolli teknik i punimeve në terren u konstatuan disa diferenca midis volumeve të punës të situacionuara me punimet faktike në terren, si dhe volume të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbatimit/projekt-preventivin e rishikuar si më poshtë:
-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize “*2.37/3a-Transport materiale ndertimi, dheu me auto ÷5.0 km”* i cili është raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 1,676.20 m^3, dhe në vlerën 335,240 lekë pa TVSh. Gjatë kontrollit të librezave të masave në llogaritjet e volumeve për këtë zë pune janë përfshirë në mënyrë të gabuar volume edhe nga disa zëra të tjerë punimesh (*2.426/1-Prishje mur tulle me pastrim; 2.426/3-Prishje shtresë betoni punimet elek, hidraulike; 2.426/3-Prishje shtresa betoni mbi dhe nen hidroizolim dhe shtresat e dyshemeve sipas kateve)*; zëra të cilët e kanë të përfshirë transportin në analizat teknike të çmimit të tyre. Sasia totale e këyre volumeve llogaritet në vlerën: 638 m^3 x 200 lekë/m^3 = **127,600 lekë pa TVSh, vlerë e cila do të konsiderohet si dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize “*2.84-Mur me tulle me vrima, t=10cm, h~3m, llaç perzier M15”*, i cili është raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 128.22 m^3 dhe në vlerën 1,602,750 lekë pa TVSh. Gjatë kontrollit të librezave dhe situacionit përfundimtar për këtë zë pune, vihet re se projektuesi ka parashikuar që prishjet e muraturës së tullave të kryhen me pastrim sipas zërit*“2.426/1-Prishje mur tulle me pastrim”,* që do të thotë që tullat që do të pastrohen dhe do të ripërdoren përsëri. Rrjedhimisht për realizimin e këtij zëri pune duhet të zbritej materiali i tullës pasi përftohet nga zëri *“Prishje mur tulle me pastrim”.* Sipas manualit të ri të çmimeve, çmimi për këtë zë pune është 22,312.78 lekë/m^3, nëse këtë zë pune e zhveshim nga materiali “tullë”, ky çmim kalon në 12,896.37 lekë/m^3 dhe nëse bëjme raportin midis tyre 12,896.37 /22,312.78 = 58%. Nëse e aplikojmë këtë % tek vlera e raportuar 58% x 1,602,750 lekë pa TVSh = 929,595 lekë pa TVSh do kemi vlerën e llogaritur për këtë zë. Nëse kryejmë diferencën midis vlerës së raportuar dhe vlerës së llogaritur do të kemi vlerën (1,602,750 lekë pa TVSh - 929,595 lekë pa TVSh) = **673,155 lekë pa TVSh, vlerë e cila është përfituar padrejtësisht nga ana e Kontraktorit, kjo vlerë do të konsiderohet si dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize "*2.262/3-Shtrese betoni C 12/15 t-10 cm"* i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 157.3m^3, gjatë kontrollit në terren dhe librezave të masave u konstatua kjo sasi nuk është llogaritur në mënyrë korrekte pasi; sipas raportimit në situacionin përfundimtar shtresa termoizoluese është raportuar 1085.31m^2, nëse këtë sipërfaqe e shumëzojmë me t=10cm(referuar zërit në fjalë) do të kemi sasinë e cila duhet të ishte raportuar sipas llogaritjeve korrekte: 1085.31x0.1=108.5m^3. Diferenca midis volumeve të raportuara dhe atyre faktike 157.3m^3-108.5m^3, është në vlerën **390,160 lekë pa TVSh, vlerë e cila do të konsiderohet si dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize "*2.196/c-Hidroizolim me dy shtresa mapej"* i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 374.75 m^2, gjatë kontrollit të dokumentacionit tekniko-ligjor materiali fotografik dhe librezave të masave u konstatua kjo sasi nuk është llogaritur në mënyrë korrekte, referuar shtresës niveluese e cila është raportuar 191.87 m^2. Nëse këtë sasi e llogarisim për zërin e punës hidroizolim do të kemi (191.87 + 191.87*0.2)=230 m^2 do te kemi sasinë e cila duhet të ishte raportuar sipas llogaritjeve korrekte. Diferenca midis volumeve të raportuara dhe atyre faktike 374.75m^2-230 m^2, shkon në vlerën **173,407 lekë pa TVSh, vlerë e cila do të konsiderohet si dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize "*2.324/b-Plintuse grez importi, h = 10 cm"*, i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 1,849.89 ml dhe në vlerën 554,967 lekë pa TVSh. Gjatë kontrollit në terren u konstatua se plintuesit ishin realizuar me lartësi nga 10 cm në 8 cm; ose me lartësi rreth 20% më të ulët sesa përcaktimi i zërit në fjalë. Nëse e aplikojmë këtë % tek vlera 554,967 lekë pa TVSh do të kemi vlerën e cila duhet të zbritet 20% x 554,967 lekë = **110,993 lekë pa TVSh, vlerë e cila është përfituar padrejtësisht nga ana e Kontraktorit dhe do të konsiderohet si dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize "*2.273/1-Davancale mermeri t = 3 cm (dyer + dritare)"*, i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 100.90 m^2 dhe në vlerën 504,500 lekë pa TVSh. Gjatë kontrollit në terren u konstatua se plintuesit ishin realizuar me lartësi nga 3 cm në 2 cm; ose me lartësi rreth 33% më të ulët sesa përcaktimi i zërit në fjalë. Nëse e aplikojmë këtë % tek vlera 504,500 lekë pa TVSh do të kemi vlerën e cila duhet të zbritet 33% x 504,500 lekë = **166,485 lekë pa TVSh, vlerë e cila është përfituar padrejtësisht nga ana e Kontraktorit dhe do të konsiderohet si dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize "*2.575-Pusetë kontrolli 1x1x1.5m per kanalizimet e ujerave te zeza"*, i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 2 copë dhe në vlerën 100,000 lekë pa TVSh. Gjatë kontrollit në terren u konstatua se pusetat ishin realizuar me kapak betoni dhe jo kapak gize. Në manualin e ri të çmimeve, në analizën teknike të çmimi për këtë zë, nëse e zhveshim nga kapaku i gizës, çmimi kalon nga 106,267.71 lekë/copë në 64,637 lëkë/copë ose në bëjmë raportin e tyre 64,637 /106,267.71 lekë/copë =61%. Nëse e aplikojmë këtë % tek vlera 100,000 lekë pa TVSh do të kemi vlerën e cila duhet të zbritet 61% x 100,000 lekë = 61,000 lekë pa TVSh. Nëse kryejmë diferencën midis vlerës së raportuar me vlerën e llogaritur do të kemi 100,000 lekë pa TVSh – 61,000 lekë pa TVSh = **39,000 lekë pa TVSh, vlerë e cila është përfituar padrejtësisht nga ana e Kontraktorit dhe do të konsiderohet si dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize *"2.410/a-Parapet Pandusi me tuba inoksi h=80~90 cm"* i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 20ml dhe 30ml dhe në vlerat 110,000 lekë dhe 165,000 lekë. Gjatë kontrollit në terren u konstatua se parapeti për pandusin nuk ishte realizuar me tuba inoksi. Sasia totale e këtyre punimeve është përftuar padrejtësisht nga ana e Kontraktorit në vlerën **510,000 lekë pa TVSh, vlerë e cila do të konsiderohet si dëm ekonomik.**

Në total rezultuan diferenca me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Mat në vlerën 2,190,800 lekë pa TVSh.
Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve OE "T.".ShPK, në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk kanë zbatuar rigorozisht përcaktimet kontraktuale dhe ligjore të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit". *(Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimi nr. 10, datë 29.06.2026, dorëzuar me protokoll në Bashkisë Mat).*

6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: ***"Rikonstruksion i plotë i shkollës së mesme "Pjetër Budi" + terrene sportive", Burrel Bashkia Mat*** ku rezultoi se: Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës së sipërmarrjes publike me nr. 5296 prot., datë 04.10.2023, lidhur midis AK Bashkia Mat dhe Kontraktorit OE "U.".ShPK. Vlera e kontratës është 91,182,262.17 lekë me TVSH. -Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 12 muaj nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit. -Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr.5426 prot., datë 09.10.2023, lidhur midis AK Bashkia Mat dhe Mbikëqyrësit OE "E.".ShPK, sipas licencës për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK…./17. -Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr.5240/6 prot., datë 17.12.2024, midis AK Bashkia Mat dhe Kolaudatorit BOE "E.".ShPK & "I.".ShPK, sipas liçensës për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK… dhe MK. …./13. -Nga kontrolli i dokumentacionit tekniko-ligjor i vënë në dispozicion të GA konstatohet se: Dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe njoftimi i fillimit të punimeve është kryer më datë 31.10.2023. Njoftimi i fillimit të punimeve nga mbikëqyrësi, procesverbali i fillimit të punimeve si dhe akti i piketimit, janë realizuar më datë 31.10.2023. Njoftimi i përfundimit të punimeve është kryer nga Kontraktori dhe Mbikëqyrësi më datë 16.09.2024.
-Nga kontrolli teknik i punimeve në terren u konstatuan disa diferenca midis volumeve të punës të situacionuara me punimet faktike në terren, si dhe volume të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbatimit/projekt-preventivin e rishikuar si më poshtë:
-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize "*3.158/5a+An-Transport materiale ndertimi, dheu me auto ÷5.0 km"* i cili është raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 284 m^3, dhe në vlerën 136,320 lekë pa TVSh. Gjatë kontrollit të librezave të masave në llogaritjet e volumeve për këtë zë pune janë përfshirë në mënyrë të gabuar volume edhe nga disa zëra të tjerë punimesh (*2.426/1-Prishje mur tulle me pastrim; 2.426/3-Prishje shtresë betoni;* dhe zëri *Prishje shtrese me pllaka ekzistuese dhe nenshtresat* si zë i pakryer*)*; zëra të cilët e kanë të përfshirë transportin në analizat teknike të çmimit të tyre. Sasia totale e këyre volumeve llogaritet në vlerën: (38+12+320*0.1)=82m3 rrjedhimisht 82 m^3 x 480 lekë/m^3 = **39,360 lekë pa TVSh, vlerë e cila do të konsiderohet si dëm ekonomik.**
-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize "*2.324/2-F.V Plintus mermeri t=10cm"*, i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 68 ml dhe në vlerën 66,640 lekë pa TVSh. Gjatë kontrollit në terren u konstatua se plintuesit ishin realizuar me lartësi nga 10 cm në 8 cm; ose me lartësi rreth 20% më të ulët sesa përcaktimi i zërit në fjalë. Nëse e aplikojmë këtë % tek vlera 66,640 lekë pa TVSh do të kemi vlerën e cila duhet të zbritet 20% x 66,640 lekë = **13,328 lekë pa TVSh, vlerë e cila është përfituar padrejtësisht nga ana e Kontraktorit dhe do të konsiderohet si dëm ekonomik.**
-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize "*An-F.V rezervuari zingato 5000 litra"*, i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 1copë dhe në vlerën 178,200 lekë pa TVSh. Gjatë kontrollit në terren u konstatua se rezeruvari ishte lyer nga jashtë dhe ishte rivendosur rezervuari ekzistues. Vlera prej **178,200 lekë pa TVSh, vlerë e cila është përfituar padrejtësisht nga ana e Kontraktorit dhe do të konsiderohet si dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize *"Anal-Ndricues led 60x60 per klasat"* i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 147 copë dhe në vlerën totale Furnizim+Vendosje = 760,725

lekë pa TVSh. Gjatë kontrollit në terren u konstatuan 15 copë ndricues në mangësi. Vlera tyre në furnizim+vendosje llogaritet 15 copë x (4,590+585)lekë/copë= **77,625 lekë pa TVSh, vlerë e cila do të konsiderohet si dëm ekonomik.**

Në total rezultuan diferenca me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Mat në vlerën 308,513 lekë pa TVSH.
Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve OE "E.".Shpk, në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet kontraktuale dhe ligjore të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit". *(Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimi nr. 11 datë 29.06.2026, dorëzuar me protokoll në Bashkisë Mat).*

5 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Bashkia Mat ka të miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor (këtu e në vazhdim PPV) dhe Rregulloren e Planit të Përgjithshëm të Territorit me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit (këtu e në vazhdim KKT), nr. 01, datë 08.02.2017, ku përfshihen Plani i Zhvillimit, Rregullorja e PPV-së, Strategjia Territoriale, Vlerësim Strategjik Mjedisor, si dhe hartat e përdorimit të tokës sipas kategorive, ndarja e territorit në sisteme, infrastruktura e transportit, fazat e zbatimit të PPV-së, vizioni strategjik, ndarja e territorit në zona dhe njësi.

Auditimi konsiston në këto fusha:
- Dhënia e lejes së zhvillimit, krahasimi i dokumentacionit me kriteret e vendosura;
- Dhënia e lejes së ndërtimit, dokumentacioni, krahasimi dhe zbatimi i treguesve parametrik;
- Saktësia e llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë;
- Dhënia e çertifikatës së përdorimit.

<u>LEJET E NDËRTIMIT, ZHVILLIMIT DHE PËRDORIMIT PËR PERIUDHËN 01.01.2023 - 31.12.2025</u>

Referuar të dhënave në sistemin elektronik *e-lejet* për Bashkinë Mat, rezulton se për afatin e auditimit **01.01.2023 deri në 31.12.2025** ka pasur **156 aplikime në sistem për lloje të ndryshme lejesh** si: leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m2, leje zhvillimi, deklarata për kryerje punimesh, çertifikata përdorimi, etj., të evidentuara në tabelën përmbledhëse në **Tabelën nr. 1.**

Tabela nr. 1: aplikimet në sistemin e-lejet për periudhën 01.01.2023-31.12.2025

Aplikimet e lejeve të ndërtimit për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2025 nga sistemi e-Leje			
Nr.	**Përshkrimi i lejes**	**Numri i aplikimeve**	**Numri i miratimeve**
1	Certifikatë përdorimi	**18**	**14**
2	Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	**43**	**43**
3	Leje infrastrukture	**10**	**6**
4	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me siperfaqe deri në 250 m^2	**4**	**4**
5	Leje ndërtimi për prishje ndërtimi ekzistues	**1**	**1**
6	Leje për ndryshim funksioni	**2**	**2**
7	Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	**1**	**1**
8	Leje përshtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	**8**	**5**
9	Leje zhvillimi	**14**	**11**
10	Njoftim për fillim punimesh	**30**	**23**
11	Kërkesë për plotësim dokumentacioni	**1**	**0**


Aplikimet e lejeve të ndërtimit për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2025 nga sistemi e-Leje			
Nr.	**Përshkrimi i lejes**	**Numri i aplikimeve**	**Numri i miratimeve**
12	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m^2	**4**	**3**
13	Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me siperfaqe më të madhe se 250 m^2	**6**	**6**
14	Njoftim për raportin e mbikëqyrjes	**7**	**7**
15	Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni	**7**	**7**

Burimi: DPZHT Bashkia Mat *Përpunoi: Grupi i auditimit*

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga Sektori i Planifikimit Urban dhe Mjedisit i Bashkisë Mat, si dhe në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit, janë përzgjedhur për t'u audituar 2 certifikata përdorimi si dhe 1 leje ndërtimi me sipërfaqe më të madhe se 250 m2 për të cilat janë konstatuar problematika si vijon:

Nr.	Objekti	Nr. vendimi	Data	Zhvilluesi
1	Ndërtesë multifunksionale shërbim, biznes, banim 3 kat + 1 kat nëntokë	579	03.09.2025	Q. C.
	Adresa: *Rr. "Pirusët" , Nj. Adm. Burrel, Bashkia Mat*			

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të *"Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe me të madhe se 250 m^2"*, me nr. aplikimi *AN260620250125*, u konstatua si më poshtë:



Parcela e marrë në studim bën pjesë në njësinë strukturore 1/22 (sipas PPV-së), ndërkohë që për këtë njësi strukturore nuk është parashikuar hartimi i Planit të Detajuar Vendor (nga këtu e në vazhdim PDV).

Kjo leje ndërtimi është miratuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për shqyrtimin e aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi, pasi:

1. Dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë, pasi:

- Dokumentet e pronësisë nuk janë ngarkuar të plota pasi mungon certifikata e pronësisë. Në zbatim të nenit 17 të Ligjit nr. 111/2018 *"Për kadastrën"*, ekstrakti i dokumentit të pronësisë është certifikata e pronësisë, shoqëruar nga harta treguese dhe kartela e pasurisë së paluajtshme. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, pika 1, nënpika b);
- Mungon certifikata e performancës së energjisë, si pjesë përbërëse e raportit të eficencës së energjisë, veprim ky jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, pika 1/1, nënpika v) dhe pikën III.2 të VKM-së nr. 537, datë 08.07.2020 *"Për miratimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe të elementeve të ndërtesave"*;
- Mungon deklarata e përgjegjësisë profesionale e hartuesit të raportit të auditimit të eficencës së energjisë, veprim ky jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, pika 1, nënpika e) dhe pikën III.2 të VKM-së nr. 537, datë 08.07.2020 *"Për miratimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe të elementeve të ndërtesave"*;
- Mungon deklarata e përgjegjësisë profesionale e hartuesve të studimit sizmologo – inxhinierik dhe gjeologo-inxhinierik, veprim ky jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë

13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, pika 1, nënpika e);
- Mungon studimi gjeologo-inxhinierik, veprim ky jo në përputhje me pikën 1 të VKM-së nr. 1162, datë 24.12.2020 *"Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi / ndërtimi"*, si dhe pikën 5 të Shtojcës II të këtij vendimi;
- Policat e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e raportit të auditimit të eficencës së energjisë, njëkohësisht hartues i projektit elektrik, është jashtë afatit të mbulimit në raport me datën e aplikimit për pajisje me leje ndërtimi (26.06.2025). Vlefshmëria e policës është për periudhën 28.05.2024 – 27.05.2025, veprim ky jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, pika 1, nënpika g);
- Mungojnë policat e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e projektit hidrosanitar, të projektit të instalimeve të ngrohje / ftohje / ventilimit, si dhe studimit gjeologo - inxhinierik, veprim ky jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, pika 1, nënpika g);
- Mungon vendimi i vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis (së bashku me dokumentacionin shoqërues), ose së paku deklaratë për përjashtimin nga detyrimi për pajisje me vlerësim mjedisor (nga një vlerësues i licencuar), veprim ky jo në përputhje me Shtojca 2, pika 10/b të Ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 *"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"*;
- Mungon projekti i gjelbërimit dhe projekti i mobilimit urban e hapësirave rekreative e argëtuese, nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, pika 1/1, nënpika vi) dhe vii).

2. Sektori i Planifikimit Urban dhe Mjedisit nuk ka kërkuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Referuar nenit 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, i ndryshuar, pika 6, SPUM ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me sa më lartë cituar, rezulton se:
- SPUM është mjaftuar me miratimin në heshtje nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, edhe pse informacioni që mundëson kjo drejtori nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë / kartelat e pasurive;
- Nuk është kërkuar mendimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), për të marrë informacion nëse objekti që kërkohet të zhvillohet duhet t'i nënshktrohet ose jo vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- Nuk është respektuar mendimi i Agjencisë së Eficencës së Energjisë, e cila me anë të shkresës me nr. 1192 prot., datë 14.07.2025, ka kërkuar plotësimin e dokumentacionit me certifikatën e performancës së energjisë, kusht ky i cili nuk është plotësuar nga aplikanti / zhvilluesi. Edhe pse në këto kushte, Bashkia Mat ka vijuar me miratimin e lejes së ndërtimit.

Për miratimin e lejes së ndërtimit, si dhe vlerësimit pozitiv të praktikës, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi:
Z. A. G., me funksion përgjegjës i Sektorit të Planifikimit Urban dhe Mjedisit;
Znj. D. N., në cilësinë e kontrolluesit në sistemin elektronik të lejeve;
Znj. E. K., në cilësinë e nëpunësit në sistemin elektronik të lejeve.

Gjithashtu, në zbatim të Ligjit 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, neni 29, pika a), për vendimmarrjen e jashtëligjshme lidhur me aplikimin për leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Mat, ngarkohet me përgjegjësi:
Z. M. Z., në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Mat.

Titulli gjetjes 2: Miratim i çertifikatës së përdorimit jo në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi për Çertifikatën e Përdorimit me vendim nr. 368 Port., datë 23.05.2023, të Kryetarit të Bashkisë Mat për objektin "Stallë për Gjedhë (Majmëri Vçash) 1 KT+Hangar 1KT + Zyra administrate 2 KT+Mur rrethues", me adresë fshati Zenisht, Njësia Administrative Lis, Bashkia Mat dhe subjekt zhvillues I. M..

Situata: Nga auditimi i proçedurës së auditimit të "Çertifikatë Përdorimi", me nr. aplikimi *AN150520230069,* u konstatua se:



Kjo çertifikatë përdorimi është miratuar jo në përputhje me legjislacionin në fuqi për shqyrtimin e aplikimeve për pajisje me çertifikatë përorimi, pasi:

1. Mungojnë aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit.
Konkretisht mungojnë: -Ngritja e kantierit të punimeve, -Piketimi i strukturës, -Përfundimi i themeleve dhe kuota 0, -Përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin, -Përfundimi i fasadave, rifiniturave dhe sistemit të jashtëm në planin e vendosjes së strukturës së re, veprime jo në përputhshmëri me nenin 27/1, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar

2. Mungojnë aktet përkatëse (procesverbal, akt miratimi, akt kolaudimi, akt teknik etj.) nga institucionet kompetente për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, si dhe për menaxhimin e mbetjeve urbane, veprime jo në përputhshmëri me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, pika 1, nënpika ë).

3. Mungon policën e sigurimit të përgjegjësisë së ndërtuesit për dëmtime të objektit të përfunduar, veprime jo në përputhshmëri me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, pika 1, nënpika i).

4. Mungon projekti për mirëmbajtjen e objektit, veprime jo në përputhshmëri me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, pika 1, nënpika gj).

5. Mungon raporti përfundimtar i auditimit të eficiencës së energjisë, veprime jo në përputhshmëri me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, pika 1, nënpika ll).

Për miratimin e lejes së ndërtimit, si dhe vlerësimit pozitiv të praktikës, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi:
Z. A. G., me funksion përgjegjës i Sektorit të Planifikimit Urban dhe Mjedisit;
Znj. D. N., në cilësinë e kontrolluesit në sistemin elektronik të lejeve;
Znj. E. M., në cilësinë e nëpunësit në sistemin elektronik të lejeve.

Gjithashtu, në zbatim të Ligjit 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, neni 29, pika a), për vendimmarrjen e jashtëligjshme lidhur me aplikimin për leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Mat, ngarkohet me përgjegjësi:
Z. A. M., në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Mat.

Titulli gjetjes 3: Miratim i çertifikatës së përdorimit jo në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi për Çertifikatën e Përdorimit me vendim nr. 419 Port., datë 13.05.2024, të Kryetarit të Bashkisë

Mat për objektin "Godinë Banimi 2kt", me adresë rruga "Dalip Hysa" Njësia Administrative Burrel, Bashkia Mat dhe subjekt zhvillues E. D..

Situata: Nga auditimi i proçedurës së auditimit të "Çertifikatë Përdorimi", me nr. aplikimi *AN200420240021,* u konstatua se:



Kjo çertifikatë përdorimi është miratuar jo në përputhje me legjislacionin në fuqi për shqyrtimin e aplikimeve për pajisje me çertifikatë përorimi, pasi:

1. Mungojnë aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit.

Konkretisht mungojnë aktet e kontrollit për: - Përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin, - Përfundimi i fasadave, rifiniturave dhe sistemit të jashtëm në planin e vendosjes së strukturës së re, veprime jo në përputhshmëri me nenin 27/1, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar. Në zbatim të nenit të sipërciuar, përcaktohet se në çdo rast, verifikimi dhe konfirmimi i akteve të kontrollit janë të detyrueshme.

2. Mungojnë licensa e kolaudatorit të punimeve, veprime jo në përputhshmëri me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, pika 1, nënpika c).

3. Mungon policën e sigurimit të përgjegjësisë së ndërtuesit për dëmtime të objektit të përfunduar, veprime jo në përputhshmëri me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, pika 1, nënpika i).

4. Mungojnë aktet përkatëse (procesverbal, akt miratimi, akt kolaudimi, akt teknik etj.) të lëshuara nga shoqëria "Ujësjellës-Kanalizime" sh.a., Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, institucionet kompetente për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, si dhe ato për menaxhimin e mbetjeve urbane, veprime jo në përputhshmëri me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e rregullores së zhv

5. illimit të territorit", i ndryshuar, pika 1, nënpika ë).

6. Mungojnë fotografi të objektit në të gjitha orientimet, veprime jo në përputhshmëri me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, pika 1, nënpika j).

7. Mungon kontrata e nënshkruar, ndërmjet zhvilluesit dhe mbikëqyrësit të punimeve, veprime jo në përputhshmëri me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, pika 1, nënpika l).

8. Mungon raporti përfundimtar i auditimit të eficiencës së energjisë, veprime jo në përputhshmëri me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, pika 1, nënpika ll).

9. Mungon projekti për mirëmbajtjen e objektit, veprime jo në përputhshmëri me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, pika 1, nënpika gj).

Për miratimin e lejes së ndërtimit, si dhe vlerësimit pozitiv të praktikës, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi:

Z. A. G., me funksion përgjegjës i Sektorit të Planifikimit Urban dhe Mjedisit;

Znj. D. N., në cilësinë e kontrolluesit në sistemin elektronik të lejeve;

Znj. E. M., në cilësinë e nëpunësit në sistemin elektronik të lejeve.

Gjithashtu, në zbatim të Ligjit 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, neni 29, pika a), për vendimmarrjen e jashtëligjshme lidhur me aplikimin për leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Mat, ngarkohet me përgjegjësi:
Z. A. M., në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Mat.

6 Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore.
6.1. Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.
6.2. Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV; Për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.
6.3. Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmërin e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit te Zhvillimit Territorit.

-Struktura e IMT Bashkia Mat ka funksionuar përgjatë vitit 2023, me tre inspektorë dhe një kryeinspektor. Për vitin 2024 nga data 31.03.2024 deri në 31.12.2024 ka funksionuar me dy inspektorë dhe një kryeinspektor, ndërkaq për vitin 2025 ka funksionuar po ashtu me dy inspektorë dhe një kryeinspektor
-Nga IMTV Bashkia Mat, bazuar edhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion grupit të auditimit, u konstatua se janë hartuar planet mujorë për vitin 2023, 2024, gjithashtu është hartuar plani vjetor për vitin 2025.
-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua nuk është raportuar për veprimtarinë e IMT Bashkia Mat pranë IKMT, për vitin 2025, në kundërshtim me nenin 5, pika f të Ligjit 9780 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme.
-Për mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi Kryeinspektori I IMT Bashkia Mat, z. S. D..
-Për periudhën 01.01.2023-31.12.2025 nga Inspektorët e Inspektoriatit të Mbrojtjes të Territorin në Bashkinë Mat. janë proceduar gjithsej 8 subjekte për ndërtime informale të ndërtuar pa leje ndërtimi, shkelje të afatit të përfundimit të punimeve.
-Nga këto për prishjen e objektit të kundërligjshëm, nga IMT-ja janë marrë 2 vendime. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, në vijim të vendimmarrjes për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm, nuk është ekzekutuar prishja e objektit të kundërligjshëm në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar me zgjedhje i procedurave të ndjekura nga IMTV-ja për inspektimin e bërë në terren në lidhje me ndërtimet informale të ndërtuar pa leje dhe shkelje të tjera, u konstatua si më poshtë vijon:
Dosja e subjektit M. G:
-Nga inspektimi i bërë në terren me datë 07.06.2023 nga Inspektorët S. D. dhe B. P., në subjektin M. G me adresë Njësia Administrative Baz, fshati Rreth, është konstatuar ndërtim pa leje, konkretisht ndërtimi i një muri mbajtës me llaç dhe kolona hekuri me përmasa 12 m dhe lartësi 1.2.
-Nga inspektorët e IMTV-së me datë 03.08.2023 është mbajtur procesverbali me nr. 27, për konstatimin e kundërvajtjes të ndërtimit pa leke.
-Me vendimin nr. 56 të datës 03.08.2023, nga inspektorët është marrë vendimi për pezullimin e ndërtimit.
-Me vendimin nr. 40 të datës 09.08.2023, nga Kryeinspektori i IMT Bashkia Mat është marrë vendimi për dënimin me gjobë të subjektit në vlerën 50,000 lekë, duke u bazuar në nenin 51, pika d të Ligjit nr. 17.2014 "Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit".
-Me vendimin nr. 12 të datës 09.08.2023 është vendosur prishja e ndërtimit të kundërligjshëm.

-Nga verifikimi i Vendimit nr. 40 të datës 09.08.2023, u konstatua se në dispozitivin e vendimit, kryeinspektori dhe inspektori e kanë cilësuar kundërvajtjen si ndërtim pa leje, ndërkaq në Vendimin e gjobës Kryeinspektori e ka klasifikuar shkeljen në mënyrë të gabuar duke iu referuar përcaktimit të nenit 52, pika d të Ligjit për Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.
-Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me nenin 5, pika b të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar,
-Me shkresën me nr. 2895 prot datë 24.07.2024, Bashkia Mat ka kërkuar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit për gjobën e e vendosur ndaj kundërvajtësit M. G.
-Bashkia Mat nuk disponon informacion lidhur me vendimin e gjykatës administrative.
-Kryeinspektori i IMT nuk ka marrë masat e duhura për ndjekjen e rrugës ligjore për arkëtimin e të ardhurave nga gjoba e vendosur nga subjekti.
-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se nuk është ekzekutuar vendimi i prishjes. Nuk është hartuar shkresë e protokolluar drejtuar Kryetarit të Bashkisë Mat apo strukturave vendore të Policisë për pajisjen me mjetet e nevojshme për ekzekutimin e vendimit.
-Mosveprime në kundërshtim me nenin 4 të Ligjit Nr. 9780 Datë 16.07.2007 i ndryshuar.
-Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ish Kryetarin e Bashkisë Mat z. A. M. dhe Kryeinspektori i IMT Bashkia Mat, znj. S. D.
-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se nuk është proceduar me kallëzimin penal në Prokurorinë e juridiksionit gjyqësor përkatës për z. M.G..
-Mosveprim në kundërshtim me nenin 5, pika dh të Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, neni 52 pika 7 të Ligjit nr. 107/2014 Për Planifikimi dhe Zhvillimin e Territorit.
-Për sa më sipër mban përgjegjësi Kryeinspektori e Bashkisë Mat, znj. S. D..
Dosja e subjektit K. D.
Nga inspektimi i bërë me datë 31.07.2023 në terren nga Inspektorët S. D. dhe B. F, në subjektin K. D. (adresa Lagjja e Re, Njësia Administrative Komsi), është ndërtim pa leje, konkretisht 4 kolona betoni me përmasa 45x50 cm dhe lartësi 4 m.
-Me vendimin nr. 39 datë 09.08.2023, Kryeinspektori i IMTV Bashkia Mat ka vendosur gjobitjen e subjektit me shumën në vlerën 57,540, lekë, duke u bazuar në nenin 52, pika 2, pika "e" të Ligjit për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit.
-Me vendimin nr. 55 të datës 31.07.2023 Kryeinspektori ka vendosur pezullimin e punimeve për një afat ditor 10 ditë.
-Me vendimin 09.08.2023, Kryeinspektori ka vendosur prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm
-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se në Vendimin për Dënimin me Gjobë me nr. 39, datë 09.08.2023, Kryeinspektori e IMT Bashkia Mat, ka vendosur dënimin me gjobë të subjektit, me një shumë në vlerën 57,540 lekë., referuar Ligjit nr 107/2014 Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, neni 52, pika e. Grupi i auditimit konstaton se pika "e" e këtij neni, konkretisht" kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500 000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera;, është shfuqizuar me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese me nr. 15 datë 22.06.2022, konkretisht në pjesën që parashikon dënimin me gjobë për kryerjen e punimeve pa leje për plotësimin e nevojave për strehim. Aktualisht ky ligj nuk e sanksionon me gjobë ndërtimin pa leje për qëllime strehimi, por parashikon dënimin me gjobë për kryerjen e punimeve në vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror, kur ndërtimi bëhet për qëllime fitimi.
-Për sa parashtruam më sipër konstatojmë se Kryeinspektori i IMT Bashkia Mat i është referuar një baze ligjore të shfuqizuar për sa i përket trajtimit të këtij rasti.
-Veprimet e mësipërme vijnë kundërshtim me nenin 4, neni 100 të Ligjit Nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë.

-Për sa më sipër, në përputhje me përcaktimet e nenit 108 të Kodit të Procedurave Administrative, ky akt përbën një akt absolutisht të pavlefshëm.
-Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi Kryeinspektori i IMT Bashkia Mat, znj. S. D..
-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se nuk është ekzekutuar vendimi i prishjes. Nuk është hartuar shkresë e protokolluar drejtuar Kryetarit të Bashkisë Mat ose strukturave vendore të Policisë për pajisjen me mjetet e nevojshme për ekzekutimin e vendimit.
-Mosveprime në kundërshtim me nenin 4 të të Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"
.-Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Mat z. A. M. dhe Kryeinspektori i IMT Bashkia Mat, znj. S. D.
-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se nuk është proceduar me kallëzimin penal në Prokurorinë e juridiksionit gjyqësor përkatës për z. K. D.
-Mosveprim në kundërshtim me nenin 5, pika dh e Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"., nenin 52, pika 7 e Ligji nr. 107/2014
-Për sa më sipër mban përgjegjësi Kryeinspektorja e Bashkisë Mat, znj. S. D..
¬-Me veprimin bankar të datës 11.08.2023, subjekti K. D. ka kryer shlyerjen e gjobës së vendosur nga IMT Bashkia Mat në vlerën prej 57,540 lekë pa t.v.sh.
Dosja e subjektit G. B.:
-Me Vendimin nr. 45 të datës 04.03.2024, Kryeinspektori i IMT, ka marrë vendimin për dënimin me gjobë në shumën prej 200,000 lekësh në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, i ndryshuar, bazuar në nenin 52 pika dh.
-Nga verifikimi i dosjes së subjektit u konstatua se nuk është mbajtur një akt konstatimi nga ana e Kryeinspektorit për konstatimin e kundërvajtjes.
-Mosveprim në kundërshtim me nenin 12, pika 5 të Ligjit për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit.
Për sa më sipër mban përgjegjësi Kryeinspektori i IMT, z. S. D..
-Me faturën e datës 11.03.2023, subjekti G. B. ka paguar gjobën prej 200,000 lekësh.

Dosja e subjektit V. sh.p.k
-Me Vendimin nr. 456 të datës 10.10.2025, Kryeinspektori i IMT, ka marrë vendimin për dënimin me gjobë në shumën prej 100,000 lekësh në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, i ndryshuar, bazuar në nenin 52 pika dh.
-Nga verifikimi i dosjes së subjektit u konstatua se nuk është mbajtur një akt konstatimi nga ana e Kryeinspektorit për konstatimin e kundërvajtjes.
-Mosveprim në kundërshtim me nenin 12, pika 5 të Ligjit për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit.
Për sa më sipër mban përgjegjësi Kryeinspektori i IMT, z. S. D..
-Me veprimin bankar të datës 24.10.2025 subjekti ka paguar gjobën në vlerën prej 100,000 lekësh.

Dosja e subjektit L. sh.p.k:
-Me Vendimin nr. 41 të datës 02.10.2023, Kryeinspektori i IMT, ka marrë vendimin për dënimin me gjobë në shumën prej 200,000 lekësh në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, i ndryshuar, bazuar në nenin 52 pika dh.
-Nga verifikimi i dosjes së subjektit u konstatua se nuk është mbajtur një akt konstatimi nga ana e Kryeinspektorit për konstatimin e kundërvajtjes.
-Mosveprim në kundërshtim me nenin 12, pika 5 të Ligjit për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit.
Për sa më sipër mban përgjegjësi Kryeinspektori i IMT, z. S. D..
-Me veprimin bankar të datës 02.11.2023, subjekti L. sh.p.k ka kryer pagesën në vlerën 200,000 lekësh sipas gjobës së vendosur.

Dosja e subjektit V. sh.p.k:

-Me Vendimin nr. 42 të datës 25.10.2023, Kryeinspektori i IMT, ka marrë vendimin për dënimin me gjobë në shumën prej 100,000 lekësh në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, i ndryshuar, bazuar në nenin 52 pika dh.
-Nga verifikimi i dosjes së subjektit u konstatua se nuk është mbajtur një akt konstatimi nga ana e Kryeinspektorit për konstatimin e kundërvajtjes.
-Mosveprim në kundërshtim me nenin 12, pika 5 të Ligjit për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit.
Për sa më sipër mban përgjegjësi Kryeinspektori i IMT, z. S. D..
-Me faturën e datës 30.10.2023, subjekti G. B. ka paguar gjobën prej 100,000 lekësh.

Dosja e subjektit L. L.:
-Me Vendimin nr. 43 të datës 26.10.2023, Kryeinspektori i IMT, ka marrë vendimin për dënimin me gjobë në shumën prej 100,000 lekësh në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, i ndryshuar, bazuar në nenin 52 pika dh.
-Nga verifikimi i dosjes së subjektit u konstatua se nuk është mbajtur një akt konstatimi nga ana e Kryeinspektorit për konstatimin e kundërvajtjes.
-Mosveprim në kundërshtim me nenin 12, pika 5 të Ligjit për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit.
Për sa më sipër mban përgjegjësi Kryeinspektori i IMT, z. S. D..
-Me veprimi bankar të datës 07.11.2023, subjekti L. L. ka paguar gjobën prej 100,000 lekësh.
Dosja e subjektit G. M.:
-Me Vendimin nr. 44 të datës 26.10.2023, Kryeinspektori i IMT, ka marrë vendimin për dënimin me gjobë në shumën prej 100,000 lekësh në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, i ndryshuar, bazuar në nenin 52 pika dh.
-Nga verifikimi i dosjes së subjektit u konstatua se nuk është mbajtur një akt konstatimi nga ana e Kryeinspektorit për konstatimin e kundërvajtjes.
-Mosveprim në kundërshtim me nenin 12, pika 5 të Ligjit për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit.
Për sa më sipër mban përgjegjësi Kryeinspektori i IMT, z. S. D..
-Me faturën e datës 01.11.2023, subjekti G. M. ka paguar gjobën prej 100,000 lekësh.

Pika 6.3 Auditim mbi procedurat e nndjekura nga IMT Bashkia MAT lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Njësia e IMT Bashkia Mat, nuk ka dokumentuar inspektimin e objekteve në ndërtim për të verifikuar zbatueshmërinë e kushteve të lejes së ndërtimit.
veprime dhe mosveprime në kundërshtim me nenin 5 gërma a të Ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme", pikën 2 të vendim nr. 894, datë 4.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të Kontrollit të Territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit" dhe ai i njësisë vendore.
-Për sa më sipër mban përgjegjësi Kryeinspektori i Bashkisë Mat, z. S. D..

7. Auditim mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Drejtoria e Mbrojtjes Civile dhe Pronave është pjesë e strukturës të Bashkisë Mat ku me VKB nr. 28, datë 25.08.2023, është miratuar numri i përgjithshëm i punonjësve, ku me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, ka dalë organigrama ku pjesë e strukturës së saj është dhe Specialisti i Pronave në varësi të shefit të Sektorit të Mbrojtjes Civile dhe Pronave, varësi e cila është dhe aktualisht. Ky pozicion nga muaji Dhjetor 2024 ka qenë vakant, vend i cili është plotësuar më datë 24.07.2024.

Në rregulloren e brendshme të administratës së bashkisë e miratuar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr.717 Prot., datë 24.11.2016 funksionale për vitin 2025, në nenin 58 dhe 59 përcaktohen detyrat përgjegjësitë për dokumentimin dhe përditësimin e të dhënave për asetet e Bashkisë Mat, mbikëqyrin gjithë procesin e inventarizimit në bazë të urdhrit të titullarit dhe arshivojnë gjithë inventarët, sigurojnë dokumentimin, inventarizimin dhe ruajtjen e mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit përkatës financiar kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar të inventarit kontabël të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese, përpilojnë fletët e inventarit të aktiveve të qëndrueshme sipas zyrave në Bashki, institucioneve të arsimit, çerdheve, gjendjes civile, ndriçimit rrugor dhe mbajnë kartelat për aktivet e qëndrueshme dhe inventarin e imët. Bashkia Mat, ka detyrimin ligjor që përpara konsolidimit të pasqyrës së pozicionit financiar, ndër të tjera, duhet të ketë të saktësuar zërat si: Pronat, tokat dhe pasuritë natyrore. Një pjesë e konsiderueshme e pronave dhe tokave, Bashkia Mat i ka fituar nëpërmjet akteve ligjore dhe nënligjore, shpronësimeve, si dhe një pjesë të tyre nga shkrirja e ish-komunave, aktualisht Njësi Administrative të Bashkisë Mat. Me qëllim pasqyrimin real dhe të drejtë të vlerës së pronave dhe tokave në pasqyrat financiare, nga Bashkia Mat duhet bërë inventarizimi i tyre, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve, vlerësimin monetar, si dhe krijimin e regjistrit kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia.

a. Në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Aparatit të Bashkisë Mat dhe Njësive Administrative Burrel, Komsi, Ulëz, Baz, Derjan-Rukaj gjatë vitit 2023 është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve për të cilën janë vlerësuar vetëm aktive të cilat janë kontabilizuar në pasqyrat financiare për aktivet të cilat janë transferuar në Bashkinë Mat dhe Njësitë Administrative Lis dhe Macukull nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të këtyre pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", neni 37, pika 1, ku përcaktohet që, "Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji".

Sa më sipër grupi i auditimit kërkoi regjistrin e pronave, tokave dhe pasurive natyrore të cilat janë në pronësi të Bashkisë Mat. Gjithashtu referuar rregullores së brendshme të Bashkisë Mat, në mënyrë të përgjithshme përcaktohen detyrat për inventarizimin, përditësimin, regjistrimin e pronave të të gjitha llojeve, për inventarizimin e pronave, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve dhe më pas regjistrimin në kadastër.

b. Nga auditimi i llogarisë 210 "Toka, troje, terrene", 211 "Pyje, plantacione", 212 "Ndërtesa e konstruksione", 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", 214 "Instalime teknike, makineri pajisje vegla pune", 215 "Mjete transporti" dhe 218 "Inventar ekonomik" konstatohet se nga Bashkia Mat disponohet një regjistër kontabël në formatin Excel, sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, konkretisht në të evidentohet datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia. Nuk është përmbushur detyrimi ligjor për krijimin e një regjistri fizik në zbatim të Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26-30 si dhe pronat e transferuara me VKM-të për llogaritë 210,211,212 dhe 213 nuk janë të evidentuara në regjistrat të cilat Bashkia Mat i mban në programin Excel.

Asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë Mat dhe Njësive Administrative që përmbledh kjo bashki nuk janë inventarizuar të gjitha, si dhe nuk janë marrë në dorëzim me procesverbale.

Dokumentacioni dhe të dhënat përkatëse në lidhje me asetet e Bashkisë janë vënë në dispozicion me shkresa zyrtare nëpërmjet VKM-ve përkatëse, si më poshtë:

c) Me vendimit përkatëse janë transferuar pranë Bashkisë Mat 2,848 prona si ndërtesa, pyje, kullota toka, terrene, infrastrukturë etj. Nga 2,848 prona në total, të certifikuara kemi 75 prona. Të ndara si më poshtë:

Njësia Administrative Burrel.

Me VKM-në Nr. 771 datë 14.11.2007 janë transferuar 419 Prona nga këto 57 janë të certifikuara. Me VKM- në Nr. 408 datë 15.06.2022 është transferuar 1 (një) pronë me Nr 2/26 dhe pasuria me numër 2/306.Me VKM-në 806 datë 12.12.2022 është transferuar prona 717 me emërtim "Shtëpia e Ushtarakëve" në zonën kadastrale 1326. Në pronësi janë 386 prona dhe 34 prona janë në përdorim. Duke qenë se Bashkia Mat po bën përditësimin e inventarin e pronave rezulton se ka 386 prona në pronësi ky numër nuk është i saktë pasi shumica e pronave janë privatizuar nga qytetarët ndër vite. Pasi kjo VKM është e vitit 2007 dhe nga kjo periudhe deri më sot ka pësuar ndryshim.

Njësia Administrative Komsi.

Me VKM nr.698 datë 16.08.2013 janë transferuar 921 prona nga këto 7 janë të certifikuara. Në pronësi janë 877 prona dhe 44 prona janë në përdorim. Duke qenë se Bashkia Mat po bën përditësimin e inventarin e pronave rezulton se ka 877 prona në pronësi ky numër nuk është i saktë pasi shumica e pronave janë privatizuar nga qytetarët ndër vite. Pasi kjo VKM është e vitit 2013 dhe nga kjo periudhe deri më sot ka pësuar ndryshim.

Njësia Administrative Ulez.

Me VKM nr.726 datë 01.07.2019 janë transferuar 427 prona (në pronësi) nga këto 6 janë të certifikuara.

Njësia Administrative Rukaj

Me VKM nr.886 datë 11.06.2008 janë transferuar 45 prona (në pronësi) nga këto 5 janë të certifikuara.

Njësia Administrative Baz

Me VKM nr.903 datë 11.06.2008 janë transferuar 145 prona (në pronësi) nga këto 0 janë të certifikuara.

Njësia Administrative Dërjan

Me VKM nr.799 datë 04.06.2008 janë transferuar 55 prona (në pronësi) nga këto 0 janë të certifikuara.

Njësia Administartive Lis

Me VKM nr.4 datë 04.01.2008 janë transferuar 372 prona (në pronësi) nga këto 0 janë të certifikuara.(Ku lista e pronave ka ardhur në bashkinë Mat me shkresen me nr.5071 Prot me datë 15.11.2023). Me Vkm-nr.376 datë 27.03.2008 janë transferuar 131 prona.

Njësia Administrative Macukull

Me VKM nr.724 datë 01.07.2009 janë transferuar 463 prona (në pronësi) nga këto 0 janë të certifikuara.

Me VKM nr.1108 datë 30.12.2015 për transferimin nga Ministria e Bujqësise dhe Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave te bashkitë të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit të personelit dhe aseteve te luajtshme dhe të paluajtshme, të bordeve rajonale të kullimit. Janë transferuar 56 prona të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit. Me Vkm nr.433 datë 08.06.2016 për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike Bashkia Mat ka në pronësi 1752 prona, të cilat Administrohen nga Drejtoria e Pyjeve dhe Bujqësisë.

Tabela nr.1 Transferimet me VKM të pronave.

Nr.	Nj.A	VKM		Në pronësi Në numër	Në përdorim Në numër	Çertifikuar	Inventarizuar	Vlerësuar	Kontabilizuar
		Numër	Datë						
1	Bashkia Mat	771	14.11.2007	386	34	57	273	273	273
2		408	15.06.2022						
3		806	12,12.2022						

Nr.	Nj.A	VKM		Në pronësi Në numër	Në përdorim Në numër	Çertifikuar	Inventarizuar	Vlerësuar	Kontabilizuar
		Numër	Datë						
4	NJA Komsi	698	16.08.2013	877	44	7			
5	NJA Ulëz	726	01.07.2019	427	-	6			
6	NJA Rukaj	886	11.06.2008	45	-	5			
7	NJA Baz	903	11.06.2008	145	-	-			
8	NJA Derjan	799	04.06.2008	55	-	-			
9	NJA Lis	4	04.01.2008	372	-	-			
10	NJA Macukull	724	01.07.2009	463	-	-			
	Total			**2,770**	**78**	**75**	**273**	**273**	**273**

Burimi: Bashkia Mat

Inventarët e pronave të paluajtshme të miratuara me VKM përgjatë viteve, dhe VKM për njësitë e tjera administrative nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Mat nuk është rakorduar me Drejtorinë Vendore të ASHK-së Mat, mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm që kanë pësuar këto pasuri, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore.

Në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26-30 konstatohet se nga strukturat përgjegjëse nuk janë ngritur grupet e punës apo ndërmarrë masa konkrete për ndjekjen e procedurës së inventarit të pasurive të paluajtshme sipas VKM respektive.

Konstatohet se, edhe në vitin 2023 nuk është marrë ndonjë masë apo procedurë ose ngritur një grup pune që do të ndjekë zbatimin e këtyre VKM si edhe regjistrimin e pronave në ASHK.

Si konkluzion: Me VKM-të përkatëse janë transferuar në total 2,848 pasuri si ndërtesa, pyje, kullota, toka, terrene etj., nga të cilat 75 pasuri të certifikuara dhe 78 pasuri në përdorim.

Për sa trajtuar më sipër nga Bashkia Mat nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" Kreu IV neni 37 pika 1, 2. germa a, b, Ligjin nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", nenet 35-41, VKM nr. 510, datë 10.06.2015, "Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme", Kreu (VI) "Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme" dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26-30.

Bazuar VKM-në 433, datë 08.06.2016

"Për transferimin në pronësi të bashkive të pyje dhe kullota publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave e Bashkive*"*, këto janë sipërfaqet pyjore dhe kullosore në pronësi të Bashkisë Mat:

-Sipërfaqe totale: **35,160 ha**

*E ndarë sipas formës së qeverisjes nga këto**:**

-Trungishte = **10,055.67 ha**

-Cungishte = **14,874.71 ha**

-Shkurre = **2,748.83 ha**

-Kullota =**2,999.03 ha**

-Bimësi pyjor =**1,333.58 ha**

-Djerr = **254.1 ha**

-Inproduktive = **28,88.88 ha**

-Ujore = **5.1ha**

Në territorin e Bashkisë Mat ndodhen Parku natyror Ulëz, Shkopet dhe Parku kombëtar Lurë-Mali i Dejës me sipërfaqe prej **5,448.26 ha.**

Bashkia Mat administron një sipërfaqe te fondit pyjor e kullosor prej **29,711.74 ha**, të ndara:

-Pyje = **23,540.94 ha**

-Bimësi pyjore = **1,085.13 ha**
-Djerrë = **61.36 ha**
-Inproduktive = **2,419.52 ha**
-Kullota = **2,602.52 ha**
-Ujore = **2.7 ha.**
Në aneksin 2/4/1 bashkëlidhur raportit të auditimit paraqitet tabela me listën e pronave të regjistruara sipas objekteve dhe certifikatës së pronësisë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:
1.Z. A. G., me detyrë Drejtor i d=Drejtorisë i Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës
2.Z.N. S. me detyrë ish Drejtor i Sektorit të Mbrojtjes Civile dhe Pronave.

8 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.
8.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.
8.2. Realizimi programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.
8.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Për sa më poshtë në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit", Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me vendimin nr. XXX., datë 09.08.2025 i ka dërguar Bashkinë Mat, "Raportin përfundimtar", për përmirësimin e gjendjes, janë rekomanduar zbatimin e masave të mëposhtme:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

-Me shkresën me nr. 3701 prot datë 16.10.2025, Kryetari i komanduar i Bashkisë Mat, z. M. Z. ka ngritur grupin e punës për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Raporti i Audimit Financiar të ushtruar në Bashkinë Mat, administruar pranë këtij institucioni me shkresën me nr. 463/7 prot datë 03.10.2025, me përbërje si vijon: E. R., D. T., G. P., E. A., A. G., S. C., M. L., E. H., N. S., A. H.
-Me shkresën me nr 3752 prot datë 21.10.2025, Bashkia Mat ka dërguar shkresën në adresë të KLSH, për të raportuar mbi masat e marra në kuadrim e zbatimit të rekomandimeve
-Me shkrësën me nr. 4778 prot datë 31.12.2025 është hartuar plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH
-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u kosntatua se Bashkia Mat nuk ka dërguar në adresë të KLSH-së raportin e zbatimit të rekomandimeve nga ana e Bashkisë, brenda afatit 6-mujor të parashikuar në ligjin organik të KLSH-së. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën nr. 2, neni 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", e cila citon: "*Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*".
-Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi grupi i punës i ngarkuar nga titullari i institucioni me përbërje si vijon: E. R., D. T., G. P., E. A., A. G., S. C., M. L., E. H., N. S., A. H..

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 16 masa organizative
Nga auditimi rezulton se:
-Nga 16 Masa Organizative të rekomanduara, janë pranuar plotësisht për zbatim 16 masa, janë zbatuar 2 masa, janë në proces zbatimit 10 masa, janë zbatuar pjesërisht 2 masa dhe nuk janë zbatuar 2 masa.

Në mënyrë të detajuar po i paraqesim më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse për menaxhimin financiar dhe kontrollin të marrin masa për hartimin dhe miratimin e procedurave të brendshme për etikën dhe sinjalizimin, të hartojë një plan rekrutimi bazuar në nevojat reale dhe të sigurojë zbatimin e procedurave të hapura konkurruese për punësimet. Gjithashtu, të planifikojë dhe realizojë trajnime të brendshme në funksion të rritjes së kapaciteteve të stafit administrativ.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i subjektit: Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion për grupin e audtimit, subjekti pretendon se ka hartuar planin vjetor të rekrutimit, konkretisht me shkresën me nr. Me shkresën me nr. 611 prot datë 13.02.2025. Për sa i përket rregullave të etikës, subjekti pretendon se është trajtuar në Rregulloren e Bashkisë Mat. Për sa i përket procedurave të rekrutimit, subjekti pretendon se rekrutimi në shërbimin civil për Bashkinë mat, zhvillohet sipas një Plani Vjetor të Rekrutimit, të hartuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe miratuar nga titullari i institucionit. Për sa i përket hartimin dhe realizimit të trajnimeve të brendshme, subjekti pretendon se ka bashkëpunuar me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike për realizimin e trajnimit të personelit të Bashkisë Mat.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstauta se se Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk ka hartuar një plan trajnimesh të brendshme e për rrjedhojë nuk ka kryer trajnime me qëlllim aftësimin punonjësve të Bashkisë Mat. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë pjesërisht i zbatuar.

2.1. Rekomandimi: Bashkia Mat nëpërmjet njësisë së Auditit të Brendshëm të marrë masa për zbatimin të planit vjetor të auditimit dhe fokusimi në fushat me risk të lartë, dhënia e opinionit të përgjithshëm në raportet e auditimit, krijimin dhe mirëmbajtjen e dosjeve të përhershme për çdo njësi të audituar, ndjekjen dhe përfundimin me sukses të procesit të certifikimit për të gjithë audituesit e Njësisë së Auditimit të Brendshëm. Të përmirësohet cilësia e raporteve të auditimit, të formulohen rekomandime të qarta, të matshme dhe me afatë konkretë për zbatimin e tyre, në mënyrë që njësitë të orientohen drejt përmirësimit real të gjendjes së konstatuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

-Nga verifikimi i i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se subjekti nuk ka marrë masa për zbatimin e rekomandimit lidhur me veprimtarinë dhe funksionimin e NJAB Bashkia Mat. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

3.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Kontratave të marrë masa për sistemimin e veprimeve kontabël sipas llogarive përkatëse me qëllim paraqitjen sa më të drejtë të investimeve në proces dhe burimeve të investimeve që i përkasin njësisë për periudhën ushtrimore. Gjithashtu për diferencën e konstatuar prej 7,038,001 lekë të bëhet evidentimi dhe të kryhen sistemimet përkatëse në llogaritë kontabël të njësisë me qëllim paraqitjen e sakte të pozicionit financiar të llogarisë 231 "Për aktive afatgjata materiale" dhe llogarive të klasës 2, duke bërë që llogaritë e aktiveve afatgjata materiale të paraqiten në vlera të drejta dhe të rakorduar sipas kërkesave të teknikave kontabël.*

Menjëherë

Qëndrimi i subjektit: Ne lidhje me rekomandimin e mesiperm për shumën prej 2,797,509 lekë nga organizata ndërkombëtare për projektë që janë në proces,ato janë fonde të perfituara nga projektë të huaja por jo domosdoshmërisht për shpenzime kapitale dhe nuk janë shpenzuar por janë mbartur në vitin pasardhës dhe si të tilla nuk mund ti përfshijmë në llogarinë kundërparti 106 "Teprica e granteve kapitale të huaja"., gjithashtu në lidhje me konstatimin qe shtesat gjatë vitit 2024 kanë qenë në shumën 653,127,346 lekë dhe pakësimet në shumën 1,332,806,182 lekë, pakësime të cilat i përkasin mallrave, projekteve dhe punimeve të marra në dorëzim të cilat janë kapitalizuar në llogaritë e klasës 2 në shumën 1,325,768,181 lekë sipas pasqyrës "Gjendja dhe

ndryshimet e aktiveve afatgjata". Pra veprimet kontabël në kredi të llogarisë 231"Për aktive afatgjata materiale" nuk rakordojnë me veprimet në debi pas kapitalizimeve me një diferencë në shumën 7,038,001 lekë.Ju sqarojmë që diferenca prej 2,459,203 leke janë materiale të cilat janë përfshiurë në bilancin e viti 2023 pasi janë bërë hyrje në vitin 2023 por është bërë likujdimi në v itin 2024 ndërsa shuma prej 4,578,798 lekë është përfshirë në pasqyrën 7/a gabimisht në kollonën shtesa pa pagesë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se rekomandimi i mësipërm rezulton të jetë në proces zbatimi.

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Kontratave të marrë masa për kryerjen e sistemimeve të nevojshme të detyrimeve të prapambetura dhe regjistrimin e tyre në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, për një pasqyrim më të drejtë të pozicionit financiar, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

Menjëherë

Qëndrimi i subjektit: Ne lidhje me rekomandimin e mesiperm në pasqyrat financiare të viti 2025 është bërë sistemimi sipas rekomandimit duke paraqitur shumën për detyrime për vendime gjyqësorë në llogarinë 467 për shumën 3,249,210 lekë (zbatuar)

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se ky rekomandim rezulton të jetë zbatuar nga njësitë e menaxhimit të Bashkisë Mat, bazuar edhe në pasqyrat financiare të vitit 2025. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë i zbatuar.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Kontratave të marrë masa për kryerjen e sistemimeve të nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, për një pasqyrim më të drejtë të pasqyrës së fondeve neto, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

Menjëherë

Qëndrimi i subjektit: Ne lidhje me rekomandimin e mesiperm në pasqyrat financiare të viti 2025 është bërë sistemimi sipas rekomandimit duke paraqitur shumën për pakësime e cila në bilancin e vitit 2024 ka qenë e paraqitur në rreshtin 85 rezultat i vitit ushtrimor në shumën -1,401,605,282 lekë në bilancin e vitit 2025 është paraqitur në rreshtin 1016 1059 ne kollonën fonde të tjera të veta në shumën 445,735,313 lekë (zbatuar)

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar audititmit të pasqyrave financiare të vitit 2025, pasaktësitë e mësipërme janë korrigjuar dhe këto llogari janë të sakta. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë i zbatuar

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Kontratave të marrë masat e nevojshme për kryerjen e regjistrimeve kontabël dhe rakordimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për investime me qëllim pasqyrimin sa më të sakte në pasqyrat financiare.

Menjëherë

Qëndrimi i subjektit: *Në lidhje me rekomandimin e mësipërm ky konstatim nuk qëndron pasi diferenca prej 2,640,774 lekë e cila i përket një investimi të kryer me fonde të akorduara nga AKMC në llogarinë 604 pavaresisht natyrës së shpenzimit nëse është shpenzime korentë apo shpenzime kapitale ato i kane celur fondet në llogarinë 604 ..shuma e paraqitur prej 650,486,572 lekë është e sakte pasi në këtë rresht janë paraqitur të gjitha shpenzimet e llogarise 231 , ndërsa në pasqyrën statistikore shuma prej 653,127,346 lekë ka të përfshirë edhe Investimet e celuara nga AKMC të cilat celen në Degën e Thesarit në llogarinë 604 transferime korente pasi ato në vetvetë janë investime dhe në bilancin e vitit janë paraqitur në llogaritë e klasës 2 Aktive Afatgjata sipas listës më poshtë:*

Rehabilitim i segmentit te rruges fshati Shqefen dhe Ura German	123,787
Ndertim bazamenti urembajtes ne fshatin Stojan , muri prites fshati Bater e Vogel dhe muri mbajtes German	2,448,000

Mbikeqyrje Ndertim bazamenti urembajtes ne fshatin Stojan , muri prites fshati Bater e Vogel dhe muri mbajtes German	59,989
Kolaudimm Ndertim bazamenti urembajtes ne fshatin Stojan , muri prites fshati Bater e Vogel dhe muri mbajtes German	8,998
shuma	**2,640,774**

Pas konsultimit qëe patëm me Ministrinë e Financave ato e kanë zgjidhur këtë problem duke i akorduar fondet e AKMC sipas nevojave të Bashkisë ne 604 ose 231

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë në proces zbatimi.

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Kontratave të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, për një pasqyrim më të drejtë të pasqyrës së investimeve dhe burimeve të investimeve me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

Menjëherë

Qëndrimi i subjektit: *Në lidhje me rekomandimin e mësipërm ky konstatim nuk qëndron pasi diferenca prej* 15,672,923 lekë që pretendohet janë fondet e trashëguara nga viti paraardhës të cilat paraqiten në rreshtin 33 teprica në fillim të vitit ushtrimor periudha raportuese.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë në proces zbatimi.

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Kontratave të marrë masa për kryerjen e sistemimeve dhe regjistrimeve në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, për një pasqyrim më të drejtë të rezultatit të periudhës ushtrimore, me qëllim që të parandalohen parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

Menjëherë

Qëndrimi i subjektit: *Në lidhje me rekomandimin e mësipërm për shumën e paraqitur në rubrikën III "Transferta të tjera" kjo shumë përbën fonde që nuk trashëgohen në vitin pasardhës me burim financimi fondet e deleguara që nuk janë me grup 00 kryesisht fonde nga Ministritë e linjës për investime dhe shpenzime të tjera korente dhe bazuar në udhëzimin nr 08 datë 09.03.2018 "Për mbylljen e pasqyrave financiare vjetore" pika 15 c ku thuhet që c) Në fund të vitit ushtrimor, për fondet buxhetore (për shpenzime korrentë dhe kapitale), të papërdorura gjatë vitit ushtrimor, bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:*

- Debitohet, për mbyllje, llogaria 476, "Të ardhura të caktuara për t'u përdorur"; dhe
- Kreditohet llogaria 520, "Disponibilitetë në thesar".

Për sa më sipër teprica e paraqitur e llogarise 85 "Rezultati i veprimtarise së vitit ushtrimor" në mbyllje të vitit 2024 në shumën 98,580,391 lekë është e sakte kjo bazuar edhe në akt rakordimin e mbajtur me Degën e Thesarit Mat në fund të viti ushtrimor 2024.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë në proces zbatimi.

9.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit të Mjedisit dhe Pronës si dhe Drejtorinë e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Kontratave të marrë masa për identifikimin e gjendjes së aseteve të mbetura pa regjistruar të cilat i janë transferuar në pronësi në mënyrë përfundimtare. Të kryhet përgatitja e dokumentacionit tekniko ligjor për pasuritë e paluajtshme (AAGJM) të transferuara dhe të evidentuara në pasqyrat financiare, për të vijuar me aplikimet përkatëse në ASHK për pajisje me certifikatë pronësie. Më pas të vijohet me vlerësimin dhe kontabilizimin e aseteve (aktiveve) të pa vlerësuara, në mënyrë që kjo njësi vendore, këto aktive ti zotërojë e të sigurojë njohjen në kontabilitet mbi bazën e dokumenteve ligjorë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë në proces zbatimi.

10.1. Rekomandim: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit*", për përmirësimin e gjendjes, Ju

rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshpejtimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

Nga verifikimi rezulton se për sa më sipër statusi i rekomandimeve të lëna sipas RPA përcjellje me shkresën, ka ndryshuar për efekt kohor. Problematika e të ardhurave të munguara është trajtuar në akt konstatimin përkatës.

A. Masat Organizative

1.1. Rekomandimi: *Bashkia Mat dhe Drejtoria e Shërbimeve të marrë masat:*

- Për mbajtjen e dokumentacionit të munguar të pastrimit, mbajtjen e akt rakordimeve të mjetit teknologjik dhe mjeteve të tjera të pastrimit duke krahasuar kilometrat e përshkuara sipas fletë-udhëtimeve me kilometrat sipas panelit të kontrollit të mjetit.

- Të sigurohet mbikëqyrje dhe informacion mujor periodik, për mirëmbajtjen e varrezave.

- Të marrë masa për mbulimin e shpenzimeve të pastrimit nga tarifa e pastrimit, e cila destinohet për këtë shërbim.

2.1. Rekomandimi: *Bashkia Mat dhe Drejtoria e Shërbimeve të marrë masat:*

-Për plotësimin e fletë-udhëtimeve me gjithë të dhënat që kërkohen në bazë distancave të miratuara nga DPSHTRR dhe nga KQ për distancat e rrugëve jashtme dhe te brendshme.

-Për hartimin dhe miratimin në Këshillin Bashkiak të normave mujore të karburantit për çdo makinë.

-Për vlerësimin e gjendjes teknike-xhenerike të automjeteve nëse janë rentabël ose jo, pasi janë te amortizuara sidomos mjetet e ardhura nga ish-komunat sot njësite administrative.

4.3. Rekomandimi: *Sektori i infrastrukturës së Drejtorisë së Shërbimeve Bashkiake të marrin masa për pajisjen me leje të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure me afatin e përcaktuar në kuadrin ligjor për këtë lloj aktiviteti; të analizojë situatën e krijuar me 2 subjektet e bllokuara, me qëllim që në periudhat e ardhshme të arkëtohen detyrimet brenda afatit ligjor, arkëtimin e atyre të prapambetura për të parandaluar krijimin e detyrimeve të reja*

Është trajtuar në akt konstatimin ....

6.1. Rekomandimi: *Drejtoria Ekonomike të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 "Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar" për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm*

7.1.Rekomandimi: *Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, të marrë masa për të njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.*

8.1.Rekomandimi: *Drejtoria Ekonomike, Bashkia Mat të kryejë kontabilizimet në klasat e aktivit në përputhje më legjislacionin për të pasur informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.*

11.1.Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Mat të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llogarit 210 "Toka, Troje, Terrene" dhe 211 "Pyje, Plantacione" dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.*

12.1.Rekomandimi: *Bashkia Mat të marrë masa për të krijuar një sektor të posaçëm për kadastrën, si pjesë të strukturës organike, me qëllim realizimin e detyrave për hartimin dhe përditësimin e inventarëve të pasurive të paluajtshme të bashkisë, përfshirë ish-komunat, aktualisht njësi administrative. Të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përllogarisë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.*

13.1.Rekomandimi: *Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me DTTV Bashkia Mat të marrin masa për rakordimin e debitorëve sipas drejtorive dhe regjistrimin e tyre në kontabilitet dhe regjistrat e llogarive të DTTV*

B.1. <u>Masa për elimimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, me efekt mungesë të ardhurash</u>*.*

1.1 Rekomandimi*: Sektori i Taksa dhe Tarifa Vendore në bashkëpunim me drejtoritë e tjerë të Bashkisë Mat të marrin masat administrative e ligjore duke ndjekur të gjitha rrugët për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve në vlerën 50,486,470 lekë për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit që mund të krijohet nga mos ndjekja e tyre.*

2.1. Rekomandimi*: Drejtoria e Shërbimeve Bashkiake dhe Sektori i Infrastrukturës në bashkëpunim me STTV dhe Sektorin Juridik të analizojnë situatën specifike të subjektit "M."dhe marrin masa për të llogaritur saktë detyrimin ndaj tij për ushtrim të aktivitetit në kundërshtim me kuadrin ligjor si dhe kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës 1,200,000 lekë të 2 subjekteve debitore, për rritjen e të ardhurave në buxhetin e Bashkisë Mat.**.**

3.1. Rekomandimi: *Sektori i Taksa e Tarifave Vendore, Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Policinë Bashkiake të marrin masa për të mundësuar kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës progresive 2,201,000 lekë për 2,927 debitorë si dhe për parandalimin e krijimit të debitorëve të rinj, për të bërë të mundur arkëtimin nga kundërvajtësit brenda afateve ligjore vlerën e gjobave të vendosura.*

4.1. Rekomandimi*: Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjeve në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike të marrin masa për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit ndaj 13 subjekteve në vlerën progresive të debisë 9,555,857 lekë.*

D. Masa disiplinore

Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, t'i kërkojë komisionit disiplinor fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore si më poshtë:

a)Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet.

1. Z.E. R. me detyrë Drejtori i Shërbimeve Bashkia Mat.

2. Znj. M. L. me detyrë Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve.

3. Znj. L. K. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit Pastrimit Mbetjeve Urbane Bashkia Mat.

Menjëherë

B. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE

<u>1.1. Rekomandimi</u>: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët dhe në vijim të ndjekë të gjitha rrugët ligjore në rend shterues, për arkëtimin e detyrimeve debitore në shumën **64,245,273 lekë** nga subjektet e biznesit dhe institucionet.

Komenti i subjektit: *Drejtoria e Taksave Vendore ka nxjerrë njoftimet vlerësimet dhe bashkangjitur faturat për të gjithë subjektet debitore. Njoftim vlerësimet me Nr.660,datë 17.02.2025 për biznesin vip, Nr.749 Prot, datë 26.02.2025 për biznesin e madh, Nr.811 Prot për biznesin e vogël, Nr.1057 Prot, datë 21.03.2025.Si masë shtrënguese janë dërguar dhe urdhër bllokimet bankare me Nr.3760 Prot, datë 22.10.2025, Nr.3759 Prot, datë 22.10.2025, Nr.3758 Prot, datë 22.10.2025 si dhe janë bërë dhe disa urdhër sekuestro për disa subjekte që bankat kanë kthyer përgjigje që kanë gjendje në llogari vlerën që i detyrohen bashkisë; me Nr.4469 Prot, datë 15.12.2025, Nr.4614 Prot, datë 23.12.2025. Ka patur arkëtime në vlerën 12,225,092 lekë nga subjektet biznes vip, i madh ,vip dhe shoqëri sigurimesh, ndërsa nga institucione nuk ka patur arkëtime .*

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë në proces zbatimi.

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me administratorët e njësive administrative të krijojnë një regjistër të plotë të taksapaguesve familjarë, duke evidentuar detyrimet dhe debitë e tyre, duke i pasqyruar dhe në kontabilitet. Të ndiqen të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve në shumën 45,353,162 lekë të taksapaguesve familjarë.

Komenti i subjektit: Punonjësit e Taksave Vendore bashkë me administratorët në Njësitë Administrative kanë krijuar regjistrat e plotë të taksapaguesve për çdo njësi Administrative duke i evidentuar kryefamiljarët me gjendje civile duke bashkëpunuar me Zyrat e Gjendjes Civile në Njësitë Administrative. Kanë shpërndarë Njoftim detyrimet dhe faturat dhe ka patur arkëtime sipas Njësive; Njësia Administrative Rukaj 348,575 lekë, Komsi 480,827 lekë, Baz 105,101 lekë, Macukull-Derjan 220,633 lekë, Lis 408,017 lekë, Ulëz 100,652 lekë. Për Njësinë Administrative Burrel ka patur arkëtime në vlerën 2,436,267 lekë. Regjistri i taksapaguesve për Njësinë Administrative Burrel nuk është përfunduar akoma i sakte duke evidentuar kryefamiljarët me Gjendje civile, jemi në proces dhe për këtë arsye debitorët familjarë nuk janë kontabilizuar, pasi në Njësinë Administrative Burrel ka emigrantë të cilët janë të përjashtuar me paketë fiskale dhe jemi në proces identifikimi, ka kryefamiljarë të larguar me gjendje civile dhe akoma maturohen pasi mungon informacioni nga ana Gjendjes Civile.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë në proces zbatimi.

2.1. Rekomandimi: Bashkia Mat nëpërmjet Drejtorisë së Taksave e Tarifave Vendore dhe Drejtorisë së Financës të marrin masa që për taksën e ndikimit në infrastrukturë të kryhen veprimet për kontabilizimin e detyrimeve debitore sipas listave me vlerat e taksës të llogaritur. Gjithashtu të zbatohen të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit në shumën 3,768,709 lekë.

Komenti i subjektit: Nga ana e Drejtorisë së Taksave Vendore është nisur shkresa me **Nr.847 Prot,datë 03.03.2026** Drejtorisë së Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Kontratave me debitorët nga Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë dhe Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Kontratave i ka kontabilizuar. Arkëtime gjatë vitit 2025 nga debia deri 31.12.2024 në vlerën 500,000 lekë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë në proces zbatimi.

Menjëherë

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrin masa që të kontabilizohen detyrimet e konstatuara për tarifën e autorizim/licencës të tregtimit të karburanteve. Gjithashtu të zbatohen të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin nga 2 subjektet debitore të vlerës 600,000 lekë.

Komenti i subjektit: *Drejtoria e Taksave Vendore i ka dërguar me shkresë me Nr.847 Prot, datë 03.03.2026 Drejtorisë së Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Kontratave debitorët e subjekteve hidrokarbure dhe i ka kontabilizuar. Detyrimin deri 31.12.2024 J. e ka shlyer në vlerën 200,000 lekë ndërsa P. Shpk gjysmën e detyrimit në vlerën 200,000 lekë.*

Menjëherë

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se ky rekomadim rezulton të jetë pjesërisht i zbatuar.

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjeve në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Financës të marrin masa për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit ndaj 13 subjekteve në vlerën progresive të debisë 8,119,085 lekë.

Komenti i subjektit:*Nga ana e Drejtorisë së Taksave Vendore është nisur shkresa me* ***Nr.847 Prot,datë 03.03.2026*** *Drejtorisë së Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Kontratave me debitorët nga kontrata qiraje për dhënie me qira të parcelave nga fondi pyjor/kullosor dhe Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Kontratave i ka kontabilizuar.*
Nga debia 31.12.2024 gjatë vitit 2025 janë arkëtuar 4,064,610 lekë*, konkretisht subjektet A. SHPK dhe D. SHPK. Njoftimet janë bërë për të gjithë subjektet debitore.*
Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë në proces zbatimi.

Menjëherë

D. <u>MASA DISIPLINORE</u>

Mbështetur në nenin 15 "*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së"*, shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", nenin 58 "*Llojet e masave disiplinore*", të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*", **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Mat, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, t'i kërkojë Komisionit Disiplinor të ngritur pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore si më poshtë:

a -"<u>Vërejtje" neni 58 shkronja (a), për 2 punonjës, si më poshtë</u>:

1. **Znj. D. T.** me detyrë me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Kontratave,

2. Z. S. C., me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Taksave.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se rekomandimi i mësipërm nuk është zbatuar.

Për sa më sipër, veprime dhe mosveprimet janë në mospërputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së" dhe neni 30 "Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit", për të cilat mbahet ky akt verifikim me përfaqësues të Bashkia Mat.

IV GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i funksionimit të sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Bashkinë Mat u konstatua se mjedisi i kontrollit dhe organizimi i administrimit të brendshëm nuk janë ngritur dhe nuk funksionojnë në përputhje të plotë me kërkesat e kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi, konkretisht:
Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk ka hartuar një plan të brendshëm trajnimesh për aftësimin profesional të stafit; në dosjet e personelit të verifikuara janë konstatuar mangësi dokumentare në kundërshtim me legjislacionin për nëpunësin civil dhe rregullat për administrimin e burimeve njerëzore; si dhe në përbërjen dhe veprimtarinë e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS). Nuk është hartuar dhe miratuar Plani i Strategjisë së Zhvillimi. Gjithashtu, rezultoi se nuk është miratuar gjurma e auditit të brendshëm, nuk është përditësuar Rregullorja e Bashkisë në përputhje me strukturën e re organizative, si dhe mungon plani strategjik i zhvillimit 5-vjeçar i institucionit.

Në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore, rezulton se për punonjësit që kanë plotësuar kushtet për pension nuk janë iniciuar ose nuk janë zbatuar në kohë procedurat për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, duke sjellë raste të vijimit të marrëdhënieve të punës edhe pas plotësimit të moshës së pensionit dhe moszbatim të urdhrave të nxjerrë. Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore". nen 32, VKM Nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit të regjistrit qendror të personelit", pika 3, kreu II, Udhëzimi i MFE nr. 16 datë 20.07.2016, pika 3.2.2, pika 2.2.4, Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, paragrafi 3.1, Kreu II kap. 2.2.6, aneksi nr. 2. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1.1, faqe 11-22, të Raportit të Auditimit*).

1.1.Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, në bashkëpunim me strukturat përkatëse, të hartojë dhe miratojë një plan të brendshëm vjetor trajnimesh për ngritjen profesionale të stafit, si dhe të kryejë menjëherë verifikimin dhe plotësimin e dosjeve të personelit në përputhje me kërkesat e legjislacionit për nëpunësin civil, duke garantuar administrim të plotë dhe të saktë të dokumentacionit.

1.2.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa për përmirësimin e funksionimit të mekanizmave të brendshëm të qeverisjes institucionale, përmes përfshirjes së plotë të anëtarëve të parashikuar në GMS dhe dokumentimit të rregullt të veprimtarisë së tij, miratimit të gjurmës së auditit të brendshëm, përditësimit të rregullores së institucionit dhe hartimit të planit strategjik 5-vjeçar, si dhe të sigurohet zbatimi i menjëhershëm i procedurave ligjore për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për punonjësit që kanë plotësuar kushtet për pension.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Mat rezulton se:

- Audituesit e NjAB nuk janë të certifikuar si "Audit i Brendshëm" si dhe NjAB Bashkia Mat nuk ka bërë analizën e kapaciteteve profesionale audituese dhe hapat që do të ndërmarrë njësia për të mënjanuar këto probleme;
- Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit;
- Nuk janë kryer auditime në fushat të cilat vlerësohen me risk të lartë;
- Dosjet e auditimit nuk janë të plotësuara me dokumentacionin e nevojshëm sipas kërkesave ligjore;
- Nuk është siguruar arkivimi i dosjeve të auditimit dhe nuk janë hapur dosje të përhershme për njësitë e menaxhimit, duke reflektuar dobësi në organizimin, dokumentimin dhe zbatimin e funksionit të auditit të brendshëm. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016, të MF "Për miratimin e Manualit të AB në sektorin publik" i ndryshuar me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020, kapitulli VI, pika 4.1.1. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1.1, faqe 11-22, të Raportit të Auditimit*).

2.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat, në bashkëpunim me Drejtuesin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm, të marrë masa për forcimin e funksionimit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm duke siguruar plotësimin e strukturës si dhe bazuar në vlerësimin e riskut, të kryej auditime duke përfshirë në mënyrë prioritare fushat me risk të lartë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i faturave të palikuiduara rezulton se, detyrimet e papaguara në fund të vitit 2025 sipas raportit të vetëvlerësimit të situatës së gjendjes financiare paraqiten në shumën 57,837,650 lekë, e cila përbëhet nga detyrime për shpenzime për investime në shumën 53,532,284 lekë, detyrime për shpenzime për vendimeve gjyqësore në shumën 3,249,210 lekë dhe detyrime për shpenzime mallra e shërbime në shumën 1,056,156 lekë. Mos shlyerja e detyrimeve ndaj të tretëve është në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, nenet 5/c, 40/h, me

Udhëzimin e MFE nr. 09, datë 20.07.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të e buxhetit" i ndryshuar, pikat 48/i, 58,130, me Udhëzimin e MF nr.22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore" shtojca 4 germa (c), me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", pikat 82-91. (*Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1), faqe (29-39), të Raportit të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Monitorimit të Kontratave, Bashkia Mat të marrë masa që me miratimin e fondeve buxhetore të hartojë plane të detajuara për financimin e detyrimeve të prapambetura dhe për likuidimin e tyre si dhe të raportojë periodikisht në MFE vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të taksës së tokës konstatohet se për vitin 2025 është realizuar në shumën 692,831 lekë nga 1,600,000 lekë të planifikuara, ose në masën 43% kundrejt planit. Referuar të dhënave mbi fondin e tokës bujqësore të ndarë sipas Njësive Administrative dhe kategorisë së tokës dhe përcaktimeve të paketës fiskale sipas kategorive nga përllogaritjet rezulton se planifikimi i të ardhurave nga taksa e tokës është në shumën 6,303,900 lekë, pra 4,703,900 lekë të ardhura planifikuar më pak, fakt që tregon se programimi i kësaj takse nuk është bërë mbi bazë reale. Nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjeve nuk janë bërë përditësimet e nevojshme të fondit të tokës bujqësore si dhe identifikimin dhe saktësimin e fermerëve taksapagues me qëllim përcaktimin e saktë të detyrimeve për taksën e tokës. Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nëpërmjet specialistëve të taksave në njësitë administrative nuk është bërë pune e mjaftueshme për rritjen e arkëtimeve të taksës së tokës, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.8752, datë 26.03.2021 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës" i ndryshuar, neni 11,12, me VKM nr.121, datë 17.02.2011 "Për mënyrat të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjen së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komuna dhe/ose bashki" i ndryshuar Kreu II "Detyrat dhe përgjegjësitë e DAMT-së për mbajtjen dhe ruajtjen dhe përtëritjen e dokumentacionit kadastral mbi tokën", me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, nenet 6 dhe 9 pika 1.3, me VKB nr. 90, datë 24.12.2024 "Mbi miratimin e paketës fiskale 2025 për Bashkinë Mat", dhe me Rregulloren e Bashkisë Mat. (*Më hollësisht është trajtuar në pikën (2.1), faqe (29-39), të Raportit të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nëpërmjet specialistëve të taksave në njësitë administrative të marrë masa që, në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë dhe Pyjeve të saktësojë të dhënat për planifikim real e të argumentuar të të ardhurave nga taksa e tokës, të përditësojë të dhënat mbi regjistrin e taksapaguesve fermerë, si dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksën e tokës bujqësore.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i aktiveve afatgjata jo materiale konstatohet se teprica e llogarisë 202 "Studime dhe Kërkime" në fund të vitit 2025 paraqitet 46,282,809 lekë që i përket 23 projekt-studimeve për investime të pakryera ose të kryera nga ish-komunat, të cilat duhet ishin shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale në rastin e investimeve të kryera. Gjithashtu për këto aktive nuk është llogaritur amortizimi në masën 15% që nga viti 2021, duke sjellë mbivlerësimin e tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II pika16/b.d, Kreu III. pika 36, Aneksi 1 pika 2 Klasa 2. (*Më hollësisht është trajtuar në pikën 3 faqe (39-52), të Raportit të Auditimit*).

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Monitorimit të Kontratave të kryejë inventarin fizik të studim-projektimeve të blera gjendje në llogarinë 202 "Studime dhe Kërkime", nëse është e mundur të bëjë shpërndarjen e vlerës së tyre, si vlerë e shtuar sipas llojit të

aktivit të kapitalizuar, të përllogarisë amortizimin për to sipas normës dhe metodës së miratuar, duke i kryer veprimet sistemuese kontabël në llogaritë përkatëse dhe të reflektohen edhe në tabelën shoqëruese përkatëse.

Deri me datë 31.03.2027

6. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrën e pozicionit financiar llogaria 231 "Për aktive afatgjata materiale" paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në shumën 1,273,157,999 lekë, ndërsa në llogaritë kundërparti të saj në rubrikën "Fondin e konsoliduar" paraqiten në shumën 347,639,031 lekë si: llogsria 105 "Teprica e granteve kapitale të brendshme" në shumën 347,639,031 lekë, llogaria 106 "Teprica e granteve kapitale të huaja" në shumën 0 lekë, llogaria 115 "Nga fondet e veta të investimeve" në shumën 0 lekë, pra llogaritë e shpenzimeve për investime duhet të kuadronin me llogaritë e burimeve të financimit. Diferenca prej 925,518,968 lekë është keqklasifikuar në llogarinë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar".
- Referuar analizës dhe lëvizjeve të llogarisë 231 "Për aktive afatgjata materiale" u konstatua se shtesat gjatë vitit 2025 janë në shumën 347,639,091 lekë dhe pakësimet në shumën 398,592,705 lekë, pakësime të cilat i përkasin mallrave, projekteve dhe punimeve të marra në dorëzim të kapitalizuara në llogaritë e klasës 2 të paraqitur në pasqyrën "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata" në shumën 382,209,312 sipas kolonës "Blerje e krijuar me pagesë" në shumën 87,824,122 lekë dhe kolonës "Lëvizje brenda aktiveve" në shumën 294,385,190 lekë. Pra veprimet kontabël në kredi të llogarisë 231"Për aktive afatgjata materiale" nuk rakordojnë me veprimet në debi pas kapitalizimeve me një diferencë në shumën 16,383,393 lekë.
- Në pasqyrën e investimeve dhe burimeve të investimeve tepricat e llogarisë 231"Për aktive afatgjata materiale" në fillim të vitit ushtrimor është në shumën 0 lekë, kur teprica e kësaj llogarie në pasqyrën e pozicionit financiar është në shumën 1,324,111,613 lekë. Teprica në fund të vitit ushtrimor është në shumën 0 lekë, kur teprica e kësaj llogarie në pasqyrën e pozicionit financiar është në shumën 1,273,011,812 lekë.
Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Aneksi 1. (*Më hollësisht është trajtuar në pikën 3 faqe (39-52), të Raportit të Auditimit*).
6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Monitorimit të Kontratave të marrë masa për sistemimin e veprimeve kontabël sipas llogarive përkatëse me qëllim paraqitjen sa më të drejtë të investimeve në proces dhe burimeve të investimeve që i përkasin njësisë për periudhën ushtrimore. Gjithashtu për diferencën e konstatuar prej 16,383,393 lekë të bëhet evidentimi dhe të kryhen sistemimet përkatëse në llogaritë kontabël të njësisë me qëllim paraqitjen e saktë të llogarisë 231 "Për aktive afatgjata materiale" dhe llogarive të klasës 2 në pasqyrën e pozicionit financiar, duke bërë që llogaritë e aktiveve afatgjata materiale të paraqiten në vlera të drejta dhe të rakorduar sipas kërkesave të teknikave kontabël.

Deri me datë 31.03.2027

7. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrën e pozicionit financiar, rubrika D "Fondi i Konsoliduar" t**e**prica e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" në mbyllje të vitit 2025 është në vlerën 4,487,502,890 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 3,946,656,640 lekë. Nga auditimi analitik i llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" u konstatua se vlera e paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar nuk rakordon me lëvizjet dhe sistemimet kontabël të kësaj llogarie. Nga rakordimi i çeljes me shtesat e aktiveve, ndryshimin e gjendjes së inventarit, amortizimin, kalimin e kapitalit dhe nxjerrjet jashtë përdorimit të aktiveve, teprica e llogarisë rezultoi në vlerën 4,234,530,751 lekë, ndërkohë që në pasqyrën e pozicionit financiar është paraqitur në vlerën 4,487,502,890 lekë, duke rezultuar një diferencë e parregulluar prej 252,971,539 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në njësitë e

qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar kap 1.1, kap 2.1, kap.3.1 dhe Aneksi 1. (*Më hollësisht është trajtuar në pikën 3 faqe (39-52), të Raportit të Auditimit*).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Monitorimit të Kontratave të marrë masa që të saktësojë llogarinë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar", e cila është mbivlerësuar për vlerën 252,971,539 lekë në fund të vitit 2025.

Deri me datë 31.03.2027

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së performancës u konstatua se ka pasaktësi në llogaritë:

- Gjendja e llogarisë 7200 "Grant korent i brendshëm nga buxheti për NJQP" paraqitet në shumën 330,175,288 lekë, ndërsa sipas seksionit 1 "Akordim fonde buxhetore për shpenzime korente" në pasqyrën e flukseve monetare paraqitet në shumën 738,510,054 lekë, ndërkohë që sipas akrakordimit me thesarin fondet e akorduara për shpenzime korente janë në shumën 394,644,154 lekë.
- Gjendja e llogarisë 600 'Paga, shpërblime e të tjera personeli" për vitin 2025 paraqitet në shumën 112,967,198 lekë, ndërsa nga përllogaritja rezultoi se shpenzimet e kryera në fakt të konstatuara janë në vlerën 113,947,057 lekë me një diferencë në vlerën 979,859 lekë, po kështu gjendja e llogarisë 601 'Kontribute për sigurime" për vitin 2025 paraqitet në shumën 18,694,876 lekë, ndërsa nga përllogaritja rezulton në shumën 18,822,418 lekë, me një deviacion në vlerën 127,542 lekë.
- Seksioni "Shpenzime të tjera" në mbyllje të vitit ushtrimor paraqitet në shumën 0 lekë, e cila nuk mund të jetë me këtë tepricë, pasi në seksionin "Shpenzime të tjera" evidentohen veprimet e korrigjimit të rezultatit dhe llogaritë duhet të rakordojnë me llogaritë në pasqyrën e flukseve monetare në rubrikën "Transferta të tjera", ku llogaria "Transferime në buxhet të fondeve të papërdorura" paraqitet në shumën 37,773,819 lekë dhe llogaria "Lëvizje e brendshme e transferta të tjera" në shumën 404,322,017 lekë.

Pasaktësia në paraqitjen e tepricave të këtyre llogarive ndikon në rezultatin e veprimtarisë së vitit ushtrimor 2025 dhe, për rrjedhojë, në paraqitjen e pozicionit financiar të subjektit në datën e mbylljes së pasqyrave financiare. Gjithashtu, këto mospërputhje nuk japin siguri të mjaftueshme mbi saktësinë dhe plotësinë e tepricave të transaksioneve që kanë shërbyer si bazë për përgatitjen e pasqyrës së flukseve monetare dhe pasqyrës së pozicionit financiar.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF me nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022, Aneksi 1, pika 4, faqe 48-51. (*Më hollësisht është trajtuar në pikën 3 faqe (39-52), të Raportit të Auditimit*).

8.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Monitorimit të marrë masa që në hartimin e pasqyrave financiare të sigurojë që të bëhet kontabilizimi i saktë i veprimeve me fondet dhe i transaksioneve financiare në llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve në pasqyrën e performancës, duke i rakorduar me Thesarin dhe me pasqyrat e tjera që lidhen me to.

Brenda datës 31.03.2027

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik, u konstatua se në 11 procedura nga 11 të audituara, njësia e prokurimit nuk ka argumentuar kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, duke rezultuar në parregullsi në hartimin e tyre, të cilat nuk janë në përputhje me tipologjinë dhe natyrën e objektit që prokurohet, konkretisht në procedurat me objekt si vijon: "Përshtatje për ambiente frigoriferike dhe punime meremetimesh në tregun fruta-perime, Burrel", viti 2023 me fond limit 24,999,999 lekë, "Rikonstruksion i pallatit të kulturës "Shefqet Doda" Burrel, Bashkia Mat", viti 2023 me fond limit 18,140,977 lekë, "Rikonstruksion rruga Lis", viti 2023 me fond limit 27,870,583 lekë, "Rikonstruksion rruga Qamil Xhika", viti 2023 me fond limit 19,971,512 lekë, "Rikonstruksion i ish-Hotelit të ish-Uzinës së Ferrokromit, në qytetin e Burrelit", viti 2023 me fond limit 61,212,916 lekë, "Rikonstruksion i plotë i shkollës së mesme "Pjetër Budi" + terrene sportive", viti 2023 me fond limit 79,060,800 lekë, "Rikonstruksion ure pasarel në fshatin Rreth-Baz, Njësia Administrative Baz, Bashkia Mat", viti 2023 me fond limit

15,315,674 lekë, "Rikualifikim urban i Bllokut "Lagje e re", viti 2023 me fond limit 27,617,117 lekë, "Asfaltim i rrugëve lidhëse në fshatrat e Njësive Administrative Burrel, Baz, Lis, Komsi, Rukaj", viti 2024 me fond limit 360,432,605 lekë, "Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit Shqefën", viti 2025 me fond limit 75,416,389 lekë, "Rikonstruksion shkolla e mesme e bashkuar "Abdyrrahman Permeti" Lis si dhe ndërtim ambienti sportiv brenda ambienteve te saj", viti 2025 me fond limit 94,203,705 lekë, në kundërshtim me nenin 36 dhe 77 të Ligj nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe nenet 39, 40 dhe 78 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 52-107 të Raportit të Auditimit*).

9.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Mat të marrë masa dhe të nxjerrë përgjegjësitë e parregullsive të konstatuara në hartimin e kritereve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kritere të veçanta për kualifikim, që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e objektit që prokurohet.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik, u konstatua se në 2 procedura me fond limit 54,909 mijë lekë, nga 11 procedura të audituara, janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, konkretisht janë deklaruar mjete të cilat nuk janë të regjistruar në regjistrat publikë dhe nuk disponon çertifikatën e pronësisë për dhënien me qira për të tretë, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik, konkretisht si vijon:

- Në procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksion rruga Lis", viti 2023 me fond limit 27,870,583 lekë, ku fitues është shpallur OE "L." Sh.p.k me vlerë kontrate 27,469,100 lekë.
- Në procedurën e prokurimit me objekt "Rikualifikim urban i Bllokut "Lagje e re", viti 2023 me fond limit 27,617,117 lekë, ku fitues është shpallur OE "N." Sh.p.k me vlerë kontrate 27,439,912 lekë.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me kërkesat e nenit 92, pika 3, nenit 99 pika 1 e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 52-107 të Raportit të Auditimit*).

10.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Mat, të analizojë arsyet e parregullsive në vlerësimin e ofertave nga KVO, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, rezultoi se në 2 procedura nuk është përdorur asnjë metodë për përllogaritjen e fondit limit; në 5 procedura nuk është administruar relacion teknik për përcaktimin e sasisë së mallrave objekt prokurimi; në 2 procedura NJP ka përcaktuar markën e produktit objekt prokurimi; në 2 procedura janë vendosur kritere të paargumentuara teknikisht dhe ligjërisht; si dhe në 7 procedura përbërja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO) nuk është në përputhje me legjislacionin për menaxhimin financiar dhe kontrollin, duke sjellë devijime nga parimet e transparencës, barazisë dhe konkurrencës në procedurat e prokurimit publik. Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 22, pika 5, Ligji për Prokurimin Publik neni 36, pika 4, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", neni 2, pika 2, gërma c, neni 74 pika 3, neni 76, neni 78, pika 2. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 52-107 të Raportit të Auditimit*).

11.1.Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor (Komisioni i Prokurimit të Blerjeve të Vogla), të marrë masa, që të sigurojë që çdo fazë e procedurave të prokurimit – nga planifikimi dhe argumentimi, deri te inventarizimi dhe arkivimi i dosjes – të jetë e dokumentuar dhe e justifikuar, me qëllim

forcimin e hallkave te kontrollit të brendshëm. Kriteret e kualifikimit të jenë të argumentuara dhe në raport me objektin, natyrën dhe volumin e kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i përputhshmërisë së dokumentacionit dhe procedurave të ndjekura për lejen e ndërtimit me objekt "Ndërtesë multifunksionale shërbim, biznes, banim 3 kat + 1 kat nëntokë", miratuar me vendimin nr. 579, datë 03.09.2025, me zhvillues Q. C., rezultoi së dokumentacioni i paraqitur në sistemin e-leje nuk është i plotë pasi mungon certifikata e performancës së energjisë, mungon deklarata e përgjegjësisë profesionale e hartuesit të raportit të auditimit të eficencës së energjisë, mungon deklarata e përgjegjësisë profesionale e hartuesve të studimit sizmologo – inxhinierik dhe gjeologo-inxhinierik, mungon studimi gjeologo-inxhinierik, policat e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e raportit të auditimit të eficencës së energjisë, njëkohësisht hartues i projektit elektrik, është jashtë afatit të mbulimit në raport me datën e aplikimit për pajisje me leje ndërtimi (26.06.2025), mungon projekti i gjelbërimit dhe projekti i mobilimit urban i hapësirave rekreative e argëtuese, si dhe Sektori i Planifikimit Urban dhe Mjedisit nuk ka kërkuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Sa më sipër, veprime janë në kundërshtim me VKM-në 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, neni 15, pika 1, 20, pika 4. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 137-141 të Raportit të Auditimit*).

12.1.Rekomandim: Sektori i Planifikimit Urban dhe Mjedisit në Bashkinë Mat, përpara miratimin të lejes së ndërtimit, të shqyrtojë të gjithë dokumentacionin teknik në lidhje me saktësinë dhe mangësi të tij, si dhe të verifikojë që i gjithë dokumentacioni që ka qenë pjesë e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për leje ndërtimit, të jetë pjesë e dosjes në sistemin elektronik e-leje, duke përfshirë edhe kontratat, marrëveshje, ose korrespondencat shkresore të realizuara ndërmjet institucioneve.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i certifikatave të përdorimit u konstatuan **2 praktika** tek të cilat dokumentacioni i ngarkuar në sistemin e-leje nuk paraqitet i plotë dhe ka mangësi lidhur me projektin "as build", me realizimin e objektit në përputhje me lejen e ndërtimit, si dhe me kryerjen e të gjitha verifikimeve të nevojshme përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, nëse ka pasur ndryshime/ devijime në zbatimin e punimeve të ndërtimit dhe nëse është respektuar destinacioni i objektit sipas lejes së ndërtimit të miratuar. Përkatësisht në certifikatat e përdorimit me objekt:

1. "Stallë për Gjedhë (Majmëri Vçash) 1 KT+Hangar 1KT + Zyra administrate 2 KT+Mur rrethues", me adresë fshati Zenisht, Njësia Administrative Lis, Bashkia Mat dhe subjekt zhvillues I. M., miratuar me vendimin nr. 368 Port., datë 23.05.2023;
2. "Godinë Banimi 2kt", me adresë rruga "Dalip Hysa" Njësia Administrative Burrel, Bashkia Mat dhe subjekt zhvillues E. D., miratuar me vendimin nr. 419 Port., datë 13.05.2024. Sa më sipër, veprime në kundërshtim me Ligjin 107/2014, datë 31.7.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, neni 42, neni 51; me VKM 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, neni 27, neni 27/1, neni 27/2; me Ligjin Nr.9780, datë 16.07.2007, "Për inspektimin e ndërtimit", Neni 10. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 137-141 të Raportit të Auditimit*).

13.1.Rekomandim: Sektori i Planifikimit Urban dhe Mjedisit në Bashkinë Mat të marrë masa për të shqyrtuar dhe verifikuar në sistemin e-Leje të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që kërkohet të paraqitet, vërtetësinë/saktësinë e tij, si dhe të kryej verifikimet në terren për realizimit e punimeve të zbatimit dhe të japë konformitetin për aktkontrollet e detyrueshme (përfundimi i karabinasë, i fasadave dhe sistemimit të jashtëm), që të jenë në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar.

13.2.Rekomandim: Sektori i Planifikimit Urban dhe Mjedisit në Bashkinë Mat, në bashkëpunim me strukturat e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të vijojnë me kontrolle të vazhdueshme në

terren përgjatë gjithë periudhës së zbatimit deri në përfundim të punimeve të ndërtimit dhe pas saj, në mënyrë që objekti i realizuar të mos pësoj ndryshime/ devijime nga leja e ndërtimit e miratuar dhe të ruaj të njëjtin destinacion sipas së cilit është miratuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit (IMT) në Bashkinë Mat rezulton se ka mangësi të theksuara në ushtrimin e funksioneve ligjore dhe administrative, si dhe në zbatimin e procedurave të inspektimit dhe ekzekutimit të vendimeve. Konkretisht, IMT nuk ka raportuar pranë IKMT për veprimtarinë vjetore të vitit 2025, nuk ka iniciuar në dy raste kërkesat për mbështetje pranë titullarit dhe organeve kompetente për ekzekutimin e urdhrave të prishjes së objekteve pa leje, si dhe nuk ka kryer kallëzime penale për subjektet përgjegjëse për ndërtim pa leje. Gjithashtu, janë konstatuar parregullsi në vendosjen e gjobave, ku në dy raste është përdorur bazë ligjore e shfuqizuar ose e pasaktë, duke sjellë akte absolutisht të pavlefshme ose të përllogaritura gabim. Në 6 raste mungon hartimi i procesverbaleve të konstatimit për kundërvajtjet, si dhe nuk është dokumentuar në mënyrë të plotë inspektimi i objekteve në ndërtim për verifikimin e zbatimit të kushteve të lejeve të ndërtimit, çka tregon parregullsi në kontrollin, dokumentimin dhe zbatimin e ligjit në fushën e inspektimit të territorit. Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar, neni 4, neni 5 pika a), b), dh), f) dhe neni 12 pika 5, si dhe Ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", neni 4 dhe neni 100, si dhe Ligji për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, neni 52 pika 7. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 142-145 të Raportit të Auditimit*)

14.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa për forcimin e funksionimit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit (IMT) në Bashkinë Mat, duke siguruar zbatimin e plotë të legjislacionit në fuqi për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit, përmes raportimit të rregullt të veprimtarisë pranë IKMT, dokumentimit të plotë të të gjitha inspektimeve dhe procedurave, si dhe respektimit të afateve dhe detyrimeve ligjore për ekzekutimin e vendimeve për prishjen e objekteve pa leje Gjithashtu, të përdoret baza ligjore e saktë në nxjerrjen e akteve administrative, si dhe të kallëzohen penalisht subjektet në rastet e ndërtimit pa leje, në përputhje me legjislacionin penal dhe administrativ në fuqi, me qëllim sigurimin e ligjshmërisë dhe efektivitetit të veprimtarisë së IMT-së.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurat e ndjekura për hipotekimin dhe vlerësimin e pronave të paluajtshme të listave përfundimtare të formularëve të inventarit të transferuara me VKM nga pushteti qendror u konstatua se Bashkisë Mat i janë transferuar në përdorim/pronësi 2,770 asete dhe 35160 ha pyje e kullota, nga të cilat ka të regjistruara dhe pajisur me certifikatë vetëm 273 asete, rrjedhimisht dhe të inventarizuara. Për pjesën tjetër të pasurive të pa luajtshme dhe parcelat nga fondi pyjor/kullosor nuk është kryer përditësimi i inventarit dhe nuk janë marrë masa për përgatitjen e dokumentacionit tekniko-ligjor të tyre për të vijuar me procesin e aplikimit dhe regjistrimit të tyre në Drejtorinë Vendore të ASHK-së Mat. Për këto asete mungon informacioni për gjendjen e tyre, nëse janë ende ekzistente, të zaptuara, të dëmtuara, në proces legalizimi nga individë etj. Gjithashtu nuk ka vlerësim të pasurive të paluajtshme si ato të certifikuara dhe ato të pa certifikuara, nuk janë vlerësuar dhe evidentuar në mënyrë të plotë si aktive në pasqyrat financiare, duke ndikuar në paraqitjen e gjendjes reale të pasurisë së njësisë vendore. Bashkia Mat nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për regjistrimin dhe hipotekimin e aktiveve afatgjata materiale në pronësi të saj, ndërkohë që regjistrimi dhe kontabilizimi i tyre nuk është mbështetur në dokumentacion të plotë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.20/2020, datë 05.03.2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", Kreu IV "Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike" nenet 35-4, me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011

"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, Kreu I, pika 4, Kreu III, pika 35. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 145-148 të Raportit të Auditimit*).

Rekomandimi 15.1. Bashkia Mat, nëpërmjet strukturave drejtuese dhe përgjegjëse, të marrë masa për identifikimin dhe evidentimin e aktiveve të mbetura pa regjistruar, të cilat i janë transferuar në pronësi në mënyrë përfundimtare, si dhe të vijojë me përgatitjen e dokumentacionit tekniko-ligjor për secilin prej tyre, me qëllim kryerjen e procedurave të regjistrimit.

Menjëherë

Rekomandimi 15.2: Bashkia Mat të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për pasuritë e paluajtshme (AAGJM) të evidentuara në pasqyrat financiare dhe të vijojë me paraqitjen e aplikimeve përkatëse pranë ASHK-së për regjistrimin dhe pajisjen me certifikatë pronësie, me qëllim dokumentimin e plotë të pronësisë dhe sigurimin e paraqitjes së saktë të këtyre aktiveve në pasqyrat financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se Bashkia Mat nuk ka përcjellë në Kontrollin e Lartë të Shtetit raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor të përcaktuar në legjislacionin në fuqi, duke mos respektuar detyrimet ligjore për raportimin dhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit si dhe nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e përcaktuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe anekset përkatëse, pasi nuk ka ndjekur në mënyrë të plotë procedurat administrative dhe ligjore për marrjen e masave korrigjuese. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomandua 16 masa organizative të rekomanduara dhe të pranuara për zbatim, vetëm 2 masa rezultojnë të zbatuara, 10 masa janë në proces zbatimi, 2 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 2 masa nuk janë zbatuar, nga të cilat rekomandimi 1.1, 2.1, 3.1, 8.1 dhe 9.1 nuk rikërkohen pasi janë pjesë e gjetjeve të sipërcituara. Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me: Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 30, pika 2. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 149-155 të Raportit të Auditimit*).

16.1.Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

Për 2 masë organizative

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Kontratave të marrë masat e nevojshme për kryerjen e regjistrimeve kontabël dhe rakordimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për investime me qëllim pasqyrimin sa më të sakte në pasqyrat financiare.

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Kontratave të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, për një pasqyrim më të drejtë të pasqyrës së investimeve dhe burimeve të investimeve me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 shkronja "b" dhe "c" -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të Ligjit nr. 44, datë 30/4/2015, "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", dhe pikën 93 të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Mat), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për

shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **6,117,898 lekë pa TVSh**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "**Ndërtimi i rrugës Varrezat e qytetit – fshati Batër e Vogël, Faza I" Bashkia Mat**, rezultoi se në përfundim të procedurës përkatëse të prokurimit është lidhur kontrata e sipërmarrjes më nr. 887., prot datë 24.02.2023, me vlerë 32,415,101 lekë me TVSH, ndërmjet AK Bashkia Mat dhe OE "K." SHPK me afat 5 muaj. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga krahasimi i volumeve të paraqitura në situacionin përfundimtar, librezën e masave dhe vizatimeve sipas faktit, si dhe nga verifikimi në terren, janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit shuma prej **577,390 lekë pa TVSH** në 5 zëra punimesh. Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve OE "E." ShPK, nuk ka zbatuar me rigorozitet përcaktimet kontraktuale dhe ligjore sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit". (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 , faqe 108-136, të Raportit të Auditimit*).
1.1. Rekomandim: Bashkia Mat, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore, si dhe procedurat në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **577,390 lekë pa TVSH**, nga OE "K." SHPK, për diferencat e konstatuara në volumet e punimeve të likuiduara dhe të pakryera në fakt.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "**Rikonstruksioni i ish hotelit të ish Uzinës së Ferrokromit në qytetin e Burrelit" Bashkia Mat**, rezultoi se në përfundim të procedurës përkatëse të prokurimit është lidhur kontrata e sipërmarrjes më nr. 6332 prot., datë 30.11.2023, me vlerë 73,265,133 lekë me TVSH, ndërmjet AK Bashkia Mat dhe OE "C." SHPK me afat 6 muaj. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga krahasimi i volumeve të paraqitura në situacionin përfundimtar, librezën e masave dhe vizatimeve sipas faktit, si dhe nga verifikimi në terren, janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit shuma prej **1,672,568 lekë pa TVSH** në 6 zëra punimesh. Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve OE "N." ShPK, nuk ka zbatuar me rigorozitet përcaktimet kontraktuale dhe ligjore sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit". (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 , faqe 108-136, të Raportit të Auditimit*).
2.1. Rekomandim: Bashkia Mat, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore, si dhe procedurat në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **1,672,568 lekë pa TVSH**, nga OE "C." SHPK, për diferencat e konstatuara në volumet e punimeve të likuiduara dhe të pakryera në fakt.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "**Rikonstruksioni i rrugës Lis" Bashkia Mat**, rezultoi se në përfundim të procedurës përkatëse të prokurimit është lidhur kontrata e sipërmarrjes më nr. 957 prot datë 01.03.2023, me vlerë 32,962,920 lekë me TVSH, ndërmjet AK Bashkia Mat dhe OE "L." SHPK me afat 7 muaj. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga krahasimi i volumeve të paraqitura në situacionin përfundimtar, librezën e masave dhe vizatimeve sipas faktit, si dhe nga verifikimi në terren, janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit shuma prej **977,180 lekë pa TVSH** në 2 zëra punimesh. Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve OE "E." ShPK, nuk ka zbatuar me rigorozitet përcaktimet kontraktuale dhe ligjore sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë

15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit". (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 , faqe 108-136, të Raportit të Auditimit*).

3.1. Rekomandim: Bashkia Mat, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore, si dhe procedurat në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **977,180 lekë pa TVSH**, nga OE "L." SHPK, për diferencat e konstatuara në volumet e punimeve të likuiduara dhe të pakryera në fakt.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "**Rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare "Ali Metra" Komsi dhe sistemi i ngrohjes + ndërtim palestre" Bashkia Mat**, rezultoi se në përfundim të procedurës përkatëse të prokurimit është lidhur kontrata e sipërmarrjes më nr. 1638/11 prot datë 28.06.2024, me vlerë 105,215,770.96 lekë me TVSH, ndërmjet AK Bashkia Mat dhe OE "U." SHPK me afat 6 muaj. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga krahasimi i volumeve të paraqitura në situacionin përfundimtar, librezën e masave dhe vizatimeve sipas faktit, si dhe nga verifikimi në terren, janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit shuma prej **391,447 lekë pa TVSH** në 4 zëra punimesh. Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve OE "E." ShPK, nuk ka zbatuar me rigorozitet përcaktimet kontraktuale dhe ligjore sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit". (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 , faqe 108-136, të Raportit të Auditimit*).

4.1. Rekomandim: Bashkia Mat, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore, si dhe procedurat në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **391,447 lekë pa TVSH**, nga OE "U." SHPK, për diferencat e konstatuara në volumet e punimeve të likuiduara dhe të pakryera në fakt.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Banesa Sociale me qira, adoptim i objektit ekzistues (Rikonstruksion i ish-shtëpisë së ushtarakëve), Burrel, me vlerë të kontratës (pa TVSH) 68,973,645 lekë, realizuar nga BOE "A." shpk & "Z."shpk., rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **2,190,800 lekë pa TVSH, përkatësisht për zërat e punimeve: "**2.37/3a-Transport materiale ndërtimi, dheu me auto ÷5.0 km","2.84-Mur me tulle me vrima, t=10cm, h~3m, llaç përzier M15", "2.262/3-Shtrese betoni C 12/15 t-10 cm", "2.196/c-Hidroizolim me dy shtresa mapej", "2.324/b-Plintuse grez importi, h = 10 cm", "2.273/1-Davancale mermeri t = 3 cm (dyer + dritare)","2.575-Pusetë kontrolli 1x1x1.5m për kanalizimet e ujerave të zeza" dhe "2.410/a-Parapet Pandusi me tuba inoksi h=80~90 cm"**.** Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve OE "T." ShPK, nuk ka zbatuar me rigorozitet përcaktimet kontraktuale dhe ligjore sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit". (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 , faqe 108-136, të Raportit të Auditimit*).

5.1 Rekomandimi: Bashkia Mat, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore, si dhe procedurat në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **2,190,800 lekë pa TVSH,** nga BOE "A.".shpk & "Z.".shpk, për diferencat e konstatuara në volumet e punimeve të likuiduara dhe të pakryera në fakt.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Rikonstruksion i plotë i shkollës së mesme "Pjetër Budi" + terrene sportive", Burrel, Bashkia Mat; me vlerë të kontratës (pa TVSH) 91,182,262.17 lekë, realizuar nga OE "U." ShPK., rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **308,513 lekë pa TVSH, përkatësisht për zërat e punimeve: "**3.158/5a+An-Transport materiale ndërtimi, dheu me auto ÷5.0 km", "2.324/2-

F.V Plintus mermeri t=10cm", "An-F.V rezervuari zingato 5000 litra" dhe "Anal-Ndricues led 60x60 për klasat**.** Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve OE "E."ShPK, nuk ka zbatuar me rigorozitet përcaktimet kontraktuale dhe ligjore sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit". (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 , faqe 108-136, të Raportit të Auditimit*).

6.1 Rekomandimi: Bashkia Mat, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore, si dhe procedurat në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **308,513 lekë pa TVSH,** nga OE "U." sh.p.k, për diferencat e konstatuara në volumet e punimeve të likuiduara dhe të pakryera në fakt.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion rezultoi se ka nivel të lartë debitorësh në numër dhe në vlerë për taksat dhe tarifat vendore. Debitorët për biznesin të raportuara nga DTV, evidentuar dhe në kontabilitet në fund të vitit 2024 është 73,841,616 lekë, shtesat gjatë vitit 2025 janë në shumën 47,101,566 lekë, janë kryer arkëtime në shumën 59,407,642 lekë. Detyrimet progresive për taksa dhe tarifa vendore në fund të vitit 2025 janë në shumën 61,535,540 lekë, e cila përbëhet nga:

- Debitorë për taksa e tarifa vendore nga biznesi dhe institucionet në shumën 52,642,762 lekë.
- Debitorë për taksa e tarifa vendore të trashëguara nga ish-komunat në shumën 8,892,778 lekë.

Mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga taksapaguesit debitorë ka sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Mat në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, nenet 6 dhe 9/pika 1.3.

Nga Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Mat për vjeljen e detyrimeve janë mjaftuar vetëm me nxjerrjen e njoftim-vlerësimeve për detyrimin dhe një numri të kufizuar të masave shtrënguese dhe nuk janë aplikuar të gjitha masat administrative dhe ligjore, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91 dhe 93 dhe me paketën fiskale. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 29-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët dhe në vijim të ndjekë të gjitha rrugët ligjore në rend shterues, për arkëtimin e detyrimeve debitore në shumën **61,535,540 lekë** nga subjektet e biznesit dhe institucionet.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për taksapaguesit e kategorisë "familjar" rezultoi se debitorët për këtë kategori në fund të vitit 2025 janë në shumën 62,006,212 lekë, i cili nga viti në vit ka ardhur duke u rritur edhe pse nga DTTV janë dërguar njoftim-pagese drejt 5226 familjeve debitore. Kështu në fund të vitit 2024 debitorët familjarë ishin në shumën 43,562,163 lekë, gjatë vitit 2025 shuma e detyrimit të krijuar është 18,444,049 lekë. Mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga debitorët familjarë ka sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat. Detyrimet nga taksat dhe tarifat vendore për familjet në shumën 62,006,212 lekë nuk janë kontabilizuar në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" në pasqyrat financiare të vitit 2025, pasi ka ardhur si pasojë e mos evidentimit të plotë taksapaguesve familjarë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF

vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kap. III, pika 3.2, me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Kreu XI, nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, me ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10 dhe me paketën fiskale. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 29-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me administratorët e njësive administrative të krijojnë një regjistër të plotë të taksapaguesve familjarë, duke evidentuar detyrimet dhe debitë e tyre, duke i pasqyruar dhe në kontabilitet. Të ndiqen të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve në shumën 62,006,212 lekë të taksapaguesve familjarë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit dhe të dhënave të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore u konstatua se detyrimet për taksën në infrastrukturë nga legalizimet e ndërtimeve pa leje në fund të vitit 2024 kanë qenë në shumën 3,768,709 lekë. Gjatë vitit 2025 janë legalizuar 37 objekte me vlerë totale të detyrimit 1,256,968 lekë, ndërsa arkëtimet janë në shumën 1,325,882 lekë. Në fund të vitit 2025 rezulton të jenë debitorë 54 individë në shumën 3,699,795 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Mat. Mos arkëtimi i detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë është në kundërshtim VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave vendore", i ndryshuar, neni 27, pika 3 dhe me paketën fiskale. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 29-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi: Bashkia Mat nëpërmjet Drejtorisë së Taksave e Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës të marrin masa që të zbatohen të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit në shumën 3,699,795 lekë.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se 2 subjekte qe ushtrojnë aktivitet të tregtimit të karburanteve me seli në territorin e Bashkisë Mat, nuk kanë likuiduar vlerën e plotë të detyrimeve duke mbetur debitorë në shumën 600,000 lekë: Shoqëria "P. 2015" në shumën 400,000 lekë dhe shoqëria "J." në shumën 200,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë. Këto veprime janë në papajtueshmëri me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" neni 22, pika 3, germa "dh" me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, neni 35, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa "b", dhe pika 9. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 29-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore të marrë masa që të zbatohen të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin nga 2 subjektet debitore të vlerës 600,000 lekë e tarifës së autorizim/licencës të tregtimit të karburanteve.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT